PËR MËSUESIN/EN

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Diana Duraku, Abetare Rexha,
Antonija Bytyqi, Arbnesha Shehu

# MATEMATIKA

Për klasën e parë të arsimit fillor

1

# PËRMBAJTJA


Udhërrëfyes ..... 7
Hyrje ..... 9
Planifikimi vjetor ..... 20
Plani dymujor: shtator—tetor ..... 21
Plani dymujor: nëntor—dhjetor ..... 26
Plani dymujor: janar—shkurt—mars ..... 30
Plani dymujor: prill—maj—qershor ..... 36
Mësimi 1: Orientimi ..... 42
Mësimi 2: Mirë se vini në klasën e parë ..... 44
Mësimi 3: Duke ngjyrosur, zbulojmë objektet ..... 46
Mësimi 4: Kuptimet: para, pas, mbi dhe nën ..... 48
Mësimi 5: Kuptimet: para, pas, mbi dhe nën/U ..... 50
Mësimi 6: Kahet e lëvizjes: lart, poshtë, djathtas, majtas ..... 52
Mësimi 7: Kahet e lëvizjes: lart, poshtë, djathtas, majtas/U ..... 54
Mësimi 8: Kuptimet: më i madh (e madhe), më i vogël (e vogël) ..... 56
Mësimi 9. Kuptimet: brenda, jashtë dhe në ..... 58
Mësimi 10: Bashkësia, elementet e bashkësisë ..... 60
Mësimi 11: Numërimi i elementeve që formojnë një bashkësi ..... 62
Mësimi 12: Bashkësia, elementet e bashkësisë/U ..... 64
Mësimi 13: Paraqitja e bashkësisë me diagram ..... 66
Mësimi 14: Paraqitja e bashkësisë me diagram/U ..... 68
Mësimi 15: Numri i elementeve të bashkësisë ..... 70
Mësimi 16: Numri i elementeve të bashkësisë/U ..... 72
Mësimi 17: Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve ..... 74
Mësimi 18: Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve/U ..... 76
Mësimi 19: Formimi i bashkësisë nga dy bashkësi të dhëna ..... 78
Mësimi 20: Detyra për përsëritje ..... 80
Mësimi 21: Kuptimet: Më shumë se, më pak se dhe aq sa ..... 82
Mësimi 22: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 84
Mësimi 23: Numri një ..... 86
Mësimi 24: Numri dy ..... 88
Mësimi 25: Numri tre ..... 90
Mësimi 26: Numrat 1, 2 dhe 3/U ..... 92
Mësimi 27: Numrat 1, 2 dhe 3/U ..... 94
Mësimi 28: Numri katër ..... 96
Mësimi 29: Numri katër/U ..... 98
Mësimi 30: Numri zero ..... 100
Mësimi 31: Numrat deri në katër/U ..... 102
Mësimi 32: Shenjat: më e madhe, më e vogël ..... 104
Mësimi 33: Shenja e barazimit ..... 106
Mësimi 34: Shenjat <, > dhe =/U ..... 108
Mësimi 35: Mbledhja e numrave ..... 110
Mësimi 36: Mbledhja e numrave deri në 4/U ..... 112
Mësimi 37: Mbledhja e numrave deri në 4 ..... 114
Mësimi 38: Zbritja e numrave ..... 116
Mësimi 39: Zbritja e numrave/U ..... 118

Mësimi 40: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 4 - Detyra për përsëritje ..... 120
Mësimi 41: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 122
Mësimi 42: Numri pesë ..... 124
Mësimi 43: Numrat deri në 5/U ..... 126
Mësimi 44: Mbledhja e numrave deri në 5 ..... 128
Mësimi 45: Mbledhja e numrave deri në 5/U ..... 130
Mësimi 46: Zbritja e numrave deri në 5 ..... 132
Mësimi 47: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 5/U ..... 134
Mësimi 48: Detyra për përsëritje ..... 136
Mësimi 49: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 138
Mësimi 50: Vijat e drejta dhe të lakuara ..... 140
Mësimi 51: Pika si prerje e vijave ..... 142
Mësimi 52: Vijat e hapura dhe të mbyllura ..... 144
Mësimi 53: Segmenti/U ..... 146
Mësimi 54: Figurat dhe format e njëjta ..... 148
Mësimi 55. Vijat, figurat dhe format e njëjta/U ..... 150
Mësimi 56: Numri gjashtë ..... 152
Mësimi 57: Numri shtatë ..... 154
Mësimi 58: Numri 6 dhe 7/U ..... 156
Mësimi 59: Mbledhja e numrave deri në 7 ..... 158
Mësimi 60: Mbledhja e numrave deri në 7/U ..... 160
Mësimi 61. Zbritja e numrave deri në 7 ..... 162
Mësimi 62: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 7/U ..... 164
Mësimi 63: Detyra për përsëritje ..... 166
Mësimi 64: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 168
Mësimi 65: Numri tetë ..... 170
Mësimi 66: Numri tetë/U ..... 172
Mësimi 67: Numri nëntë ..... 174
Mësimi 68: Numri nëntë/U ..... 176
Mësimi 69: Detyra për përsëritje ..... 178
Mësimi 70: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9 ..... 180
Mësimi 71: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9/U ..... 182
Mësimi 72: Detyra për përsëritje ..... 184
Mësimi 73: Detyra për përsëritje ..... 186
Mësimi 74: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 188
Mësimi 75: Shuma e tre numrave ..... 190
Mësimi 76: Shuma e tre numrave/U ..... 192
Mësimi 77: Ndryshimi i tre numrave ..... 194
Mësimi 78: Ndryshimi i tre numrave/ U ..... 196
Mësimi 79: Numri dhjetë ..... 198
Mësimi 80: Numrat deri në dhjetë/U ..... 200
Mësimi 81: Detyra për përsëritje ..... 202
Mësimi 82: Paraqitja e numrave në boshtin numerik ..... 204
Mësimi 83: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10 ..... 206
Mësimi 84: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10/U ..... 208
Mësimi 85: Zbatimi i mbledhjes dhe i zbritjes ..... 210
Mësimi 86: Detyra për përsëritje ..... 212
Mësimi 87: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 214

Mësimi 88: Edhe matematika është zbavitje ..... 216
Mësimi 89: Detyra për përsëritje ..... 218
Mësimi 90: Paraja – Euro ..... 220
Mësimi 91: Paraja – Euro/U ..... 222
Mësimi 92: Paraja – Euro/U ..... 224
Mësimi 93: Figurat – format dhe ngjyrat ..... 226
Mësimi 94: Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit ..... 228
Mësimi 95: Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit/U ..... 230
Mësimi 96: Figurat në formë të trekëndëshit dhe të katrorit ..... 232
Mësimi 97: Figurat në formë të trekëndëshit dhe të katrorit/U ..... 234
Mësimi 98: Detyra për përsëritje ..... 236
Mësimi 99: Simetria dhe drejtëza e simetrisë ..... 238
Mësimi 100: Simetria dhe drejtëza e simetrisë/U ..... 240
Mësimi 101: Simetria dhe drejtëza e simetrisë/U ..... 242
Mësimi 102: Për sa është një numër më i madh se tjetri? ..... 244
Mësimi 103: Për sa është një numër më i madh se tjetri?/U ..... 246
Mësimi 104: Për sa është një numër më i vogël se tjetri? ..... 248
Mësimi 105: Për sa është një numër më i vogël se tjetri?/U ..... 250
Mësimi 106: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 252
Mësimi 107: Edhe matematika është zbavitje ..... 254
Mësimi 108: Detyra për përsëritje ..... 256
Mësimi 109: Shuma dhe mbledhorët ..... 258
Mësimi 110: Shuma dhe mbledhorët/U ..... 260
Mësimi 111: I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi ..... 262
Mësimi 112: I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi/U ..... 264
Mësimi 113: Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve ..... 266
Mësimi 114: Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve/U ..... 268
Mësimi 115: Lidhja në mes mbledhjes dhe zbritjes ..... 270
Mësimi 116: Lidhja në mes mbledhjes dhe zbritjes /U ..... 272
Mësimi 117: Zbërthimi i numrave në mbledhorë ..... 274
Mësimi 118: Zbërthimi i numrave në mbledhorë/U ..... 276
Mësimi 119: Detyra për përsëritje ..... 278
Mësimi 120: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 280
Mësimi 120: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 282
Mësimi 122: Numrat prej 11 deri në 20 ..... 284
Mësimi 123: Numrat prej 11 deri në 20/U ..... 286
Mësimi 124: Mbledhja e numrave deri në 20 ..... 288
Mësimi 125: Mbledhja e numrave deri në 20/U ..... 290
Mësimi 126: Zbritja numrave deri në 20 ..... 292
Mësimi 127: Zbritja e numrave deri në 20/U ..... 294
Mësimi 128: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20 ..... 296
Mësimi 129: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20/U ..... 298
Mësimi 130: Detyra për përsëritje ..... 300
Mësimi 131: Zbatimi i mbledhjes dhe zbritjes në problema ..... 302
Mësimi 132: Detyra lidhur me mbledhjen dhe zbritjen/U ..... 304
Mësimi 133: Detyra për përsëritje ..... 306
Mësimi 134: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 308
Mësimi 135: Kubi dhe kuboidi ..... 310
Mësimi 136: Kubi dhe kuboidi/U ..... 312

Mësimi 137: Cilindri, koni dhe sfera ..... 314
Mësimi 138: Cilindri, koni dhe sfera /U ..... 316
Mësimi 139: Kllapat ..... 318
Mësimi 140: Kllapat /U ..... 320
Mësimi 141: Detyra për përsëritje ..... 322
Mësimi 142: Mbledhja e numrave duke plotësuar 10 ..... 324
Mësimi 143: Mbledhja e numrave duke plotësuar 10/U ..... 326
Mësimi 144: Mbledhja e numrave duke plotësuar 10/U ..... 328
Mësimi 145: Mbledhja e numrave duke plotësuar 10/U ..... 330
Mësimi 146: Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes ..... 332
Mësimi 147: Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes/U ..... 334
Mësimi 148: Zbritja e numrave, pa e prishur dhjetëshen ..... 336
Mësimi 149: Zbritja e numrave, pa e prishur dhjetëshen/U ..... 338
Mësimi 150: Zbritja e numrave, duke veçuar dhjetëshen ..... 340
Mësimi 151: Zbritja e numrave, duke veçuar dhjetëshen/U ..... 342
Mësimi 152: Zbritja e shumës ..... 344
Mësimi 153: Zbritja e shumës/U ..... 346
Mësimi 154: Detyra për përsëritje ..... 348
Mësimi 155: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 350
Mësimi 156: Edhe matematika është zbavitje ..... 352
Mësimi 157: Zbatimi i mbledhjes dhe i zbritjes në problema ..... 354
Mësimi 158: Numrat çift dhe tek ..... 356
Mësimi 159: Numrat çift dhe tek/ U ..... 358
Mësimi 160: Detyra për përsëritje ..... 360
Mësimi 161: Kuptimi i numrave rendorë ..... 362
Mësimi 162: Paraardhësi dhe pasardhësi i një numri ..... 364
Mësimi 163: Paraardhësi dhe pasardhësi i një numri/U ..... 366
Mësimi 164: Grumbullimi dhe paraqitja e të dhënave ..... 368
Mësimi 165: Puna me të dhëna/U ..... 370
Mësimi 166: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 372
Mësimi 167: Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij ..... 374
Mësimi 168: Të gjejmë numrin e panjohur ..... 376
Mësimi 169: Të gjejmë numrin e panjohur/U ..... 378
Mësimi 170: Detyra për përsëritje ..... 380
Mësimi 171: Kuptimi i jobarazimit dhe i zgjidhjes së tij ..... 382
Mësimi 172: Kuptimi i jobarazimit dhe i zgjidhjes së tij ..... 384
Mësimi 173: Të gjejmë numrat e panjohur ..... 386
Mësimi 174: Edhe matematika është zbavitje ..... 388
Mësimi 175: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 390
Mësimi 176: Gjysma ..... 392
Mësimi 177: Çereku ..... 394
Mësimi 178: Matja e gjatësisë ..... 396
Mësimi 179: Matja e gjatësisë/U ..... 398
Mësimi 180: Matja e gjatësisë/U ..... 400
Mësimi 181: Detyra për përsëritje ..... 402
Mësimi 182: Vlerësojmë të kuptuarit ..... 404
Mësimi 183: Zbatimi i matjeve në problema ..... 406
Mësimi 184: Detyra për përsëritje ..... 408
Mësimi 185: Njehsojmë me numrat deri në 20/U ..... 410

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehi të të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënit dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

# UDHËRRËFYES

## për konceptimin e mësimeve model

### Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.

Mësimi synon që përmes rezultateve të të nxënit të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Mësimi 61

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: I Klasa: I
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahasimin numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,II.2,8; III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,4; 3.1,3,4,5; 6.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave deri në 7

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcaktohen numrin e elementeve në shembujt e dhënë;
- Gjen ndryshimin e numrave deri në 7;
- Shpjegojnë me fjalë mënyrën e zgjidhjes së detyrës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Petiza, kube, fasule, etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sporte dhe shëndetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të vendosin mbi bankë dy katrorë të kuq dhe pesë katrorë të kuq.
Paraqitet shuma në tabelën magnetike.
Pyetën nxënësit:
Sa katrorë kemi mbi bankë? (*Shtatë*) Një përgjigje e mundshme. Ngritheë një nxënës dhe vendos etiketën me numrin 7.
Po t'i hoqim katrorët e kuqërr, sa katrorë do të mbetën? (Pesë) Nxënës të thonë gjithnjë ishin 7 katrorë, i hoqa 2 të kuqërr mbetën 5 të kuq. Nxënësit e paraqesin aktivitetin me fjalë matematikë si 7 - 2 = 5.
Përsëritën veprimet duke larguar 5 katrorë të kuq.

Për mësuesin/en

162

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes duke ia bërë më të lehtë atë.

Të gjitha mjetet dhe materialet, e çdo lloji, që shërbejnë për konkretizim në ndihmë të të nxënit.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera të cilat evidentohen.

Metodologjia e mësimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

### Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësimdhënësin gjatë përgatitjes duke ia bërë më të lehtë atë.

Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësimdhënësit në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mësimit.

Për të përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mësimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.


Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vërejnë figurat e detyrës 1 dhe përmes pyetjeve nxiten të gjejnë numrin e elementeve, p.sh.:
Çfarë ka në figurë? Sa qiriq janë ndezur? Çfarë duhet të gjejmë? Sa qiriq mbetën pa u ndezur? (7-2=5).
Vazhdohet veprimi i njëjtë me figurat e tjera.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të bashkojnë fushet e numrave në detyrën 2, për të krijuar barazime të sakta.

Erdhetat me barazime vendosen në tabelë dhe lexohen nga nxënësit, të cilat më pas shkruhen në fletore.

Hapi 4: Udhëzohen të plotësojnë detyrën 4 duke njehsuar ushtrimet dhe ngjyrosur kutitat.

Hapi 5: Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura me ushtrime, të cilat plotësohen në mënyrë të pavarur.
Më pas shpjegojnë me fjalë mënyrën e zgjidhjes së detyrave.

7 - 4 = _____ 7 - 4 = _____

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, përcaktimin e saktë të numrit të elementeve dhe për saktësinë me të cilën plotësojnë detyrat me zbritjen e numrave deri në shtatë.

Detyrë:
Të plotësohet ushtrimi 3 nga libri.

Refleksion për rezultatin e orës mësimore:

Për mësuesin/en

163

Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimit, ku përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënët bëhet më tërheqës dhe nxënësit janë aktivë në përfshirjen gjatë veprimtarive të ndryshme.

Veprimtaritë në këtë hap, a hapa të mësimit, udhëhiqen nga mësimdhënësi dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që të vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

## Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

**Rezultatet e të nxënit të temës:** Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese në Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore, mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore, kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

**Rezultatet e të nxënit:** Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënit të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

**Kriteret e vlerësimit/suksesit:** Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës-hapat e zhvillimit të mësimit:** Meqenëse fëmijët e klasës së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, së këndejmi edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, prandaj mësimi kalon përmes hapave.

***Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?***



Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë, kështu që bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura jepen së bashku njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesi duhet të ndërtojë mësimin mbi të mëparshmen dhe të ketë parasysh se çfarë mund të vijojë. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të ecur më tej përpara.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilët sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

**Hyrje:** Identifikohen njohuritë dhe shprehitë fillestare të nxënësve që të nxitet interesi i tyre për mësimin. Pjesa kryesore e mësimit. Mësuesi përmes përdorimit të teknikave të ndryshme synon ta bëjë tërheqës të nxënët e mësimit përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, si: figura, tabela, foto, video dhe të tjera.

**Praktikë e udhëhequr:** Veprimtaritë në këtë etapë të mësimit kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

**Praktikë e pavarur:** Nxënësit inkurajohen që të vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

# HYRJE

## Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin

## MATEMATIKA 1

*Fusha e matematikës* ka si qëllim t`i pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë për strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve në jetën e përditshme. Matematika promovon përvetësimin themelor të koncepteve matematike, përforcim dhe zhvillim, në identifikimin e simboleve, kryerjen e veprimeve themelore, matje me instrumente jo-standarde dhe standarde, formën e figurave dhe trupave gjeometrikë, grumbullimin e të dhënave, leximin dhe paraqitjen e grafikëve të thjeshtë, si dhe vendosjen e një baze të njohjes dhe qëndrimeve pozitive ndaj matematikës.

*Fusha e matematikës,* gjithashtu ka si qëllim zhvillimin e aftësive, shkathtësive dhe shprehive të nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integrimit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.

Po ashtu edhe njëri nga qëllimet e fushës së matematikës është funksionalizimi i dijeve përmes integrimit të saj në të gjitha fushat, lidhjet ndërkurrikulare dhe arsimimin e qëndrueshëm, me anë të të cilave zotërohen kompetencat kryesore.

### Udhëzime metodologjike

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e parë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësuesi/ja është i lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodat dhe teknikat e punës me nxënës lipset të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënit dhe të zbatimit në jetën e përditshme.

### Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Libri që keni në duar, është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathësive. Këtu trajtohen temat mësimore në përputhje me "Kurrikulën Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënit të fushës, rezultatet specifike të të nxënit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe dështimet, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është bërë kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - pro-

cedurave të mësimdhënies dhe të të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet 'trekëndëshi magjik'. Trekëndëshi paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.




*Burimi: Nga Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE*

***Zgjeroni dhe thelloni dijet*** *Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: CDE, faqe 101-128.*

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, i cili ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues, është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e Zhvillimit Proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultat.

***Zgjeroni dhe thelloni dijet*** *Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 47-51.*




*Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE*

Sipas Piazhesë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgim. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi i tyre në mënyrë sistematike, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit të nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuara në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar kontribuojnë, japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve si edhe formimin e shprehive.

***Zgjeroni dhe thelloni dijet*** *Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 32-36.*

## Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

| I | Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv |
|---|---|
| 1. | Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës. |
| 2. | Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar. |
| 3. | Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |
| 4. | Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur. |
| 5. | Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit. |
| 6. | Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që janë të përshatshme për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët. |
| 7. | Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve. |
| 8. | Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimit të një tregimi, shikimit apo performimit të një vallëzimi, dëgjimit apo performimit të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse. |
| 9. | Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë. |

| II. | Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ |
|---|---|
| 1. | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |
| 2. | Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një probleme matematike (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. |
| 3. | Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet. |
| 4. | Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësuesi/ja duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. |
| 5. | Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese të dhëna si detyrë dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku. |
| 6. | Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse. |
| 7. | Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna. |
| 8. | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |

| III. | Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm |
|---|---|
| 1. | Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. |
| 2. | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| 3. | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. |
| 4. | Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. |
| 5. | Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë apo aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë. |
| 6. | Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale. |
| 7. | Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla dhe informata gjatë hasjes së vështirësive. |

| IV. | Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv |
|---|---|
| 1. | Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre. |
| 2. | Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). |
| 3. | Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar. |
| 4. | Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup. |
| 5. | Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet. |
| 6. | Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes. |

| V. | Kompetenca personale – Individ i shëndoshë |
|---|---|
| 1. | Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron. |
| 2. | Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet). |
| 3. | Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si shkrim, vizatim etj.) me ushqimet të cilat i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre. |
| 4. | Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët. |
| 5. | Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj. |
| 6. | Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit. |
| 7. | Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.). |

| VI | Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm |
|---|---|
| 1. | Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta dhe i diskuton me bashkëmoshatarë. |
| 2. | Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. |
| 3. | Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar. |
| 4. | Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si, p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.). |
| 5. | Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij. |
| 6. | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |
| 7. | Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilët kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup. |

## Rezultatet e të nxënit të fushës së Matematikës Shkalla 1

| I. | **NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen te nxënësi/ja përmes përvojave mësimore që ndërlidhen me: |
|---|---|
| 1. | Zgjidhjen e problemeve, |
| 2. | Arsyetimet dhe vërtetimet matematike, |
| 3. | Komunikimin në/përmes matematikë/s, |
| 4. | Lidhjet matematike, |
| 5. | Përfaqësimin matematik, |
| 6. | Promovimin e modelimit matematik, |
| 7. | Strukturimin e të menduarit matematik, |
| 8. | Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë. |

| 1. | **Zgjidhja e problemeve:** |
|---|---|
| | Zgjidhja e problemeve është një proces që zhvillon njohuritë e nxënësve në matematikë përmes detyrave ku rezultati dhe procedura e zgjidhjes nuk është e njohur më parë. Nxënësi ndërton njohuri, përshkruan dhe zgjidh situata problemore që krijohen brenda matematikës dhe në kontekste nga fushat e tjera, si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme. Nxënësit i mundësohet që të zbatojë dhe të përshtatë një shumëllojshmëri të strategjive për t`i zgjidhur problemet. |
| | **Nxënësi/ja:** |
| 1. | Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. |
| 2. | Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme. |
| 3. | Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë. |
| 4. | Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave. |
| 5. | Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. |

| 2. | **Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:** |
|---|---|
| | Arsyetimi është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësve në matematikë përmes konjukturave matematike, nxjerrje të konkluzioneve logjike, hipoteza dhe të menduarit e tyre kritik, justifikim idesh, analizim të provave dhe ndërtim argumentesh. Nxënësve iu mundësohet përdorimi për arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. |
| | **Nxënësi/ja:** |
| 1. | Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. |
| 2. | Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësime. |
| 3. | Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët. |

| 3. | Komunikimi në/përmes matematikë/s |
|---|---|
| | Komunikimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t`i shprehur idetë matematike me rrjedhje logjike, të cilat i justifikon në audiencë dhe në shoqëri përmes të folurit dhe shkruarit për atë që e bëjnë me simbole, terma, grafikë, modele dhe shprehje matematikore.<br><br>Nxënësve u mundësohet përdorimi i komunikimit nëpërmjet shenjave, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarit matematik.<br><br>**Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. |
| **2.** | Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor. |
| **3.** | Komunikon të menduarit matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme. |
| **4.** | Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. |
| **5.** | Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. |
| **6.** | Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune. |

| 4. | Lidhjet në matematikë |
|---|---|
| | Lidhja matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t`i lidhur idetë dhe njohuritë matematike, brenda fushës së matematikës dhe jashtë saj. Nxënësve iu mundësohet për të njohur për të përdorur lidhjet e ideve matematikore, për të kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente, si dhe zbatimi i matematikës në kontekste brenda dhe jashtë fushës së matematikës.<br><br>**Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve. |
| **2.** | Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme. |

| 5. | Përfaqësimet matematike |
|---|---|
| | Përfaqësimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të përfaqësuar objektet matematikore dhe veprimet duke përfshirë numra, forma dhe marrëdhënie. Përfaqëson dhe analizon situatat dhe strukturat matematikore. Nxënësve iu mundësohet për të krijuar dhe për të përdorur përfaqësitë për të organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore, për të zgjidhur, përkthyer dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhje problemesh matematikore, duke përdorur përfaqësimet për modele dhe interpretime të fenomeneve sociale, natyrore dhe matematikore.<br><br>**Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |

| 6. | Modelimi matematik |
|---|---|
| | Modelimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të kuptuar format, modelet në kontekste të ndryshme, marrëdhëniet dhe funksionet, paraqitjen dhe analizimin e strukturave matematikore. Nxënësve u mundësohet që të krijojnë dhe të përdorin modele të ndryshme, t'i paraqesin modelet dhe rolin tyre në kontekst, për t'i përdorur modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet sasiore, për të interpretuar me modele fenomenet sociale, natyrore dhe matematikore. |
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme. |
| **2.** | Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive. |
| **3.** | Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme. |
| **4.** | Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |

| 7. | Strukturimi i të menduarit matematik |
|---|---|
| | Të menduarit matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të parashtruar pyetje dhe pritjet nga përgjigjet e mundshme. Nxënësit ndërgjegjësohen për mënyrën, formën, qasjen dhe për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën si dhe llojet e përgjigjeve të pritshme. |
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor. |

| 8. | Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë |
|---|---|
| | Përdorimi i teknologjisë është një proces që zhvillon njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përmbushur rezultatet e të nxënit të fushës së matematikës dhe për ta bërë të suksesshëm edhe përtej shkollës. Nxënësve iu mundësohet ta përdorin teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione. |
| | **Nxënësi/ja:** |
| **1.** | Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme matematikore. |
| **2.** | Përdor kalkulatorin për të verifikuar saktësinë e zgjidhjes së problemit. |

## II. VLERAT DHE QËNDRIMET që zhvillohen

Qëndrimet e individit, bindjet dhe emocionet luajnë një rol të rëndësishëm në interesimin e tij, përgjigjen ndaj matematikës dhe përdorimin e saj  në jetën e tij.  Qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës i vendosin ata drejt angazhimit produktiv të tyre në matematikë, si:

**Nxënësi/ja:**

- Interesimi për matematikën - nëse ata e shohin atë si të dobishme në jetën reale.
- Gatishmëria për t'u angazhuar në matematikë - ka të bëjë me qëndrimet emocionale dhe besimin personal që e shpie nxënësin drejt përfitimit.

**Formimet relevante në këtë fushë janë përfshirë te:**

- Kurioziteti
- Motivimi për mësim
- Imagjinata në kreativitetin për zgjidhjen e problemeve
- Insistimi, këmbëngulja dhe fuqia në fokusimin e problemeve
- Pavarësia në mendime dhe veprime
- Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme
- Organizimi i të menduarit
- Besimi në forcat vetjake
- Besimi në përdorimin e teknologjisë
- Dëshira për njohuri matetematike
- Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit
- Kritikat konstruktive
- Pavarësia në mendime
- Gatishmëria për bashkëpunim
- Prania e kritikave dhe gatishmëria për kritika konstruktive
- Gatishmëria për gara të ndershme
- Kuraja për të kërkuar përkrahje/ndihmë
- Qëndrimi i hapur ndaj përkrahjes së të tjerëve
- Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe kërkesave
- Vullneti
- Toleranca
- Respekti për saktësinë, përpjekjet personale dhe ato në grup

## III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

- Identifikim
- Përshkrim
- Zbatim
- Njehsim
- Matje
- Vlerësim
- Skicim
- Krijim modelesh
- Qasje e problemave nga perspektiva të ndryshme

## IV. KONCEPTET SPECIFIKE DHE NJOHURITË

**Numrat, algjebra dhe funksioni, forma, hapësira, matja dhe gjeometria, përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti**

- Numrat natyrorë dhe të plotë,
- Veprimet themelore me numra,
- Ekuacionet, inekuacionet dhe funksionet,
- Forma e figurave të rregullta (trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi dhe rrethi),
- Hapësira – objektet gjeometrike dhe trupat e rregullt gjeometrikë (kubi, kuboidi, piramida, prizmi dhe sfera),
- Matjet (e gjatësisë, perimetri dhe syprina) e figurave të rrafshëta,
- Të dhënat (elemente themelore të statistikës) grumbullim të shënimeve, mostra, prova, mesi aritmetik.

## Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Matematikë Klasa 1

| Lëndët e fushës kurrikulare | TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE | | | | Rezultatet e Kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë) |
|---|---|---|---|---|---|
| | PERIUDHA I | | PERIUDHA II | PERIUDHA III | |
| | shtator—tetor | nëntor—dhjetor | janar—shkurt—mars | prill—maj—qershor | |
| MATEMATIKË | Orientimi<br>(9 orë)<br><br>Bashkësitë dhe relacionet<br>(13 orë)<br><br>Numrat natyrorë<br>(21 orë) | Numrat natyrorë<br>(33 orë)<br><br>Figura gjeometrike/Sipërfaqe<br>(6 orë) | Numrat natyrorë<br>(41 orë)<br><br>Ekuacione dhe inekuacione<br>(3 orë)<br><br>Figura gjeometrike/Sipërfaqe/Modele<br>(9 orë)<br><br>Trupa gjeometrikë<br>(4 orë) | Numrat natyrorë<br>(37 orë)<br><br>Ekuacionet dhe inekuacione lineare me një të panjohur<br><br>Shprehje shkronjore<br>(4 orë)<br><br>Njësitë matëse<br>(3 orë)<br><br>Puna me të dhëna<br>(2 orë) | Komunikues efektiv<br>I.3,7<br><br>Mendimtar kreativ<br>II.1,2,3,4,7,8<br><br>Nxënës i suksesshëm<br>III.1,2,3,4,5,6,7<br><br>Kontribues produktiv<br>IV.2,4,5<br><br>Individ i shëndoshë<br>V.2,5,7<br><br>Qytetar i përgjegjshëm VI.2,6 |
| | Gjithsej 43 orë | Gjithsej 39 orë | Gjithsej 57 orë | Gjithsej 46 orë | |

# PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

**Lënda mësimore: Matematikë**

**Fusha e kurrikulës:** Matematikë **Klasa:** I

**Temat mësimore:** Orientimi
Bashkësitë dhe relacionet
Numrat natyrorë

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** | |
|---|---|
| **I. 3** | Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |
| **I.7** | Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve. |

| **Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | |
|---|---|
| **II.1** | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |
| **II.2** | Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një probleme matematikore (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. |
| **II.4** | Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. |
| **II.7** | Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna; |
| **II.8** | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkenca e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |

| **Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | |
|---|---|
| **III.1** | Përzgjedh materialet/mjete, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen bërë. |
| **III.2** | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| **III.3** | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. |
| **III.4** | Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. |

| **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | |
|---|---|
| **IV.4** | Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup. |
| **IV.5** | Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedis shtëpiak apo në lagje/komunitet. |

| Kompetenca personale – Individ i shëndoshë | |
|---|---|
| V.5 | Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj. |

| Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm | |
|---|---|
| VI.2 | Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. |
| VI.6 | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |

| Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: | |
|---|---|
| 1.1 | Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. |
| 1.2 | Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme. |
| 2.1 | Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. |
| 3.1 | Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. |
| 3.4 | Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. |
| 3.5 | Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. |
| 3.6 | Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune. |
| 4.1 | Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve. |
| 4.2 | Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme. |
| 5.1 | Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| 6.1 | Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme. |
| 6.2 | Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive. |
| 7.1 | Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor. |
| 8.1 | Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme matematikore. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Orientimi**<br><br>**Bashkësitë dhe relacionet** | - Përcakton vendin e objekteve, para,<br><br>- Përshkruan rrugën nga një vend (pikënisja) në një vend tjetër (pikarritja) dhe anasjelltas;<br><br>-Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh;<br><br>- Identifikon objektet që janë brenda ose jashtë bashkësisë;<br><br>-Paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit; | 1. Orientimi, fq.5<br>2. Mirë se vini në klasën e parë, fq. 6<br>3. Duke ngjyrosur, zbulojmë objektet, fq.7<br>4. Kuptimet: para, pas, mbi dhe nën, fq.8/ ZH<br>5. Kuptimet: para, pas, mbi dhe nën, fq.9 / U<br>6. Kahet e lëvizjes: lart, poshtë, djathtas, -majtas, fq.10, 11 / ZH<br>7. Kahet e lëvizjes: lart, poshtë, djathtas, -majtas, fq.12 / U<br>8. Kuptimet: më i madh (e madhe) se e, më i vogël (e vogël) se, fq. 13/ ZH<br>9. Kuptimet brenda, jashtë dhe në, fq. 14/ ZH<br>10. Bashkësia, elementet e bashkësisë, fq. 15 / ZH<br>11. Numërimi i elementeve që formojnë një bashkësi fq.16 / ZH<br>12. Bashkësia, elementet e bashkësisë fq. 17 / U<br>13. Paraqitja e bashkësisë me diagram fq. 18 / ZH<br>14. Paraqitja e bashkësisë me diagram fq. 19/ U<br>15. Numri i elementeve të bashkësisë fq.20 / ZH<br>16. Numri i elementeve të bashkësisë fq.21 / U<br>17. Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve fq.22/ ZH<br>18. Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve fq.23 / U<br>19. Formimi i bashkësisë nga dy bashkësi të dhëna fq.24 / ZH | 43 | Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në rritjen e kompetencave<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencuar | Vlerësim i vazhdueshëm<br><br>Vlerësimi përmbledhës<br><br>Vlerësimi i portfolios<br><br>Lista e kontrollit | Gjuhë amtare (shqipe)<br><br>Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Edukatë figurative<br><br>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti<br><br>Shkathtësi për jetë<br><br>Njeriu dhe natyra<br><br>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore<br><br>Zhvillim i qëndrueshëm | Matematika 1a<br><br>Burime nga interneti |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numrat natyrorë | - Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve);<br><br>Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet; më shumë; më pak, aq sa;<br><br>-Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër;<br><br>- Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna;<br><br>- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;<br><br>-Numëron me rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20. | 20. Detyra për përsëritje, fq.25 / P<br>21. Kuptimet: më shumë se, më pak se dhe aq sa, fq.26/ ZH<br>22. Vlerësojmë të kuptuarit, fq.27 / V<br>23. Numri një, fq.28 / Zh<br>24. Numri dy, fq.29 / Zh<br>25. Numri tre, fq.30/ Zh<br>26. Numrat 1, 2 dhe 3, fq. 31/ U<br>27. Numrat 1, 2 dhe 3, fq. 32/ U<br>28. Numri katër, fq. 33/ Zh<br>29. Numri katër, fq. 34/ U<br>30. Numri zero, fq. 35/ Zh<br>31. Numrat deri në katër, fq.36/ U<br>32. Shenjat: më e madhe, më e vogël, fq. 37/ ZH<br>33. Shenja e barazimit, fq. 38/ ZH<br>34. Shenjat <, > dhe =, fq. 39, 40/ U<br>35. Mbledhja e numrave, fq. 42 / U<br>36. Mbledhja e numrave deri në 4, fq. 43/ U<br>37. Mbledhja e numrave deri në 4/, fq.43 / U<br>38. Zbritja e numrave, fq.45/ U<br>39. Zbritja e numrave/U<br>40. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 4 - Detyra për përsëritje<br>41. Vlerësojmë të kuptuarit<br>42. Numri pesë | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Kupton shenjat:+, -, <, >,=, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;<br><br>-Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/ vizatime;<br><br>-Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën dhe të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20;<br><br>-Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0). | | | | | | |

# PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

**Lënda mësimore: Matematikë**

**Fusha e kurrikulës:** Matematikë **Klasa:** I

**Temat mësimore:** Numrat natyrorë
Figurat gjeometrike/
Sipërfaqe

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:** | |
|---|---|
| | **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** |
| **I. 3** | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |

| **Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | |
|---|---|
| **II.1** | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |
| **II.2** | Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një probleme matematikore (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. |
| **II.8** | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |

| **Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | |
|---|---|
| **III.1** | Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. |
| **III.2** | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| **III.3** | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. |
| **III.4** | Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. |
| **III.5** | Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë apo aktiviteti, duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve – vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë. |
| **III.6** | Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale. |
| **III.7** | Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla dhe informata gjatë hasjes së vështirësive. |

| **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv** | |
|---|---|
| **IV.5** | Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjete etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet. |

| Kompetenca personale – Individ i shëndoshë | |
|---|---|
| V.5 | Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë/shkollë apo jashtë saj. |

| Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm | |
|---|---|
| VI.2 | Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si dhe rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. |
| VI.6 | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit, duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |

| Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: | |
|---|---|
| 1.1 | Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. |
| 1.5 | Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike. |
| 2.1 | Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. |
| 2.2 | Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësimeve nëpërmjet diskutimeve me të tjerët. |
| 3.1 | Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. |
| 3.2 | Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëshkollor. |
| 3.3 | Komunikon të menduarit matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme. |
| 3.4 | Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. |
| 3.5 | Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. |
| 3.6 | Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune. |
| 4.2 | Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme. |
| 5.1 | Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| 6.4 | Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| 7.1 | Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor. |
| 8.1 | Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme matematikore. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numrat natyrorë | - Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;<br><br>- Numëron në rendin rritës me numrat nga 1 deri në 20;<br><br>- Kupton shenjat; +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;<br><br>- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;<br><br>-Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);<br><br>-Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna; | 44. Mbledhja e numrave deri 5, fq. 52/ Zh<br>45. Mbledhja e numrave deri në 5, fq. 53/U<br>46. Zbritja e numrave deri në 5, fq. 54 / ZH<br>47. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 5, fq.55, 56/U<br>48. Detyra për përsëritje, fq. 57, 58/P<br>49. Vlerësojmë të kuptuarit, fq. 59<br>50. Vijat e drejta dhe të lakuara, fq. 60/Zh<br>51. Pikat si prerje e vijave, fq. 61/Zh<br>52. Vijat e hapura dhe të mbyllura, fq. 62/Zh<br>53. Segmenti, fq.63, 64/U<br>54. Figurat dhe format e njëjta, fq. 65/Zh<br>55. Vijat, figurat dhe format e njëjta, fq. 66/U<br>56. Numri gjashtë , fq. 67/Zh<br>57. Numri shtatë, fq. 68/Zh<br>58. Numri 6 dhe 7, fq. 69/Zh<br>59. Mbledhja e numrave deri në 7, fq. 70/Zh<br>60. Mbledhja e numrave deri në 7, fq. 71/U<br>61. Zbritja e numrave deri në, 7 fq.72/Zh<br>62. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 7, fq. 73, 74/U<br>63. Detyra për përsëritje, fq. 75<br>64. Vlerësojmë të kuptuarit, fq. 76<br>65. Numri tetë/U, fq. 77/Zh<br>66. Numri tetë, fq. 78 /U<br>67. Numri nëntë, fq. 79/Zh<br>68. Numri nëntë/U, fq. 80/U<br>69. Detyra për përsëritje, fq. 81/P<br>70. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në nëntë fq. 82, 83/Zh<br>71. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9, fq. 84, 85/U<br>72. Detyra për përsëritje, fq. 86/P | 39 | Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në rritjen e kompetencave<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencuar | Vlerësim i vazhdueshëm<br><br>Vlerësim përmbledhës<br><br>Vlerësim i portofolios<br><br>Lista e kontrollit | Gjuhë amtare (shqip)<br><br>Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Edukatë figurative<br><br>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti<br><br>Shkathtësi për jetë<br><br>Njeriu dhe natyra<br><br>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore<br><br>Zhvillim i qëndrueshëm | Matematika 1a<br><br>Burime nga interneti |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Figurat gjeometrike/ Sipërfaqe | - Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura;<br><br>- Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë; të tjerë që ngjasojnë me figura gjeometrike;<br><br>- Ngjyros sipërfaqen brenda figurave të ndryshme (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi, rrethi);<br><br>- Tregon shembuj të tjerë që ngjasojnë me figura gjeometrike;<br><br>- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20. | 73. Detyra për përsëritje, fq.87/P<br>74. Vlerësojmë të kuptuarit, fq. 88/V<br>75. Shuma e tre numrave, fq. 89<br>76. Shuma e tre numrave, fq. 90/U<br>77. Ndryshimi i tre numrave, fq. 91/Zh<br>78. Ndryshimi i tre numrave, fq. 92/U<br>79. Numri dhjetë, fq. 93/Zh<br>80. Numrat deri në dhjetë/ U<br>81. Detyra për përsëritje, fq. 96/P<br>82. Paraqitja e numrave në boshtin numerik, fq. 97/ Zh | | | | | |

# PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

**Lënda mësimore: Matematikë**

**Fusha e kurrikulës:** Matematikë **Klasa:** I

**Temat mësimore:** Numrat natyrorë
Ekuacione dhe inekuacione
Figura gjeometrike/Sipërfaqe/Modele
Trupa gjeometrikë

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** | |
|---|---|
| | **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** |
| **I. 3** | Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |
| **I.7** | Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve. |

| **Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | |
|---|---|
| **II.1** | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |
| **II.2** | Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. |
| **II.3** | Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet. |
| **II.4** | Krahason objektet, lëndët e paraqitura nga mësuesi/ja duke i klasifikuar sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. |
| **II.8** | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |

| **Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | |
|---|---|
| **III.1** | Përzgjedh materialet/mjetet, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë. |
| **III.2** | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| **III.3** | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. |
| **III.4** | Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. |
| **III.5** | Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve – vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë. |
| **III.7** | Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive. |

| Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv | |
|---|---|
| **IV.2** | IV.2 Kontrollon mjetet/materialet dhe kohë që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj). |
| **IV.5** | IV.5 Identifikon burimet e nevojshme (materialet, mjete etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet. |

| Kompetenca personale – Individ i shëndoshë | |
|---|---|
| **V.2** | Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet). |
| **V.5** | Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë/shkollë apo jashtë saj. |

| Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm | |
|---|---|
| **VI.2** | Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si: rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. |
| **VI.6** | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |

| Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: | |
|---|---|
| **1.1** | Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. |
| **1.2** | Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme. |
| **2.1** | Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. |
| **2.2** | Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësimeve nëpërmjet diskutimeve me të tjerët. |
| **3.1** | Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. |
| **3.2** | Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëshkollor. |
| **3.3** | Komunikon të menduarit matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme. |
| **3.4** | Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; |
| **3.5** | Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. |
| **3.6** | Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune. |
| **4.2** | Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme. |
| **5.1** | Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| **6.1** | Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme. |
| **6.2** | Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive. |
| **6.4** | Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| **8.1** | Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme matematikore. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore,me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numrat natyrorë | -Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;<br><br>-Numëron në rendin rritës me numrat nga 1 deri në 20;<br><br>- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;<br><br>-Kupton shenjat; +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;<br><br>-Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20. | 83. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10<br>84. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10/U<br>85. Zbatimi i mbledhjes dhe i zbritjes<br>86. Zbatojmë fq.101<br>87. Detyra për përsëritje<br>88. Vlerësojmë të kuptuarit<br>89. Edhe matematika është zbavitje<br>90. Detyra për përsëritje fq.106,107/P<br>91. Paraja – Euro fq.5/Zh<br>92. Paraja – Euro/U fq.6/U<br>93. Paraja – Euro/U<br>94. Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit<br>95. Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit/U<br>96. Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit<br>97. Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit/U<br>98. Detyra për përsëritje<br>99. Simetria dhe drejtëza e simetrisë<br>100. Simetria dhe drejtëza e simetrisë/U<br>101. Simetria dhe drejtëza e simetrisë/U<br>102. Për sa është një numër më i madh se tjetri?<br>103. Për sa është një numër më i madh se tjetri?/U<br>104. Për sa është një numër më i vogël se tjetri?<br>105. Për sa është një numër më i vogël se tjetri?/U | 57 | Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në rritjen e kompetencave<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencuar | Vlerësim i vazhdueshëm<br><br>Vlerësim përmbledhës<br><br>Vlerësim i portfolios<br><br>Lista e kontrollit | Gjuhë amtare (shqip)<br><br>Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Edukatë figurative<br><br>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti<br><br>Njeriu dhe natyra<br><br>Shkathtësi për jetë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore<br>Zhvillim i qëndrueshëm | Matematika 1a<br><br>Matematika 1b |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Ekuacione dhe inekuacione lineare<br><br><br><

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numrat natyrorë | -Vizaton figurën e radhës duke vëzhguar vargun e figurave paraprake;<br><br>-Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20;<br><br>-Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20; duke përfshirë dhe numrin 0);<br><br>-Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20.<br><br>-Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna;<br>-Kupton shenjat;<br>+, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;<br><br>-Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale). | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Trupa gjeometrik | - Emërton trupat gjeometrikë(kubi, kuboidi, sfera);<br><br>- Krahason trupat gjeometrikë (përmasat e tyre);<br><br>- Identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën;<br><br>- Gjen (bën) dallimet ndërmjet figurave gjeometrike dhe trupave gjeometrikë. | | | | | | |

# PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

**Lënda mësimore: Matematikë**

**Fusha e kurrikulës:** Matematikë **Klasa:** I

**Temat mësimore:**

Numrat natyrorë
Njësitë matëse
Ekuacione dhe inekuacione lineare me një të panjohur
Puna me të dhëna
Shprehje shkronjore

| **Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:** | |
|---|---|
| | **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit - Komunikues efektiv** |
| **I. 1** | Lexon një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës. |
| **I. 3** | Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |

| **Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ** | |
|---|---|
| **II.1** | Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta. |
| **II.2** | Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore. |
| **II.4** | Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre. |
| **II.8** | Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta. |

| **Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm** | |
|---|---|
| **III.1** | Përzgjedh materialet/mjete, si: letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen e bërë. |
| **III.2** | Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj. |
| **III.3** | Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit. |
| **III.4** | Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes. |
| **III.5** | Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve – vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë. |
| **III.6** | Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale. |
| **III.7** | Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitet të caktuar dhe kërkon këshilla dhe dhe informata gjatë hasjes së vështirësive. |

| Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv | |
|---|---|
| IV.2 | Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj). |
| IV.4 | Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup |
| IV.5 | Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedis shtëpiak apo në lagje/komunitet. |

| Kompetenca personale – Individ i shëndoshë | |
|---|---|
| V.5 | V.5 Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë/shkollë apo jashtë saj. |

| Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm | |
|---|---|
| VI.2 | Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. |
| VI.6 | Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar. |

| Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohet të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: | |
|---|---|
| 1.1 | Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta. |
| 1.2 | Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë. |
| 2.1 | Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. |
| 3.1 | Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore. |
| 3.2 | Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëshkollor. |
| 3.3 | Komunikon të menduarit matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit dhe të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme. |
| 3.4 | Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. |
| 3.5 | Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash. |
| 4.1 | Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve. |
| 1.2 | Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme. |
| 5.1 | Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| 6.4 | Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete. |
| 7.1 | Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor. |
| 8.1 | Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë problema të ndryshme matematikore. |

| Temat mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore | Njësitë mësimore | Koha mësimore (orë mësimore) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore,me çështjet ndërkurrikulare dhe dhe situatat jetësore | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numrat natyrorë | - Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë dhe numrin 0);<br><br>- Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet numrave nga 1 deri në 20;<br><br>- Përcakton radhën (numrat rendorë);<br><br>- Identifikon numrat çift dhe tek nga 1 deri në 20;<br><br>- Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20; | 140. Kllapat (U), fq.63<br>141. Detyra për përsëritje, fq.64/P<br>142. Mbledhja e numrave duke plotësuar 10, fq.65/Zh<br>143. Mbledhja e numrave duke plotësuar 10, fq.66/U<br>144. Mbledhja e numrave duke plotësuar 10, fq.67/U<br>145. Mbledhja e numrave duke plotësuar 10, fq.68/U<br>146. Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes (Zh), fq.69,70/Zh<br>147. Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes, fq.71/U<br>148. Zbritja e numrave pa e prishur dhjetëshen, fq.72/Zh<br>149. Zbritja e numrave pa e prishur dhjetëshen, fq.73, 74/U<br>150. Zbritja e numrave, duke veçuar dhjetëshen<br>151. Zbritja e numrave, duke veçuar dhjetëshen<br>152. Zbritja e shumës, fq.78 /Zh<br>153. Zbritja e shumës, fq.79,80/U<br>154. Detyra për përsëritje, fq.81/P<br>155. Vlerësojmë të kuptuarit, fq.82<br>156. Edhe matematika është zbavitje, fq.83<br>157. Zbatimi i mbledhjes dhe zbritjes në problema, fq.84<br>158. Numrat çift dhe tek, fq.85/Zh<br>159. Numrat çift dhe tek, fq.86/U | 46 | Mësimdhënia dhe të nxënët me fëmijët në qendër dhe gjithëpërfshirja<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e bazuar në rritjen e kompetencave<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e integruar<br><br>Mësimdhënia dhe të nxënët e diferencuar | Vlerësim i vazhdueshëm<br><br>Vlerësim përmbledhës<br><br>Vlerësim i portfolios<br><br>Lista e kontrollit | Gjuhë amtare (shqipe)<br><br>Shoqëria dhe mjedisi<br><br>Edukatë figurative<br><br>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti<br><br>Njeriu dhe natyra<br><br>Shkathtësi për jetë<br><br>Çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore<br><br>Zhvillim i qëndrueshëm | Matematika 1b<br><br>Burime nga interneti |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Puna me të dhëna<br><br>Ekuacione dhe inekuacione | - Identifikon mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur nga numri 1 deri në 20;<br><br>- Zgjidh problema me fjalë me numra nga 1 deri në 20;<br><br>- Lexon dhe kupton të dhënat statistikore (me figura të ndryshme) nga jeta e përditshme;<br><br>- Lexon dhe plotëson një tabelë me të dhëna të thjeshta nga mjedisi;<br><br>- Organizon mbledhjen e të dhënave e informacioneve dhe përdor informacionet e mbledhura;<br><br>- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike; | 160. Detyra për përsëritje, fq.87/P<br>161. Kuptimi i numrave rendorë<br>162. Paraardhësi dhe pasardhësi i një numri, fq.89 /Zh<br>163. Paraardhësi dhe pasardhësi i një numri, fq.90/U<br>164. Grumbullimi dhe paraqitja e të dhënave, fq.91,92, 93/Zh<br>165. Puna me të dhëna, fq.94, 95, 96/U<br>166. Vlerësojmë të kuptuarit, fq.97<br>167. Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij, fq.98/Zh<br>168. Të gjejmë numrin e panjohur, fq.99 /Zh<br>169. Të gjejmë numrin e panjohur, fq.100/U<br>170. Detyra për përsëritje, fq.101<br>171. Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij, fq.102/Zh<br>172. Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij, fq.103/Zh<br>173. Të gjejmë numrat e panjohur, fq.104/U<br>174. Edhe matematika është zbavitje, fq.105<br>175. Vlerësojmë të kuptuarit, fq.106<br>176. Gjysma, fq.107/Zh<br>177. Çereku, fq.108/ Zh<br>178. Matja e gjatësisë, fq.109/Zh<br>179. Matja e gjatësisë, fq.110 /U<br>180. Matja e gjatësisë, fq. 111/U<br>181. Detyra për përsëritje, fq.112,113/P<br>182. Vlerësojmë të kuptuarit<br>183. Zbatimi i matjeve në problema/ fq.114/Zh<br>184. Detyra për përsëritje, fq.115, 116<br>185. Njehsojmë me numrat deri në 20, fq.117/U | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shprehjet shkronjore<br><br>Njësitë matëse | - Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave;<br><br>- Modelon problema me shprehje shkronjore;<br><br>- Zgjidh probleme nga jeta e për-ditshme duke shfrytëzuar shprehjet shkronjore;<br><br>- Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde (pëllëmba e dorës, hapi, lapsi, shkopinj etj.);<br><br>- Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë duke përdorur shpre-hjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq; | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | - Orientohet në kohë duke përdorur fjalët e duhura (p.sh., dje, para një jave, tani, nesër, pas disa ditësh në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme;<br><br>- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë. Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.<br><br>- Përdor njësi matëse standarde, si: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave; | | | | | | |

# Mësimi 1

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në;
- Përshkruan rrugën nga një vend (pikënisja) në një vend tjetër (pikarritja) dhe anasjelltas.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3 , II.4, III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2 , 1.7 , 4.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan objektet përreth;
- Tregon pozicionin e objekteve përreth.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të printuara, objekte te ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të tregojnë se çfarë shohin, pra për objektet që i rrethojnë në klasë, si: bankat, tabela, dera, karriget etj.

**Hapi 2**: Më pas shtrohen pyetjet se ku ndodhen këto objekte. Për shembull:
Ku ndodhet tabela? (Para)
Ku ndodhen dritaret? (Majtas)




Ku është dera? (Djathtas)
Kush është pas teje? (Shoku, shoqja apo muri).

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të hapin librat dhe në dyshe të vështrojnë foton e dhënë.
Vëzhgojnë me vëmendje figurat. Shtrohen pyetjet:

- Çfarë po shihni?
- Ku po shkojnë fëmijët?
- Në cilën anë e kanë autobusin?
- Po semaforin?
- Kë kanë para?
- Makina ngjyrë portokalli në cilën anë të fëmijëve është?

**Hapi 4**: Nxënësit përshkruajnë rrugën nga banka e tyre drejt derës së klasës, pastaj rrugën nga klasa deri në oborrin e shkollës e në fund nga shkolla për në shtëpitë e tyre.



Fig.1



Fig.2

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen se si të plotësojnë në klasë labirinthin në fig. 1, ndërsa në shtëpi plotësojnë fig. 2.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në veprimtari, përshkrimin e objektve dhe saktësinë e përcaktimit të pozicionit të tyre.

**Detyrë:**
Plotësoni fletën e printuar nga ana e mësueses si në fig. 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 2

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, I.7, IV.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2, 2.1, 4.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mirë se vini në klasën e parë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton objektet në figurë dhe në klasë;
- Përshkruan objektet që e rrethojnë;
- Krahason klasën me atë në libër.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të printuara, objekte të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Diskutohet me nxënësit të tregojnë si do të dëshironin të rregullonin ndryshe klasën me ato objekte që kanë.
- Ku do të donin ta vendosnin shportën?
- Po tabelën?
- Renditja e bankave në rresht apo në grup?

Nxënësit i shprehin mendimet e tyre duke i arsyetuar ato.




**Hapi 2**: Hapen librat dhe nxënësit për disa minuta shohin fotografinë e klasës në libër. Udhëzohen të bashkëbisedojnë në dyshe duke i emërtuar sendet dhe ngjyrat që shohin në libër. Ata mund të bëjnë edhe emërtimin e nxënësve të figurës.

Diskutohet me nxënësit:

- A mendoni se shihet e tërë klasa? (*Jo*)
- Si mund të duket pjesa tjetër? (*Libra, banka për të gjithë nxënësit, dera, mësuesja etj.*)
- A ka klasa më shumë nxënës?
- Çfarë bëjnë të tjerët? (*Mësojnë; bëjnë detyra; luajnë edhe ata*).

**Hapi 3:** Nxënësit bëjnë krahasimin e klasës së tyre me atë të ilustruar në libër.

Pyeten:

- Cila klasë ju pëlqen më shumë?
- Pse ju pëlqen?
- Po të ishe në mesin e tyre, në cilin kënd do të doje të merrje pjesë? (*Të vizatimit, lojës, këndimit).*

**Hapi 4**: Vizatohet në tabelë skema e klasës me elementet kryesore. Nxënësit udhëzohen si duhet të punohet me fletore. Më pas fillojnë të vizatojnë klasën e tyre. Në fund nxënësit i paraqesin punimet e tyre para të tjerëve duke treguar se çfarë kanë vizatuar.

Nxiten të emërtojnë sa më shumë secilën figurë të vizatuar, duke i pyetur:

- Çfarë është kjo figurë?
- Para kujt është?
- Pas kujt qëndron?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, emërtimin, përshkrimin dhe krahasimin e objekteve.

**Detyrë:**
Vazhdoni vizatimin e filluar në klasë duke shtuar objekte të tjera.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 3

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në;
- Përshkruan rrugën nga një vend (pikënisja) në një vend tjetër (pikarritja) dhe anasjelltas.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.4 , III.3.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.7, 2.1, 4.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Duke ngjyrosur, zbulojmë objektet/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon disa nga ngjyrat kryesore;
- Lidh numrin me ngjyrën përkatëse.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të printuara, objekte të ndryshme, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lipset nga nxënësit t'i nxjerrin ngjyrat mbi bankë. U kërkohet ngjyra e verdhë dhe ngrenë dorën me ngjyrën përkatëse në dorë.
- Po e kuqja cila është?
- E kaltra?

Kështu vazhdon loja me të gjitha ngjyrat bazë, derisa të kuptohet që nxënësit i dallojnë.




**Hapi 2**: Ftohen nxënësit të grupohen sipas ngjyrave që kanë veshur.

- Cila është ngjyra e veshjes suaj?
- A është kjo ngjyra juaj që ju pëlqen më shumë? (*Po ose jo*).

Atyre që thonë jo, u kërkohet të tregojnë se cila ngjyrë u pëlqen.

**Hapi 3:** Hapet libri dhe diskutohet për figurën e parë. (*Teatri i kukullave*).

- A keni qenë ndonjëherë në teatër?
- Kush luan atje?
- Si duhet të sillemi në teatër?

**Hapi 4**: Vizatohen në tabelë figurat si më poshtë, të cilat janë orientuese për ngjyrosjen e figurës.



Nxënësit ngjyrosin figurën në libër duke numëruar pikat. Secila pikë ka ngjyrën përkatëse.

**Hapi 5:** Punimet e përfunduara vlerësohen duke përdorur simbolet si më poshtë.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe saktësinë e ngjyrosjes sipas numrit përkatës.

**Detyrë:**

Të ngjyroset ushtrimi 2 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 4

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3 , II.4, III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2 , 2.1 ,4.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimet: para, pas, mbi dhe nën

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon vendndodhjen e objekteve, duke i përdorur fjalët logjike: para, pas, mbi dhe nën;
- Përcakton vendndodhjen e objekteve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ngjyra, fotografi, objekte te ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendoset në mes të klasës (para nxënësve) një bankë. Mbi të vendoset një çantë, nën bankë një top, para saj një libër dhe pas një karrige. Nxiten nxënësit të tregojnë për vendndodhjen e sendeve duke i përdorur fjalët *para, pas, mbi* dhe *nën*.
- Ku ndodhet çanta? (*Mbi bankë*).
- Po topi ku është? (*Nën bankë*).
- Ku qëndron libri? (*Para bankës*).
- E karrigia? (*Pas bankës*).




**Hapi 2**: Nxënësve u kërkohet ta vendosin librin mbi bankë. Nën libër të vendosin fletoren, para librit lapsin dhe pas librit gomën.

Udhëzohen  në dyshe t'i tregojnë njëri-tjetrit se ku qëndrojnë sendet që kanë vendosur mbi bankë.

**Hapi 3:** Pasi t'i kenë hapur nxënësit librat, e vëzhgojnë figurën e dhënë aty. Diskutohet për pozitën e fëmijës, të kafshëve dhe të topit.

**Hapi 4**: Nxiten nxënësit të përshkruajnë pozicionet e sendeve në detyrën 2, duke u ndihmuar me pyetje, ku theks i veçantë i vihet përdorimit të fjalëve para, pas mbi  dhe nën.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të bëjnë ngjyrosjen me ngjyrën e caktuar për pozicionin e caktuar. Pas plotësimit, disa nga nxënësit tregojnë ngjyrën dhe pozicionin e objekteve në detyrë.

**VEPRIMTARI SHTESË**

*Loja me duar*

U kërkohet nxënësve që kur të dëgjojnë fjalën "mbi",  t'i vendosin duart mbi kokë; kur të dëgjojnë fjalën "nën", duart t'i vendosin nën mjekër. Po kështu veprohet edhe me kuptimet "para", ta prekin hundën; dhe "pas", ta prekin kokën pas. Nxiten të veprojnë shpejt dhe me kujdes, sepse ndërrohet renditja e veprimeve.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përdorimit të fjalëve: para, pas, mbi dhe nën, si dhe përcaktimin e vendndodhjes së objekteve.

**Detyrë:**

Vizatoni në fletore figurën e tretë të detyrës së dytë (tavolina, topi, fletorja).

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 5

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3 , II.4, III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2 , 2.1 ,4.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimet: para, pas, mbi dhe nën /U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton vendndodhjen e objekteve;
- Ngjyros figurat sipas përcaktimit të vendndodhjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Objekte të ndryshme nga klasa, fotografi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet në tabelë një lëndinë me lule, flutura që fluturojnë, bletë që qëndrojnë mbi lule dhe zogj që fluturojnë. Diskutohet për vendndodhjen e figurave të ndryshme.

- Ku janë bletët? (*Mbi lule*).
- Po fluturat? (*Pas luleve*).
- Ku i shihni zogjtë? (*Para luleve*).
- Po barin? (*Nën lule*).


KUPTIMET PARA, PAS, MBI DHE NËN

Ushtrojmë

1 Identifikojmë objektet që ndodhen mbi dhe ato që ndodhen nën.

2 Zogjtë që ecin para pulës i ngjyrosim me të kuqe, kurse ata pas i ngjyrosim me të kaltër.

3 Objektet nën i ngjyrosim me të kuqe, kurse ato mbi i ngjyrosim me të kaltër.

4 Përshkruajmë kush është para kujt dhe kush është pas kujt.

9

**Hapi 2**: Diskutohet për vendndodhjen e nxënësve në raport me tabelën, murin, derën, dritaren etj.

- Ku qëndron tabela?
- Cilin nxënës e ke pas?
- Çfarë ke mbi bankë?
- Po nën libër?

**Hapi 3:** Identifikohen objektet në ushtrimin e parë nga libri duke i nxitur nxënësit të përdorin sa më shumë fjalët: *mbi* dhe *nën*. Shprehin mendime se a janë të vendosura objektet në vendin e duhur (*Jo, sepse libri duhet të jetë mbi bankë*). Ngjyroset ushtrimi i tretë.

**Hapi 4**: Bisedohet me nxënësit rreth ushtrimit 3, se zogjtë të cilët ecin *para* pulës, të ngjyrosen me të kuqe e *pas* me të kaltër. Përshkruajnë me fjalë ushtrimin 4.

**Hapi 5:** Në tabelë vizatohet fig. 1, ndërsa nxënësit në fletore.
Pastaj në grup nga 4 nxënës tregojnë se ku qëndrojnë këto objekte kundruall diellit (zemra - *mbi*; ylli - *nën*; reja - *pas*; fytyra - *para*).



Fig.1

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përdorimit të konceptetve para, pas, mbi, nën, si dhe estetikën e ngjyrosjes.

**Detyrë:**
Vizaton tavolinën e vet të punës me objektet që gjenden në të.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 6

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, lart, poshtë, djathtas, majtas.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 3.4; 3.5; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kahet e lëvizjes: lart, poshtë, djathtas, majtas

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përdor fjalët lart, poshtë, djathtas, majtas për pozitën e sendeve;
- Përcakton saktë kahet e lëvizjes së objekteve;
- Vendos objektet sipas kërkesave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, ngjyra, laps, ilustrim, spango, fije peri, shenja trafiku.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Njeriu dhe natyra, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësit ftohen të vëzhgojnë foton e paraqitur dhe të tregojnë se çfarë shohin lart në qiell dhe çfarë poshtë në tokë. Gjatë përshkrimit ata duhen nxitur të përdorin fjalët: lart, poshtë.

**Hapi 2**: Nxënësit udhëzohen ta hapin tekstin dhe t'i vëzhgojnë figurat e dhëna në detyrat 1 dhe 2. Në çifte, ata përshkruajnë me fjalë se cili shkon lart dhe cili poshtë duke i paraqitur kahet e lëvizjes me shigjeta të dhëna në libër.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet që me dorën e djathtë ta marrin lapsin, kurse me të majtën gomën. Po ash-




tu kërkohet që nga dy nxënës të tregojnë se cilin shok a shoqe e kanë djathtas dhe cilin majtas.

**Hapi 4**: Paraqitet me anë të spangos një rrugë ku në krahun e djathtë vendoset një shenjë rreziku që tregon kthesë djathtas. Kurse, në krahun e majtë një shenjë trafiku me kthesë majtas. Ftohen dy nxënës që të lëvizin nëpër këtë rrugë djathtas apo majtas. Me këtë rast shpjegohet domethënia e shenjave të vendosura të trafikut. Bazuar në këtë demonstrim, nxënësit në dyshe ngjyrosin kahet e lëvizjes në dy shembujt e detyrës 4.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që individualisht të rrethojnë objektin që ndodhet majtas nga vajza në detyrën 5. Saktësia e tyre vlerësohet.

**Hapi 6**: Lipset nga ata që të vendosin një fije peri në mes të bankës. Nxënësit do të punojnë në dyshe. Njëri nxënës vendos majtas perit petëza të kuqe (fasulet, shkopinjtë), kurse tjetri vendos djathtas petëza të kaltra. Saktësia e tyre vlerësohet.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit përdorin saktë fjalët: lart, poshtë, djathtas, majtas për përcaktimin e pozitës dhe lëvizjes së objekteve.

**Detyrë:**

Të plotësohen shembujt e mbetur të detyrës 4 dhe detyra 6 në libër (faqe 11).

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 7

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan rrugën nga një vend (pikënisja) në një vend tjetër (pikarritja) dhe anasjellas.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; II.4; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kahet e lëvizjes: lart, poshtë, djathtas, majtas/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon kahet e lëvizjes me anë të ngjyrave të caktuara;
- Demonstron kahet e lëvizjes me anë të vizatimit;
- Shpjegon me terma përkatës kahet e lëvizjes së objekteve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ngjyra, ilustrim.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS





**Hapi 1:** Nxënësit pyeten rreth filmit të animuar "Liza në botën e çudirave".
A e keni parë këtë film? Ju pëlqen?
Njëri nga personazhet është edhe lepuri i bardhë. Ta ndihmojmë ta gjejë rrugën për te karota.
Njëri nxënës thirret para klasës që të vizatojë rrugën sipas udhëzimeve të mësuesit: dy katrorë para, dy katrorë poshtë, një katror djathtas, dy katrorë lart, dy katrorë djathtas dhe tre katrorë poshtë.
Lepuri arriti te karota. I gëzuar ju falënderon për ndihmën tuaj.




**Hapi 2**: Nxënësve u kërkohet t'i hapin librat dhe të dallojnë kahet e lëvizjes: lart, poshtë me anë të ngjyrës së caktuar në detyrë. Në fund përshkruhet drejtimi i lëvizjes së njërës dhe tjetrës vajzë duke përdorur saktë fjalët: poshtë, lart.

**Hapi 3:** Nxënësit përshkruajnë ilustrimin e detyrës 2. U kërkohet që të marrin dy ngjyra për të ngjyrosur shigjetat në rrugë. Shigjetën që tregon lëvizjen në të majtë, e ngjyrosin me të kuqe, kurse shigjetën që tregon lëvizjen në të djathtë e ngjyrosin me të kaltër.

Librat i shkëmbejnë me shokun a shoqen e bankës, ku e bëjnë vlerësimin e ngjyrosjes së saktë të shigjetave duke ia vendosur një nga fytyrat përkatëse.



**Hapi 4**: Punohet detyra 3 sipas udhëzimeve të dhëna. Peshqit duhet të ngjyrosen sipas drejtimit që ka marrë koka e tyre; djathtas me të kuqe, majtas me të gjelbër, lart me të verdhë dhe koka e drejtuar poshtë me të kaltër.
Në fund i numërojnë peshqit sipas kaheve - ngjyrave duke formuar fjali, p.sh.:
Pesë peshq notojnë djathtas.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit dallojnë, demonstrojnë dhe shpjegojnë saktë me fjalë kahet e lëvizjes: lart, poshtë, majtas, djathtas.

**Detyrë:**
Vizatoni rrugën e vet nga shtëpia deri në shkollë duke përdorur kahet e lëvizjes me shigjeta.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 8

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; III.4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1; 3.4; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimet: më i madh (e madhe), më i vogël (e vogël)

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton sende duke i përdorur fjalët: më i madh, më i vogël;
- Grupon sende sipas madhësive të ndryshme;
- Krahason objekte sipas madhësisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, balona, shkronja kartoni, vizore, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Para nxënësve paraqiten dy tullumbace (balona) me madhësi të ndryshme. U kërkohet t'i përshkruajnë balonat sipas madhësisë duke i përdorur saktë fjalët "më i madh", "më i vogël".

**Hapi 2**: Nxënësve u kërkohet që të punojnë në grupe, ku çdo grup do ta ketë detyrën e njëjtë, por mjete të ndryshme pune (kompletin e petëzave, shkronja kartoni, libra, fletore, lapsa me madhësi të ndryshme, kuti me madhësi të ndryshme). Çdo grup do t'i grupojë sipas madhësisë mjetet e veta punuese. Në përfundim do t'i emërtojnë grupet e formuara, p.sh.: grupi i shkronjave të mëdha, grupi i shkronjave të vogla.




**Hapi 3:** Nxënësit i hapin librat dhe nxiten t'i krahasojnë madhësitë e figurave, kafshët e dhëna në libër, duke përdorur saktë fjalët "më i madh", "më i vogël" gjatë emërtimit të tyre. Udhëzohen për kërkesat e detyrave.

**Hapi 4**: Nxënësit vizatojnë në dyshe. Njëri nga ata do të vizatojë një objekt të madh, tjetri të njëjtin objekt, por të vogël. Ndërrohen rolet.

**Hapi 5**: Nxënësit udhëzohen që në mënyrë individuale të vizatojnë figurën (barkën) dy herë më të madhe se figura e dhënë.

**VEPRIMTARI SHTESË:**
Nxënësve u shpërndahen fletë dhe udhëzohen të punojnë në dyshe. Njëri vizaton një figurë të vogël, kurse tjetri të njëjtën figurë, por të madhe.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit grupojnë, krahasojnë, emërtojnë dhe vizatojnë saktë sendet, objektet sipas madhësisë.

**Detyrë:**
Vizatoni tri sende të ndryshme sipas madhësisë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 9

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Orientimi

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, në.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.1; 3.5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Kuptimet: brenda, jashtë dhe në

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përdor fjalët brenda, jashtë, në për pozitën e objekteve.
- Paraqet me anë të vizatimit kuptimet: brenda, jashtë, në;
- Vendos petëza *brenda* diagramit të bashkësisë, *jashtë* tij dhe *në* të.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, shkopinj, fasule, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Një grup nxënësish ftohen që të luajnë lojën "Macja e miu". Kapen dorë për dore për ta formuar rrethin. Dy nxënës të tjerë kanë role të ndryshme: njëri nxënës e ka rolin e miut e tjetri rolin e maces. Miu dhe macja do të lëvizin lirshëm nëpër klasë deri në momentin kur themi "macja". Atëherë miu vrapon drejt rrethit për të shpëtuar. Kur thuhet "iku", miu është i lirë prapë për të lëvizur nëpër klasë. Përsëriten dy-tri herë këto veprime. Në fund u përgjigjen pyetjeve: Ku ndodhet miu kur shpëton? Po macja?




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të vëzhgojnë ilustrimet e dhëna në detyrën 1. Ata do të tregojnë se cili ndodhet brenda, jashtë apo në objektin e caktuar.

**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet që në mënyrë individuale të punojnë në detyrën 2. Ata do të ngjyrosin rrathët brenda, jashtë, në me ngjyra të caktuara.

Kontrollohet saktësia e punës.

**Hapi 4**: Çdo nxënës me një fije peri do të formojë një rreth, në të cilin do të vendosë petëza (shkopinj, fasule) sipas dëshirës.

Ai e shpjegon punën e tij para klasës duke i përdorur saktë fjalët: brenda, jashtë, në.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përdorimit të fjalëve që përcaktojnë pozitën e objekteve.

**Detyrë:**
Vizatoni sende sipas dëshirës brenda, jashtë, në rrethin e formuar.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 10

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësi si një grumbull objektesh;
- Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1,4; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.3; 3.4,5; 4.2; 6.1,2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Bashkësia, elementet e bashkësisë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan grumbullimin si bashkësi dhe element bashkësie;
- Dallon bashkësi sipas një vetie të përbashkët të elementeve;
- Krijon së paku dy bashkësi me mjete të punës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete të punës, petëza, lapsa me ngjyra, shkopinj, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Arsim për zhvillim të përbashkët.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit ftohen të ndahen, në një skaj të klasës vajzat, dhe në skajin tjetër djemtë. Bisedohet me ata se si janë ndarë, çfarë janë formuar. Këtu njoftohen nxënësit se këto grumbullime paraqesin bashkësi dhe se vajzat apo djemtë paraqesin elemente të bashkësisë.
Si mund të emërtohen këto bashkësi?

Duhet të dalë në pah vetia e përbashkët e elementeve të bashkësisë së caktuar.




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet që t'i hapin librat dhe në dyshe të vështrojnë foton e dhënë për të përshkruar se çfarë shohin nëpër parcela.

Lipset nga ata që të rrethojnë mollët dhe të tregojnë se çfarë formuan. Nxënësve u sqarohet se në këtë bashkësi, mollët paraqesin elemente.

Nxënësit vazhdojnë të rrethojnë pemët e perimet e tjera. Pas rrethimit, nxiten ata të përdorin fjalët *bashkësi* dhe *element i bashkësisë*.

**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet që në mënyrë të pavarur të krijojnë bashkësi me mjete të ndryshme të punës që kanë mbi bankë (fasule, shkopinj, lapsa, petëza).





**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në përshkrimin e aktiviteteve apo detyrës përkatëse dhe përdorimin e saktë të fjalës bashkësi dhe element bashkësie. Po ashtu vlerësohen për saktësinë e krijimit të bashkësive.

**Detyrë:**
Vizatoni dy bashkësi sipas dëshirës në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 11

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3, II. 1, 2, 4, III. 2, 3, 6, IV. 5, VI. 2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 2, 5, 2. 1, 3. 1, 2, 4, 4. 2, 5. 1, 6, 1, 2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numërimi i elementeve që formojnë një bashkësi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve;
- Plotëson bashkësitë me numrin e elementeve;
- Numëron elementet e bashkësisë së krijuar.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Figura me ngjyra të ndryshme (të verdha, të kaltra, të gjelbra, të kuqe), objekte në klasë (banka, karrige, çanta të ngjyrave etj.), spango.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të formojnë grumbuj të ndryshëm të sendeve (formohet grupi i bankave, i karrigeve, i çantave të ngjyrave, i lapsave, i gomave).
Pyeten:
- Si quhen këto grupe të formuara? (*Bashkësi*).
- Cilat bashkësi u formuan? (*Bashkësia e karrigeve etj*).
- Si quhen sendet në bashkësi? (*Elemente*).
- Sa elemente kanë bashkësitë? (*Tregohet numri i elementeve*).




**Hapi 2**: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë fotografinë që fillimisht të emërtojnë bashkësitë dhe më pas në etiketat e zbrazëta të përcaktojnë numrin e elementeve siç është dhënë te bashkësia e çantave.

**Hapi 3:** Me figurat gjeometrike, të cilat mund të jenë trekëndësha, katrorë, rrathë dhe drejtkëndësha, të përgatitura paraprakisht, të formojnë bashkësi sipas vetive të tyre, si p.sh., sipas ngjyrës (të verdha, të kaltra, të gjelbra, të kuqe).

**Hapi 4:** Bashkësinë e formuar në grup nxënësit e vizatojnë në fletore duke e paraqitur numrin e njëjtë të elementeve dhe duke i ngjyrosur me po të njëjtën ngjyrë.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive dhe saktësinë e paraqitjes së numrit të elementeve të bashkësisë.

**Detyrë:**

Vizatoni dy bashkësi me elemente sipas dëshirës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 12

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3, II. 1, 2, 4, III. 2, 3, 6, IV. 5, VI. 2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 2, 5, 2. 1, 3. 1, 2, 4, 4. 2, 5. 1, 6, 1, 2.


BASHKËSIA, ELEMENTET E BASHKËSISË

Ushtrojmë

1

Objektet (elementet) e bashkësisë dallohen për ndonjë veti të tyre. Duke veçuar vetinë e elementeve, rrethojmë me të kuqe bashkësinë e fluturave, me të kaltër bashkësinë e zogjve, me të gjelbër bashkësinë e balonave dhe me të verdhë bashkësinë e rrathëve.

2

Dallojmë me √ elementin që nuk e ka vetinë e elementeve të tjera brenda bashkësisë.

17

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Bashkësia, elementet e bashkësisë /U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rrethon bashkësinë duke u bazuar në vetinë e elementeve;
- Krijon bashkësi sipas vetisë së përbashkët të elementeve;
- Dallon elementin që nuk e ka vetinë e elementeve të tjera brenda bashkësisë

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete të ndryshme brenda klasës, spango.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të formojnë bashkësi me veti të përbashkët me gjësendet që kanë në klasë. Bashkësitë e formuara mund të jenë bashkësia e lapsave, e gomave, e çantave, e çantave të ngjyrave etj.

**Hapi 2**: Nxënësit e vëzhgojnë detyrën 1, u shpjegohet atyre vetia e formimit të bashkësive (bashkësia e fluturave rrethohet me të kuqe, bashkësia e zogjve me të kaltër, bashkësia e balonave me të gjelbër dhe bashkësia e rrathëve me të verdhë). Secila bashkësi e ka vetinë e vet të përbashkët.




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të dallojnë me shenjën "v" elementin që nuk e ka vetinë e elementeve të tjera brenda bashkësisë.

**Hapi 4:** Diskutohet me ata: Pse keni vendosur "v" te elementi karrige? (Nuk kanë veti të përbashkët me specat etj.)

**Hapi 5:** Organizohet një aktivitet me nxënësit e klasës. Me spango, në dysheme të klasës formohet një bashkësi boshe (e zbrazët). Nxënësit shëtisin nëpër klasë, mësimdhënësi ua thotë një veti të përbashkët të bashkësisë që duhet formuar, p.sh.: nxënësit të cilët janë djem, vajza, nxënësit më të shkurtër se Blerimi, nxënësit më të gjatë se Blerimi etj). Vetinë e bashkësisë e përcakton mësimdhënësi i klasës, sepse njeh veçoritë e klasës së tij.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, për dallimin e saktë të vetisë së elementeve të bashkësisë së dhënë.

**Detyrë:**

Formoni disa bashkësi në fletore sipas vetisë së përbashkët që i jep nxënësi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 13

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3, II. 1, 2, 4, III. 2, 3, 6, IV. 5, VI. 2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 2, 5, 2. 1, 3. 1, 2, 4, 4. 2, 5. 1, 6, 1, 2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraqitja e bashkësisë me diagram

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Formon bashkësinë me anë të diagramit;
- Krijon bashkësi sipas ngjyrës dhe formës;
- Përcakton bashkësinë e formuar sipas vetisë së përbashkët të elementeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fruta, perime, sende të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit kanë marrë me vete nga shtëpia gjërat e kërkuara. Ata të cilët kanë fruta formojë bashkësinë e frutave, të tjerë që kanë perime formojnë bashkësinë e perimeve, dhe nxënësit me sende formojnë dy grupe të tjera. P.sh.: me sendet që përdoren në shkollë formohet bashkësia e re dhe me sendet që përdoren në kuzhinë formohet bashkësia tjetër. (Bashkësitë formohen varësisht nga numri i nxënësve në klasë).

**Hapi 2**: Ushtrimi 1 u shpjegohet nxënësve për paraqitjen e bashkësisë me diagram, e cila bëhet duke i




rrethuar elementet e saj me një vijë të mbyllur.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet në ushtrimin 2 të formojnë bashkësi nga elementet e njëjta.

**Hapi 4:** Në ushtrimin 3 udhëzohen të krijojnë bashkësi duke marrë për bazë ngjyrën dhe formën.

**Hapi 5:** Në ushtrimin 4 nxënësit udhëzohen të krijojnë bashkësi duke marrë për bazë vetinë e formimit të bashkësive në ushtrimin paraprak.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, për dallimin e saktë të ngjyrës dhe formës së elementeve me të cilat kanë formuar bashkësinë.

**Detyrë:**
Të formohen disa bashkësi në fletoret e nxënësve sipas ngjyrës dhe formës së elementeve.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 14

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3, II. 1, 2, 4, III. 2, 3, 6, IV. 5, VI. 2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 2, 5, 2. 1, 3. 1, 2, 4, 4. 2, 5. 1, 6, 1, 2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraqitja e bashkësisë me diagram/U




**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Formon bashkësi nga elementet me formë dhe ngjyrë të njëjtë;
- Grupon elemente sipas vetisë së përbashkët;
- Emërton bashkësinë me shkronja të mëdha të alfabetit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fruta, perime, figura gjeometrike të punuara nga nxënësit (katrorë, drejtkëndësha, trekëndësha dhe rrathë).

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lipset nga nxënësit që figurat gjeometrike të punuara në shtëpi t'i grupojnë sipas vetisë që u kërkohet. Rrethimi i këtyre elementeve bëhet me spango.
Diskutohet për bashkësitë e formuara nga nxënësit e klasës. Prezantohen bashkësitë e formuara me figurat gjeometrike dhe tregohet vetia e përbashkët e formimit të bashkësive.

**Hapi 2**: Diskutohet me nxënës:
Shembujt e dhënë në detyrën 1 a paraqesin bashkësi? Jo, sepse vija e lakuar është e hapur.


PARAQITJA E BASHKËSISË ME DIAGRAM

Ushtrojmë

1 Duke i rrethuar elementet, paraqesim bashkësinë. Themi se bashkësia është paraqitur me diagram. Mbyllim vijën për të treguar paraqitjen e bashkësive me diagram.

2 Duke rrethuar, formojmë bashkësi nga elementet e të njëjtit lloj.

3 Formojmë bashkësitë me elemente të një ngjyre dhe i emërtojmë ato.

19

Çfarë duhet të bëhet për të krijuar bashkësi? Vija e hapur duhet të mbyllet.
Si quhet bashkësia e paraqitur me vijë? Bashkësia e paraqitur me vijë është bashkësi e paraqitur me diagram.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të formojnë bashkësi me elemente të të njëjtit lloj.

**Hapi 4:** Lipset nga ata të formojnë bashkësi me elemente të një ngjyre dhe të emërtohen ato.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që bashkësitë e krijuara me diagram të vizatohen në fletore.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, për formimin e bashkësive sipas vetisë së kërkuar me anë të diagramit.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 15

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3, II. 1, 2, 4, III. 3, 6, IV. 5, VI. 2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1. 5, 2. 1, 3. 2, 4, 4. 2, 6, 1, 2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri i elementeve të bashkësisë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon numrin e elementeve të bashkësisë së dhënë;
- Lidh bashkësinë me numrin e elementeve të dhëna;
- Plotëson bashkësinë me elemente aq sa tregon numri i dhënë dhe anasjelltas;
- Zbulon rregullën e nisur duke ngjyrosur.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4 të përgatitura nga mësimdhënësi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Janë përgatitur fletë të bardha me numër të caktuar të elementeve, të cilat u shpërndahen nxënësve. Ata i ngjyrosin elementet dhe krijojnë çifte me shokun që ka numër të njëjtë të elementeve. Bashkëbisedohet me nxënësit: Pse u krijuat kështu në çifte? Ata u krijuan në çifte, sepse kanë numër të njëjtë të elementeve.

**Hapi 2**: Nxënësit nxiten t'i vëzhgojnë bashkësitë duke i numëruar elementet, pastaj të lidhin numrin me katrorin që tregon po atë numër të elementeve. Në pjesën tjetër të kësaj detyre kërkohet që të numërohen elementet dhe të vizatohen në katrorin e zbrazët ato elemente me rrathë të vegjël.




**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të plotësohet bashkësia me numrin e elementeve që kërkohet në katrorin e zbrazët.

**Hapi 4:** Nxënësit zbulojnë rregullën e vargut të nisur duke i ngjyrosur kubet.

Disa nga nxënësit paraqesin punët e tyre para nxënësve të klasës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive; shkruan pika aq sa ka numër të elementeve në bashkësi.

**Detyrë:**
Në fletoren e nxënësve të paraqiten bashkësi dhe të tregohet numri i elementeve të tyre.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 16

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objek-tesh.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I. 3; II.1, 4; III.2, 3, 7; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2, 5; 2.1; 3.1, 4, 4.2,5; 6.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri i elementeve të bashkësisë /U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon numrin e elementeve të bashkësisë së dhënë;
- Lidh bashkësinë me numër të njëjtë të elementeve;
- Plotëson bashkësinë me elemente aq sa tregon numri i dhënë dhe anasjellas.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ilustrim, fasule me ngjyra, fije peri, etiketa me pika.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në çdo kënd të klasës vendosen bashkësi të ndryshme, me numër të ndryshëm të elementeve. Nxënësve u shpërndahen etiketa me numër të ndryshëm të rrathëve. Kërkohet të vendosin etiketën te bashkësia që tregon numër të njëjtë të elementeve. Nxënësit emërtojnë bashkësitë dhe tregojnë numrin e elementeve.








**Hapi 2**: Nxënësve u kërkohet të vështrojnë me vëmendje foton në detyrën 1. Çfarë po shihni? Ku janë të vendosura mollët?
Poshtë mollëve janë disa katrorë me rrathë. Si duhet të veprojmë?
Nxënësit lidhin bashkësinë me numrin e elementeve të dhëna në katror.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të vendosin mbi bankë një fije peri të kuq. Brenda fijes vendosin disa fasule me ngjyra. Prej tyre kërkohet t'i numërojnë fasulet dhe në etiketa të vogla të vizatojnë aq rrathë sa është numri i fasuleve. Pas kësaj veprimtarie nxënësit në dyshe e plotësojnë ushtrimin 2. I numërojnë frutat në pjata dhe vendosin aq rrathë në katrorët e zbrazët.

Ata kontrollojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë kryerjes së detyrës.

**Hapi 4:** Udhëzohen të punojnë në dyshe. Një nxënës vizaton një bashkësi me elemente sipas dëshirës, nxënësi tjetër shënon në etiketë numrin e elementeve me rrathë.

Veprimtaria kryhet në formë loje, nxënësit ndërrojnë rolet me njëri-tjetrin. Vlerësohet puna e nxënësve.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, emërtimin e saktë të numrit të elementeve, vendosjen e rrathëve në katrorë dhe plotësimin e elementeve sipas numrit të dhënë.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 3 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 17

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet: më shumë, më pak, aq sa.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, 3; II. 1, 4; III. 2, 3, 7; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2, 5; 2.1,3; 3. 1, 2, 4; 5.1; 6.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve




**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve;
- Lidh bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve;
- Formon bashkësi nga elemente të njëjta.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa, fletë të bardha, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit ftohen të vëzhgojnë me vëmendje disa bashkësi me shkronja, të fjalëve "ERA, URA, MAKINA, LIBRAT". Prej tyre kërkohet të tregojnë sa është numri i elementeve në secilën bashkësi, pastaj t'i lidhin ato me numër të njëjtë të elementeve.






**Hapi 2**: Nxënësve u kërkohet t'i hapin librat dhe në dyshe të vështrojnë foton e detyrës 1. Përshkruani se çfarë shihni në natyrë? Sa është numri i pemëve? Po i luleve? Sa bashkësi janë paraqitur me diagram? A kanë numër të njëjtë të elementeve?
Nxënësit nxiten të përshkruajnë ilustrimin duke përdorur saktë shprehjen: *bashkësi me numër të njëjtë të elementeve.*

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të lidhin bashkësitë që kanë numrin e njëjtë të elementeve në detyrën 2. Më pas, librat shkëmbehen me shokun e bankës për ta vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

**Hapi 4:** Nxënësve u shpërndahen disa fletë të bardha. Prej tyre kërkohet të vizatojnë dy bashkësi me numër të njëjtë të elementeve.

Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në përshkrimin e detyrës, saktësinë e lidhjes së bashkësive me numër të njëjtë të elementeve dhe formimin e bashkësive me elemente të njëjta.

**Detyrë:**
Vizatoni bashkësi sipas dëshirës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 18

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet: më shumë, më pak, aq sa.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.2, 3; II. 1, 4; III. 2, 3, 7; IV. 5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2, 5; 2. 1, 3; 3. 1, 2, 4; 6. 1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Formon bashkësi me elemente të njëjta;
- Lidh bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve;
- Krijon së paku dy bashkësi me numër të njëjtë të elementeve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të bardha, fasule, petëza, zare.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet që në dyshe me shokun e bankës të luajnë lojën me zare. Njëri prej dyshes hedh zarin, nxënësi tjetër formon bashkësi me aq elemente sa tregon numri në zar. Më pas, nxënësit ndërrojnë rolet.






**Hapi 2:** Nxënësit vështrojnë me kujdes foton në detyrën 1. I emërtojnë bashkësitë dhe numërojnë se nga sa elemente janë të përbëra ato. Udhëzohen ata t'i lidhin bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve.

**Hapi 3:** Nxënësit në dyshe identifikojnë bashkësitë me numër të njëjtë të elementeve, pastaj i lidhin me vija.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të grupohen brenda rrathëve të vendosur në dysheme, ashtu që të formojnë bashkësi me numër të njëjtë të nxënësve.

**Hapi 5:** U shpërndahen disa fletë ku janë të vizatuara dy bashkësi boshe. Kërkohet nga nxënësit që në mënyrë individuale të krijojnë bashkësi me numër të njëjtë të elementeve. Si element mund të përdorin topa të vegjël, fasule, kapakë, makarona etj.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për lidhjen e bashkësive me numër të njëjtë të elementeve dhe krijimin e bashkësive me mjete të ndryshme të punës.

**Detyrë:**

Vizatoni dhe ngjyrosni bashkësi sipas dëshirës në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 19

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1, 4; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1; 6.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Formimi i bashkësisë nga dy bashkësi të dhëna

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Formon një bashkësi nga dy bashkësi të dhëna;
- Emërton bashkësitë e formuara.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza rrethore, petëza katrore, fije.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësit ftohen të ndahen në dy grupe, grupi i vajzave dhe i djemve. Diskutohet me ta se çfarë kanë formuar dhe se si mund të emërtohen këto dy bashkësi. Udhëzohen vajzat dhe djemtë të bashkohen në një bashkësi të vetme.

Pyeten:
- Çfarë keni formuar?
- Si do ta emërtojmë bashkësinë e re?

**Hapi 2:** Pranë tabelës vendosen disa vizore dhe lapsa, duke formuar dy bashkësi të ndryshme. Nxënësit nxiten t'i emërtojnë bashkësitë e formuara. Më pas kërkohet të bashkohen në një bashkësi duke e emërtuar atë.




**Hapi 3:** Nxënësit i hapin librat për t'i përshkruar figurat 1 dhe 2 që gjenden aty. Udhëzohen t'i emërtojnë bashkësitë e formuara dhe të tregojnë numrin e elementeve.
- Në detyrën 1 formohet bashkësia e zogjve, ndërsa në detyrën 2 formohet bashkësia e kafshëve.

**Hapi 4:** Nxënësve në dyshe u kërkohet të vendosin mbi bankë nga një fije peri. Njëri vendos brenda fijes petëza rrethore  e tjetri petëza katrore.

Pyeten:
- Çfarë bashkësie formuat?
- A mund të krijojmë një bashkësi të re?

Nxënësit udhëzohen t'i rrethojnë dy bashkësitë me një fije duke formuar bashkësinë e petëzave. Bazuar në këtë aktivitet nxënësit e plotësojnë detyrën 3 në libër.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet të plotësojnë individualisht detyrën 4. Nga bashkësia
e madhe të formojnë dy bashkësi të vogla sipas vetisë së caktuar të elementeve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e formimit të bashkësisë nga dy bashkësi të dhëna dhe emërtimit të tyre.

**Detyrë:**
Të vizatohet një bashkësi e mollëve dhe një bashkësi e dardhave.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 20

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1, 4; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2; 3.1; 6.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon numrin e elementeve të bashkësisë së dhënë;
- Klasifikon elementet e bashkësisë sipas formës dhe ngjyrës;
- Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e elementeve.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fasule, fije të kuqe.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të nxjerrin mbi bankë dy fije të kuqe dhe petëza me forma të ndryshme. U kërkohet të formojnë bashkësi të ndryshme me petëza, duke marrë për bazë formën.
Nxënësit i emërtojnë bashkësitë e formuara: bashkësi me katrorë, drejtkëndësha, rrathë, trekëndësha.








**Hapi 2:** Nxënësit ftohen të punojnë për plotësimin e ushtrimeve të librit. Bashkërisht punohen detyrat 1 dhe 2. Në ushtrimin 1 nxënësit duhet të numërojnë: aeroplanët, antenat, peshqit, kitarat, dhe makinat, pastaj t'i plotësojnë katrorët me rrathë.
Në detyrë 2 udhëzohen ata që t'i klasifikojnë elementet e bashkësisë sipas ngjyrës dhe formës.

Mund të ndihmohen me anë të pyetjeve:
- Sa elemente janë me ngjyrë të gjelbër?
- Sa me ngjyrë të kaltër?
- A ka më shumë elemente me ngjyrë të kaftë apo të verdhë?
- Në tabelën tjetër, elementet me cilën formë duhet t'i vendosim në rreshtin e parë?

Kontrollohet saktësia e punës.

**Hapi 3:** Nxënësve u shpërndahen disa fletë ku janë të vizatuara disa elemente dhe dy bashkësi boshe. U kërkohet që në mënyrë individuale të formojnë dy bashkësi me ato elemente.

- Bashkësia A përmban elemente në formë trekëndore.
- Bashkësia B përmban elemente me ngjyrë të verdhë.



A

B

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të numrit të elementeve në bashkësitë e dhëna, klasifikimin e elementeve sipas formës dhe ngjyrës dhe krijimin e bashkësive duke u bazuar në cilësitë e elementeve.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 3 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 21

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Krahason bashkësitë duke përdorur shprehjet: më shumë, më pak, aq sa.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1,4; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2,4; 4.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimet: Më shumë se, më pak se dhe aq sa

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përdor konceptet matematikore: më shumë se, më pak se dhe aq sa;
- Shoqëron elementet e bashkësive për të arritur në përfundim se cila prej tyre ka më shumë se, më pak se dhe aq sa;
- Paraqet me anë të vizatimit bashkësi me më shumë se, më pak se dhe aq sa elemente.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, spango dhe mjete mësimore të nxënësve

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxirren para klasës tre nxënës, dy prej të cilëve u jepet nga një laps në dorë. Përdoren me kujdes termat krahasues: *më shumë, më pak* elemente.

**Hapi 2:** Pasi nxënësit e kanë të qartë këtë lloj krahasimi, kalohet në krahasimin e bashkësive me numër të njëjtë të elementeve. Nxirren para klasës 6 nxënës dhe 6 karrige. U kërkohet atyre që të ulen në karrige. Pyeten nxënësit: Çfarë ka më shumë? Çfarë ka më pak?




**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të formojnë bashkësi me aq lapsa sa petëza. Formojnë bashkësi me më shumë ngjyra se goma. Udhëzohen nxënësit të shoqërojnë një për një elementet e një bashkësie me një tjetër për të dalluar sasinë e njëjtë, më shumë apo më pak të elementeve të dy bashkësive.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet t'i vështrojnë figurat e librit. Detyrat punohen në mënyrë individuale duke i shoqëruar elementet e dy bashkësive. Ndihmohen nxënësit për të lexuar kërkesat e detyrave. Nxiten ata të përdorin fjalët: *më pak, më shumë* dhe *aq sa*.

**Hapi 5:** Nxënësit në mënyrë të pavarur plotësojnë detyrën 3. Duke i shoqëruar, në rastin e parë vizatojnë më shumë elemente në bashkësinë B se sa ka në bashkësinë A. Në rastin e dytë, vizatojnë më pak elemente në bashkësinë B se sa ka në bashkësinë A. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen nga pjesëmarrja aktive në diskutim dhe për përdorimin e saktë të koncepteve matematike - më pak, më shumë dhe aq sa.

**Detyrë:**

Vizatoni bashkësi me numër të ndryshëm të elementeve.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 22

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Bashkësitë dhe relacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve);
- Paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit;
- Numëron dhe shkruan numrin e elementeve të bashkësisë së dhënë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.7; III,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.1; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Formon bashkësi nga elementet e njëjta;
- Përdor diagramin për të formuar bashkësitë;
- Shkruan saktë numrin e elementeve të bashkësisë së dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, fasule, penj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen në grup të nxjerrin petëzat (figurat gjeometrike). Ata do të formojnë bashkësi të ndryshme. Shtrohen pyetjet: Sa petëza të kuqe keni grupi juaj? Po të verdha? Nxënësit tregojnë duke ngritur gishtërinjtë.

**Hapi 2:** Nga nxënësit kërkohet të ndajnë petëzat sipas formës, duke i rrethuar me penj për të formuar bashkësi.




Pyeten: Çfarë kanë të përbashkët? A mund të formojmë bashkësi edhe në bazë të ngjyrës? Po në bazë të madhësisë?

**Hapi 3:** Pranë bashkësive vendosin fasulet për të treguar se nga sa petëza ka secila bashkësi. Vendosin lapsat në mes, dhe lapsi i tërhequr nga mësuesja, tregon se nga sa elemente ka secila bashkësi.

**Hapi 4:** Hapen librat dhe nxënësit, punojnë në mënyrë individuale. Udhëzohen që në detyrën e parë të numërojnë elementet, dhe në katror të shënojnë pika sa ka edhe elemente.

Në detyrën e dytë të vizatojnë aq elemente sa ka edhe pika.

Detyra 4 të punohet duke rrethuar me anë të diagramit sipas vetisë së përbashkët. Në katrorin e zbrazët të shënojnë pikët që tregojnë numrin e elementeve, ashtu sikurse punuan më parë me fasule.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen nga pjesëmarrja aktive në bashkëbisedim, si dhe plotësimi i saktë i detyrave: krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve); paraqet bashkësinë përmes diagramit të Venit; numëron dhe shkruan numrin (pikët) e elementeve të bashkësisë së dhënë.

**Detyrë:**
Të ngjyroset ushtrimi 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 23

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III,2; V.5

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 5.1




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri një

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon bashkësitë me një element;
- Përcakton vlerën sasiore të tij;
- Shkruan saktë grafikun e numrit një.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të printuara, petëza, spango, fasule, gjëra përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Paraqitet në projektor figura, dhe kërkohet që nxënësit t'i emërojnë elementet. Më pas ata identifikojnë se cilat figura kanë nga një element. Në bankat e tyre formojnë me spango dhe petëza bashkësi me 1 element.



**Hapi 2:** Hapen librat, diskutohet fotografia e ushtrimit të parë. Ku ndodhen nxënësit? (Në klasë). Sa nxënës po vijnë? ( Një). Në projektor paraqitet vjersha për numrin 1: https://youtu.be/fU_Yq7y2V5M




**Hapi 3:** Ushtrimi i dytë paraqet bashkësinë me një element duke shtuar njohuritë për grafikun e numrit "një". Vizatohet në tabelë një bashkësi me një element. Shkruhet grafiku i numrit 1. Ftohen disa nxënës të shkruajnë në tabelë grafikun e numrit 1.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të punojnë ushtrimin 3 dhe 4 në libër, gjithnjë duke treguar kahet e shkrimit të numrit 1.

**Hapi 5:** Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me fletët e printuara. Duke përcjellë kahet e shigjetës për paraqitjen e numrit 1, të vazhdojnë të shkruajnë dy rreshta me grafikun e numrit 1 e më pas të ngjyrosin vetëm rrathët që paraqesin numrin 1.
Puna e nxënësve vlerësohet.

**AKTIVITET SHTESË**
Mësohet vjersha për numrin 1
NJËSHI
Hapim librin dhe e shohim,
Të gjithë njëshin ne e njohim:
E ka trupin si qiri,
Qëndron drejt e pa u shtri.
Ka një strehë lart në kokë,
me një këmbë rri në tokë.
Një jam unë,
Një je ti,
Një dhe nëna
Shqipëri!



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e bashkësisë me 1 element, përcaktimin e vlerës sasiore dhe paraqitjen grafike të numrit 1.

**Detyrë:**
Në fletore të vizatohet një bashkësi me 1 element dhe të shkruhen tre rreshta me grafikun e numrit 1.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 24

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III,2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri dy

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon bashkësitë me dy elemente;
- Përcakton vlerën sasiore të tij;
- Shkruan saktë grafikun e numrit dy.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të printuara, petëza, spango, fasule, gjëra përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në projektor paraqitet vjersha për numrin 2: Numri 2- vjershë - YouTube
Nxitet diskutim rreth videos duke parashtruar pyetjet: Çfarë shihet në ekran? (2 zogj) Çfarë përmendet tjetër? (2 sy, 2 veshë, 2 këmbë, 2 duar, 2 vetulla, 2 sy).

**Hapi 2:** Vizatohen në tabelë 2 qershi, 3 lule, 1 mollë. Nxënësve u kërkohet të identifikojnë figurën që ka 2 elemente. Pasi merren përgjigjet e duhura, nxënësit paraqesin në dyshe në bankat e tyre bashkësi me dy elemente. Mund të jenë me libra, fletore, lapsa, goma, ngjyra, petëza, fasule etj. Nxiten ata të




mendojnë dhe të thonë: dy emra njerëzish, dy emra kafshësh dhe dy emra lulesh si dhe cilat pjesë të trupit i kanë nga dy (p.sh., sytë, veshët, duart, këmbët).

**Hapi 3:** Shkruhet në tabelë grafiku i numrit 2. Nxënësit formojnë me plastelina numrin 2 në bankat e tyre.

**Hapi 4:** Hapen librat, diskutohet fotografia e ushtrimit të parë, duke pyetur se nga sa nxënës janë të vendosur brenda rrathëve. Po ashtu udhëzohen të ngjyrosin rrathët poshtë fotografive. Praktikë e udhëhequr me ushtrimin e tretë në libër, gjithnjë duke udhëzuar kahet e shkrimit të numrit 2. Ndërsa në ushtrimin 4 kërkohet të formojnë bashkësi me 1 dhe 2 elemente, duke i shoqëruar me shportën që mban po atë numër.

**Hapi 5:** Praktikë e pavarur me fletët e printuara. Duke përcjellë kahet e shigjetës për paraqitjen e numrit 2, të vazhdojnë të shkruajnë 2 rreshta me grafikun e numrit 2 e më pas të ngjyrosin vetëm rrathët që paraqesin numrin 2. Puna e nxënësve vlerësohet.





**AKTIVITET SHTESË** - Mësohet vjersha për numrin DY

| | |
|---|---|
| Një dhe një na bëjnë Dy,<br>Të gjithë kemi nga dy sy.<br>Sytë i duam për të parë,<br>kurse duart për t'u larë | ... e që rrugës mos të ngecim,<br>nga dy këmbë që të ecim...<br>Unë jam Gimi, kjo është Leta,<br>vëlla e motër bëjmë dy veta. |

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e bashkësisë me 2 elemente, përcaktimin e vlerës sasiore dhe paraqitjen grafike të numrit 2.

**Detyrë:**
Në fletore të vizatohet një bashkësi me 2 elemente dhe të shkruhen tre rreshta me grafikun e numrit 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 25

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.
- Numëron me rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III,2; V.5 .

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri tre

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon bashkësitë me tri elemente;
- Përcakton vlerën sasiore të tij;
- Shkruan saktë grafikun e numrit tre.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të printuara, petëza, spango, fasule, gjëra përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në projektor paraqitet përralla "Tre derrkucët" në https://www.youtube.com/watch?v=HYek-STNeGpo. Nxiten diskutimet rreth videos duke parashtruar pyetjet:
- Sa derrkucë ishin?
- Sa shtëpi ndërtuan?
- Cili derrkuc mendoi zgjidhjen më të mirë?

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të formojë bashkësi me tri elemente me mjetet që posedojnë. Shkruhet në tabelë grafiku i numrit 3 i shoqëruar me një bashkësi me tri elemente. Nxënësit formojnë me plastelina




në bankat e tyre numrin 3, pranë bashkësisë që formuan. Kërkohet nga ata të ngrenë tre gishta dhe të numërojnë 1, 2, 3 dhe anasjellas 3, 2, 1.

**Hapi 3:** Praktikë e udhëhequr ku nxiten nxënësit të formojnë një tregim të shkurtër me ushtrimin e parë, duke shtuar pyetje: Sa fëmijë janë? Ku ndodhen? Çfarë ka në natyrë? Nga sa bredha dhe sa lule janë?

**Hapi 4:** Nxënësit shkruajnë grafikun e numrit 3 në libër, gjithnjë duke udhëzuar kahet e shkrimit të numrit 3. Ndërsa në ushtrimin 4 kërkohet të shkruajnë numrin 3 aty ku mungon, ndërsa ku është numri 3, të vizatojnë elementet përkatëse. Ushtrimi i pestë, duke formuar numrin tre si shumë të dy mbledhorëve, nxënësit vazhdojnë të ngjyrosin flamujt dhe shkruajnë numrin në kutinë përkatëse.

**Hapi 5:** Praktikë e pavarur me fletët e printuara. Duke përcjellë kahet e shigjetës për paraqitjen e numrit 3, të vazhdojnë të shkruajnë dy rreshta me grafikun e numrit, e më pas të ngjyrosin vetëm rrathët që paraqesin numrin 3. Puna e nxënësve vlerësohet.

**AKTIVITET SHTESË**- Mësohet vjersha për numrin TRE

| | |
|---|---|
| Dielli ditën na jep dritë,<br>Tokën tonë gjallëron,<br>kurse Hëna vezullon,<br>vetëm netëve ndriçon. | Hënë, Diell edhe Tokë,<br>po t'i numërojmë tok,<br>japin numrin që mes nesh<br>e thërrasim gjithnjë TRESH. |



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e bashkësisë me 3 elemente, përcaktimin e vlerës sasiore dhe paraqitjen grafike të numrit 3.

**Detyrë:**

Në fletore të vizatohet një bashkësi me 3 elemente dhe të shkruhen tre rreshta me grafikun e numrit 3.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 26

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.2, III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5; 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat 1, 2 dhe 3/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan numrat 1, 2, 3;
- Dallon numrat 1, 2, 3;
- Rendit numrat 1, 2, 3 në vargje numerike.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shkopinj, etiketa, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të punojnë në dyshe. Njëri nga ta do të nxjerrë sipas dëshirës shkopinj (nga 1 – 3), kurse nxënësi tjetër shkruan numrin e shkopinjve në etiketë. Ndërrohen rolet.
Në fund krahasohen numrat nga 1 – 3. Për sa është më i madh numri 2 se numri 1?; Për sa është numri 1 më i vogël se numri 3?

**Hapi 2:** Udhëzohen të hapin librat dhe të vërejnë ilustrimin e dhënë. Përshkruajnë atë duke identifikuar numrin e saktë të zogjve dhe të qenve të caktuar. Shqiptimi i çdo numri shoqërohet me shkrimin e tij në etiketë. Librat shkëmbehen me shokun e bankës dhe nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin.




**Hapi 3:** Udhëzohen që në detyrën 2 të shkruajnë saktë numrin e elementeve brenda çdo bashkësie të dhënë. Në fund komentohet me fjalë, p.sh.: Kemi tri karota.

**Hapi 4:** Nxënësit nxiten të vëzhgojnë vargjet e katrorëve të detyrën 3. Ndihmohen përmes pyetjeve të gjejnë rregullën e çdo vargu për të vazhduar ngjyrosja e katrorëve.

Për rreshtin e parë: Çfarë mendoni, me cilën ngjyrë duhet vazhduar ngjyrosja e katrorit pas të kuqit? Pse?

Kështu vazhdohet edhe për vargjet e tjera me pyetje ndihmëse.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet të shkruajnë vargun rritës të numrave nga 1 deri në 3 dhe anasjelltas, nga numri 3 deri te numri 1. Shkëmbehen fletoret me shokun e bankës dhe vlerësohet saktësia e kryerjes së detyrës me vendosjen e njërës nga këto fytyra:





**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësi dallon, shkruan dhe rendit saktë numrat 1-3.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 e librit.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 27

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.2, III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat 1, 2 dhe 3/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shoqëron bashkësinë e objekteve me numrin përkatës të elementeve;
- Vizaton figura sa tregon numri në etiketë (1, 2 ose 3);
- Formon vargje numerike me 1, 2, 3 elemente.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, etiketa, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet ta shkruajnë emrin e tyre dhe ta rrethojnë shkronjën e parë të emrit. Pyeten: Sa shkronja keni rrethuar?; Cilën shkronjë e keni rrethuar me radhë?; Me cilën shkronjë fillon emri juaj? Secili nxënës do ta thotë shkronjën e parë të emrit të tij.

**Hapi 2:** Lipset nga nxënësit që të ngjyrosin nga një element në çdo bashkësi të dhënë në detyrën 1. Ata tregojnë se çfarë kanë ngjyrosur në çdo bashkësi; çfarë kanë të përbashkët këto tri bashkësi. Nxënësit nxiten të arrijnë te përgjigjja: Një element të ngjyrosur.

**Hapi 3:** Nxënësve u shpërndahen etiketa bashkësish me numër të ndryshëm të elementeve. Në çdo cep të klasës vendoset etiketa me numër të caktuar 1, 2 dhe 3.




Nxënësve u kërkohet ta vendosin etiketën e tyre te numri që tregon numrin e elementeve të bashkësisë. Parashtrohet pyetja:

Çfarë kanë të përbashkët bashkësitë që janë te numri 1?; Çfarë kanë të përbashkët bashkësitë te numri 2? Kështu vazhdohet edhe për bashkësitë me 3 elemente.

**Hapi 4:** Nxënësit shoqërojnë bashkësitë me numrin përkatës të elementeve në detyrën 6. Në përfundim, nxënësit tregojnë me fjalë për secilën bashkësi se sa elemente ka.

**Hapi 5:** Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 7. Vizatojnë aq figura sa tregon numri në etiketë. Librat shkëmbehen me shokun e bankës, me ç'rast vlerësohet saktësia e punës.

**Hapi 6:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë detyrën 8. Në rreshtin e parë, me çfarë ngjyre duhet vazhduar ngjyrosja e rrethit? Po pas së kuqes me cilën ngjyrë duhet ngjyrosur rrethi tjetër? Pra, sa rrathë duhen ngjyrosur me një ngjyrë të caktuar? Po në rreshtin e dytë, sa rrathë duhen ngjyrosur me ngjyrë të gjelbër? Kështu vazhdohet edhe për rreshtin e tretë.

**Hapi 7:** Nxënësve u shpjegohet loja "Peshkaqeni" që do ta luajnë. Ftohen të gjithë ata të lëvizin nëpër klasë dhe kur dëgjojnë fjalën "Peshkaqeni", ata duhet të formojnë bashkësi me tre nxënës për të shpëtuar nga peshkaqeni. Ata që mbesin, largohen nga loja. Kështu vazhdohet deri te tre fituesit e fundit.

I përgjigjen pyetjes: Çfarë kishin të përbashkët bashkësitë që ju formuat?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit shoqërojnë saktë bashkësinë me numrin e caktuar të elementeve, vizatojnë numrin e saktë të figurave dhe formojnë saktë vargje numerike sipas kërkesës.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 9 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 28

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, III.1, III.3, III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri katër

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon katër elemente në bashkësitë e dhëna;
- Shkruan saktë grafikun e numrit 4;
- Krijon bashkësi me katër elemente.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numër 4, fotografi, petëza, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të dëgjojnë një poezi. Poezia shoqërohet me fotografi sipas mundësive.




Katër këmbë kanë kafshët,
Katër brinjë katrori,
Katër stinë viti,
Katër rrota traktori.

U përgjigjen pyetjeve: Cila fjalë po përsëritet? Me cilin numër mund ta zëvendësojmë këtë fjalë?
Njëri nxënës do ta vendosë etiketën me numrin 4 mbi fjalën katër.




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet ta përshkruajnë pamjen e dhënë në detyrën 1. Çfarë shihni në fotografi?
Sa pemë? Sa mollë ka secila pemë? (kështu me radhë). Çfarë kanë të përbashkët ? (numrin 4).

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të formojnë bashkësi me katër elemente me petëza, shkopinj ose fasule. Në fund do të thonë: "Bashkësia ime ka katër petëza". Kërkohet të vëzhgojnë detyrën 2 në libër dhe ta përshkruajnë me fjalë. Demonstrohet edhe në tabelë:




**Hapi 4:** Paraqiten para nxënësve tri elementet e shkrimit të grafikut të numrit 4. Nxënësit shkruajnë numrin 4 në libër.




Atyre u kërkohet t'i vendosin me radhë numrat magnetikë nga 1 deri në 4 dhe nga 4 deri në 1: 1 2 3 4; 4 3 2 1.
Të njëjtat vargje i shkruajnë në libër në detyrën 3.

**Hapi 5:** Lipset nga nxënësit të shkruajnë numrin e elementeve të çdo bashkësie të dhënë në detyrën 4. Komentohet me fjalë numri i elementeve për çdo bashkësi.

**Hapi 6:** Vëzhgojnë detyrën 5 dhe e analizojmë së bashku. Sa flamuj të gjelbër kemi brenda litarit të parë? (3). Sa flamuj të verdhë?(1). Sa flamuj janë gjithsej?(4). Pra numrit 3 sa i duhet shtuar për të fituar numrin 4? Nxënësit punojnë të pavarur në detyrën 5. Librat shkëmbehen me shokun e bankës, me ç'rast vlerësojnë njëri-tjetrin për saktësinë e plotësimit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit dallojnë dhe krijojnë bashkësi me 4 elemente, si dhe shkruajnë saktë grafikun e numrit 4.

**Detyrë:**
Vizatoni objekte që kanë numrin 4 dhe e shkruan atë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 29

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri katër/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan numrat nga 1 deri në 4;
- Lexon numrat nga 1 deri në 4;
- Përcakton numrin e elementeve të bashkësive të dhëna.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numra magnetikë nga 1-4, fotografi kafshësh, etiketa me numra nga 1-4, fletë me bashkësi të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u paraqiten disa fotografi në tabelë. Kërkohet t'i vëzhgojnë e të tregojnë se çfarë paraqesin këto fotografi. Cila prej tyre nuk e ka vendin aty? Pse?






**Hapi 2:** Ftohen 4 nxënës të rreshtohen për një. Thirret një nxënës tjetër t'ua vendosë etiketat me numra sipas radhës që kanë në rresht. Komentohet me fjalë radhitja e tyre në rresht.

Nxënësit i shkruajnë numrat që tregojnë vendin e fëmijëve në rresht në detyrën 1.

**Hapi 3:** Ftohet një nxënës që t'i rendisë numrat magnetikë nga 1-4 me radhë në tabelë. Nxënësit e lexojnë vargun numerik të formuar: 1, 2, 3, 4. U përgjigjen pyetjeve: Çfarë formuam? (Varg numerik). Numrat në këtë varg numerik a po rriten apo po zvogëlohen? (Po rriten).

Nxënësi tjetër i rendit numrat nga 4-1: 4, 3, 2, 1. Lexohet vargu dhe tregojnë se numrat janë duke u zvogëluar.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të shkruajnë nëpër kutizat boshe numrat përkatës në detyrën 2 të librit. Leximi i vargjeve bëhet në dyshe. Njëri lexon vargun rritës e tjetri atë zvogëlues.

**Hapi 5:** Në katër muret e klasës do të vendosen katër bashkësi të ndryshme, me numër të elementeve nga 1 deri në 4. Nxënësve u shpërndahen etiketa me numra nga 1-4. U kërkohet ta vendosin etiketën te bashkësia që tregon numrin e elementeve të saj.




**Hapi 6:** Ata udhëzohen të qarkojnë numrin përkatës të elementeve për çdo bashkësi të dhënë. Nxënësit tregojnë se sa elemente ka secila bashkësi.

## Vlerësimi i nxënësve:

Shkruani dhe lexon saktë numrat deri në 4. Po ashtu përcakton saktë numrin e elementeve të bashkësisë.

**Detyrë:**
Shkruani numrat nga 1-4 dhe anasjellas, nga 4-1.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 30

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2; III.3; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.3; 3.5; 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri zero

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan me fjalë konceptin e numrit zero;
- Shkruan grafikun e numrit zero;
- Vizaton bashkësi me 0, 1, 2, 3, 4 elemente.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fotografi, numra magnetikë nga 0-4, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Hapet një diskutim rreth fotografive të paraqitura. Ka ndonjë lule në saksi? Shkruhet fjala: ASNJË.
Ka ndonjë peshk në akuarium? Prapë shkruhet fjala: ASNJË. Kam ndonjë gjë në dorë? Shkruhet fjala: ASGJË.



Çfarë mendoni, me cilin numër mund të zëvendësohet fjala ASNJË dhe ASGJË?

Zëvendësohet me numrin zero dhe vendosim 0 te fjalët: ASNJË, ASGJË.




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të shkruajnë numrin e elementeve të bashkësive në detyrën 1. Sa mollë kemi në fillim? Sa kemi në bashkësinë e fundit?

Sa fëmijë janë të ulur në stolin (ulësen) e parë? (0). Me cilin numër përfunduat? (4). Numëroni me radhë nga 0 deri në 4 dhe anasjelltas, nga 4 deri në 0.

**Hapi 3:** Paraqitet para nxënësve grafiku i numrit zero.

0 Me cilën shkronjë ju ngjason? Nxënësit e shkruajnë numrin 0 në detyrën 2, në kutiza duke lënë nga një kutizë të zbrazët mes numrave.

**Hapi 4:** Kërkohet të shkruajnë numrin e elementeve të bashkësive në detyrën 3 dhe 4. Pasi plotësohen në mënyrë individuale, ia komentojnë me fjalë shokut të bankës. Me këtë rast bëhet vlerësimi i ndërsjellë.

**Hapi 5:** Nxënësit do të punojnë në çifte në detyrën 5. Nxiten me anë të pyetjeve të dallojnë dy kërkesa brenda detyrës. Çfarë mendoni se duhet bërë majtas nga lapsi? (Duhet shkruar numrat nga 4 deri në 0). Çfarë duhet bërë djathtas nga lapsi? (Duhet vizatuar rrathë sa tregon numri).
Njëri nxënës shkruan numrat poshtë shtyllave me rrathë (4-0), kurse nxënësi tjetër vizaton rrathë në shtylla sa tregon numri poshtë tyre. Vlerësojnë saktësinë e njëri-tjetrit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit dallojnë numrin zero dhe shkruajnë saktë grafikun e tij. Vizatojnë saktë bashkësi me numra nga 0-4.

**Detyrë:**

Vizatoni pesë bashkësi duke filluar nga zero elemente bashkësia e parë e deri te bashkësia e fundit me katër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 31

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron me rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat deri në katër/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon numrat deri në 4;
- Shkruan numrat deri në 4;
- Percakton vlerën e numrave në vargun numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube me numra, shirit me numra, numra të printuar.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxirren para klasës katër nxënës. I jepet secilit prej tyre nga një numër i printuar në fletë A4, numrat 1 - 4. Ata mbajnë numrin në dorë përpara, në atë pozitë që mund ta shohin nxënësit e tjerë. Pyeten ata: Cili numër është ky? Nxënësit përgjigjen, p.sh., numri 1, 2, 3, 4. Pastaj radhiten numrat në anën e kundërt 4, 3, 2, 1 dhe i lexojnë ata.

**Hapi 2:** Nxënësve u shpërndahen kube me numra nga 1 deri në 4. U kërkohet atyre t'i radhisin kubet me numrat sipas radhës nga numri më i vogël deri te më i madhi 1, 2, 3, 4 dhe nga numri më i madh deri te më i vogli 4, 3, 2, 1.




**Hapi 3:** Paraqitet shiriti me numra deri në 4 në dysheme, ku mund ta shohin të gjithë nxënësit. Thirren disa nxënës dhe e lexojnë numrin duke shkelur mbi të. Një herë sipas rendit rritës, pastaj sipas rendit zbritës.




**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen t'i vështrojnë figurat e librit. Detyrat punohen në mënyrë individuale duke ngjyrosur rrethin për të plotësuar vargun e numrave dhe duke shkruar numrin që mungon. Plotësojnë njëherë vargun rritës 1, 2, 3, 4, pastaj plotësojnë dhe ngjyrosin vargun zbritës 4, 3, 2, 1. Nxënësit në mënyrë të pavarur e plotësojnë detyrën 2, duke i ngjyrosur aq katrorë sa thotë numri poshtë katrorëve, dhe shkruajnë numrin në vendin e zbrazët aq sa ka katrorë.

**Hapi 5:** Në detyrën 3 shikojnë figurat që janë paraqitur me pemë dhe rrethojnë numrin e duhur aq sa ka pemë të tilla. Në detyrën 4 nxënësit ngjyrosin katrorët me dy ngjyra të ndryshme duke formuar numrin 4 si shumë e dy mbledhorëve. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete; lexojnë dhe shkruajnë saktë numrat deri në 4 dhe përcaktojnë vlerën në vargun numerik.

**Detyrë:**

Në fletoret e tyre të shkruhen nga dy rreshta për secilin numër, nga 1 deri në 4.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 32

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat: +, -, <, >,=, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,4; V,5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 3.1,3; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shenjat: më e madhe, më e vogël

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon shenjat < , >;
- Krahason numrat prej 0 deri te 4 me shenjat < dhe >.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, fletë të printuara, petëza, CD ose projektor, topa.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Me projektor paraqiten pamje të ndryshme, ku përmes gojës së krokodilit dhe të patës, nxënësit njoftohen me kuptimin e shenjave *më e madhe* dhe *më e vogël.* Pjesa e picës është më e madhe se keku, dhe keku është më i vogël se pjesa e picës. Në anën ku shpjegohet shenja *më e madhe* në gojën e patës ka më shumë topa, ndërsa në anën tjetër ka më pak topa. Nxiten diskutimet rreth pamjeve duke parashtruar pyetjet: Cila anë është më e madhe, andej nga ka më shumë topa apo më pak? Cila anë është më e vogël?








**Hapi 2:** Nxënësve u shpërndahen fletë të punës dhe u kërkohet që në dyshe të vendosin kokrra të fasules në katror duke u bazuar në gojën e krokodilit. Kontrollohet puna e tyre nga mësuesja dhe plotësohet nëse ka nevojë.



**Hapi 3:** Hapen librat, diskutohet fotografia e ushtrimit të parë, duke pyetur se nga sa topa ka në gojën e patës dhe sa topa janë në anën tjetër. Shkruhen në tabelë përgjigjet e nxënësve dhe paraqiten shenjat < , > , p.sh., 2 < 4, 4 > 2.

**Hapi 4:** Në detyrën 2 nxënësit numërojnë rrathët me ngjyrë të kuqe dhe ngjyrë të kaltër, shkruajnë numrat poshtë rrathëve dhe vendosin shenjën e duhur, < ose >. Në detyrën 3 nxënësit numërojnë petëzat me format e trekëndëshit dhe vendosin shenjën e duhur në katrorin e zbrazët.



**Hapi 5:** Nxënësve u shpërndahen fletët e punës dhe u kërkohet të shkruajnë numra në drejtkëndëshat e zbrazët, numrat duhet të vendosen duke u bazuar në shenjat < , >. Për shembull: 3 < 4, 2 > 1, 3 < 4, 1 < 3 etj.
Puna e nxënësve vlerësohet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, identifikimin e shenjave < , >, dhe krahasimin numrave prej 0 deri te 4.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në shtëpi; të krahasohen numrat duke u bazuar në numrin e katrorëve.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 33

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat: +, -, <, >,=, dhe i përdor ato në raste të caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1, 2, 3, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 3.1,3,5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shenja e barazimit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krahason numrin e elementve të bashkësive të dhëna;
- Përdor saktë shenjën e barazimit në fjalitë numerike;
- Zbulon mënyrën e zgjidhjes së barazimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela magnetike, petëza, etiketa me numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në tabelën magnetike vendosen 4 petëza të mëdha dhe katër petëza të vogla. – *Sa petëza janë në tabelë?- Çfarë ka më shumë, petëza të mëdha apo të vogla?* Nxënësit krahasojnë numrin e petëzave. Arrihet në përfundim se petëza të vogla ka po aq sa të mëdha. Shkruhet barazimi 4 = 4 në tabelë dhe lexohet me zë "numri katër është i barabartë me numrin katër".
Nxënësve u tregohet mënyra se si duhet shkruar shenja e barazimit.

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të hapin librat dhe në dyshe të vështrojnë shembujt e paraqitur në detyrat 1, 2 dhe 3. Pyeten:
- Çfarë po shihni?
- Nga sa elemente janë të përbëra bashkësitë?
- Si duhet të veprojmë në detyrën 1?
- Po në detyrën 2, çfarë duhet të vizatojmë brenda bashkësisë së dhënë?




Nxënësit duke shoqëruar një për një elementet e bashkësive i krahasojnë ato, e shkruajnë numrin e duhur në etiketa dhe vendosin shenjën e barazimit. Më pas detyrat e plotësuara i komentojnë para klasës.

**Hapi 3:** Paraqitet në tabelë skema e parë e detyrës 4. Përmes diskutimit nxiten nxënësit të gjejnë mënyrën e zgjidhjes së detyrës. – Çfarë po shihni? Sa petëza të kuqe janë brenda bashkësisë? Çfarë tregon numri në etiketë? Edhe sa petëza duhet t'i vendosim? Plotësohet skema.




**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur të plotësojnë dy bashkësitë e tjera. Më pas shpjegojnë me fjalë mënyrën se si është fituar barazia e saktë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive gjatë krahasimit të bashkësive; vendosjen e saktë të shenjës së barazimit, si dhe për saktësinë me të cilën plotësuan detyrat.

**Detyrë:**
Formoni bashkësi të ndryshme me numër të njëjtë të elementeve.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 34

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat: <, >,=, duke përdorur ato në çaste të caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2, III.1,3,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2; 3.1,4,5;4.2;5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shenjat <, > dhe =/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krahason numrat duke përcaktuar saktë
- numrin e elementeve;
- Vendos shenjat <, =, > në fjalitë numerike;
- Krijon vargje me numra duke i renditur nga më i madhi te më i vogli dhe anasjellas.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube me ngjyra, etiketa me numra, tablo e përgatitur.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të vendosin mbi bankë kube me ngjyra. Ngrihet etiketa me numrin 4 dhe kërkohet prej tyre të vendosin aq kube sa tregon etiketa. Ata kontrollojnë njëri-tjetrin. Pastaj ngrihet etiketa me numrin 3. Nxënësit tregojnë se cili numër është dhe sa kube duhet të marrin. *–A ka më shumë kube me numrin 4 apo 3? - Si mund ta gjejmë?* Nxënësit lidhin kubet dhe formojnë shtylla. I krahasojnë ato dhe arrihet në përfundim se 4>3 dhe 3<4.









**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurën e detyrës 1 dhe të plotësojnë katrorët e zbrazët, duke i krahasuar numrat e dhënë. Lexohen jobarazimet: *Numri një është më i vogël se numri dy, numri dy më i vogël se numri tre etj.* Në fund nxënësit renditin numrat nga 0 deri në 4 në telin tharës.

**Hapi 3:** Modeli i detyrës 2 paraqitet në tabelë. Analizohet përmes pyetjeve.

- Sa rrathë janë në bashkësinë e parë? (2);
- Po në bashkësinë e dytë sa është numri i rrathëve? (2);
- Cilën shenjë duhet ta vendosim në mes? (=) Pse?

Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë.
2 = 2, 4 = 4, 3 = 3, 1= 1, 4 >3, 2 < 3.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të plotësojnë detyrat 6 dhe 7. Në fund shkëmbehen librat me shokun e bankës dhe krahasojnë zgjidhjet.

**Hapi 5**: Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura si në figurë. Prej tyre kërkohet të vendosin saktë shenjat <, =, > . Vlerësohet saktësia e zgjidhjes së detyrave.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive gjatë krahasimit të numrave, vendosjen e saktë të shenjave <, =, >, renditjen e numrave dhe krijimin e vargjeve.

**Detyrë:**
Të plotësohen detyrat 4 dhe 8 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 35

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.1,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4,5; 4.2; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kupton shenjën e mbledhjes +;
- Shkruan shenjën e mbledhjes +;
- Kryen veprimin e mbledhjes me numra prej 1 deri në 4.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela magnetike, petëza, CD ose teknologji, topa.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë, Edukatë muzikore.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet me projektor ose CD kënga, "Jemi një, s'jem dy" https://www.youtube.com/watch?v=-f788LTkewNI.
Pasi të dëgjohet kënga, analizohet rreshti: ***Unë e di, ti e di, një dhe një bëjnë dy...*** Kjo fjali shkruhet në tabelë. Pyeten nxënësit: Çfarë kuptoni me fjalët 'një dhe një bëjnë dy'? -Si mund ta paraqesim me numra? Merren disa përgjigje dhe shkruhen në tabelë, 1+1 = 2. Pra kjo shenjë është shenja plus '+' e cila përdoret për mbledhjen e numrave. Nxënësve u kërkohet të shkruajnë nga 3 rreshta në fletore me




shenjën plus.

**Hapi 2:** Nxirren 2 nxënës te tabela, pastaj edhe dy nxënës të tjerë. Pyeten ata: Sa nxënës ishin në fillim? (2); Sa nxënës erdhën pastaj? (2); Sa nxënës u bënë tani? (4). Thirret një vullnetar që ta paraqesë shprehjen në tabelë: 2 + 2 = 4.

**Hapi 3:** Hapet libri, kërkohet nga nxënësit të shikojnë me vëmendje pamjet në detyrën 1. Pyeten: Sa nxënës janë të kapur dorë për dore? (2); A po u bashkohet atyre edhe ndonjë nxënës tjetër? (Po,1); Sa nxënës bëhen pastaj? (3). Njëjtë vazhdohet edhe me pamjet e tjera. Përgjigjet e nxënësve shkruhen në tabelë: 2 +1=3,
3 + 1 = 4, 1+ 1 = 2, 2 + 1 = 3.

**Hapi 4:** Në tabelën magnetike paraqiten petëzat me trekëndëshat me dy ngjyra, petëza të kuqe dhe petëza të gjelbra, si në detyrën 3. Ftohen nxënësit vullnetarë t'i plotësojnë barazimet sipas figurave. Në të njëjtën kohë punojnë detyrën 3 në libër.

**Hapi 5**: Sqarohet para nxënësve se si duhet të punohet detyra 4. Ata shikojnë me vëmendje ngjyrën e topave, numërojnë topat sipas ngjyrës dhe i shkruajnë numrat në katrorët me ngjyrën e njëjtë të topave dhe kryejnë pastaj veprimin e mbledhjes.

**AKTIVITET SHTESË - *Loja me topa***

Organizohet loja me topa te vegjël që kanë ngjyra të ndryshme. Ftohen 4 nxënës dhe formohen dy çifte. Çiftit të parë i jepen 2 topa të kuq dhe 1 top i gjelbër, ndërsa çiftit të dytë 1 top i kuq dhe 2 topa të gjelbër. Nxënësit gjuajnë topin te shoku me udhëzimet e mësueses. Nxënësi tjetër e kap atë. Pyeten ata se sa topa ka shoku tani. Barazimet shkruhen në tabelë. Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë barazimet në fletoret e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për të kuptuarit e shenjës plus (+), të shkruarit shenjës + dhe mbledhjen e numrave prej 1 deri në 4.

**Detyrë:**

Kryeni 6 detyra me mbledhje me numrat prej 1 – 4.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 36

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.4; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 4/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton numrin katër si shumë e dy mbledhorëve;
- Interpreton mbledhjen në boshtin numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, kube, lapsa me ngjyra, ilustrim i frutave.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në tabelë ose në videoprojektor paraqiten dy bashkësi, bashkësia e mollëve dhe e dardhave. U kërkohet të emërtojnë secilën bashkësi dhe të tregojnë numrin e elementeve të tyre. Më pas, rrethojnë me një vijë të dyja bashkësitë. Çfarë bashkësie u formua? Sa është numri i frutave gjithsej? (Dy plus dy baras me katër). Një nxënës shkruan në tabelë barazimin dhe lexon "dy plus dy baras me katër".



2 + 2 = 4




**Hapi 2:** Nxënësit nën udhëheqjen e mësimdhënësit plotësojnë kërkesat e detyrave në libër.
*Detyra 1:* Nxënësit udhëzohen të numërojnë sa zogj ishin në fillim dhe sa u bënë më pas. Shkruhet barazimi në tabelë 2+1=3, dhe lexohet nga një nxënës. Pastaj numërohen kubet. Dy kube të kaltra plus dy të gjelbra, sa kube janë gjithsej? ( 2+2=4)

*Detyra 2:* Nxënësit shkruajnë numrin e figurave gjashtëkëndëshe në katrorët e vegjël, më pas lexojnë barazimin e formuar.

*Detyra 3:* Për të fituar shumën 4, nxënësit orientohen t'i ngjyrosin rrathët e gjelbër pastaj të plotësojnë barazimet në libër.

*Detyra 4:* Fillimisht u sqarohet nxënësve se duhet të paraqiten katër rrathë në çdo bashkësi, pastaj u kërkohet të punojnë në dyshe vetëm dy shembujt e parë. Kontrollohet saktësia e punës.

**Hapi 3:** U shpjegohet atyre se për të shkuar te nxënësi i parë duhet një hap, për të shkuar te i dyti duhet edhe një hap tjetër. Po kështu ndodh edhe në boshtin numerik. Më pas me ndihmën e një shiriti dhe etiketave me numra (0, 1, 2, 3, 4) formohet boshti numerik, si në foto. Demonstrohet shembulli i parë (2+2=4).
Pastaj nxënësit në mënyrë individuale gjejnë në boshtin numerik shumat 1+3; 3+1.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për gjetjen e saktë të mbledhorëve që formojnë numrin katër dhe interpretimin e mbledhjes në boshtin numerik.

**Detyrë:**
Të plotësohet shembulli i tretë i detyrës 4 në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 37

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 3.4; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 4

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Paraqet numrin katër si shumë e dy mbledhorëve;
- Formon bashkësi me katër elemente.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Eiketa me numra, numëratore, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit ftohen të formojnë një rreth dhe u tregohet se do të luajnë një lojë me mbledhje nën tingujt e muzikës. Në momentin kur u thuhet një plus tre, nxënësit ndalojnë vallëzimin për të formuar bashkësinë me katër veta, ata që nuk e formojnë grupin largohen nga loja dhe e shkruajnë barazimin në tabelë.
Përsëritet veprimtaria duke ndërruar numrat 4 dhe 0. Lexohen barazimet nga nxënësit.









**Hapi 2:** Nxënësit nxiten të shpjegojnë situatën e dhënë në detyrën 1 të tekstit dhe të lexojnë barazimet e fituara. Më pas u kërkohet të mbajnë lart tre gishta, pastaj edhe një gisht.
- Sa gishta ke nxjerrë ti? 3 + 1 = 4 gishta. Barazimi shkruhet në tabelë dhe lexohet me zë nga nxënësit. (Tre plus një baras me katër). Përsëritet veprimtaria duke ndërruar numrat.



**Hapi 3:** Nxënësit nxiten të zbulojnë kërkesën e detyrës 2, e cila na tregon se duhet të ngjyrosen katrorët me të njëjtat ngjyra si numrat për të formuar numrin katër. Nxënësit në dyshe e plotësojnë detyrën, nën vëzhgimin e mësimdhënësit.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të plotësojnë në dyshe detyrën 3. Ngjyrosen katrorët si dhe formojnë bashkësi sipas të dhënave të gjetura. Nxënësit mund të shërbehen me numëratore ose fasule.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të vendosin brenda fijes 2 petëza. Edhe sa petëza duhen vendosur për të formuar numrin katër? Nxënësit vendosin edhe dy petëza brenda bashkësisë dhe formojnë numrin katër. Bazuar në këtë aktivitet, nxënësve u kërkohet ta zgjidhin detyrën 4 individualisht. Duke vëzhguar figurat nxënësit do të plotësojnë katrorët e zbrazët për të formuar numrin katër. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së mbledhorëve që formojnë numrin katër dhe për formimin e bashkësive me katër elemente.

**Detyrë:**
Të plotësohet fleta e modeluar.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 38

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.1,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 3.3; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen numrin e elementeve që mbesin pas zbritjes;
- Shkruan barazime me zbritje, duke u mbështetur në situata reale;
- Praktikon zbritjen në shiritin numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ilustrim.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet ilustrimi në tabelë dhe duke u bazuar në të krijojmë një tregim të shkurtër.

Edlira po shkonte te gjyshja. Rrugës duke ecur, në një kopsht të bukur me lule, pa katër flutura të bukura. Sapo u afrua t'i shikonte, një flutur u largua.
Pyesim:
Sa flutura mbetën në kopsht? Nxënësit të shprehin me fjalë se në kopsht ishin katër flutura, një u largua dhe mbetën tri.
Si mund ta paraqesim si barazim? Ftohet një nxënës vullnetar ta shkruajë në tabelë barazimin 4 - 1 = 3.
Po sikur të largohet edhe një flutur, sa do të mbesin 3 - 1 = 2 ?






**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen se si duhet ta plotësojnë detyrën 2 në libër. Në fillim ata përshkruajnë me fjalë çka tregon figura, pastaj e plotësojnë barazimin.
- Në figurë janë katër dardha, kur hiqet 1, mbesin 3 të tilla. Shkruhet dhe lexohet barazimi. (4 -1=3). Njëjtë veprohet me të gjithë shembujt e detyrës 2. Ftohen nxënësit me radhë t'i shkruajnë barazimet në tabelë.

**Hapi 3**: Paraqiten para nxënësve 4 balona të fryra dhe kërkohet nga ata të krijojnë situata problemore dhe të tregojnë zgjidhjen e detyrës. Barazimet e shkruara në tabelë lexohen me zë nga nxënësit, si: "Katër minus një, baras me tre". 4 - 2 = 2 ; 4 – 3 = 1; 4 – 4 = 0.

**Hapi 4:** Nxënësit ftohen me radhë të praktikojnë zbritjen në shiritin numerik. Përzgjidhet një nxënës të vendoset mbi numrin 4. Ai kërcen një hap pas. U kërkohet të thonë se te cili numër arriti (te numri 3). Ftohet një nxënës ta shkruajë barazimin në tabelë. Përsëritet ushtrimi disa herë me numra të tjerë.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së numrit të elementeve pas zbritjes; për shkrimin e barazimeve dhe praktikimin e saktë në shiritin numerik.

**Detyrë:**
Të shkruhen barazimet e detyrës 3 në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 39

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2, III.1; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,4; 3.3; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen numrin e elementeve që mbeten pas zbritjes;
- Interpreton zbritjen në boshtin numerik;
- Shkruan fjali numerike duke u bazuar në figurat e tekstit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Birila, top.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Mësimi fillon me një lojë. Vendosen para klasës në një vijë të drejtë katër birila. Një nxënës hedh topin dhe numërohen sa birila janë rrëzuar dhe kanë rënë në tokë, dhe sa kanë mbetur pa u goditur. Barazimet shkruhen në tabelë.
Përsëritet disa herë veprimi.






**Hapi 2:** Nxënësit nxiten të vëzhgojnë figurën e detyrës 1 dhe ta komentojnë, duke i ndihmuar me pyetjet:
Sa gjethe janë gjithsej? Sa kanë rënë nga dega? Sa mbetën?
Nxënësit plotësojnë barazimet në libër.

**Hapi 3**: Vizatohet në tabelë një bosht numerik dhe shënohen numrat nga 0-4. Ftohen disa nxënës të vijnë në tabelë, të shkruajnë në boshtin numerik numrin e parë dhe të vizatojnë dy kërcime mbrapa. Lexohet numri ku është ndalur. Më pas plotësohet shembulli i parë në detyrën 3. Përsëriten veprimet edhe për shembullin e dytë. Vlerësohet puna e nxënësve.

**Hapi 4:** Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura si në detyrën 4. Udhëzohen që në mënyrë individuale të plotësojnë ushtrimet me shenjat përkatëse + -. Vlerësohet puna e tyre.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për gjetjen e saktë të numrit të elementeve, paraqitjen e zbritjes në boshtin numerik dhe vendosjen e saktë të shenjave + - në fjalitë numerike.

**Detyrë:**
Të shkruhen barazimet e detyrës 2 në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 40

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III,2; IV.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.4, 6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 4 -Përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mbledhorin e panjohur në detyra të ndryshme;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave nga 1-4;
- Krahason numrat deri nga 1-4.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube me ngjyra, fletëza të përgatitura, lapsa, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura. Kërkohet prej tyre të gjejnë mbledhorët që formojnë numrin 4. Grafiku i njëjtë paraqitet në tabelë dhe diskutohet me nxënësit. Ngjashëm plotësohet detyra 1 në libër.






**Hapi 2:** Vëzhgohet detyra 2 dhe analizohet së bashku me nxënësit.

1. Sa kube të kuqe janë? (2).
2. Sa kube të kaltra? (1).
3. Sa kube janë gjithsej? (3)

Pra, numrit 2 i duhet shtuar 1 për të fituar numrin 3. Paraqiten disa shembuj në tabelë pastaj punohet në libër.

**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet të nxjerrin mbi bankë dy ngjyra të kuqe, një të kaltër dhe një të verdhë. –*Sa ngjyra keni gjithsej?* (4) *Si i gjetët?* 2+1+1=4. Shkruhet barazimi në tabelë.
Nxënësit punojnë detyrën 3 duke u bazuar në ngjyrat e figurave të dhëna, vendosin numrat e duhur në vendet e zbrazëta. Nxënësit shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

**Hapi 4:** Nxënësit ndihmohen me pyetje për të plotësuar detyrat 6 dhe 7. - *Sa lapsa po shihni në figurën e parë?* (3) - *Sa lapsa mbetën pasi e larguam një?* (2) sepse 3-1=2. Pse? Sepse 2+1= 3. Sa qirinj janë gjithsej? –*Sa mbetën pasi u fik një?* (2). Nxënësit punojnë detyrat në libër dhe lexojnë barazimet.

**Hapi 5:** Nxënësve u sqarohet kërkesa e detyrës 8, ku pas ngjyrosjes së rrathëve dhe plotësimit të kolonave, krahasojnë numrat duke vendosur shenjat <. =, >. Ata punojnë në mënyrë të pavarur. Vlerësohet saktësia e zgjidhjes së detyrës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen pë saktësinë e identifikimit të mbledhorit të panjohur me anë të mbledhjes dhe zbritjes, njehsimit të shumës dhe ndryshimit të numrave deri në 4, si dhe krahasimin e tyre.

**Detyrë:**
Të plotësohen detyrat 5 dhe 9 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 41

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20.
- Kupton shenjat: +, -, <, >,=, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III,2; IV.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.4, 6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton numrin e elementeve në figurë;
- Rendit numrat në vargun numerik;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, petëza, spango, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet t'i ngrenë duart lart. Në fillim të ngrenë 1 gisht, pastaj 3 gishta, 0 gishta (bëjnë dorën grusht), 2 gishta dhe në fund 4 gishta. Më pas udhëzohen të përsërisin të njëjtin aktivitet me lapsa.




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe, duke renditur në bankat e tyre: librin, lapsin, fletoren, librin, lapsin dhe tani parashtrohet pyetja: Cili objekt e ka radhën tani? (Fletorja).

**Hapi 3**: Paraqitet faqja e skanuar e librit në ekran. Lexohet kërkesa e detyrës së parë, dhe pritet gjersa nxënësit në mënyrë të pavarur ta plotësojnë. Vazhdohet me kërkesën e detyrës së dytë duke ua rikujtuar aktivitetin me libra, lapsa e fletore. Udhëzohen se si do të punohen detyrat e tjera.

**Hapi 4:** Nxënësit punojnë ushtrimet e radhës në mënyrë të pavarur. Ndihmohen vetëm ata që kanë ngecje, duke mbajtur shënime se sa herë është ndihmuar, në mënyrë që të ketë pasqyrim sa më të saktë të vlerësimit në progresin e procesit mësimor.
Puna e nxënësve vlerësohet.

**AKTIVITET SHTESË** - Nxënësit që plotësojnë më shpejt faqen e librit, ngjyrosin fig.1, ndërsa fig. 2 punohet si detyrë shtëpie nga të gjithë nxënësit.



Fig. 1




Fig. 2

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shkrimin e numrit të elementeve në figurë, renditjen e numrave në vargun numerik, gjetjen e shumës dhe ndryshimin e numrave.

**Detyrë:**
Të ngjyroset figura 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 42

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/ vizatime;
- Numëron me rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri pesë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Numëron nga 0 deri te 5 dhe anasjelltas;
- Përcakton vlerën sasiore të tij;
- Rendit saktë vargun e numrave deri në 5.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të printuara, petëza, spango, fasule, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në projektor paraqitet vjersha për numrin 5 - NUMRI 5 - VJERSHA - Bing video.
Nxiten diskutimet rreth videos duke parashtruar pyetjet: Çfarë shihet në ekran? Çfarë përmendet tjetër? Pyeten nxënësit se për cilin numër do të mësojnë sot. Kërkohet nga ata të ngrenë dorën dhe të tregojnë sa gishtërinj kanë; të numërojë nga zeroja deri te pesa, dhe anasjellas nga pesa deri te zeroja. Ftohet një nxënës të vizatojë dorën në tabelë, nxënësi tjetër vizaton një bashkësi me pesë pika, kurse tjetri shkruan numrin pesë si në figurë.




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të formojnë bashkësi me pesë elemente. Nxiten të interpretojnë, si: "Unë kam formuar një bashkësi me pesë lapsa".

**Hapi 3**: Diskutohet fotografia e ushtrimit të parë. Nxënësit do të tregojnë se sa fëmijë janë, sa zogj dhe sa pisha, sa lule. Pyeten se nëse kërkohet nga ata që në këtë figurë do të vizatonin topa aq sa është numri i zogjve, pishave dhe fëmijëve, atëherë sa topa do të vizatonin? Nxënësit mund të vizatojnë pesë topa në figurë, ku edhe plotësohet tregimi me fjalë që 5 fëmijët në një natyrë të rrethuar me 5 pisha dhe 5 lule do të luajnë me 5 topa.

**Hapi 4:** Në tabelë paraqitet grafiku i numrit 5, duke treguar kahet e shkrimit të numrit. Udhëzohen nxënësit të shkruajnë në kutizat e detyrës 3, grafikun e numrit 5, si dhe numrat 1-5 në rendin rritës dhe zbritës. Ushtrimi 4 plotësohet duke shoqëruar grafikun e numrave me bashkësinë përkatëse.

**Hapi 5:** Nxënësit plotësojnë ushtrimin 5 duke shkruar numrat në rendin rritës dhe zbritës; ushtrimin 6 duke vizatuar pika dhe shkruar numra në kutizat përkatëse.

**Hapi 6:** Duke bashkëbiseduar me nxënësit, plotësohen ushtrimet 7 dhe 8. Vlerësohen ata për përgjigjet e tyre.



**AKTIVITET SHTESË** - Mësohet vjersha për shqisat.
*Une kam pesë shqisa,*
*me sy shikoj, me veshë dëgjoj,*
*me gojë shijoj, me hundë nuhas*
*e me duar prekë.*
Vjersha mësohet njëkohësisht edhe me gjestikulacione.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e numërimit nga 0 deri te 5 dhe anasjellas, përcaktimit të vlerës sasiore dhe saktësinë e renditjes së vargut të numrave deri më 5.

**Detyrë:**
Në libër, plotësoni detyrën 9.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 43

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat deri në 5/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon bashkësitë me numër përkatës të elementeve;
- Përcakton vlerën sasiore të tyre;
- Shkruan mbledhorët e numrit 5.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të printuara, objekte të ndryshme, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet gjëegjëza
Tre lepuj dhe dy breshka
Së bashku bisedonin
dhe tryezën shtronin.
Sa pjata kërkonin?




Nxiten nxënësit që në grupe ta paraqesin në gjuhën matematikore zgjidhjen e gjëegjëzës. Pasi të kenë përfunduar, me tërheqjen e lapsave në mes, një anëtar i grupi paraqet zgjidhjen e gjëegjëzës në tabelë.

$3 + 2 = 5$

Më pas, një anëtar tjetër i grupit përgjigjet me fjalë: *3 lepuj dhe 2 breshka kërkonin 5 pjata.*

**Hapi 2:** Në ushtrimin 1 udhëzohen nxënësit t'i numërojnë lulet në vazo, dhe në kutizat ta shënojnë numrin. Pyeten se cili numër është para dhe pas numrit 3, cili numër është para numrit 5.
Në ushtrimin 2 kërkohet të tregojnë se çka ka më shumë (kërpudha) dhe çka ka më pak (peshku). Detyrën e tretë e plotësojnë në dyshe, duke krahasuar ngjyrosjen e rrathëve.

**Hapi 3**: Nxënësit plotësojnë individualisht detyrën 4. Puna e tyre vlerësohet. Vëzhgohet kush ka vështirësi në zgjidhjen e detyrës. Kërkohet nga nxënësit e tjerë t'i ndihmojnë shokët.



**AKTIVITET SHTESË**

Shkruhet në tabelë fjala *Ylber*. Lipset nga nxënësit të tregojnë se sa shkronja ka kjo fjalë. Secilit grup i jepet nga një etiketë me një numër si në fotografi dhe kërkohet nga ata t'i vendosin copat e shkëputura në tabelë dhe t'i bashkojnë në mënyrë që të formohet ylberi. Pyeten se si arritën deri te zgjidhja, nëpërmjet figurave apo numrave që duhej të renditeshin sipas radhës. Nxënësit tregojnë për mënyrën më të lehtë që kanë përdorur për të arritur deri te zgjidhja.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e bashkësisë, shkrimin dhe gjetjen e numrit të elementeve në figura, si dhe shkrimin e mbledhorëve të numrit 5.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 44

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkran numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 5

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krijon bashkësi me 4 dhe 5 elemente;
- Zbërthen numrat 2, 3, 4 dhe 5 në dy mbledhorë;
- Interpreton mbledhjen e numrave deri në 5 në boshtin numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Trakë numerike, objekte të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Fillohet me një garë në trakën numerike që është e vendosur në dysheme. Ftohen dy nxënës, njëri shkruan një barazim, si p.sh., 2 +2, tjetri do të niset nga numri 2 dhe do të kërcejë dy herë. Ai do të arrijë te numri 4, nxënësi tjetër shkruan rezultatin në tabelë. Çiftet që kryejnë mirë detyrën duartrokiten nga shokët.

**Hapi 2:** Nxënësit nxiten të flasin rreth figurës së detyrës 1, p.sh.: *"Në figurë janë 4 fëmijë duke luajtur, atyre u bashkëngjitet edhe një fëmijë tjetër, që gjithsej bëhen 5 fëmijë".*




Në detyrën e tretë, pyeten nxënësit se si quhet vija me numra, po shigjetat çfarë tregojnë. Kërkohet nga ata që të lidhin aktivitetin e bërë me vijën numerike (boshtin numerik) në detyrë. Gjatë plotësimit të detyrës, nxiten nxënësit të përshkruajnë rrugën e zgjidhjes së detyrës.

**Hapi 3**: Vizatohet në tabelë figura e mëposhtme. Tregohet që në secilën shtëpi jetojnë familje me numër të ndryshëm të anëtarëve. Pyeten se sa kate janë shtëpitë, dhe çka tregon numri në kulmin e secilës shtëpi. Marrim si shembull shtëpinë e parë. Tregohet që në secilin kat jetojnë nga katër anëtarë, në katin e parë është një anëtar, edhe sa anëtarë duhet të vijnë që të plotësohet numri 4? Kështu vazhdohet edhe për katet e tjera.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në mënyrë të pavaur ushtrimin 4. Vëzhgohet puna e nxënësve, ndihmohen ata që kanë vështirësi në plotësimin e detyrës.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për krijimin e bashkësive, interpretimin e mbledhjes së numrave në boshtin numerik, si dhe për zbërthimin e numrave 2, 3, 4 dhe 5 në dy mbledhorë.

**Detyrë:**

Të plotësohet detyra 2 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 45

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 5/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon numrin e elementeve në figurë;
- Gjen shumën e numrave;
- Formon fjali numerike;
- Paraqet numrat si shumë të mbledhorëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Komplet matematikor, objekte të ndryshme që e rrethojnë nxënësin.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të formojnë një rreth dhe u tregohet që do të mbledhin duke luajtur. Kur të dëgjojnë sa bëjnë një plus dy, ata duhet të bashkohen dhe të formojnë grupin prej tre vetash. Nxënësit që nuk e gjejnë rezultatin saktë duhet ta shkruajnë barazimin në tabelë, përsëritet aktiviteti disa herë.

**Hapi 2:** Kërkohet që tre nxënës të dalin para tabelës dhe u shpërndahet nga një numër 1, 4 dhe 5. Pyeten se për të shkruar një barazim çfarë u duhet të kenë përveç numrave. Cilat shenja po mungojnë te shokët tuaj? Ftohen edhe dy nxënës të tjerë të marrin në kutinë e numrave shenjat + dhe =, pastaj renditen në




vendin e duhur te shokët që i kanë vetëm numrat. Një nxënës lexon barazimin e fituar dhe e shkruan atë në tabelë, $4 + 1 = 5$. Pastaj pyeten se cilët numra e formuan numrin 5, dhe shkruajnë barazimin $5 = 4 + 1$ që është i njëjtë si barazimi i parë. Merren edhe shembuj të tjerë që nxënësit të gjejnë vetë mënyrën e paraqitjes së barazimeve.

**Hapi 3**: Detyrat 2 dhe 3 paraqiten në tabelë. Disa nxënës që mendohet se mund të kenë vështirësi në zgjidhjen e detyrave dalin dhe i plotësojnë ato, duke i udhëzuar. Ndërsa nxënësit e tjerë plotësojnë librin, puna e tyre vlerësohet.

**Hapi 4:** Vizatohet në tabelë një shtëpi me figura gjeometrike si në detyrën 4. Pyeten nxënësit se me cilat figura është ndërtuar shtëpia, sa katrorë të mëdhenj janë, sa të vegjël, sa trekëndësha të mëdhenj e sa të vegjël janë, numrin e të cilëve e shkruajnë në katrorët e zbrazët. Ndërkohë bëhet vlerësimi i punës së tyre.

**AKTIVITET SHTESË:**
Nxënësit udhëzohen që të punojnë në çifte, njëri do të ndërtojë kulla me lego, tjetri duke u bazuar në ngjyrat e kubeve do të shkruajë barazimet e duhura (shih foton). Më pas ndërrohen vendet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, përcaktimin e saktë të numrit të elementeve, nga saktësia me të cilën plotësojnë detyrat me mbledhje, si dhe duke i paraqitur numrat si mbledhorë.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 1 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 46

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave deri në 5

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon numrat që zbriten me anë të figurave me heqje;
- Shkruan barazimet me zbritje;
- Zbret numrat deri në 5 me anë të boshtit numerik duke shpjeguar ecurinë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatim, numra magnetikë, numëratore, trakë numerike.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u paraqiten disa vizatime, ku ata i komentojnë duke i ndihmuar me pyetje: Sa gaforre ishin në fillim? Sa gaforre po largohen? Sa gaforre mbetën? Çfarë tregon vija mbi gaforre? Cili veprim duhet të përdoret kur largojmë diçka? Si mund ta paraqesim me numra këtë çfarë po shohim?

Ftohet një nxënës ta paraqesë me numra magnetikë barazimin. Lexohet nga e gjithë klasa: Pesë minus një është baras me katër.



5 - 4 = 1




**Hapi 2:** Nxënësit vërejnë detyrën 1 dhe e komentojnë me fjalë. Qershitë janë fruta që rriten në pemë. Ndihmohen në fillim me pyetje: Sa qershi ishin në fillim në degë? Sa qershi ranë nga dega? Si e shkruajmë këtë me numra? 5-1=4. Nxënësit vazhdojnë të komentojnë shembujt e tjerë me fjalë dhe barazimet. Pra, numri i parë (para- shenjë minus) tregon sa janë në fillim, numri i dytë tregon sa janë larguar dhe numri pas-shenjë barazi tregon sa kanë mbetur në fund.

**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet të plotësojnë individualisht barazimet në detyrën 2 dhe 3. Pasi ta plotësojnë pyeten: Çfarë kanë të përbashkët shembujt në rreshtin e parë me ata të rreshtit të dytë në detyrën 3? Po ku ndryshojnë? Çfarë bëtë në shembujt poshtë? Nxënësit i lexojnë barazimet e plotësuara.

**Hapi 4:** Vendoset shiriti numerik në dysheme dhe thirret një nxënës të vendoset te numri 5. Kërkohet të ecë tre hapa pas dhe të tregojë se te cili numër arriti. Pse? Një nxënës tjetër e shkruan barazimin 5-3=2.

**Hapi 5:** Paraqitet në tabelë një bosht numerik dhe analizohet me anë të pyetjeve.




Nga cili numër po fillon shigjeta? (5); Sa numra po ecën pas?(2); Te cili numër u ndal? (3). Numri 5 a u zvogëlua në fund? Pse? Shkruhet barazimi: 5-2=3. Ngjashëm plotësohen barazimet në detyrën 4.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë shembullin e dytë në detyrën 5 dhe i përgjigjen pyetjes: Çka kanë të përbashkët barazimet? E plotësojnë atë.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit identifikojnë saktë figurat me heqje te zbritja, përshkruajnë me fjalë zbritjen, shkruajnë saktë barazimet me zbritje dhe përdorin boshtin numerik për zbritje më të lehtë.

**Detyrë:**
Detyra 5 të shkruhet në fletore si barazim.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 47

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë;
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1-20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.4; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 5/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton zbritësin, të zbritshmin, mbledhorin e panjohur;
- Argumenton lidhjen mes mbledhjes dhe zbritjes deri në 5;
- Kryen mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 5.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatim, numëratore, trakë numerike.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të plotësojnë barazimet në bazë të figurave në detyrën 1, në libër. Ndihmohen me pyetje: Sa qirinj ishin të ndezur në fillim? Sa janë fikur? Sa qirinj mbetën të ndezur? Plotësohet barazimi 5 – 1 = 4. Kështu veprohet edhe me dy shembuj e tjerë të detyrës 1.

**Hapi 2:** Para nxënësve paraqitet një bashkësi me katrorë, të cilën e paraqesin me barazim njëri nga nxënësit.
Nxënësit plotësojnë detyrën 4 në libër. Në shembullin e parafundit ndihmohen me pyetje: Sa figura janë? Sa duhen hequr që të mbeten 0 figura? Plotëson barazimin në libër.






**Hapi 3**: Vendoset shiriti numerik në dysheme dhe thirren dy nxënës. Njëri nxënës vendoset te traka mbi numrin 5 dhe kërkohet të lëvizë njëherë 3 hapa pas dhe të tregojë te cili numër arriti. Më pas lëviz edhe 1 hap pas dhe tregon te cili numër arriti. Nxënësi tjetër e paraqet me anë të shprehjes numerike: 5 – 3 – 1 = 1. Shpjegohet si zbriten tre numra. Ngjashëm plotësohen barazimet te detyra 5 në libër.

**Hapi 4:** Nxënësit vëzhgojnë detyrën 6 dhe komentohet me ndihmën e pyetjeve shembulli i parë: Çfarë po shihni?; Sa figura janë me ngjyrë të gjelbër? (4); Sa figura janë të kuqe? (1); Sa janë gjithsej? (5). Plotësoni barazimin: 4 + 1= 5. Po nëse këtyre 5 figurave ua heqim 1 të kuqe, sa na mbesin? (4). Plotësohet në libër: 5 – 1 = 4. Pra e kundërta me mbledhjen është zbritja. Nxënësit individualisht plotësojnë shembujt në detyrën 6, duke argumentuar lidhjen mes mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 5. P.sh., 3 + 2 = 5 (tre plus dy, baras me pesë) Po, pesë minus dy, baras me tre (5 – 2 = 3).

**Hapi 5:** Çdo çifti të nxënësve u jepen disa barazime të mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 5. Ata do të punojnë në dyshe, ku njëri kryen mbledhjen e tjetri zbritjen e numrave duke treguar lidhjen mes tyre. Pra punojnë paralelisht me njëri – tjetrin. Në fund vlerësohet saktësia e njehsimit.

| Mbledhja deri në 5 | Zbritja deri në 5 |
|---|---|
| 1 + 1 = _____ | 2 - 1 = _____ |
| 2 + 1 = _____ | 3 - 1 = _____ |
| 2 + 2 = _____ | 4 - 2 = _____ |
| 3 + 1 = _____ | 5 - 1 = _____ |
| 3 + 2 = _____ | 5 - 2 = _____ |

**Hapi 6**: Plotësohet detyra 9 në mënyrë individuale. Numrit 3 sa i duhet shtuar? Pse? Cili numër fitohet? Nxënësit vazhdojnë të kryejnë mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 5, si operatorë. Shkëmbejnë librat me shokun e bankës me ç'rast vlerësohet saktësia e plotësimit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit përcaktojnë saktësisht zbritësin, të zbritshmin dhe mbledhorin. Kryejnë saktë mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 5 dhe argumentojnë lidhjen mes tyre.

**Detyrë:**
Plotësoni detyrat 2, 3, 7 dhe 8 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 48

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë;
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mbledhorin e panjohur në mënyra të ndryshme;
- Njehson shumën dhe ndryshesën e numrave nga 1-5;
- Krahason numrat nga 1-5 të dhënë si barazime.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatim, numra magnetikë, numëratore, etiketa me numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet në tabelë një shtëpi me tri kate. Komentohet me ndihmën e pyetjeve: Sa kate është ndërtesa? (3); Cili numër është në kulmin e ndërtesës? (5); Pra, në secilin kat duhet të jenë nga 5 banorë. Në katin e parë janë zero banorë. Edhe sa banorë nevojiten për t'u bërë 5 banorë (5). Pse? Nxënësit plotësojnë ngjashëm detyrën 1 (shembullin e parë dhe të fundit) në libër.

| 5 |
|---|
| 2 + |
| 4 + |
| 0 + |

**Hapi 2:** Nxënësve u shkruhet në tabelë: 5, 4, 1, -, =.
Kërkohet që me këta numra dhe shenja të shkruajnë një barazim i cila paraqitet në tabelë:




5 – 4 = 1 Mund ta shkruajmë ndryshe?
1 = 5 – 4 ose 5 – 1 = 4 , 4 = 5– 1
Nxënësit ngjashëm punojnë detyrën 3 në libër, ku ndryshesën e njehsuar e paraqesin me bashkësinë e lapsave.

**Hapi 3**: Analizohet detyra 4 me anë të pyetjeve: Në çdo kat të ndërtesës cilin numër duhet fituar? (5). Numrit 2 edhe sa i duhet shtuar për të fituar numrin 5? (3). Në sa mënyra mund të shkruhet ky barazim? Shkruhet: 5=2+3; 2+3=5; 5-2=3. Plotësohen dy shembujt e tjerë të detyrës 4, të pavarur. Në fund, librat shkëmbehen me shokun e bankës dhe vlerësohen.

**Hapi 4:** Kur bien pikat e shiut çfarë hapim? Nxënësve u kërkohet të vërejnë detyrën 5. Çfarë duhet të bëni? Nxënësit punojnë në dyshe. Njëri nxënës lidh pikat me numrin përkatës në ombrellë majtas, e nxënësi tjetër punon djathtas nga ombrella. Shkëmbehen librat me shokun e bankës.

**Hapi 5:** Paraqitet para nxënësve dy barazime, të cilat duhet t'i krahasojnë. Ç'mendoni, cilën shenjë duhet vendosur mes këtyre dy barazimeve? Çfarë duhet bërë së pari? P.sh.: 5-3=2, 4-2=2. Pra, 5-3 = 4-2. Lexohet me zë. Nxënësit punojnë barazimet me zbritje në detyrën 6. Pyeten: Çfarë kanë të përbashkët këto detyra? Ku dallohen ato?

**Hapi 6:** Paraqitet në tabelë me numra magnetikë barazimi i paplotësuar: 5□3□1=1; 4□2□1=3. Cilën nga shenjat +, - duhet vendosur mes numrave te barazimi i parë? Nxënësit llogarisin dhe vendosin shenjat. 5 – 3 – 1 = 1. Kurse te e dyta, 4 – 2 + 1 = 3. Nxënësit vendosin shenjat përkatëse në shembujt e shtyllës së parë. Pas plotësimit lexohen me zë.

**Hapi 7:** Nxënësit njehsojnë shumën ose ndryshesën dhe ngjyrosin balonën sipas ngjyrave përkatëse për numrin e caktuar.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit identifikojnë saktë mbledhorin e panjohur me anë të mbledhjes dhe zbritjes. Njehson dhe krahason saktë shumën dhe ndryshesën e numrave deri në 5.

**Detyrë:**
Të punohen shembujt e mbetur të detyrave 1, 4, 5, 6, 7 si dhe detyra 3 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 49

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë. Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.2; III.4; III.7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.4; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit numrat me radhë nga 1-5 dhe anasjellas;
- Njehson shumën dhe ndryshesën e numrave deri në 5;
- Krahason numrat deri në 5.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, numra magnetikë, spango, shkronja e numra lëvizës, etiketa me barazime.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Njoftohen nxënësit me temën e orës, vlerësimin e tyre me anë të detyrave. Njoftohen që do të punojnë në mënyrë individuale.

**Hapi 2:** Lexohen detyrat duke ua sqaruar kërkesat e tyre.
Në detyrën 1, nxënësit udhëzohen që të plotësojnë vargun numerik nga 5 deri në 1, duke i shkruar numrat që mungojnë në kutizat boshe. Nxënësve u kërkohet që në detyrën 2 t'i ndihmojnë nxënësit për të gjetur vendet e tyre.


VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

Vlerësojmë

1

Në katrorët e zbrazët, i shkruajmë numrat që mungojnë:

5 ☐ 3 2 ☐

2

Ndihmojmë nxënësit t'i gjejnë vendet e tyre.

2 + 3 | 4 − 2 | 5 − 4
3 − 1 | 4 − 3 | 1 + 4
5 − 1 | 1 + 2 | 5 − 3

3

a) < = > ? 4 ☐ 3 3 ☐ 3 1 ☐ 3 4 ☐ 2

b) Në katrorin e zbrazët, shkruajmë një numër që të fitojmë barazi ose pabarazi të saktë.

☐ < 3 5 > ☐ ☐ < 2 4 = ☐

c) Numrat i shoqërojmë me shkronja. Shkronjat i rendisim sipas alfabetit.

1 4 0 2 3 5

O A B C D E

4

0 1 2 3 4 5

___ + ___ = ___

0 1 2 3 4 5

___ + ___ = ___

59

Ata gjatë mbledhjes dhe zbritjes mund të përdorin numratoren sipas nevojës. Punohet individualisht dhe në mënyrë të pavarur.

Udhëzohen të vërejnë detyrën 3, e cila ka tri kërkesa të ndryshme. Nën a) duhet të vendosin njërin nga shenjat: <, >,= mes numrave të dhënë p.sh.:

- **Numri 4, a është më i vogël, më i madh apo baraz me numrin 3?**

**Vendos shenjën që duhet në katrorin mes numrave.**
Nxënësit orientohen që të shkruajnë numrin përkatës nën b).

Cili numër është më i vogël se numri 3? Të tjerat plotësohen individualisht.

Për kërkesën e tretë, nën c) nxënësit shoqërojnë numrat me shkronjat sipas alfabetit.
Ndihmohen me pyetjet:
- Cila shkronjë është e para në alfabet?
- Me cilin numër duhet të lidhet me shigjetë?

Vazhdojnë të pavarur plotësimin e detyrës.

Te detyra 4 udhëzohen nxënësit që ta vërejnë shembullin e parë.
Ndihmohen me pyetje:
- Shigjeta e kuqe sa numra është e gjatë?
- Po shigjeta e kaltër sa numra është e gjatë?
- Cili veprim është paraqitur në bosht numerik?
- Shkruani barazimin poshtë boshtit numerik.

U kërkohet nxënësve të plotësojnë edhe shembullin e dytë. Nxënësit punojnë të pavarur.

**Hapi 3:** Mblidhen librat për të kontrolluar e vlerësuar saktësinë e zgjidhjes së detyrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit rendisin saktë numrat nga 1-5. Njehsojnë saktë shumën dhe ndryshesën e numrave deri në 5, si dhe i krahasojnë numrat deri në 5 duke vendosur shenjën e duhur.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 50

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 6.1; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vijat e drejta dhe të lakuara

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton vijat e drejta dhe të lakuara;
- Vizaton vija të drejta me vizore dhe të lakuara me dorë të lirë;
- Klasifikon vijat sipas llojit, në të drejta dhe të lakuara.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizore, ngjyra druri, vizatime, letra ngjitëse me vija, fletë të bardhë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten para nxënësve disa vizatime dhe të komentohen ato. Çfarë po shihni? Me çfarë vija është vizatuar shtëpia? Me çfarë vije vizatohet topi?

Emërtohen vijat te shtëpia - vijat e drejta kurse, te Dielli përdoret vija e lakuar.



Nxënësit nxiten të gjejnë objekte që kanë vija të drejta ose të lakuara.

**Hapi 2:** Shtrohet pyetja: Si mendoni, si i vizatojmë vijat e drejta? Po vijat e lakuara si i vizatojmë?




Kërkohet të vëzhgojnë detyrën 1 në libër. Demonstrohet si përdoret vizorja për të vizatuar vija të drejta.

**Hapi 3**: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë disa vija të drejta duke përdorur vizore te detyra 2. Në detyrën 3 do të vizatojnë disa vija të lakuara, kurse në detyrën 4 do të vizatojnë vija të drejta dhe të lakuara. Nxënësit ndihmohen në përdorimin e vizores sipas nevojës. Librat shkëmbehen me shokun e bankës për ta vlerësuar punën e njëri-tjetrit. Parashtrohen pyetjet: Çfarë kanë të përbashkët këto dy lloje të vijave? (Se janë vija). Ku dallon vija e drejtë nga ajo e lakuar? (vija e drejtë vizatohet me vizore, kurse vija e lakuar me dorë të lirë).

**Hapi 4:** Nxënësve nëpër grupe u shpërndahen disa letra ngjitëse me vija të drejta dhe të lakuara dhe një letër A4 e ndarë në dy shtylla. U kërkohet t'i ndajnë vijat në dy shtylla sipas llojit.

| VIJA TË DREJTA | VIJA TË LAKUARA |
|---|---|
|  |  |
|  |  |
|  |  |

Përfaqësuesi i çdo grupi e paraqet punën e grupit të tij.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit i emërtojnë dhe i klasifikojnë saktë vijat e drejta dhe të lakuara. Po ashtu i vizatojnë drejt vijat e drejta me vizore dhe të lakuara me dorë të lirë.

**Detyrë:**
Vizatoni figura me vija të drejta dhe figura me vija të lakuara.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 51

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1, 2; II.1,2; III.1,2 ,6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1,4; 5.1; 6.1,2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Pika si prerje e vijave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon pikën si prerje e vijave;
- Bashkon pikat me vijë të drejtë dhe të lakuar;
- Vizaton vijat duke caktuar pikat në vendin ku priten.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Spango, fije shkrepse ose shkopinj të vegël, fletë A4, shkronja, kapëse letrash.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS







**Hapi 1:** Dalin disa nxënës te tabela. Marrin një spango të gjatë dhe e kapin duke kaluar nga njëra spango mbi tjetrën në disa vende.
Vendi ku ato priten kapet me kapëse letrash dhe u tregohet nxënësve se ato vende ku është kapësja quhen pika ku priten vijat, ose pika prerëse.

**Hapi 2:** Hapen librat dhe vërehet me vëmendje se si janë takuar vijat dhe janë krijuar pikat prerëse. U tregohet nxënësve që pikat ku takohen vijat shkruhen me shkronja të mëdha: A, B, C, D etj. Dy vija mund të priten në një pikë ose në shumë pika.




**Hapi 3**: Në detyrën 3 në libër nxënësit i bashkojnë pikat A dhe B me vijë të drejtë. Ndërsa pikat C dhe D i bashkojnë me vijë të lakuar. Atyre u përsëritet gjatë punës që pikat ku takohen vijat shkruhen me shkronja të mëdha A, B, C, D etj.

**Hapi 4:** Punohet detyra 4. Pikat A dhe B nxënësit i bashkojnë me vijë të drejtë dhe vijë të lakuar. Vija e lakuar do të takohet disa herë me vijën e drejtë. Në secilin vend ku janë takuar vijat nxënësit caktojnë nga një pikë, të ndryshme nga pika A dhe B.




**AKTIVITET SHTESË**

Formohen grupet me nxënës, u shpërndahen letra A4, spango me ngjyra të ndryshme, si dhe shkronja të mëdha. Nxënësit i kalojnë spangot me ngjyra njëri mbi tjetrin duke krijuar pika prerëse. Aty ku takohen spangot dhe krijohet pika prerëse, vendosin një shkronjë të madhe.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete, për identifikimin e pikave si prerje e vijave dhe vizatimin e vijave që priten.

**Detyrë:**

Në fletore të vizatohen nga dy vija të drejta që priten dhe nga dy vija të lakuara. Të caktohen pikat e prerjes.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

Për mësuesin/en

# Mësimi 52

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,6; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5,6; 6.1,2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vijat e hapura dhe të mbyllura

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon vijën e hapur dhe vijën e mbyllur
- Bën dallimin midis vijës së hapur dhe të mbyllur me anë të dy ngjyrave të dhënë në tekst;
- Klasifikon vijat e hapura dhe të mbyllura sipas lakueshmërisë dhe thyerjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Spango me ngjyra të ndryshme, shkopinj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Të gjithë nxënësit ngrihen në këmbë dhe kapen dorë për dore, ndërsa ata të fundit nuk lidhen njëri me tjetrin. Në atë pjesë rrethi mbetet i hapur. Pyeten nxënësit: Rrethi është i hapur apo i mbyllur? Pastaj nxënësit e fundit lidhen njëri me tjetrin. Në këtë rast rrethi mbyllet. Pyeten ata: Tani rrethi është i hapur apo i mbyllur?

**Hapi 2:** Me spango dhe shkopinj u kërkohet nxënësve në grupe të vogla të formojnë vija të hapura dhe të mbyllura.

**Hapi 3**: Diskutohet me nxënës:
Cila është shtaza në qendër të ilustrimit në ushtrimin e parë? Shtaza në qendër të ilustrimit të parë është




macja.
A mund të futet te miu me rrethojë të hapur? Po, mund të futet pasi rrethoja është e hapur.
A mund të futet te miu me rrethojë të mbyllur? Jo, nuk mund të futet pasi rrethoja është e mbyllur.
Në cilën situatë miu është i sigurt? Në situatën e parë Pse? Sepse rrethoja është e mbyllur.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet që vijën e hapur të lakuar ta ngjyrosin me ngjyrë të kuqe, kurse vijën e mbyllur të lakuar me ngjyrë të gjelbër. Lipset nga nxënësit të përdorin shprehjen "vija e lakuar e hapur" dhe "vija e lakuar e mbyllur", gjatë përgjigjes me gojë.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që vijën e thyer të hapur të ngjyrosin me ngjyrë të kuqe, kurse vijën e thyer të mbyllur të ngjyrosin më ngjyrë të gjelbër.
Lipset nga nxënësit të përdorin shprehjen, "vija e thyer e hapur" dhe "vija e thyer e mbyllur", gjatë përgjigjes me gojë.

**Hapi 6:** Nxënësve u kërkohet që të klasifikojnë vijën e lakuar dhe vijën e thyer duke bërë tik "v" pranë vijës së lakuar dhe "-" pranë vijës së thyer te ushtrimet 2 dhe 3.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive, për saktësinë e zgjidhjeve të kërkesave dhe për sqarimin që bën në të shprehur me gojë. Vlerësimi bëhet për dallimin e vijës së hapur nga vija e mbyllur.

**Detyrë:**
Në fletore të vizatohen gjysmën e faqes me vija të lakuara të hapura dhe gjysmën tjetër të faqes me vija të lakuara të mbyllura.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 53

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1,2; III.1,2,6. IV.5, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 6.4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Segmenti/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon segmentin nga vijat e tjera;
- Formon segmente në bazë të pikave;
- Krahason segmentet në bazë të pikave.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Spango, fije shkrepëse ose shkopinj të vegjë l, fletë A4, plastelinë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Merret një spango e gjatë dhe vendoset në dysheme para tabelës. Spangoja duhet të jetë më e gjatë se gjatësia e tabelës. Pyeten nxënësit: Çka paraqet kjo spango? (Një vijë të drejtë). U thuhet atyre se po u duhet vetëm gjatësia e tabelës. Merren dy mjete mësimore dhe kufizohet gjatësia e tabelës në spango. U tregohet nxënësve që tani ka një segment. Kur vija e drejtë është e kufizuar në të dyja anët, quhet **segment**.

**Hapi 2:** Shikohen me vëmendje pamjet në detyrën 1. Pyeten nxënësit: Sa fëmijë janë në fotografi? (2); Çfarë po bëjnë ata? (Po luajnë me litar); Çfarë kanë në duar? (Një litar - vijë e lakuar); Çfarë kanë te




këmbët? (Një spango - vijë e drejtë); Cila është pjesa që nuk duhet ta kalojnë fëmijët? (Aty ku janë vendosur gurët). E shihni që pjesa ku janë vendosur gurët është e kufizuar? Kjo pjesë (vijë) e kufizuar në të dyja anët, quhet **segment**.

**Hapi 3**: Bëhen sqarime rreth detyrës 2 e cila përmban rregulla. Nga figura vërehet se dy pika A dhe B mund të takohen me shumë vija. Vetëm njëra nga ato është e drejtë.
Skajet e segmentit shënohen me shkronja të mëdha A, B, C, D etj.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrat me radhë. Duke bashkuar pikat me ngjyrë të njëjtë formojnë segmente. Me vizore bashkojnë pikat e mëdha, në faqen tjetër duke treguar rrugën e topit formojnë segmente dhe shkruajnë që vijat e tilla janë **segmente**.

**Hapi 5:** Numërojnë brinjët e trekëndëshit në libër dhe tregojnë se me sa segmente është formuar ai. Krahasojnë pastaj segmentin sipas gjatësisë duke i dalluar ata sipas ngjyrës. P.sh., segmenti i kaltër është më i shkurtër, segmenti i gjelbër është më i gjatë etj.

**AKTIVITET SHTESË**

U shpërndahen nxënësve fletë A4, shkopinj për dhëmbë, plastelinë dhe u kërkohet të formojnë segmente me to. Nxënësit mund të formojnë edhe figura gjeometrike dhe tregojnë numrin e segmenteve që kanë ato figura, si dhe i krahasojnë segmentet. Pikat i shkruajnë me shkronja të mëdha, p.sh.: A, B, C, D etj.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete, për identifikimin e segmenteve, formimin e segmenteve dhe krahasimin e tyre.

**Detyrë:**

I plotësoni detyrat 3 dhe 4, që gjenden në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 54

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë, të tjera që ngjasojnë me figura gjeometrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,6; IV.5; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4,5,6; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Figurat dhe format e njëjta

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon figurat sipas formës së njëjtë;
- Klasifikon figurat gjeometrike sipas formës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, petëza me forma të ndryshme, mjete mësimore të nxënësit, fletë pune.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Pyeten nxënësit çfarë ka në klasë që kanë formë të njëjtë? Ata gjejnë gjëra që kanë forma të njëjta, si: bankat, karriget, dritaret etj. Po në çantën tuaj a ka gjëra që kanë forma të njëjta? – pyeten ata. Nxënësit nxjerrin librat dhe fletoret e tyre nga çantat, i bashkojnë ato që kanë forma të njëjta: fletoret në një anë, librat në anën tjetër si dhe lapsat e tyre. Marrin fjalën disa nxënës me radhë dhe tregojnë se çfarë kishte nga mjetet e tyre mësimore që kanë formën e njëjtë.

**Hapi 2:** Paraqiten me projektor pamje të figurave të ndryshme. Figurat përsëriten, por janë të shpërndara. Pyeten ata se a ka forma të njëjta që janë përsëritur dy herë këtu. Provojnë t'i bashkojnë ato së bashku.






**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet të punojnë detyrën 2 në libër. Figurat që kanë formë të njëjtë i ngjyrosin me ngjyrë të njëjtë. Nxënësit shikojnë me vëmendje se cilat figura kanë formën e njëjtë për t'i ngjyrosur ato pastaj me ngjyrë të njëjtë.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen ta punojnë detyrën 3 në libër. Figurat janë paraqitur në njërën anë të gjitha bashkë, ndërsa në anën tjetër të shpërndara. Kërkohet nga nxënësit t'i vërejnë me kujdes ato dhe t'i bashkojnë me vijë figurat me të njëjtën formë.

**Hapi 5:** Nxënësve u shpërndahen fletë të punës, ku kërkohet të lidhen me shigjetë figurat me forma të njëjta. Nxënësit punojnë fletën e punës me kujdes. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe për identifikimin e figurave sipas formës së njëjtë dhe klasifikimin e figurave.

**Detyrë:**

Vizatoni në fletore nga 4 figura dhe 4 gjëra-objekte që kanë formën e njëjtë me figurat.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 55

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Vizaton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura;
- Tregon shembuj të tjerë që ngjasojnë me figura gjeometrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1,2; III.1,2; IV.5; V. 5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4,5,6; 6.1,2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vijat, figurat dhe format e njëjta/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Vizaton forma dhe figura të njëjta gjeometrike;
- Krijon nga vijat e hapura, vija të mbyllura;
- Kopjon duke vizatuar figurat e njëjta.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza me figura gjeometrike, figura gjeometrike, fletë të printuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen petëzat me figura gjeometrike. Shikohet detyra e parë në libër dhe kërkohet nga nxënësit që me petëzat që kanë para vetes të kopjojnë pamjet që janë në libër. Pastaj kërkohet nga ata që të vizatojnë dhe të ngjyrosin figurën e njëtë në libër.



**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të punojnë detyrën 2 në libër, ku kërkohet që vijat




e lakuara të hapura të mbyllen me vijë të kuqe, me vijë të kaltër të mbyllen vijat e thyera të hapura që kanë formën e trekëndëshit, ndërsa me vijë të gjelbër vijat e thyera të hapura që kanë formën e drejtkëndëshit.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të bashkojnë me vijë figurat e njëjta në detyrën 3, më pas i ngjyrosin me ngjyrën e njëjtë figurat e njëjta.

**Hapi 4:** Në detyrën e fundit në libër, nga nxënësit kërkohet të kopjojnë duke vizatuar figurën e njëjtë. Ndihmohen nxënësit që kanë vështirësi në vizatimin e figurës.

**AKTIVITET SHTESË**

U shpërndahen nxënësve fletët e punës ku gjenden figura gjeometrike me ngjyra, si dhe figurat pa ngjyra. Kërkohet nga ata t'i presin me gërshërë figurat gjeometrike që janë me ngjyrë, pastaj i ngjesin me ngjitës te figurat e njëjta pa ngjyrë. Fitohet kështu figura e trenit. Lipset nga nxënësit që të numërojnë figurat gjeometrike me të cilat është ndërtuar treni. P.sh., 3 rrathë, 2 katrorë, 1 trekëndësh dhe 2 drejtkëndësha.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete, për identifikimin e formave dhe figurave të njëjta, si dhe vizatimin e tyre.

**Detyrë:**

Punoni veturën me figura gjeometrike, ngjashëm me aktivitetin në klasë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 56

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Shkruan dhe lexon numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri gjashtë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon bashkësitë me 6 elemente;
- Shkruan grafikun e numrit 6;
- Rendit numrat prej 0 deri në 6 dhe anasjellas.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numra 0-6, petëza, fasule, shkopinj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Para nxënësve paraqiten fjalitë dhe kërkohet të dëgjojnë me vëmendje.
*"Gjashtë shokë shkuan në librari. Atje i blenë gjashtë fletore, gjashtë lapsa dhe gjashtë komplete me ngjyra."*
- Cila është fjala që dëgjuat disa herë?
- Cilin numër mund ta vendosim në vend të fjalës "gjashtë"?

Gjatë diskutimit do të dalë në pah numri gjashtë. Paraqiten etiketat me numrin gjashtë, të cilat vendosen mbi fjalën "gjashtë".
**Hapi 2:** Nxënësit ftohen të flasin për figurën e detyrës 1. Diskutohet me nxënës: *Sa fëmijë janë në radhë*




*që ta hedhin topin? Po në anën tjetër, sa fëmijë janë te porta? Sa fëmijë janë gjithsej?* Ngrihet një nxënës dhe e shkruan në tabelë barazimin 5+1=6.

**Hapi 3**: Modeli i detyrës 2 paraqitet në tabelë dhe nga nxënësit kërkohet t'i numërojnë vazot, brushat dhe pikat. Në fund lexojnë numrin gjashtë.

**Hapi 4:** Kërkohet nga ata të formojnë bashkësi (petëza, kapak, shkopinj) me pesë elemente dhe më pas të shtojnë një. Nxiten të thonë çfarë kanë formuar "Unë kam formuar një bashkësi me gjashtë elemente".

**Hapi 5:** Paraqitet grafiku i numrit gjashtë.

Nxënësit udhëzohen ta shkruajnë në fletore e më pas i vendosin numrat me radhë në tabelën magnetike.

**Hapi 6:** Ftohen nga 7 nxënës dhe u jepet nga një numër prej 0 – 6. Udhëzohen se duhet të renditen sipas vargut numerik, ndërsa një nxënës tjetër i shkruan në tabelë. Radhën tjetër renditen në rendin zbritës nga 6-0.

Vazhdohet disa herë kështu, ndërsa nxënësit e plotësojnë në mënyrë individuale detyrën 4.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të bashkësive me gjashtë elemente, shkrimit të grafikut të numrit gjashtë dhe renditjen e numrave prej 0 deri 6 dhe anasjellas.

**Detyrë:**
Të plotësohet 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 57

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri shtatë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon bashkësitë me shtatë elemente;
- Shkruan grafikun e numrit shtatë;
- Krijon bashkësi me shtatë elemente.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numrat 0-7.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten para nxënësve disa fjali dhe u kërkohet të dëgjojnë me vëmendje.
*"Andi e kishte ditëlindjen e shtatë. Ai i ftoi shtatë shokë për të festuar. Ata i sollën shtatë dhurata të bukura. Në tortën e tij kishte shtatë qirinj".*
- Cila fjalë po përsëritet disa herë?
- Cilin numër mund ta vendosim në vend të fjalës "shtatë"?
Paraqiten etiketat me numrin shtatë dhe punimi i përgatitur si në detyrën 1. Nxënësit vendosin etiketat mbi fjalën "shtatë".

**Hapi 2:** Paraqitet në tabelë ilustrimi i përgatitur me bashkësi të ndryshme. Nga nxënësit kërkohet të




identifikojnë bashkësitë me shtatë elemente. Pastaj u kërkohet atyre të formojnë bashkësi me shtatë elemente (fasule, petëza dhe kapakë). Shkruajnë numrin e elementeve me pika dhe udhëzohen të thonë: *"Kam formuar një bashkësi me shtatë elemente"*.
Kërkohet të vëzhgojnë detyrën 2 në libër dhe ta përshkruajnë me fjalë.

**Hapi 3**: Paraqitet grafiku i numrit shtatë në tabelë. Një nxënës i vendos me radhë numrat në tabelën magnetike 0-7 dhe anasjellas, nxënësit e tjerë i ngrenë gishtërinjtë dhe numërojnë me zë. Më pas plotësojnë kutizat me numrin shtatë në detyrën 3.




**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të plotësojnë detyrat 4 dhe 5 në libër sipas kërkesës së dhënë. Librat shkëmbehen me shokun e bankës me ç'rast vlerësojnë njëri-tjetrin duke vendosur simbole:  

**Hapi 5:** Kërkohet të vizatojnë në fletore një bashkësi me shtatë elemente, dhe të shkruajnë tre rreshta me numrin 7. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të bashkësive me shtatë elemente, shkrimit të grafikut të numrit shtatë dhe krijimit të bashkësive me shtatë elemente.

**Detyrë:**
Të vizatohen shtatë figura të ndryshme.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 58

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.4; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri 6 dhe 7/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shoqëron bashkësinë me numrin përkatës të elementeve;
- Krahason numrat 6 dhe 7;
- Gjen numrin e duhur për të formuar numrin 7.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numra, foto të bashkësive, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten disa bashkësi me numër të ndryshëm të elementeve dhe kartat me numrat 1-7. Nxënësve u kërkohet të shoqërojnë bashkësinë me numrin përkatës të elementeve:






**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë me vëmendje figurën e detyrës 1. Pyeten: *Çfarë duhet të gjejmë? Sa është numri i zogjve në pemë? Sa zogj janë brenda në shtëpi? Në cilën shtëpi ka më shumë zogj?*
Pasi numërojnë zogjtë ftohet një nxënës ta shkruajë barazimin në tabelë. Krahasohet numri i zogjve në dy shtëpitë. $6 < 7$ dhe $7 > 6$.

**Hapi 3**: Tregohen para klasës shtatë etiketa me numrat 1-7. Në fillim ngre numrin 1 dhe kërkohet që një nxënës të duartrokasë aq herë sa numri. Pyeten nxënësit se cili numër vjen pas numrit 1. Kërkohet të duartrokasë e gjithë klasa aq herë sa numri. Përsëritet kjo veprimtari deri te numri 7.

**Hapi 4:** Lipset të plotësohet detyra 3 në mënyrë individuale. Nxënësit i ngjyrosin fushat aq sa tregon numri. Më pas e diskutojnë mënyrën e zgjidhjes me shokun a shoqen e bankës.

**Hapi 5:** Udhëzohen të plotësojnë detyrën 4 me ndihmën e kubeve për të formuar numrin 7. Në fillim u kërkohet të vendosin 2 kube, pastaj të shtojnë nga një kub derisa ta formojnë numrin 7. Nxënësit nxiten të gjejnë numrat dhe të plotësojnë detyën. Vlerësohet puna e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shoqërimin e saktë të objekteve me numrin e duhur, krahasimin e numrave 6 dhe 7 dhe gjetjen e numrit të duhur që formon numrin 7.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 2 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 59

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Mbledhja e numrave deri në 7

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1, 3; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;2.1; 3.3; 3.4; 3.5; 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 7

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mbledhorin e panjohur në shembuj të ndryshëm;
- Njehson shumën e numrave deri në 7.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Katrorë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të vendosin mbi bankë 5 katrorë të kaltër, pastaj edhe 2 katrorë të kuq.
*Sa katrorë kemi gjithsej?* Nxiten të thonë: *Kemi pesë plus dy, baraz me shtatë katrorë.*
Shkruhet barazimi në tabelë dhe plotësohet skema.






**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të vërejnë shembujt e dhënë në detyrën 1. Përmes pyetjeve nxiten ata të gjejnë mbledhorin e dytë.
*- Sa rrathë të kuq janë brenda bashkësisë?*
*- Edhe sa rrathë duhet t'i vizatojmë që ta formojmë numrin 7?*
Nxënësit vizatojnë rrathët dhe vendosin numrin e duhur në kuti.
Në fund lexohen të gjitha barazimet e fituara.

**Hapi 3**: Detyra e ushtrimit plotësohet me ndihmën e shiritit numerik të vendosur në dysheme. Ftohen dy nxënës në tabelë. Një nxënës shkon te numri, i bën dy hapa dhe pyetet te cili numër u ndal, kurse nxënësi tjetër e shkruan barazimin në tabelë. Veprimtaria përsëritet për të gjithë shembujt e detyrës.
Barazimet e fituara shkruhen në tabelë.

**Hapi 4:** Bisedohet me nxënësit rreth figurës së paraqitur në detyrën 3.

*- Sa rrathë të kuq janë?* (3)
*- Sa rrathë të kaltër?* (4)
*- Sa rrathë janë gjithsej?* (3+4=7). Plotësohen të gjitha detyrat.

**Hapi 5:** Paraqitet në tabelë një shtëpi me tri kate. Diskutohet rreth saj: *Cili numër është në çati të shtëpisë?* (6); *–Në katin e parë sa banorë janë?* (1); *Edhe sa banorë duhet të jenë për t'u bërë 6?* (5); *Si i gjetët*? Ngrihet një nxënës dhe e vendos numrin e duhur në katin e parë. Njëjtë veprohet edhe për plotësimin e katit të dytë dhe të tretë.




**Hapi 6:** Nxënësve u kërkohet të punojnë në mënyrë të pavarur katër ushtrimet e tjera të detyrës 4. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të mbledhorit të panjohur dhe saktësinë e llogaritjes së shumës së numrave deri në shtatë.

**Detyrë:**
Të shkruhen barazimet e detyrës 3 në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 60

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.1, 3; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 3.3; 3.4; 3.5 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Mbledhja e numrave deri në 7/U




**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mbledhorin e panjohur në shembuj të ndryshëm;
- Njehson shumën e numrave deri në 7.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletëza të përgatitura, topa të vegjël.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura. Prej tyre kërkohet të gjejnë të gjitha zgjidhjet që japin shumën shtatë.






**Hapi 2:** Paraqitet në tabelë skema e detyrës 1. Përmes pyetjeve nxiten nxënësit të gjejnë mbledhorin e dytë.
*- Sa rrathë janë gjithsej në shembullin e parë?*
*- Rrathë të kuq janë katër, edhe sa rrathë të kaltër janë?*
Nxënësit shkruajnë mbledhorin e dytë dhe barazimi paraqitet në tabelë (7 = 4 + 3).
Në mënyrë të njëjtë veprohet edhe me shembujt e tjerë.

**Hapi 3**: Në detyrën e dytë nxënësit do të punojnë në dyshe. Dyshet ngrihen me radhë në tabelë dhe hedhin aq topa sa paraqet etiketa në libër. Pastaj i numërojnë topat dhe gjejnë shumën. Shkruhet barazimi në tabelë, ndërsa nxënësit plotësojnë librin. Përsëritet aktiviteti me shembuj të tjerë.



5+1=6

**Hapi 4:** Nxënësve u lexohet një problemë.
*- Fjolla kishte 3 lule, Bledi ia dha asaj edhe disa lule dhe iu bënë 7 lule. Sa lule ia dha Bledi Fjollës?*

3 + _____= 7

Kërkohet nga nxënësit të tregojnë zgjidhjen. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e llogaritjes së shumës së numrave deri në 7 dhe gjetjes së mbledhorit të dytë.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 3 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 61

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3;II.2,8; III.1,3,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2,4; 3.1,3,4,5; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave deri në 7

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton numrin e elementeve në shembujt e dhënë;
- Gjen ndryshimin e numrave deri në 7;
- Shpjegon me fjalë mënyrën e zgjidhjes së detyrës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, kube, fasule, etiketa me numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të vendosin mbi bankë dy katrorë të kaltër dhe pesë katrorë të kuq.
Paraqitet skema në tabelën magnetike.
Pyetën nxënësit:
Sa katrorë keni mbi bankë? (*Shtatë*) Një përgjigje e mundshme. Ngrihet një nxënës dhe vendos etiketën me numrin 7.
Po t'i heqim katrorët e kaltër, sa katrorë do të mbesin? (Pesë) Nxiten të thonë gjithsej ishin 7 katrorë, i hoqa 2 të kaltër më mbetën 5 të kuq. Nxënësit e paraqesin aktivitetin me fjali numerike si 7 - 2 = 5.
Përsëriten veprimet duke larguar 5 katrorë të kuq.






**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurat e detyrës 1 dhe përmes pyetjeve nxiten të gjejnë numrin e elementeve, p.sh.:
Çfarë ka në figurë? Sa qirinj janë ndezur? Çfarë duhet të gjejmë? Sa qirinj mbetën pa u ndezur? (7-2=5).
Vazhdohet veprimi i njëjtë me figurat e tjera.

**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet të bashkojnë fishet e numrave në detyrën 2, për të krijuar barazime të sakta.




Etiketat me barazime vendosen në tabelë dhe lexohen nga nxënësit, të cilat më pas shkruhen në fletore.

**Hapi 4:** Udhëzohen të plotësojnë detyrën 4 duke njehsuar ushtrimet dhe ngjyrosur kutizat.

**Hapi 5:** Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura me ushtrime, të cilat plotësohen në mënyrë të pavarur.
Më pas shpjegojnë me fjalë mënyrën e zgjidhjes së detyrave.



7 - 4 = ☐



7 - 5 = ☐



7 - 1 = _____



7 - 3 = _____

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, përcaktimin e saktë të numrit të elementeve dhe për saktësinë me të cilën plotësojnë detyrat me zbritjen e numrave deri në shtatë.

**Detyrë:**
Të plotësohet ushtrimi 3 nga libri.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 62

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.1,3,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 3.1,3,4,5; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 7/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Perdor termat matematikorë në situata të ndryshme;
- Shkruan fjali numerike sipas figurave;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 7;
- Paraqet numrat si shumë të mbledhorëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, kube, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të krijojnë tregime bazuar në figurat e detyrës 1, duke u fokusuar në numrin e përgjithshëm të elementeve dhe në numrin e elementeve që largohen (*fiken qirinjtë*), apo shtohen (*ndizen qirinjtë*). Nxiten ata t`i përdorin konceptet matematikore "*heq- zbres*" dhe "*shtoj- mbledh*".

**Hapi 2:** Paraqiten në tabelë barazimet si në detyrën 2. Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe nga 4-6 vetë, dhe secilit grup u jepet nga një kavanoz me nga 7 petëza. Nxënësit duhet të heqin nga kavanozi petëza sipas kërkesës së detyrës, disa i shkruajnë barazimet në tabelë duke i dhënë sqarimet e duhura. Njëkohësisht i plotësojnë barazimet në tekst.
Detyra 3 vazhdohet duke shtuar petëza që të formohet numri 7, bazuar në kërkesën e detyrës.




**Hapi 3**: Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe për të formuar numrin 7 dhe 6 si shumë të dy mbledhorëve. Nxënësi i parë ngre p.sh., 4 gishta, e nxënësi tjetër duhet të plotësojë numrin 7 duke ngritur 3 gishta. Një çift del para nxënësve për të treguar si e kanë formuar numrin 7 duke përdorur nga dy numra, si: 5+2=7; 4+3=7; 1+6=7, ndërsa çifti tjetër tregon si është formuar numri 6 si shumë e dy mbledhorëve. Plotësojnë detyrën 6, ku njëri nxënës paraqet numrin 7 si shumë, ndërsa tjetri si ndryshim.

**Hapi 4:** Paraqitet figura në projektor (tabelë) dhe duke rikujtuar njohuritë e kaluara, plotësojnë barazimet duke udhëzuar që të parafytyrojnë se në secilën shtëpi banojnë aq banorë sa është numri në çatinë e shtëpive. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrën 8, që në fillim të kryejnë veprimet e mbledhjes apo zbritjes, e pastaj të bëhet krahasimi i rezultateve duke vendosur shenjat >, =, <.




Puna e nxënësve vlerësohet, ndërsa ndihmohen ata që kanë vështirësi.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, saktësinë në leximin e shkrimin e barazimeve duke u mbështetur në figura, njehsimin e shumës dhe ndryshimit të numrave deri në 7.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 9 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 63

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.2,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 3.4; 4.2; 5.1; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 7;
- Paraqet numrat si shumë apo ndryshim të dy numrave;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 7 në boshtin numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirit matematikor, komplet matematikor, objekte te ndryshme që e rrethojnë nxënësin.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në dysheme vendoset shiriti matematikor. Nxënësit ndahen në dy grupe, njërit grup i shpërndahen etiketat me veprimin e zbritjes, p.sh., 7 - 3 5 - 0 6 - 6 etj., ndërsa grupit tjetër i shpërndahen etiketat me mbledhorë, p.sh., 3 + 4 6 + 1 7 + 0 etj. Nxënësit udhëzohen që me radhë të vendosen në shiritin matematikor, e pastaj ata që kanë etiketat me zbritje të bëjnë kërcime prapa, sikurse që tregon etiketa. Nxënësit që kanë etiketa me mbledhorë, të bëjnë kërcime para aq herë sa tregon mbledhori i dytë.

**Hapi 2:** Paraqitet në tabelë boshti numerik, si në detyrën e parë. Nxënësit që më parë kishin etiketat me zbritje, tani plotësojnë barazimin e mbledhjes duke i shoqëruar në boshtin numerik zgjidhjet. Po ash-




tu ata që i kishin etiketat me zbritje, tani shoqërojnë zgjidhjen e etiketave me mbledhje në boshtin numerik. Nxënësit që kanë vështirësi, zgjidhin më shumë detyra, derisa vlerësohet që e kanë kuptuar. Detyra plotësohet edhe në libër.

**Hapi 3**: Nxënësit udhëzohen që të punojnë në çifte, për të formuar numrin 7 si mbledhorë ashtu si në detyrën e dytë. Njëri nxënës rendit petëzat e kaltra me numrat e dhënë duke ia shtuar petëzat e kuqe me mbledhorët që mungojnë. Nxënësi plotëson detyrën në libër. Më pas ndërrohen rolet, ku njëri nxënës i rendit petëzat për të formuar numrin 6 si mbledhor, ndërsa nxënësi tjetër plotëson në libër.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrën e tretë, duke iu treguar se mbledhori i parë është numri i rrathëve, ndërsa mbledhori i dytë është numri që mban djali në kapelë.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen si të ngjyrosin figurën e parë të detyrës 4, duke u bazuar në rezultatet. Vëzhgohet dhe vlerësohet puna e nxënësve, ndihmohen ata që kanë vështirësi në plotësimin e detyrës.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për zbatimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave në boshtin numerik, saktësinë e zbërthimit të numrave 6 dhe 7 si mbledhorë, si dhe ngjyrosjes duke njehsuar shumën dhe ndryshimin e numrave.

**Detyrë:**
Të plotësohet figura e dytë e detyrës 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 64

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II..8; III.2,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 3.4; 4.2; 5.1; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 7;
- Paraqet shumën e numrave në boshtin numerik;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen e numrave në problema;

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, fasule, shkopinj, objekte të ndryshme që e rrethojnë nxënësin, burime nga interneti.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhët dhe komunikimi, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të nxjerrin në bankat e tyre petëzat. Kërkohet nga ata:
- Në njërën dorë mbani 3 petëza (fasule, shkopinj), e në dorën tjetër 4 petëza. Sa petëza keni në dy duart? Po t'i hiqni 5 petëza, sa ju mbesin?
- Nëse në njërën dorë keni tri petëza, edhe sa duhet shtuar që të formohen 5 petëza?
- Sa anëtarë janë në një familje nëse njëri anëtar ka dalë dhe kanë mbetur 5 anëtarë?

**Hapi 2:** Paraqitet në ekran faqja e librit. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë detyrën e parë duke shkruar shenjat " +" ose "-" që të formojnë barazime të sakta.
Më pas lexohet detyra e dytë dhe nxënësit plotësojnë në libër. Detyra e tretë plotësohet duke ua rikujtuar




se numri në kulmin e shtëpive tregon numrin e banorëve që banon në secilin kat. Në kate të shtëpive të shkruajnë edhe sa banorë duhet të vijnë që të ketë barazi të saktë. Lexohet edhe detyra e katërt duke ua rikujtuar se veprimi i mbledhjes është për të shtuar, ndërsa veprimi i zbritjes për të larguar (hequr).

Detyrat 5 dhe 6 lexohen, ndërsa nxënësit plotësojnë në libër.

**Hapi 3**: Nxënësve u kërkohet të plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrat 7 dhe 8, duke u treguar se te detyra 8 mbledhori i parë është numri i rrathëve, ndërsa mbledhori i dytë është numri që mban djali në kapelë.

**Hapi 4:** Vëzhgohet dhe vlerësohet puna e nxënësve, ndihmohen ata që kanë vështirësi në plotësimin e detyrës. Nxënësit që plotësojnë saktë detyrat në mënyrë të pavarur, vlerësohen me ★.
Nxënësit që kishin pak vështirësi, vlerësohen me ♥, ndërsa ata që kishin më shumë vështirësi vlerësohen me ✿.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për zbatimin e mbledhjes dhe zbritjes në problema dhe në boshtin numerik, zbërthimin e numrave 7 dhe 8 në mbledhorë.

**Detyrë:**
Detyra 7 të paraqitet në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 65

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri tetë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Formon bashkësi me 8 elemente;
- Shkruan grafikun e numrit 8;
- Rendit numrat prej 0 deri te 8 në vargun numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të printuara, petëza, fasule, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Pyeten nxënësit: *Sa këmbë ka 1 mace? Po dy mace? Po një pulë, një rosë e një qen?*
Në projektor paraqitet vjersha për numrin 8 https://www.youtube.com/watch?v=OFsckQCëSdë
Nxiten diskutimet rreth videos duke parashtruar pyetjet: Çfarë shihet në ekran? Çfarë përmendet tjetër? Ftohen 2-3 nxënës të shkruajnë numrin 8 në tabelë.
Kërkohet të ngrenë pesë gishta, pastaj të shtojnë edhe tre gishta të tjerë dhe të numërojnë nga pesa deri te teta duke shtuar nga një: 5, 6, 7, 8. Më pas numërojnë nga 8 deri në 5 duke hequr nga një: 8, 7, 6, 5.

Kam në xhep ca kokrra arra, i vendos këtu përpara, se me shokun, që kam pranë, do t'i ndaj si me vëllanë. Katër shokë, katër vetë, të gjitha arrat ishin TETË.




**Hapi 2:** Diskutohet fotografia e ushtrimit të parë. Nxënësit do të tregojnë se sa fëmijë janë, sa kapela kanë, çfarë forme ka rruga që përshkojnë fëmijët. Nxënësit udhëzohen të formojnë një tregim rreth figurës së librit.

**Hapi 3**: Në tabelë paraqitet grafiku i numrit 8, duke treguar kahet e shkrimit të numrit. Pyeten nxënësit se me cilin numër u ngjan, dhe se a do të kenë vështirësi të shkruajnë numrin 8. Ata shkruajnë në kutizat e detyrës 3, grafikun e numrit 8.

**Hapi 4:** Udhëzohen nxënësit të plotësojnë ushtrimin 5 duke shkruar numrat në rendin rritës dhe zbritës. Puna e tyre vëzhgohet dhe vlerësohet. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletën e printuar. Duke përcjellë kahet e shigjetës për paraqitjen e numrit 8, të vazhdojnë të shkruajnë 2 rreshta me grafikun e numrit 8 e më pas të ngjyrosin vetëm rrathët që paraqesin numrin 8.



**AKTIVITET SHTESË**

Nxënësit udhëzohen të formojnë një rreth dhe të fillojnë të numërojnë deri në 7. Kur vjen radha e numrit 8, thuhet "hop". Nxënësit që gabojnë ulen në vend. Loja vazhdon deri në zgjedhjen e fituesit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e formimit të bashkësisë me 8 elemente, shkrimin e grafikut të numrit 8, renditjes së numrave prej 0 deri te 8 në vargun numerik.

**Detyrë:**

Të vizatohet një bashkësi me 8 elemente dhe të shkruhen tre rreshta me numrin 8.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 66

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte;
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë të numrave nga 1-20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri tetë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon vendndodhjen e numrit 8 në boshtin numerik;
- Shkruan numrin 8 si shumë e dy mbledhorëve të ndryshëm;
- Përcakton numrin 8 si bashkësi me tre dhe katër mbledhorë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numra magnetikë, petëza, shkopinj, fasule, numëratore, ngjyra druri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit ftohen që t'i rendisin me radhë numrat magnetikë nga 0 deri në 8, të cilët janë të vendosur në mënyrë të çrregullt. Lexohet me zë vargu i formuar nga numrat nga 1-8.
0 1 2 3 4 5 6 7 8 dhe anasjellas 8 7 6 5 4 3 2 1 0

**Hapi 2:** Nxënësit në detyrën 1 plotësojnë boshtin numerik me numrat që mungojnë. Pas plotësimit u përgjigjen pyetjes: Për sa është numri 8 më i madh se numri 7?




**Hapi 3**: Nxënësit vëzhgojnë detyrën 2 dhe analizojnë me anë të pyetjeve. Si mendoni, çfarë duhet bërë në detyrën 2?; Sa rrathë duhet ngjyrosur?; Sa janë të ngjyrosur?; Edhe sa rrathë duhet t'i ngjyrosni?; Nxënësit punojnë në detyrën 2.

**Hapi 4:** U kërkohet atyre që të punojnë në dyshe. Nxënësit duhet të vendosin mbi bankë 8 petëza, shkopinj apo fasule. Më pas t'i ndajnë ato në tri vende sipas dëshirës. Tregojnë si e kanë ndarë numrin 8 në tre mbledhorë.

**Hapi 5:** Nxënësit vëzhgojnë shembujt e detyrës 3 dhe u përgjigjen pyetjeve: Çfarë kanë të përbashkët të gjitha bashkësitë?; Ku dallojnë ato në mes vete?
Nxënësit do të punojnë në dyshe. Secili nxënës brenda dyshes punon shembujt e njërit rresht. U kërkohet të vizatojnë brenda bashkësive të vogla, aq elemente sa të plotësohet numri i përgjithshëm 8. Po ashtu të shkruhet numri i caktuar i elementeve në kutiza boshe. Brenda dyshes shkëmbehen librat.

**Hapi 6:** Nxënësit punojnë në dyshe. Njëri nxjerr p.sh., 3 petëza, tjetri edhe 5 petëza që të bëhen 8 të tilla. Secila dyshe shkruan me numra veprimet e tyre me petëza, p.sh., barazimin: 3 + 5 = 8.



Nxënësit plotësojnë të pavarur detyrën 5, duke shkruar numrin 8 si shumë e dy mbledhorëve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit dallojnë saktë vendndodhjen e numrit 8 në boshtin numerik; shkruajnë saktë numrin 8 si shumë e dy mbledhorëve, si dhe përcaktojnë saktë numrin 8 si bashkësi me tre, katër mbledhorë.

**Detyrë:**
Detyra 4 në libër dhe detyra 5 si barazime të shkruhen në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 67

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Shkruan dhe lexon numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri nëntë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon numrin 9 nga numrat e tjerë;
- Shkruan saktë numrin 9;
- Numëron deri në 9 dhe anasjellas.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Poezi, numra magnetikë, shkopinj, petëza, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Para nxënësve paraqitet një poezi.
Nëntë planetë të veçantë
rreth Diellit rrotullohen.
Janë shumë, shumë larg
me sy nuk shikohen.

Te njëri prej tyre




njerëzit jetojnë,
ai është planeti
më i miri në botë.
Planeti ynë quhet Tokë.

Pyeten ata se cili numër po përmendet në poezi. Di ndonjëri se si shkruhet numri 9?
Njëri nxënës vendos etiketën me numrin 9 mbi fjalën "nëntë".
Komentohet vizatimi në detyrën 1 të librit. Sa saksi me lule janë mbi tavolinë?; Edhe sa saksi ia dhuroi Ari nënës?; Sa saksi u bënë gjithsej? Shkruhet 8 + 1 = 9.
Për sa është numri 9 më i madh se numri 8?

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të ngrenë pesë gishta të njërës dorë dhe katër gishta të dorës tjetër. Sa gishta i keni ngritur? Shkruhet në tabelë numri 9. Pyeten se me cilin numër ngjason?; Nga se ndryshon me numrin 6?; Për sa është më i madh se numri 6?

Nxënësit vendosin numrat magnetikë me radhë deri në 9 dhe numërojnë deri në 9 dhe anasjelltas.

**Hapi 3:** Nxënësit komentojnë detyrën 2 dhe shkruajnë saktë numrin 9 në kutizat boshe të detyrës 3.

**Hapi 4:** Ata shkruajnë numrin e elementeve të bashkësive në detyrën 4.

**Hapi 5:** Kërkohet nga nxënësit të shikojnë detyrën 5. U përgjigjen pyetjeve: Sa rrathë janë të kuq?; Sa rrathë duhen ngjyrosur me të gjelbër?

Nxënësit ngjyrosin rrathë dhe në fund tregojnë se sa rrathë të verdhë kanë ngjyrosur.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit identifikojnë dhe shkruajnë saktë numrin 9. Po ashtu numërojnë saktë deri në nëntë dhe anasjelltas.

**Detyrë:**
Krijoni një bashkësi me 9 elemente dhe shkruan dy rreshta me numrin 9 në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 68

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Numëron me rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20;
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, zbritësin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**Numri nëntë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan numrin 9 duke e shqiptuar saktë atë;
- Numëron saktë nga 0-9 dhe anasjelltas;
- Formon numrin 9 si shumë me dy dhe tre mbledhorë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatim, numra magnetikë, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Hapi 1:** Paraqitet para nxënësve një vizatim, ku shihet qiriri dhe disa pika në të. Ata duhet t'i bashkojnë sipas numrave me radhë nga 1 deri në 9. Nxënësit e tjerë shkruajnë në fletore vargun numerik nga 0 deri në 9. Shkëmbehen fletoret me shokun e bankës për të kontrolluar saktësinë e tij. Në fund, numërohet nga 0 deri në 9 dhe anasjelltas.

**Hapi 2:** Kërkohet të shikojnë detyrën 1 në libër dhe i përgjigjen pyetjes se sa petëza ka në secilën bashkësi të dhënë. Plotësohen vargjet numerike të ndryshme deri në 9.




Shkëmbehen librat me shokun dhe vlerësohen nga ta për saktësinë. Lexohen me zë vargjet e numrave të plotësuar. Kalohet në detyrën 2 ku duhet ngjyrosur figura gjeometrike aq sa tregon numri i dhënë.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe, ku brenda dyshes njëri nxënës do të jetë 1 e tjetri 2. Që të dy nxënësit do të formojnë një bashkësi me 9 petëza (shkopinj) dhe t'i ndajnë ato: 1-shat në dy bashkësi, kurse 2-shat do t'i ndajnë në tri bashkësi më të vogla. Dyshet do të shkruajnë me numra ndarjet e tyre, p.sh., lexohen me zë ndarjet.




**Hapi 4:** Nxënësit punojnë detyrën 3 individualisht dhe të pavarur. U përgjigjen pyetjeve: - *Sa rrathë të kuq duhen të jenë? - Sa janë të vizatuar? - Edhe sa duhen vizatuar? - Pse?* Kështu vazhdohet edhe për dy ndarjet e tjera të numrit 9.

**Hapi 5:** Nxiten nxënësit të vëzhgojnë detyrën 5 dhe ta komentojnë duke i ndihmuar me pyetjet: *Sa katrorë kemi në çdo rresht? -Nga se ndryshojnë mes vete? -Në çdo barazim kemi katrorë të kuq, ku do të shënoni numrin e katrorëve të kuq, katrorëve të gjelbër dhe të kaltër. -Çfarë duhet shënuar në katrorin e kaltër? -Po në të gjelbrin?* - Nxënësit punojnë individualisht dhe të pavarur. Lexohen barazimet e fituara dhe shënohen në tabelë. Pyeten: *-Çfarë kanë të përbashkët këto barazime? -Ku ndryshojnë mes vete?*

*9 = 3 + 4 + 2*
*9 = 4 + 2 + 3*
*9 = 3 + 4 + 2*
*9 = 2 + 6 + 1*
*9 = 2 + 3 + 4*

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit shkruajnë, lexojnë, numërojnë deri në 9 dhe formojnë saktë numrin 9 me dy e tre mbledhorë.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 në libër dhe të shkruhen në fletore si barazime.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 69

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.5; 2.1;3.1; 3.3; 3.5; 4.2;5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon numrin e elementeve në situatat e caktuara;
- Rendit numrat nga 1- 9 në vargje numerike;
- Krahason numrat deri në 9.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatim, etiketa me numra, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit nxiten të shpjegojnë situatën e dhënë në detyrën 1 të tekstit. Mund të ndihmohen me pyetjet: *Sa nxënës janë gjithsej? -Këta nxënës do të ulen nëpër grupe. -Kanë numër të njëjtë të nxënësve grupet?*
Ftohet një nxënës vullnetar të shkruajë në tabelë numrin e nxënësve që duhet ulur në grupin e parë, të dytin dhe në të tretin: *3 + 2 + 4.*
Sqarohet se si bëhet mbledhja e tre numrave, ku fillimisht mblidhen dy numrat e parë dhe pastaj të tretin.
Shkruhet në tabelë 3 + 2 + 4 = 9 dhe lexohet nga nxënësit.




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të nxjerrin mbi bankë 7 petëza. *Sa petëza duhen shtuar që të bëhen gjithsej 9 petëza? - Pse?- Për sa është numri 9 më i madh se numri 7? - Për sa është numri 7 më i vogël se numri 9?*

**Hapi 3:** Nxënësit kalojnë në plotësimin e detyrës 2. Rreth shembullit të parë ndihmohen me pyetje: *-Sa rrathë duhen të jenë gjithsej? - Sa rrathë janë në bashkësinë e parë? -Edhe sa rrathë duhet të vizatoni në bashkësinë e dytë? - Pse?*
Në shembujt e tjerë punojnë individualisht e të pavarur.




**Hapi 4:** Thirren 5 nxënës, ku secilit nga ta u jepet nga një numër i caktuar prej 1 deri në 9. Ata do të renditen nga numri më i vogël deri te ai më i madhi. Një nxënës tjetër e shkruan vargun numerik rritës në tabelë, kurse nxënësi tjetër shkruan vargun zvogëlues të numrave nga 9 deri në 1. Nxënësit fillojnë të plotësojnë vargjet numerike të dhëna në detyrën 3. Në përfundim vargjet e krijuara lexohen.

**Hapi 5:** Komentohet nga nxënësit situata e dhënë në detyrën 4. Ata duhet të shkruajnë numrin e pikave në çdo xhitë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit identifikojnë saktë numrin e elementeve në situatat e dhëna, renditin saktë numrat, si dhe i krahasojnë numrat deri në 9.

**Detyrë:**
Detyra 2 të shkruhet si barazime në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 70

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë;
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.4; 4.2; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Paraqet numrin 9 si shumë dhe si ndryshesë e dy numrave;
- Mbledh dhe zbret numrat deri në 9;
- Komenton me fjalë mbledhjen dhe zbritjen e numrave në bosht numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Top, numëratore, shirit numerik.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit ftohen të formojnë një rreth. Nxënësi që e ka topin do ta thotë një numër (7) dhe ia gjuan topin një shoku tjetër, i cili duhet ta gjejë numrin e dytë (2) që e formon numrin 9. Barazimi shkruhet në tabelë: 7 + 2 = 9. Loja vazhdon disa herë. Barazimet lexohen nga nxënësit.

**Hapi 2:** Nxënësit komentojnë me fjalë shembullin e parë dhe të dytë në detyrën *1. - Sa mace janë duke pirë qumësht? - Edhe sa mace po vijnë? -Sa mace u bënë gjithsej? -Plotësoni barazimin në libër: 5 + 3 = 8.* Nxënësit gjejnë shumën e numrave të dhënë duke përdorur edhe numëratoren (nëse nevojitet). Lexohen barazimet e plotësuara.




**Hapi 3:** Komentohet shembulli i parë, në rreshtin e parë të detyrës 2. *Sa katrorë rozë kemi?* (7); *-Sa katrorë të gjelbër?* (2); *- Sa bëjnë 7 + 2 = ? -Çfarë duhet bërë në shembullin tjetër?* (Të ngjyrosen katrorët sipas mbledhorëve); *-Po në rreshtin e dytë, ç'duhet bërë?* (Të shkruhet barazimi në bazë të numrit të katrorëve të ngjyrosur). Punohen nga dy shembuj të çdo rreshti. Lexohen barazimet.

**Hapi 4:** Komentohen shembujt në detyrën 4. *Sa zogj ishin duke ngrënë misër?* (8) - *Sa zogj fluturuan?* (3) *-Sa zogj mbetën?* (5). Plotësohet barazimi 8 – 3 = 5 dhe lexohet. Barazimet e tjera plotësohen në mënyrë të pavarur. (Përdoret numëratorja nëse duhet).

**Hapi 5:** Nxënësit komentojnë shembullin e parë të detyrës 5: *Ishin nëntë rrathë të kuq, nga të cilët hoqëm katër dhe mbetën pesë rrathë.* Plotësohet barazimi. Kështu vazhdohet edhe me 3 shembujt e tjerë, të shtyllës së majtë. Lexohen nga ana e nxënësve.

**Hapi 6:** Vendoset shiriti numerik dhe njëri nxënës në numrin 9. Kërkohet të ecë tre hapa prapa. *Te cili numër arrite? - Cili veprim është kur ecim (kthehemi) mbrapa?* Nxënësi tjetër shkruan në tabelë barazimin: 9–3 = 6. Demonstrohet edhe një shembull dhe kalohet në plotësimin e barazimeve në detyrën 6. *Nga cili numër po fillon shigjeta? - Sa numra po kthehet mbrapa? -Te cili numër arriti?* Plotësohen dy shembuj.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi paraqet saktë numrin 9 si shumë dhe si ndryshesë e dy numrave. Mbledh dhe zbret saktë deri në 9, si dhe komenton me fjalë zbritjen e numrave në bosht numerik.

**Detyrë:**
Të punohen shembujt e mbetur të detyrave 2, 5, 6 dhe detyrat 3, 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 71

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3; 3.2; 4.2; 6.4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9/U




**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Paraqet numrin 9 si shumë të dy mbledhorëve;
- Krahason numrat duke vendosur shenjat < dhe >.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirit me numra, petëza me formën e trekëndëshit, fruta të ndryshëm: si molla, dardha etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet para nxënësve shiriti me numra për të rikujtuar numrat e mësuar. Pastaj merren 5 mollë, u shtohen edhe 4 të tjera, pyeten nxënësit: Sa mollë ka tani? (9).
Vazhdohet kështu edhe me dardha. Pastaj paraqitet zbritja. Merren 9 dredhëza, largohen 4 prej tyre. Pyeten ata: Sa kanë mbetur tani? (5).






**Hapi 2:** Në të njëjtën kohë paraqiten në tabelë shembulli me mbledhjen e numrave në njërën anë, si dhe shembulli me zbritjen e numrave në anën tjetër të tabelës. Thirren me radhë nxënësit që të kryejnë veprimet, një me mbledhje dhe një me zbritje. Nxënësit punojnë detyrat në libër në mënyrë të pavarur.

**Hapi 3:** Në detyrën 2 kryejnë veprimet e mbledhjes dhe zbritjes duke u bazuar në topat që janë paraqitur përmes figurës së shtëpisë. Njëri mbledhor dihet tani, nxënësit gjejnë mbledhorin tjetër për të formuar shumën 9. Njëjtë veprohet edhe me zbritjen e numrave deri në 9.

**Hapi 4:** Jepen sqarimet e duhura rreth detyrës 3 në libër, ku nxënësit kryejnë veprimet e mbledhjes dhe zbritjes së numrave dhe krahasojnë rezultatet e tyre duke vendosur shenjën e duhur <, =, >.
Shkruhen disa shembuj në tabelë, pastaj punohet në libër. P.sh., 3 + 6 = 9 > 9 - 5 = 4.

**Hapi 5:** Merren petëzat me trekëndësha, vendosen 8 petëza të kuqe, u shtohet edhe një e kaltër. Pyeten nxënësit: Sa petëza me trekëndësha ka tani? (9). Vazhdohet për të njëjtat petëza veprimi i zbritjes. Kemi gjithsej 9 petëza, largojmë një trëkëndësh të kaltër, sa trekëndësha kanë mbetur tani? (8). Nxënësit punojnë detyrën duke u bazuar në ngjyrën e trekëndëshave, vendosin numrat te drejtkëndëshat me ngjyrën e njëjtë të trekëndshave.

**Hapi 6:** Sqarohet mbledhja dhe zbritja e numrave me numrat deri në 9 edhe përmes boshtit numerik. Detyra sqarohet në tabelë, dalin disa nxënës vullnetarë dhe kryejnë detyra të tilla.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për saktësinë në njehsimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 9, si dhe për krahasimin e tyre.

**Detyrë:**
Dy detyrat e fundit në libër të punohen në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 72

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3; 3.2; 4.2; 6.4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Paraqet numrin 9 si shumë e të dy mbledhorëve;
- Krahason numrat duke vendosur shenjat < , =, >.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirit me numra, topa të vegjël, boshti numerik etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.




## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet para nxënësve shiriti me numra për të kujtuar numrat e mësuar. Pastaj merren disa rrathë me numra deri në nëntë. Radhiten sipas radhës duke formuar kështu figurën e gjarprit. Merren 9 topa dhe pastaj largohen 4 topa. Pyeten nxënësit: Sa topa kanë mbetur tani? (4). Tutje merren 4 topa, u shtohen edhe 5. Shtrohet pyetja: Sa topa janë tani? (9).






**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të shikojnë me vëmendje fotografinë në detyrën 1 në libër. Bëhen pyetje të ndryshme rreth pamjes. Çfarë po bëjnë fëmijët? (po luajnë në borë); Sa fëmijë janë gjithsej? (7); Sa fëmijë u larguan me saja? (3); Sa fëmijë kanë mbetur në kodër? (4). Njëjtë vazhdohet edhe me rastin tjetër.

**Hapi 3:** Vizatohen në tabelë dy boshte numerike dhe tregohet se nga ana e majtë në të djathë bëhet mbledhja e numrave +. Ndërsa nga ana e djathtë në të majtë bëhet zbritja e numrave. Merren disa shembuj për ilustrim, më pas ftohen nxënësit të kryejnë detyrat në tabelë.

**Hapi 4:** Paraqitet në tabelë boshti numerik dhe sqarohet para nxënësve që në një bosht numerik mund të kryhet edhe veprimi i mbledhjes edhe i zbritjes. Lart kryhet veprimi i mbledhjes, ndërsa poshtë veprimi i zbritjes. Njëra detyrë punohet nga mësuesja, ndërsa detyra tjetër punohet në mënyrë të pavarur nga nxënësit.

**Hapi 5:** Kërkohet nga ata që në detyrën 4 në libër ta kryejnë veprimin e mbledhjes dhe zbritjes, pastaj t'i krahasojnë numrat duke i vendosur shenjat: <, =, >.

**AKTIVITET SHTESË**

U shpërndahen nxënësve fletë të punës ku janë numrat e shkruar si dhe shuma ose ndryshimi. Ata duhet t'i vendosin shenjat e duhura + ose - për të arsyetuar rezultatet. Nxënësit e këmbejnë fletën me shokun ose shoqen e bankës dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

4 ◯ 4=8
9 ◯ 2=7
2 ◯ 4=6
9 ◯ 4=5
2 ◯ 2=4
8 ◯ 5=3

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete; për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 9, si dhe për krahasimin e tyre.

**Detyrë:**

Në fletoret e tyre të kryhen 5 veprime me mbledhje dhe zbritje me numrat deri në 9.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 73

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3; 3.2; 4.2; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave;
- Vizaton figurën identike me figurën e dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Gjëra të ndryshme të sjella nga nxënësit, teknologji, fletë me ngjyra, copëza të vogla letre etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet t'i nxjerrin gjërat që kanë sjellë nga shtëpia, si: lodra të ndryshme, topa, zbukurime të bredhit, lapsa me ngjyra etj.
Me këto gjëra në bankat e tyre ata formojnë mbledhorë që japin shuma të ndryshme me numrat deri në nëntë. Prezantojnë më pas punën e tyre.






**Hapi 2:** Paraqitet me projektor pamja e detyrës 5 në libër, ku ka numra që paraqesin mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në nëntë. Jepen sqarimet e duhura se si duhen bashkuar veprimet me rezultatet. Pastaj nxënësit në mënyrë individuale gjejnë shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

**Hapi 3:** Paraqiten në tabelë disa shembuj nga detyra 6. Detyrat janë me dy veprime. U sqarohet nxënësve mënyra se si njëherë duhet të kryhet veprimi i parë, pastaj numri i fituar zbritet me numrin e radhës duke gjetur ndryshimin e numrave. Dalin nxënësit me radhë te tabela dhe kryejnë detyra me dy veprime.

**Hapi 4:** Vizatohen në tabelë rrathët në formë të pikados. Nëpërmjet kësaj figure bëhet mbledhja dhe zbritja e numrave. Nga veprimi i mbledhjes, gjendet më pas veprimi i zbritjes. P.sh.,
5 + 3 = 8, 8 – 5 = 3, 8 – 3 = 5.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet të shikojnë detyrën 8 në libër ku paraqitet një figurë në formë shtëpie. Lipset nga ata të vizatojnë një figurë identike me figurën e dhënë. Nxënësit bazohen në pikat e dhëna si ndihmë për të filluar vizatimin.

**AKTIVITET SHTESË**

U shpërndahen nxënësve fletë me ngjyra në të cilat janë paraqitur veprime me mbledhje dhe zbritje si dhe shumën dhe ndryshimin. Kërkohet nga nxënësit të bashkojnë veprimet me rezultatin e duhur duke e arsyetur atë veprim me gojë. Puna e nxënësve vlerësohet.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarje aktive në aktivitete dhe për njehsimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 9.

**Detyrë:**

Në fletoret e tyre të punohen 3 detyra të ngjashme me detyrën 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 74

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,3,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,3; 3.2; 4.2; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave;
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes në mënyra të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, copëza të vogla letre, bosht numerik etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Formohen grupet me nga 5 ose 6 nxënës dhe u shpërndahen copëza të vogla të letrës me veprimet mbledhje dhe zbritje, si dhe rezultatet: shuma dhe ndryshimi. Copëzat e letrave janë të përziera, nxënësit gjejnë veprimet dhe i bashkojnë me numrin e duhur si rezultat i atij veprimi.






**Hapi 2:** Paraqitet me projektor pamja e detyrës 1 në libër, ku ka numra që paraqesin mbledhjen dhe zbritjen e numrave me numrat deri në nëntë. Jepen sqarimet e duhura se si duhet të veprohet në këtë rast. U tregohet nxënësve që zbritën dy numrat e parë, pastaj ndryshimi shkruhet në rrethin e zbrazët. Ai numër në rreth tani bëhet mbledhori i parë në veprimin e radhës. Njëjtë veprohet deri në fund të detyrës.

**Hapi 3:** Paraqitet në tabelë një shembull nga detyra 2 dhe u tregohet nxënësve së në këtë rast është mbledhori i parë dhe shuma, mungon mbledhori i dytë, dhe se u duhet ta gjejnë atë. Edhe te detyrat me minus janë i zbritshmi dhe ndryshimi, ku duhet ta gjejnë zbritësin.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të shikojnë me vëmendje detyrën 3 në libër. Numrat janë paraqitur në lule me ngjyra të ndryshme. Numri në lulen e parë mblidhet me numrin në shigjetë dhe shuma vendoset te lulja tjetër e radhës. Njëjtë veprohet me të gjithë numrat në lule. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale.

**Hapi 5:** Paraqitet përmes vizatimit në tabelë detyra 4. Në një diagram janë paraqitur topa të gjelbër, nxënësit numërojnë dhe shkruajnë numrin aq sa ka topa. Në anën tjetër është numri, nxënësit vizatojnë aq topa në diagram sa thotë numri dhe në fund mbledhin të gjithë numrat ose të gjithë topat brenda diagramit. Detyra pastaj paraqitet si shumë e tre mbledhorëve: **8 = 3 + 4 + 1.**

**Hapi 6:** Mbledhja e numrave fillon duke përcjellë kahet e shigjetës. Shuma vendoset në katrorin e zbrazët. Në detyrën e fundit bashkohen me shigjetë veprimet me numrin e duhur në boshtin numerik. Puna e nxënësve vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete dhe për njehsimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 9.

**Detyrë:**
Në fletore të punohen 4 detyra të ngjashme me detyrën 2 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 75

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III,3,4; IV.5; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 3.2,3,4,5; 5.1; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shuma e tre numrave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën e tre numrave;
- Formon detyra me tre mbledhorë;
- Gjen mbledhorin që mungon.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, gjëra të ndryshme nga mjedisi, petëza me figura gjeometrike, fletë pune të printuara etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten pamje para nxënësve ku me tre mbledhorë formohet shuma. Pyeten: Nga sa lule ka në secilin vend? Sa lule janë gjithsej: 3+3+3=9. Kërkohet nga ata të formojnë nga tre mbledhorë me mjete mësimore ose gjëra të tjera nga mjedisi. Paraqesin edhe shumën e tyre.






**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të shikojnë me vëmendje se si janë formuar mbledhorët. Bëhen pyetje rreth figurave: Sa libra të kuq ka? (2); Sa libra të verdhë? (1); Sa libra me ngjyrë të hirtë? (1); Sa libra janë gjithsej? (4). Njëjtë vazhdohet me lulet, rrathët etj.
U sqarohet nxënësve se këtu po gjejmë shumën e tre numrave.

**Hapi 3:** Parqiten në projektor pamje të tilla (lapsa) si në ilustrim.
Kërkohet të gjejnë shumën.
Përsëritet disa herë derisa detyra të kuptohet.



**Hapi 4:** Në detyrën 2 në libër nxënësit gjejnë shumën e tre numrave duke u bazuar në ngjyrën e drejtkëndëshave dhe ngjyrën e numrave. Pastaj ngjyrosin aq drejtkëndësha sa thonë numrat e paraqitur me ngjyra.

**Hapi 5:** Punohet detyra 3. Nxënësit formojnë shumën nga tre mbledhorë duke u bazuar në petëzat me figurat gjeometrike. Edhe në bankat e tyre përdorin petëzat për të paraqitur detyra të njëjta. Prezantojnë punën e tyre para nxënësve dhe mësueses.

**AKTIVITET SHTESË**

Nxënësve u shpërndahen fletë të punës përgatitur nga mësuesja.
Në fletë janë paraqitur detyra me tre mbledhorë si dhe shuma e tyre.
Në secilën detyrë mungon një mbledhor. Ata duhet të gjejnë mbledhorin që mungon. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.


GJEJMË MBLEDHORIN QË MUNGON :

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | + | 4 | + | ☐ | = | 8 |
| 1 | + | 2 | + | ☐ | = | 8 |
| 3 | + | 1 | + | ☐ | = | 9 |
| 2 | + | ☐ | + | 2 | = | 6 |
| 1 | + | 3 | + | ☐ | = | 7 |
| ☐ | + | 1 | + | 2 | = | 5 |
| 1 | + | ☐ | + | 2 | = | 4 |
| 3 | + | ☐ | + | 3 | = | 9 |
| 4 | + | 1 | + | ☐ | = | 8 |
| ☐ | + | 2 | + | 4 | = | 7 |

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim e aktivitete, si dhe për gjetjen e shumës me tre mbledhorë.

**Detyrë:**

Detyra 4 në libër të punohet në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 76

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;2.1;3.4;5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shuma e tre numrave/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Plotëson fjalitë numerike me tre mbledhorë;
- Shpjegon veprimin e mbledhjes me tre mbledhorë;
- Llogarit shumën e numrave deri në nëntë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Karta me shkronja dhe numra, fletëza të përgatitura, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen disa karta me shkronja dhe fletëzat e përgatitura. Poshtë secilës kartë është i vendosur një numër. Nxënësve në dyshe u kërkohet të formojnë fjalë me shkronjat e dhëna dhe të gjejnë shumën e numrave të dhënë. Fjalët e formuara vendosen në tabelë dhe lexohen barazimet.




MIU 4 + 3 + 2 = 9

URA ___ + __ + __ =___




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të hapin librin dhe të analizojnë foton në detyrën 1. *Përshkruani me fjalë se çfarë po shihni në foto?*
Kërkohet prej tyre të plotësojnë barazimet në libër dhe t'i lexojnë barazimet.

**Hapi 3:** Lipset nga nxënësit të nxjerrin 4 kube të kuqe, tri të gjelbra dhe dy të kaltra dhe, duke u bazuar në detyrën dy, ata do të punojnë me kube. Në rastin e parë lidhin 4 kubet e kuqe dhe 3 të gjelbrat dhe formojnë shtyllën me 7 kube. Më pas lidhin edhe 2 kubet e kaltra. *Sa kube u bën gjithsej?* (9).

4 + 3 + 2
7 + 2 = 9

Në rastet e tjera i shoqërojnë mbledhorët e tjerë dhe i plotësojnë barazimet.

**Hapi 4:** Nxënësit në dyshe do të gjejnë shumën e tre numrave në detyrën 3. Pas plotësimit, dyshet lexojnë zgjidhjet dhe bëhen korrigjimet e nevojshme.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në mënyrë të pavarur. Në fletëzat e përgatitura si në foto, ata vendosin kubet me ngjyra në kolonën e duhur. Shoqërojnë dy pjesë, pastaj shtojnë të tretën. Në fund e gjejnë shumën. Vlerësohet puna e nxënësve.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e plotësimit të fjalive numerike, mënyrës së shpjegimit të veprimit të mbledhjes dhe llogaritjes së shumës së numrave deri në 9.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 77

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.4; 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndryshimi i tre numrave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon me fjalë mënyrën e zbritjes së numrave;
- Interpreton mbledhjen dhe zbritjen në boshtin numerik;
- Njehson ndryshimin dhe mbledhjen e tre numrave.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, shiriti numerik.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të nxjerrin mbi bankë 9 petëza. Pyesim:
*Kur të hiqni një petëz, sa petëza mbesin?* Numërohen petëzat me radhë. Lexohet: *Nëntë zbresim një, mbesin tetë.* Pastaj kërkohet nga nxënësit të largojnë edhe tri petëza të tjera. *Sa petëza mbetën? Si e gjetët?* 8 – 3 = 5. Ftohet një nxënës ta paraqesë me numra magnetikë barazimin. Përsëritet veprimtaria me numra të tjerë, por çdoherë duke vënë në dukje fjalët "heqim", "zbresim", "largojmë" , "sa mbetën?".




9 – 1 – 3 = 5




**Hapi 2:** Hapen librat, nxënësit vërejnë vazot me lule në detyrën 1. Pyeten:
*- Sa lule janë gjithsej në vazo?(4);*
*- Në fillim vyshket një lule, pastaj edhe dy lule të tjera. Sa lule mbesin në vazo?(1)* $4 - 1 - 2 = 1$ Lexohet: *katër zbresim një, zbresim dy, baras një.* Nxënësit vazhdojnë të komentojnë shembujt e tjerë me fjalë. Shpjegohet se zbritja është e lidhur me largimin ose heqjen e objekteve.

**Hapi 3:** Vendoset shiriti numerik në dysheme. Thirret një nxënës të qëndojë te numri 2. I kërkohet të bëjë dy kërcime para dhe të tregojë te cili numër arriti. Paraqitet në tabelë me anë të shprehjes numerike: $2 + 1 + 3 = 6$.
Nxënësi tjetër vendoset te numri 9. I kërkohet të bëjë dy kërcime pas dhe të tregojë te cili numër arriti. Paraqitet në tabelë shprehja numerike dhe shpjegohet mënyra e zbritjes së numrave: $9 - 3 - 2 = 4$. Bazuar në këtë veprimtari plotësohen detyrat e tjera. Njëjtë veprohet edhe me shembujt e tjerë.

**Hapi 4:** Sqarohet kërkesa e detyrës 3 ku nxënësit do të kryejnë veprimin e mbledhjes dhe zbritjes së tre numrave. Udhëzohen që njëri nga dyshet ta plotësojë kolonën e parë me veprimin e mbledhjes, ndërsa nxënësi tjetër kolonën e dytë me veprimin e zbritjes. Pas plotësimit, ata i ndërrojnë librat dhe ia kontrollojnë njëri-tjetrit zgjidhjet. Paraqiten disa shembuj në tabelë.

Vlerësohet saktësia e plotësimit të detyrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e saktë të zbritjes së tre numrave, njehsimin e saktë të mbledhjes dhe zbritjes së tre numrave dhe paraqitjen në boshtin numerik.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 78

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë. Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.4; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndryshimi i tre numrave/ U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon me fjalë mënyrën e zbritjes së numrave;
- Formon fjali numerike me zbritje të tre numrave;
- Njehson ndryshimin dhe mbledhjen e tre numrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatime, fletëza të përgatitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/po me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet një situatë problemore: *Era kishte 9 ëmbëlsira. Ajo hëngri 2 prej tyre, ndërsa 3 ia dha Lisit. Sa ëmbëlsira i mbetën Erës?*
Kërkohet nga nxënësit të gjejnë zgjidhjen dhe të diskutohet rreth saj.



$$9 - 1 - 3 = 5$$




**Hapi 2:** Hapen librat. Nxënësit nxiten të përshkruajnë figurën në detyrën 1 dhe të plotësojnë barazimet. Bisedohet me ata:
*- Çfarë po bëjnë fëmijët në figurën e parë? Sa fëmijë janë gjithsej? Sa fëmijë po largohen? Si e gjetët?* Nxënësit shpjegojnë me fjalë mënyrën e zbritjes së numrave: 7 - 2 - 2 = 3.

**Hapi 3:** Duke u bazuar në katrorët me ngjyra, nxënësit njehsojnë zbritjen. Udhëzohen të thonë: "Gjithsej janë nëntë katrorë, heqim tre katrorë të kuq dhe dy katrorë të verdhë, mbesin katër." Barazimet me zbritje shkruhen në tabelë.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të plotësojnë detyrën 3 duke kryer veprimin e zbritjes dhe të mbledhjes në operatorë. Pas plotësimit bëhet leximi zinxhir i detyrës dhe korrigjimet e nevojshme nga nxënësit.

**Hapi 5**: Shembulli i detyrës 4 paraqitet në tabelë. Ftohen nga dy nxënës me radhë ta zgjidhin detyrën në tabelë, njëri zgjidh detyrën e kolonës së parë me mbledhje, tjetri detyrën e kolonës së dytë me zbritje. Ata i punojnë në mënyrë të pavarur detyrat në libër.

**Hapi 6:** Nxënësve u shpërndahen fletëza me barazime. Në tabelë vendosen numrat që tregojnë zgjidhjen e detyrave. Kërkohet prej tyre të gjejnë zgjidhjen dhe të afrohen te numri që tregon atë rezultat. Lexojnë me zë.

| 8 | 1 | 2 | 5 |
|---|---|---|---|
| 3+2+3=__ | 7-4-2=__ | 7-3-2=__ | 2+1+2=__ |

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mënyrën e shpjegimit të zbritjes së numrave, formimin e fjalive numerike dhe llogaritjen e saktë të ndryshimit dhe mbledhjes së numrave.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 79

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numri dhjetë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon numrat nga 0 deri në 10;
- Përcakton numrin e elementeve të bashkësive të dhëna;
- Rendit numrat nga 0-10 dhe anasjellas në vargun numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fasule me ngjyra, numra magnetikë dhe ilustime të ndryshme.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të vendosin brenda një fijeje pesë fasule të kuqe, brenda fijes tjetër pesë fasule të kaltra. – *Çfarë ka më shumë, fasule të kuqe apo të kaltra? Sa është gjithsej numri i fasuleve?* (Pesë plus pesë = dhjetë fasule). Nxënësit udhëzohen t`i ngrisin aq gishtërinj sa është numri në etiketë dhe të lexojnë me zë. Tregohet grafiku i numrit 10. Merren edhe disa shembuj për kuptimin e numrit 10.

10






**Hapi 2:** Paraqiten bashkësi me numër të ndryshëm të elementeve. Nga nxënësit kërkohet të numërojnë me zë dhe të përcaktojnë numrin e elementeve të bashkësisë. Vendosin etiketën pranë bashkësisë dhe krahasojnë numrat në etiketë.




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të vizatojnë aq elemente sa tregon etiketa në detyrën 3. Ata kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, duke i bërë edhe korrigjimet e mundshme.

**Hapi 4:** Jepen sqarime për plotësimin e detyrës 4. Nxënësve në dyshe u kërkohet të gjejnë numrat që mungojnë në vargun e numrave. Pas plotësimit bëhet leximi zinxhir dhe korrigjimet e nevojshme nga nxënësit.

**Hapi 5**: Nxënësit ndahen në grupe me nga 10 dhe u shpërndahen etiketa me numrat 1-10. Më pas kërkohet që grupi i parë të renditet në rendin rritës 0-10, grupi i dytë në rendin zbritës 10-0, grupi i tretë lexon në kor numrat e renditur.

Më pas udhëzohen të shkruajnë në fletore disa rreshta me vargjet e numrave deri në 10. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të numrit të elementeve, leximin dhe shkrimin e numrit 10, si dhe renditjen e saktë në vargun rritës dhe zbritës.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 80

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; III. 2, 4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.6 ;4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat deri në dhjetë/ U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton mbledhorët e duhur që formojnë numrin 10;
- Rendit numrat deri në 10 në rendin rritës dhe zbritës;
- Formon vargje numerike nga 0-10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petale me shembuj të detyrave, qendrat e mesit, etiketa me numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet shiriti me numrat e mësuar për t'i rikujtuar. Pastaj nxënësit ndahen në grupe. Në çdo grup lihet qendra e lules me një numër, ndërsa nxënësve u shpërndahen petalet e luleve me barazime. Ata duhet ta gjejnë qendrën e duhur dhe ta formojnë lulen.
Lexohen barazimet.






**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të vëzhgojnë detyrën e parë. U lexohet kërkesa e detyrës dhe bisedohet me nxënës: *-Sa lloje të gjetheve janë? Numrin e cilave gjethe duhet të vendosim në kolonën e parë? Po në kolonën e dytë?* Nxënësit gjejnë mbledhorët dhe tregojnë në sa mënyra është formuar pema e dhjetës.

**Hapi 3:** Analizohet detyra 2 me anë të pyetjeve: Ç'mendoni, me çfarë ngjyre duhet t'i ngjyrosim rrathët? Si duhet të renditen numrat e dhënë? Nxënësit udhëzohen të vendosin numrat sipas radhës në rrathët e zbrazët e pastaj t'i ngjyrosin me ngjyrën përkatëse.




1, 3, 6, 8, 2, 5, 7, 4, 9, 10

Ata punojnë individualisht dhe më pas i kontrollojnë detyrat me shokun e bankës.

**Hapi 4:** Nxënësit do të punojnë në dyshe detyrën 3. Nxiten me anë të pyetjeve të dallojnë kërkesën e detyrës. – *Sa katrorë të kuq janë?* (6); *–Po katrorë të gjelbër?* (4); – *Gjithsej sa katrorë janë?* (10); *–Në katronin e parë cilin numër duhet të vendosim?* (4); *–Pse?* Sepse 6 + 4 = 10. Nxënësit i shkëmbejnë librat dhe i krahasojnë barazimet.

**Hapi 5**: Tabloja e detyrës 4 paraqitet në tabelë. Kërkohet nga nxënësit t'i lexojnë dhe t'i shkruajnë numrat në rendin rritës nga 0 - 10 dhe në rendin zbritës nga 10 - 0. Tutje i plotësojnë detyrat 5 dhe 6 në mënyrë individuale, duke formuar vargje numerike.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të mbledhorëve që formojnë numrin 10, renditjen e numrave deri në 10 në rendin rritës e zbritës, si dhe formimin e vargjeve numerike.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 81

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Kupton shenjat +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.1,7; V.5; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1,6; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit numrat prej 0 deri në 10 në vargun numerik;
- Dallon paraardhësin dhe pasardhësin e numrave;
- Përcakton vlerën sasiore të tyre.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Trakë matematikore, gota plastike, shkopinj, petëza, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe. U shpërndahen gota plastike me numrat nga 1 deri në 10 në të cilat do të vendosen shkopinj aq sa tregon numri. Grupi fitues do të duartrokitet. Vlerësohet bashkëpunimi i pjesëmarrësve në grup.






**Hapi 2:** Kërkohet nga nxënësit që në balonat e zbrazëta të shkruajnë numrat nga 1 deri në 10. Diskutohet fotografia e ushtrimit parë. Pyeten ata: Në cilën gotë vendosen më pak shkopinj? (*Gota me numrin 0*); Më pas cila gotë ishte? Cila gotë pati më shumë shkopinj?

Nxënësit vijnë në përfundim se numri 0 është më i vogël se numri 1, numri 1 është më i vogël se numri 2, e kështu me radhë. Nxiten ata që sa më shumë të përdorin konceptet matematikore "*më i vogël*" dhe "*më i madh*".

**Hapi 3:** Në tabelë vizatohen dy rende me rrathë, njëri me 7 rrathë, e tjetri rend me 8 rrathë. Ftohen dy nxënës, ku njëri nxënës në trakën matematikore bën kërcimin e bretkosës si në detyrën e dytë. Fillohet nga numri 1 dhe duke tejkaluar nga një numër kërcen deri në numrin 7. Nxënësi tjetër ngjyros në tabelë vetëm numrat në të cilët ka kërcyer shoku. Më pas ftohen dy nxënës të tjerë, ku njëri fillon nga numri 8, duke tejkaluar së pari dy numra, e pastaj nga një numër. Nxënësi tjetër i ngjyros rrathët. Detyra plotësohet në libër.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë ushtrimin 3 duke shkruar numrat që mungojnë në rendin rritës dhe zbritës. Puna e tyre vëzhgohet dhe vlerësohet. Ndihmohen nxënësit që kanë vështirësi.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që të paraqesin në fletoret e tyre 2 tabelat duke i plotësuar me numrin paraardhës dhe pasardhës.

| | |
|---|---|
| 5 | |
| 1 | |
| 9 | |

| | |
|---|---|
| 10 | |
| 4 | |
| 2 | |

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e formimit të bashkësisë me 8 elemente; lexojnë dhe shkruajnë saktë numrin 8; numërojnë saktë numrat prej 1-8; dallojnë vendndodhjen e numrit 8 në vargun numerik.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër duke shkruar paraardhësin ose pasardhësin e numrave.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 82

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** 1.3; II.2,8; III.2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1,2; 3.1,6; 5.1.


II. PARAQITJA E NUMRAVE NË BOSHTIN NUMERIK

Mësojmë

1. Në katrorët e zbrazët, shkruajmë numrat që mungojnë.
0 1 ☐ 3 ☐ 5 ☐ 7 ☐ 9 ☐

2. Në katrorët e zbrazët, shkruajmë numrat që mungojnë.
0 1 2 ☐ 4 5 ☐ 7 8 ☐ ☐

3. Analizojmë të dhënat në boshtin numerik dhe i përshkruajmë me fjalë.
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
Në boshtin numerik është paraqitur shuma e numrave 2 dhe ____.
Lexojmë: Nëse numrit ____ ia shtojmë numrin ____, fitohet shuma ____. Pra, 2 + 3 = 5.

4. Analizojmë të dhënat në boshtin numerik dhe përshkruajmë barazinë që paraqitet:
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
5 + ☐ – ☐ = ☐

5. Barazitë e dhëna i paraqesim në boshtin numerik:
5 + 2 + 3 = ☐
3 + 2 + 4 = ☐
10 – 5 – 2 = ☐
10 – 7 + 2 = ☐
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

97

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraqitja e numrave në boshtin numerik

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit numrat nga 1 deri në 10;
- Shkruan barazimet për mbledhjen dhe zbritjen e numrave në boshtin numerik;
- Përdor saktë konceptet matematikore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të printuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** U shpërndahet nxënësve shirita letre me ndarje, në të cilët ata do të shkruajnë numrat nga 1 deri ne 10. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çfarë tregon shiriti (boshti numerik) si dhe të lexojnë numrat. Vizatohet në tabelë boshti numerik. Udhëzohen nxënësit të vendosin lapsin te një numër (p.sh., 5). Kërkohet të lëvizin lapsin për 3 njësi më shumë (*të shtojnë edhe 3*). Vizatohet shigjeta në tabelë dhe nxënësit vizatojnë në shiritin e letrës. Pyeten ata: Te cili numër ishim? (5); Edhe sa i shtuam? (3); Te cili numër arritëm? (8); Shkruhet barazimi **5 + 3 = 8**.
Përsëritet veprimtaria me veprimin e zbritjes dhe njoftohen nxënësit se shigjeta në boshtin numerik


II. PARAQITJA E NUMRAVE NË BOSHTIN NUMERIK

Mësojmë

1
Në katrorët e zbrazët, shkruajmë numrat që mungojnë.
0 1 ☐ 3 ☐ 5 ☐ 7 ☐ 9 ☐

2
Në katrorët e zbrazët, shkruajmë numrat që mungojnë.
0 1 2 ☐ 4 5 ☐ 7 8 ☐ ☐

3
Analizojmë të dhënat në boshtin numerik dhe i përshkruajmë me fjalë.
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
Në boshtin numerik është paraqitur shuma e numrave 2 dhe ____.
Lexojmë: Nëse numrit ____ ia shtojmë numrin ____, fitohet shuma ___. Pra, 2 + 3 = 5.

4
Analizojmë të dhënat në boshtin numerik dhe përshkruajmë barazinë që paraqitet:
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10
5 + ☐ – ☐ = ☐

5
Barazitë e dhëna i paraqesim në boshtin numerik:
5 + 2 + 3 = ☐
3 + 2 + 4 = ☐
10 – 5 – 2 = ☐
10 – 7 + 2 = ☐
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

97

shkon në drejtim të kundërt.

**Hapi 2:** Udhëzohen ata të plotësojnë detyrat 1 dhe 2, që në kutizat e zbrazëta të shkruajnë numrat që mungojnë.

**Hapi 3:** Nxënësit analizojnë kahet e shigjetës në detyrën 3. Kërkohet nga ata të bëjnë plotësimet e duhura dhe të shprehin më fjalë punën e tyre. Te veprimi i mbledhjes, kërkohet të theksohet se drejtimi i shigjetës shkon prej së majtës kah e djathta.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen që në rastet kur janë dy veprime matematikore, mbledhje dhe zbritje, shigjetat shkojnë në dy kahe. Në rastin e detyrës 4 fillon nga numri 5 duke u rritur për 3 njësi. Pyeten ata: Ku ka filluar shigjeta e kuqe? Ku ka përfunduar shigjeta e kuqe? Shigjeta e kaltër nga cila anë po shkon? (*Prej së djathtës nga e majta*); Cilit veprim i takon? (*Zbritjes*); Për sa njësi po kalon? (8); Ku po përfundon?(0). Nxënësit plotësojnë detyrën në libër.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që në mënyrë të pavarur të plotësojnë fletën e e printuar (mund të vizatohet edhe në tabelë). Puna e tyre vlerësohet.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e shkrimit të numrave nga 1 deri në 10; vizatimit të saktë të shigjetave në boshtin numerik sipas veprimeve matematikore dhe përdorimin e fjalorit matematikor.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 5 në libër duke vizatuar edhe shigjetat sipas kërkesës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 83

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2, 8; III.2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 2.1; 3.1,4,5,6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes;
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Birila, shishe plastike, top, fasule, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Luhet loja me 10 birila. Ftohen dy nxënës, njëri që të rrotullojë topin në drejtim të birilave (mund të zëvendësohen me shishe plastike). Numërohen birilat e rrëzuara, po ashtu edhe numri i birilave të mbetura (të parrëzuara). Nxënësi tjetër shkruan në tabelë barazimet, p.sh.: 10 - 7 = 3. Vazhdohet veprimtaria me disa nxënës, ku edhe numri i birilave në fillim të lojës ndryshon.

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të analizojnë detyrën 1, më pas të krijojnë një problemë me fjalë. Orientohen me pyetje: Sa kuaj janë të bardhë? Sa kuaj ngjyrë kafe po i bashkohen? Sa kuaj u bënë gjithsej? Kuajt e bardhë paraqesin **mbledhorin e parë**, ndërsa kuajt ngjyrë kafe, paraqesin mbledhorin e dytë.




Pas bashkimit të tyre na paraqitet shuma.
Nxënësit udhëzohen të plotësojnë barazimet, gjithnjë duke pasur parasysh që kur shtojmë, në matematikë paraqitet me veprimin e mbledhjes.
Mbledhori i parë + mbledhori i dytë = shuma
Vazhdohet njëjtë edhe me shembullin e dytë, duke i udhëzuar nxënësit se kur largohen (hiqen), në matematikë paraqitet me veprimin e zbritjes.
I zbritshmi - zbritësi = ndryshimi

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen që duke u bazuar në kahet e shigjetave, të plotësojnë ushtrimin e dytë. Kërkohet nga ata të shprehin me fjalë mënyrën e zgjidhjes.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të zgjidhin individualisht detyrën 3, duke u bazuar në vetinë e ndërrimit të vendeve të mbledhorëve. (Nëse mbledhorët ndërrojnë vendin, shuma mbetet e njëjtë $4 + 6 = 10$; $6 + 4 = 10$ ). Po ashtu edhe nëse shumës i zbritet njëri mbledhor, fitohet mbledhori tjetër ( $10 - 4 = 6$; $10 - 6 = 4$ ). Puna e nxënësve vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës dhe ndryshimit të numrave, shpjegimit të mënyrës së zgjidhjes më fjalë dhe përdorimin e fjalorit matematikor.

**Detyrë:**
Të paraqitet në fletore ushtrimi 3.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 84

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2, 8; III.2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 2.1; 3.1, 4,5,6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes;
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube, fasule, petëza, numëratore, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Ftohen 4 nxënës para tabelës. Njërit nxënës i jepen 7 kube të gjelbra, tjetrit 3 kube të kuqe. Udhëzohen t`i bashkojnë kubet duke ia dhënë nxënësi kubet e kuqe, nxënësit që ka kubet e gjelbra. Pyeten: Sa kube ke tani në dorë? (10). Kërkohet që t`ia kthejë kubet qe i mori, dhe pyetet: Sa të mbetën? (7). Nxënësi i tretë shkruan barazimet:
**7 + 3 = 10** **10 – 3 = 7**
Përsëritet veprimtaria duke ia dhënë, e më pas duke ia kthyer nxënësit tjetër 7 kubet. Nxënësi 4 shkruan barazimet në tabelë.




(*Tregon numrin e rrathëve rozë*).
Shkruhet barazimi: **2 + 1 + _ = 5**
Plotësohet ushtrimi 6 në libër.

**3 + 7 = 10  10 – 7 = 3**

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të nxjerrin shufra, kube, numëratore apo çfarëdo mjeti që mund t`u ndihmojë në kryerjen e veprimeve matematikore të detyrave 2 dhe 3.

**Hapi 3:** Barazimet e detyrës 4 shënohen në tabelë. Ftohen nxënësit të dalin të plotësojnë, duke përdorur mjete konkretizimi sipas dëshirës së nxënësit. Nxiten të tregojnë mënyrën e gjetjes së rezultatit.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen në mënyrën e zgjidhjes së detyrës 5, që së pari t'i zgjidhin barazimet, e më pas t`i krahasojnë. Kërkohet nga ata që në çifte të krahasojnë barazimet në dy anët e fjongos dhe t'i vendosin shenjat. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet. Ndihmohen ata që kanë vështirësi në zgjidhjen e detyrave.

**Hapi 5:** Vizatohen në tabelë 5 rrathë.



Pyten nxënësit: Sa rrathë të kaltër janë? (2); Sa të kuq? (1); Sa janë gjithsej? (5); Edhe sa duhen shtuar që të formohet numri 5?

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e emërtimit të kufizave të mbledhjes dhe të zbritjes; njehsimit të shumës dhe ndryshimit të numrave.

**Detyrë:**
Të plotësohen ushtrimet 7 dhe 8 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 85

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2, 8; III.2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,5; 2.1; 3.1,4,5,6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbatimi i mbledhjes dhe i zbritjes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave;
- Përdor fjalorin matematikor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, petëza, shporta, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** U shpërndahen nxënësve ne grup fletët e printuara. Ata duhet të zgjidhin numrakryqin. Udhëzohen për mënyrën e zgjidhjes që të fitojnë barazime të sakta. Grupi që plotëson më shpejt dhe saktë, prezanton para shokëvë dhe shoqeve punën e tyre. Duartrokitet nga të tjerët.






**Hapi 2:** Ftohen dy nxënës para klasës. Kërkohet që të vendosin në dy shporta numër të barabartë të petëzave derisa të kenë dy shportat së bashku 6 petëza. Pyeten: Sa petëza ka në shportën e parë? Po në shportën e dytë? Vizatohet në tabelë:




Sa do të jetë libri nëse ia shtojmë shportës dhe fitojmë numrin 7?




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë në libër detyrën e parë, duke u bazuar në aktivitetin e mëparshëm. Puna e tyre vlerësohet.

**Hapi 4:** Nxënësit analizojnë detyrën e dytë. Numrat në rrathë tregojnë se cila detyrë do të zgjidhet e para. Pra, së pari të gjejnë numrin e patave (4), pastaj të dhelprave (2), më pas të arinjve (6), e në fund të lepujve (3).

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që në fletoret e tyre të krijojnë një detyrë me figura si vendmbajtëse të numrave. Nxiten ata të komentojnë punën e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës dhe ndryshimit të numrave, shpjegimit të mënyrës së zgjidhjes me fjalë dhe përdorimin e fjalorit matematikor.

**Detyrë:**

Krijoni një problemë me fjalë (figura) dhe gjeni zgjidhjen e saj.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 86

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë; zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.3;3.1; 3.3; 3.4; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Zbulon rregullën duke plotësuar kutizat te mbledhja dhe zbritja;
- Kryen mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 10;
- Krahason numrat deri në 10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizatim, etiketa me barazime, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit do të garojnë në dyshe. Secili do të marrë nga një etiketë me barazime të mbledhjes ose të zbritjes. Njëri e lexon barazimin e tjetri e jep përgjigjen e saktë, shumën apo ndryshesën. Pastaj ndërrohen rolet. Fiton ai i cili e gjen rezultatin e saktë.

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 + 4 | 6 + 3 | 9 - 2 | 8 - 5 |

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të vërejnë barazimet e shtyllës së parë, te detyra 1. *–Çfarë vëreni? –Kutizat me ngjyrë të njëjtë a e kanë numrin të njëjtë? –Te barazimi i fundit po fitohet numri 7? –Plotësoni barazimet*




*në shtyllën e dytë. Në fund duhet të fitoni numrin 9.* Nxënësit punojnë të pavarur. Shkëmbejnë librat me shokun e bankës ku kontrollojnë saktësinë e plotësimit. Lexohen barazimet e plotësuara nga nxënësit.

**Hapi 3:** Thirren tre nxënës, ku dy nxënës do të tërheqin nga një etiketë me barazime dhe do ta vendosin në tabelë. Nxënësi i tretë do t'i krahasojë, duke vendosur shenjën përkatëse mes tyre.

$$\frac{5+2}{7} > \frac{8-4}{4}$$

Krahasimi i barazimeve lexohet nga nxënësi.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të vërejnë barazimet që do t'i krahasojnë në detyrën 2. Punohet në dyshe, njëri do t'i krahasojë barazimet majtas qenit e nxënësi tjetër ato djathtas tij. Pyeten - *Çfarë kanë të përbashkët barazimet e shtyllës së parë? - Çfarë duhet bërë së pari? - Po në fund çfarë duhet shkruar në katrorin bosh? - Po barazimet e shtyllës së dytë çfarë kanë të përbashkët?* Nxënësit fillojnë të krahasojnë numrat të dhënë si barazime. Pas plotësimit shkëmbehen librat dhe kontrollohen nga njëri-tjetri. Në fund lexohet nga një barazim nga secili prej tyre.

**Hapi 5:** Komentohet nga nxënësit shembulli në detyrën 3, p.sh. - *Ishin pesë rosa duke ecur në rresht. Atyre iu bashkuan edhe dy rosa të tjera dhe u bënë shtatë rosa. Pas pak fluturoi një rosë dhe mbetën gjashtë rosa.* Plotësohen kutizat boshe nën vizatim që tregojnë këto veprime.




Plotësohen kutizat në shtyllën e parë duke krijuar tregim të shkurtër si më lart me numrat e dhënë. Në fund lexohen ato.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit plotësojnë saktë kutizat sipas rregullës dhe mbledhin e zbresin saktë numrat deri në 10. Po ashtu krahasojnë numrat duke vendosur shenjën përkatëse.

**Detyrë:**
Të punohen shembujt e mbetur te detyrat 1, 2, 3 në libër. Të shkruhen në fletore barazimet e detyrës 1.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 87

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.6; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave deri në 9;
- Krahason shumat dhe ndryshimet e numrave deri në 9;
- Zgjidh problemat me fjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit njoftohen rreth temës së orës, vlerësimit të tyre me anë të detyrave. Njoftohen që do të punohet në mënyrë individuale.
**Hapi 2:** Lexohen detyrat duke ua sqaruar kërkesat e tyre. Kërkohet nga nxënësit që të plotësojnë barazimet në detyrën 1. Gjatë mbledhjes apo zbritjes mund të përdoret numëratorja nëse është e nevojshme. Te barazimi 3 + 6 – 2 = __ ndihmohen me pyetje:
- Cili veprim duhet të kryhet i pari?
- Numrit që fitohet, sa duhet t'ia heqim?

Nxënësit njehsojnë dhe e plotësojnë barazimin. Udhëzohen te detyra 2:
- Numrit 5, sa duhet t'i shtojnë, për të fituar numrin 9?


VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

Vlerësojmë

1 Njehsojmë:

2 + 7 = ☐ 8 – 5 = ☐ 3 + 6 – 2 = ☐

2 Plotësojmë katrorin e zbrazët me numër dhe fitojmë barazi të saktë:

5 + ☐ = 9 ☐ – 1 = 0 10 – ☐ = 6

3 Blini kishte 5 fletore, kurse nëna e tij i solli edhe 4 fletore të tjera. Sa fletore ka Blini?

Blini ka: ___ + ___ = ___ fletore.

4 Duke ditur se 7 + 3 = 10, plotësojmë:

☐ – 3 = 7 ☐ – 7 = 3

5 < = > ?

3 + 6 ☐ 9 – 5 4 + 4 ☐ 8 – 0

5 + 4 ☐ 9 – 3 3 + 5 ☐ 9 – 5

6 7 8 9

7 Zbulojmë rregullën dhe plotësojmë katrorin e zbrazët me numrin e duhur:

0, 3, 6, ☐. 1, 3, 5, ☐.

8 Në librarinë e lagjes, Nora bleu një libër për 3 €, një çantë me lapsa për 4 € dhe një lodër për 2 €. Sa para harxhoi Nora?

Nora harxhoi: ___ + ___ + ___ = ___ + ___ = ___ euro.

103

- Cilit numër kur ia heqim i mbesin zero?

Plotësohen barazimet nga ana e nxënësve.

Lexohet detyra 3 me fjalë dhe nxënësit tregojnë se cilin veprim duhet përdorur që të gjejnë se sa fletore ka Blini. Plotësohet barazimi në libër.

Lexohet detyra 4, ku nxënësit duhet nga një barazim me mbledhje të shkruajnë dy barazime me zbritje.

- **Cilit numër kur ia heqim 3 mbesin 7?**
- **Cilit numër kur ia heqim 7 mbesin 3?**

Te detyra 5, nxënësit drejtohen me pyetje:
- **Për t'i krahasuar dy barazimet, çfarë duhet bërë së pari?** Nxënësit punojnë të pavarur.

Te detyra 6, shembulli i parë analizohet me pyetje:

- **Çfarë paraqet numri 7?**
- **Në sa vende janë ndarë 7 rrathë?**

Plotësohen kutizat. Pyeten:
- **Në dy shembujt e fundit, për ta plotësuar kutizën e dytë, çfarë duhet bërë?**

Nxënësit plotësojnë të pavarur detyrën.
Në detyrën 7, udhëzohen që të gjejnë për sa po rritet numri pasardhës në çdo varg numerik dhe aq t'ia shtojnë numrit të parafundit, për ta gjetur numrin e fundit në çdo varg numerik.
Lexohet detyra 8 me fjalë dhe nxënësit e zgjidhin të pavarur.

**Hapi 3:** Mblidhen librat për t'i kontrolluar dhe vlerësuar.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit përcaktojnë saktë mbledhorin, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin; vendosin shenjën e duhur gjatë krahasimit dhe zgjidhin saktë problemet me fjalë.

**Detyrë:**
Të krijojë një problemë me fjalë ose me vizatime dhe ta zgjidhë atë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 88

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.5; 4.2; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Edhe matematika është zbavitje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Mbledh dhe zbret numra deri në 9 me saktësi deri në 80%;
- Zbulon rregullën duke plotësuar vargun numerik nga 0 deri 9;
- Zgjidh detyrat e thjeshta nga jeta e përditshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, shkopinj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen t'i mbledhin numrat e dhënë në etiketa dhe t'i ngjyrosin ato sipas ngjyrës së valixhes, e cila bart shumën e duhur. Pas plotësimit i lexojnë ato.

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet ta shikojnë detyrën 2 dhe ta komentojnë. Ndihmohen duke i pyetur: *–Pse nën rrethin e kaltër kemi numrin 1 dhe nën trekëndor numrin 2?; – Çfarë lidhjeje kanë teli i numrave me telin e figurave?; - Çfarë numri paraqet katrori i gjelbër?; –Po lulja?;- Plotësoni katrorët dhe njehsoni.*
Nxënësit punojnë në çift, ku njëri nxënës i plotëson barazimet e njërit rresht e tjetri rreshtin tjetër. Shkëmbehen librat.




**Hapi 3:** Në detyrën 3 nxënësit do të shkruajnë vargun numerik me numra nga 0 deri në 9. Pyeten: *-Çfarë mendoni cili numër duhet të shkruhet pas numrit 9? –Pse?*

Çdo nxënës brenda dyshes plotëson nga një varg numerik dhe librat shkëmbehen mes tyre.

**Hapi 4:** Udhëzohen që duke mbledhur e zbritur të zbulojnë se sa vjet jeton miu. Por, të përcillen shigjetat gjatë plotësimit të katrorëve.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen që pasi të gjejnë rezultatet të shkruhet shkronja që gjendet në xhitën e rezultatit të caktuar. *Cilën fjalë e fituat?; –Çfarë kuptoni me të?; –Çfarë marrim ne në shkollë?*

**Hapi 6:** Pyeten se a u pëlqen peshkimi. Njoftohen nxënësit se do të bëjmë një garë se cili po zë më shumë peshq. Detyra 6 punohet në çift. Njëri nxënës plotëson barazimet te peshqit e verdhë e tjetri te peshqit e kaltër. Nxënësi që i plotëson më shpejt do të jetë fitues i garës së peshkimit. Fituesit i pajisim me një medalje.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit mbledhin dhe zbresin numrat me saktësi 80%; zbulojnë rregullat dhe zgjidhin saktë detyrat nga jeta e përditshme.

**Detyrë:**
Të punohen barazimet e mbetura të detyrave 2, 3 dhe 4.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 89

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat; +, -, >, <, =, dhe i përdor ato në rastet e caktuara; zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 2.2; 3.1; 3.4; 3.6; 4.2.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje




**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Vendos shenjën e duhur që të fitohet barazia e saktë;
- Zbulon numrin që e zëvendësojnë figurat në barazime;
- Zbatojnë mbledhjen dhe zbritjen në zgjidhjen e detyrave nga jeta.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numrat magnetikë, etiketa me shenjat +, - .

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Shkruhet një barazim me tre mbledhorë, por që mes tyre mungojnë shenjat përkatëse + apo -. Ftohet një nxënës që ta vendosë shenjën përkatëse mes numrave, që barazimi të jetë i saktë, p.sh.:
*Cilin veprim duhet ta përdorim me dy numrat e parë që të fitohet numër më i madh se numri 4? - Pasi fitohet numri 9, cilën shenjë duhet vendosur për ta fituar në fund numrin 5?*

**6 + 3 – 4 = 5**

**Hapi 2:** Ngjashëm vendosin shenjat "+" apo "-" në barazimet e detyrës 1. Plotësohen 3 barazimet në klasë dhe lexohen.




**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të zbulojnë numrin që paraqet kafsha, shpendi i caktuar në barazim. Ndihmohen me pyetje: *-Çfarë numri ka zogu?; – Cilët janë dy numra të njëjtë që kur të mblidhen na japin 8?( 4 ); Pse?* ( 4 + 4 = 8 ). Nxënësit punojnë individualisht.

**Hapi 4:** Detyra 3 punohet në çift, ku njëri njehson vitet e Nitës e tjetri vitet e Tonit. U tërhiqet vëmendja që të përcjellin shigjetat. *–Çfarë tregon shigjeta?*
Pasi të njehsojnë vitet e fëmijëve i krahasojmë se cili është më i vogël apo anasjelltas.

**Hapi 5:** Vëzhgohet vizatimi i dhënë në detyrën 5 dhe komentohet nga nxënësit duke krijuar një tregim të shkurtër. Ata duhet ndihmuar Babadimrin që të arrijë te saja e tij për t'i shpërndarë dhuratat. Udhëzohen të njehsojnë, dhe fushat me rezultate të njëjta t'i ngjyrosin. Kjo do të jetë rruga e duhur. Nxënësit punojnë të pavarur. Shkëmbehen librat me shokun e bankës për të vlerësuar punën e njëri-tjetrin. Në fund pyeten *– Çfarë mendoni, do të arrijë Babadimri t'ua shpërndajë dhuratat me kohë fëmijëve?*

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vendosin shenjën e duhur që të fitohet barazia e saktë; zbulojnë numrin që paraqet kafsha e caktuar dhe zgjidhin saktë detyrat nga jeta e përditshme.

**Detyrë:**
Të punohen shembujt e mbetur të detyrave 1, 3, 4. Të shkruhen në fletore barazimet e detyrës 3.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 90

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Njësitë matëse

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përdor monedhat, nga 1€ deri në 20€ për të llogaritur çmime të sendeve nga jeta e përditsh me.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; II.4; III.1; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraja – Euro

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Klasifikon monedhat sipas vlerës;
- Përcakton çmimin e artikujve të ndryshëm;
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes së monedhave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Monedha të ndryshme, mjete shkollore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u parashtrohet pyetja: - *Cila valutë para përdoret te ne?*
Para tyre vendosen disa monedha të ndryshme, metalike dhe kartëmonedha. Njoftohen me ndarjen e monedhave në ato metalike dhe kartmonedha. - *Cili është simboli i euros?* - *Çfarë tregon numri i caktuar në monedha? (vlerën e saj)*. Kërkohet nga ata t'i emërtojnë dhe t'i klasifikojnë këto monedha sipas vlerës që kanë.

**Hapi 2:** Kalohet në detyrën 1 të tekstit, ku nxënësit diskutojnë rreth parave të dhëna aty. Nxënësit gjejnë vlerën e parave në çdo shembull. Pyeten: - *Çfarë kanë të përbashkët shembulli i dytë dhe i fundit? (vlerën, 5€). - Ku ndryshojnë?*




**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit që të gjejnë çmimin e çdo artikulli të dhënë në detyrën 2.

**Hapi 4:** Nxënësve në grupe u shpëndahet kompleti i monedhave, si mjet pune. Improvizohet shitja dhe blerja e mjeteve të ndryshme shkollore. Nxënësit gjatë blerjes duhet të përdorin fjalët e shprehjet, si: monedha, cent, euro, ju lutem, sa kushton?, kusur, faleminderit.

**Hapi 5:** Nxënësit gjejnë çmimin e çdo artikulli të dhënë në detyrën 2. Pyeten: *–Nëse blejmë dy artikuj, si llogariten paratë që duhen paguar?* Kalohet menjëherë në detyrën 3, ku nxënësit gjejnë shumën e parave që duhet për blerjen e dy artikujve të dhënë. Nxënësit krijojnë detyra me fjalë me artikujt e dhënë.

**Hapi 6:** Nxënësit punojnë të pavarur në detyrën 4, ku duhet të njehsojnë shumën apo ndryshimin dhe të lidhin me shigjetë, etiketën me shumën (ndryshimin) e saktë. Në fund i lexojnë me zë njehsimet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit klasifikojnë saktë monedhat sipas vlerës, si dhe përcaktojnë saktë çmimin e artikullit të caktuar. Po ashtu ata mbledhin dhe zbresin saktë me monedha.

**Detyrë:**

Mendoni disa artikuj, ia caktoni çmimin çdo artikulli dhe shkruani monedhat që do të përdorni për ta blerë atë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 91

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përdor monedhat, nga 1 euro deri në 20 euro për të llogaritur çmime dhe sende nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,3,4, Ill.1,2,3; IV.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1,3; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraja - Euro/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Klasifikon monedhat e njëjta sipas vlerës së tyre;
- Blen dhe shet me monedha në shitoren e improvizuar;
- Mbledh dhe zbret duke përdorur monedhat.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Monedha, kartëmonedha, lodra të sjella nga fëmijët, mjete mësimore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten para nxënësve disa monedha dhe kartëmonedha dhe pyeten nxënësit: Çfarë janë këto? (para-euro); Çfarë mataeriali kanë ato që janë në formë rrethi? (metal); Po ato në formë drejtkëndëshi? (letër).
U tregohet nxënësve që paratë nga metali janë monedha, ndërsa paratë nga letra janë kartëmonedha.




**Hapi 2:** U shpërndahen nxënësve në grupe monedha dhe kartëmonedha dhe kërkohet nga ata që t'i dallojnë ato duke i grupuar monedhat në një anë, dhe kartëmonedhat në anën tjetër.




**Hapi 3:** Paraqiten në tabelë shembuj të mbledhjes dhe zbritjes me para, p.sh., 5€ + 3€ = 8€, 10€ - 4€ = 6€.
Nxënësit dalin me radhë dhe kryejnë veprime të njëjta. Plotësohet detyra 2 në libër në mënyrë të pavarur.

**Hapi 4:** Në detyrën 3 nxënësit shikojnë çmimet e gjërave dhe gjejnë shumën e tyre, p.sh., zogu lodër kushton 4€, ndërsa balona kushton 2€, të dyja bashkë kushtojnë 6€ ose 4€ + 2€ = 6€
Vazhdohet njëjtë edhe në detyrën 4 në libër duke parë çmimet e gjërave, pastaj duke i kryer veprimet që kërkohen.

**Hapi 5:** Paraqiten në tabelë shembuj të mbledhjes dhe zbritjes ku mungon njëri numër. P.sh., kemi 6€ edhe sa euro na duhen për të formuar shumën 10€? 6€ + ____ = 10€. Nxënësit e punojnë detyrën në libër në mënyrë të pavarur.

**AKTIVITET SHTESË - "Shitorja ime"**
Krijohet bashkë me nxënësit në këndin e klasës një shitore e improvizuar "Shitorja ime". Me monedha te ndryshme nxënësit afrohen për të blerë gjëra të ndryshme që kanë sjellë nga shtëpia, si: lodra e mjete mësimore. Ata inkurajohen që të përdorin fjalët apo shprehjet: monedha, cent, euro, para, kusur, sa kushton?, faleminderit etj.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për klasifikimin e parave, mbledhjen dhe zbritjen me para, shitjen dhe blerjen e gjërave duke përdorur monedhat dhe kartëmonedhat deri në 10€.

**Detyrë:**
Në fletore punoni 4 detyra të ngjashme me detyrën 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 92

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përdor monedhat, nga 1 euro deri në 20 euro për të llogaritur çmime dhe sende nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,3,4, III.1,2,3; IV.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1,3; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraja – Euro/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Klasifikon monedhat e njëjta sipas vlerës së tyre;
- Mbledh dhe zbret duke përdorur monedha;
- Blen dhe shet me paratë e improvizuara.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, monedha, kartëmonedha, mjete mësimore, fletë të printuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Me projektor paraqiten pamje para nxënësve ku janë grumbulluar monedha dhe kartëmonedha dhe ata pyeten rreth tyre.
Nxënësve u kërkohet t'i dallojnë monedhat dhe kartëmonedhat, të tregojnë se nga se dallojnë ato. Ata tregojnë nëse blejnë gjëra në shitore ose librari, dhe si veprojnë.

**Hapi 2:** Nxënësve u shpërndahen fletë të printuara ku janë paraqitur para-euro në formë të monedhave dhe të kartëmonedhave. Kërkohet nga ata t'i presin ato dhe t'i klasifikojnë paratë sipas vlerës së tyre.




**Hapi 3:** Nxënësit në çifte bëjnë shitje dhe blerje të mjeteve mësimore me paratë e improvizuara të cilat i kanë prerë pak më herët. Gjatë aktivitetit ata përdorin fjalë apo shprehje, si: monedha, euro, para, kusur, sa kushton?, faleminderit etj.

**Hapi 4:** Paraqitet me projektor pamja e detyrës 6 në libër. Flitet për të gjitha gjërat që gjenden në detyrë si dhe për çmimet e tyre. Pastaj kërkohet nga nxënësit të kryejnë veprimin e mbledhjes duke përdorur çmimet e gjërave lart në detyrë. Tashmë është mësuar mbledhja e numrave me tre numra dhe nxënësit gjejnë shumat e çmimeve me dy e tri gjëra, ashtu siç kërkohet në detyrë.



**Hapi 5:** Paraqitet në tabelë detyra 7 ku kërkohet të bashkohen me shigjetë veprimet me shumën e parave që i përshtatet atij veprimi. Nxënësit dalin me radhë te tabela, i bashkojnë ato dhe punojnë detyrën në libër.



**Hapi 6:** Praktikë e pavarur me fletët e printuara. Duke parë gjërat në figura dhe çmimet e tryre, nxënësit ngjyrosin aq monedha sa formojnë çmimin e produktit. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për klasifikimin e parave, mbledhjen dhe zbritjen me para, shitjen dhe blerjen e gjërave duke përdorur monedhat dhe kartëmonedhat deri në 10€.

**Detyrë:**

Në fletore punoni një detyrë të ngjashme me detyrën 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 93

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton figurat gjeometrike siç janë: katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi dhe rrethi;
- Tregon shembuj të tjerë që ngjasojnë me figurat gjeometrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1,2,3; III.1,2; IV.5, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1, 3.4,5; 5.1; 6.1,2,4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Figurat – format dhe ngjyrat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Grupon figura gjeometrike me formë dhe ngjyrë të njëjtë;
- Emërton figurat gjeometrike të grupuara me forma të njëjta;
- Modelon objekte me figura gjeometrike.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Letra me ngjyrë, figura, petëza me figura gjeometrike, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen petëza me figura gjeometrike. Gjatë kohës së shpërndarjes bisedohet rreth formave dhe ngjyrave të tyre. Pastaj në dysheme i grupojnë nëpër bashkësi si në foto dhe i emërtojnë ato: katrorë, rrathë, trekëndësha, drejtkëndësha etj.

**Hapi 2:** Paraqiten në dysheme figurat e mësuara. Në një kub janë vendosur figurat me ngjyrat e njëjta me ato në dysheme. Dalin 4 nxënës dhe kur gjuajnë kubin në dysheme, cila figurë që të bjerë, ai nxënës fillon të kërcejë mbi ato figura dhe thotë p.sh.: rreth, rreth, rreth gjatë






kërcimit. Veprohet kështu disa herë me radhë.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të ngjyrosin figurat sipas ngjyrave dhe sipas formave te paraqitura në detyrën 1 në libër. Më pas i krahasojnë punimet dhe bisedojnë me shokun e bankës për figurat që kanë ngjyrosur: flutur, anije.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë me kujdes figurat në detyrën 2 dhe t'i bashkojnë me shigjetë dy pjesët e të njëjtit objekt. Ata garojnë mes vete kush po i kryen më shpejt dhe më saktë.

**AKTIVITET SHTESË**

U shpërndahen nxënësve figura gjeometrike të prera nga letrat me ngjyra. Lipset nga ta të punojnë sipas imagjinatës objekte të ndryshme. Punimet e nxënësve vlerësohen dhe vendosen në këndin e punimeve të nxënësve në klasë.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, grupojnë, modelojnë dhe emërtojnë figurat gjeometrike me forma të njëjta.

**Detyrë:**

Detyra 3 në libër të punohet në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 94

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike/ Sipërfaqja, Modele

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton figurat gjeometrike siç janë: katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi dhe rrethi;
- Tregon shembuj të tjerë që ngjasojnë me figurat gjeometrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1,2,3; III.1,2; IV.5, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1,2; 5.1; 6.1,2,4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon figurën e katrorit dhe te drejtkëndëshit;
- Përshkruan figurën e katrorit dhe të drejtkëndëshit;
- Vizaton katrorin dhe drejtkëndëshin duke i krahasur ata.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, letra me ngjyra, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet me projektor kënga për katrorin dhe drejtkëndëshin në linkun që paraqitet këtu: https://www.youtube.com/ëatch?v=beSjR7oQCcM. Nxënësit shikojnë me vëmendje pamjet që paraqiten për katrorin dhe drejtkëndëshin, objektet me të cilat përshtaten këto dy figura. Pyeten për pamjet që panë në video, si dhe për gjërat që gjenden në klasë e që kanë formën e katrorit dhe të drejtkëndëshit, si: tabela, dera, dritaret, librat, fletoret, mbajtësja e lirave etj. U kërkohet nxënësve të tregojnë se si i dallojmë këto dy figura mes vete.

**Hapi 2:** U shpërndahen nxënësve letra me ngjyra ku janë të printuara format e katrorit dhe të drejtkëndëshit. Nxënësit i presin format dhe pastaj krijojnë dy bashkësi me figurat e prera. Në njërën bashkë-




si i vendosin format e katrorit, ndërsa në bashkësinë tjetër format e drejtkëndëshit. Më pas i krahasojnë figurat.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të ngjyrosin figurat në detyrën 1 në tekst, sipas udhëzimeve. Kërkohet nga nxënësit t'i emërtojnë pastaj figurat e ngjyrosura.

**Hapi 4:** Bisedohet me nxënës: Vëreni shembullin e parë: Sa kutiza janë ngjyrosur me të kuqe, të verdhë, të kaltër? (nga katër kutiza). Vëreni shembullin e dytë: Sa kutiza janë ngjyrosur me të gjelbër, të verdhë, të kuqe per të formuar drejtkëndëshin? (nga 6 kutiza). Lipset nga nxënësit të veprojnë duke ngjyrosur nga 4 kutiza për të formuar katrorin, nga gjashtë kutiza për të formuar drejtkëndëshin.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të ngjyrosin drejtkëndëshat me ngjyrë të verdhë dhe katrorët me ngjyrë të kuqe. Pastaj ata krahasojnë punën e vet me atë të shokut ose shoqes së bankës.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të vizatojnë dhe të ngjyrosin drejtkëndëshin dhe katrorin sipas modelit. Më pas në fletoret e tyre vizatojnë figura që kanë formën e katrorit dhe të drejtkëndëshit. Ata lëvizin nëpër klasë duke u treguar nxënësve të tjerë fletoren e tyre.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për dallimin, përshkrimin e figurave dhe vizatimin tyre.

**Detyrë:**
Vizatoni dhe ngjyrosni në fletore nga 4 katrorë dhe drejtkëndësha.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 95

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike/Sipërfaqja, Modele

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton figurat gjeometrike, siç janë: katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi dhe rrethi;
- Tregon shembuj të tjerë që ngjasojnë me figurat gjeometrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.1,2,3; III.1,2; IV.5, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1,2; 5.1; 6.1,2,4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Figurat në formë të drejtkëndëshit dhe të katrorit/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krahason figurën e katrorit dhe të drejtkëndëshit;
- Gjen numrin e figurave katrore dhe drejtkëndëshe në modelin e dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Letra me ngjyra, figura gjeometrike, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten në tabelë dy figurat gjeometrike: drejtkëndëshi dhe katrori. Njëherësh secilit nxënës në klasë i shpërndahen këto dy figura të përgatitura me letra. Bisedohet me ata duke i pyetur se si duken këto figura. Kërkohet nga nxënësit t'i përshkruajnë dhe t'i emërtojnë ato:

Ku dallojnë këto dy figura dhe çka kanë të përbashkët?

Gjeni sende që janë të ngjashme me formën e këtyre figurave etj.




**Hapi 2:** Nxënësve u shpërndahen letra me ngjyra ku janë të printuara format e katrorit dhe të drejtkëndëshit. Kërkohet nga ata të presin format dhe pastaj të ndajnë katrorët në një anë, drejtkëndëshat në anën tjetër. Nxënësit i përshkruajnë dhe i krahasojnë figurat sipas formës.

**Hapi 3:** Nxënësit krijojnë objekte me figurat e prera: robot, ndërtesa, tren etj. I ngjesin në fletë A4. Objektet e krijuara pastaj i prezantojnë para të tjerëve.



**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat dhe të shikojnë figurën 1 në libër. Jepen sqarimet e duhura për ngjyrosjen e figurave. Katrorin e madh e ngjyrosin me ngjyrë të kuqe, katrorët e tjerë pas tij me të gjelbër dhe drejtkëndëshat me ngjyrë të verdhë. Numërojnë sa katrorë dhe drejtkëndësha janë, pasi disa prej tyre janë fshehur pas katrorit të madh.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet t'i ngjyrosin figurat sipas modelit të dhënë dhe të tregojnë më pas cilat figura me cilën ngjyrë i kanë ngjyrosur. Numërohen pastaj ato. Pyeten nxënësit: Sa figura katrore ngjyrosët? Sa figura drejtkëndëshe? Sa figura rrethore? Cila kishte më shumë? Për sa më shumë?



**Hapi 6:** U shpërndahen nxënësve fletë të punës me figurat gjeometrike. Ata i ngjyrosin ato, pastaj i numërojnë figurat nga sa ka te secili lloj. Shkruajnë: Unë po shoh kaq rrathë, kaq katrorë, kaq trekëndësha etj.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për emërtimin e kufizave të zbritjes dhe llogaritjen e ndryshimit të numrave.

**Detyrë:**

Detyra 3 në libër të punohet në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 96

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton figurat gjeometrike, siç janë: trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi, rrethi;
- Vizaton me dorë të lirë trekëndëshin dhe rrethin.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3;II.1,3; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 6.1; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Figurat në formë të trekëndëshit dhe të katrorit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Klasifikon figurat gjeometrike;
- Emërton figurat në formë trekëndëshi;
- Vizaton me dorë të lirë trekëndëshin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kuti me forma të ndryshme, forma të mëdha gjeometrike.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen forma të ndryshme, të vendosura në një kuti. Kërkohet t'i klasifikojnë format sipas këndëvështrimit të tyre në grumbuj të ndryshëm. Secili prej grupeve e arsyeton klasifikimin e tij. Pyeten: - Pse i keni klasifikuar kështu? Çfarë keni vërë re? Nxënësit shpjegojnë mënyrën e tyre të klasifikimit, pastaj lëvizin nëpër klasë për të parë si kanë punuar grupet e tjera
Paraqiten para nxënësve dy figurat (trekëndëshi dhe rrethi). Pyesim: *-Si duken ata? Ku dallojnë? Si quhen?* Jepen sqarimet e nevojshme për rrethin dhe trekëndëshin. Vendosen etiketat pranë figurave.







**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 1 në libër. Figurat që kanë formën e trekëndëshit i ngjyrosin me ngjyrë të kuqe, kurse ato në formë rrethi me ngjyrë të verdhë. Pas plotësimit shkëmbehen librat dhe kontrollohen nga njëri-tjetri.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të vërejnë figurën në detyrën 2. Pyeten: *-Çfarë vëreni?- Me çfarë ngjyre duhet t'i ngjyrosim figurat?- Sa është numri i figurave rrethore?- Sa është numri i trekëndëshave? –Çfarë ka më shumë? –Çfarë më pak?* Nxënësit ngjyrosin figurat dhe krahasojnë detyrën me shokun e bankës.

**Hapi 4:** Demonstrohet vizatimi i rrethit në tabelë, pastaj udhëzohen nxënësit të përfundojnë vizatimin e rrethit në libër. U jepet ndihmë atyre që mund të kenë vështirësi.

**Hapi 5:** Udhëzohen të vizatojnë figurat në formë të rrethit dhe të trekëndëshit fillimisht duke i bashkuar pikat, pastaj të vizatojnë edhe disa figura të njëjta sipas modelit të dhënë.

Nxënësit i emërtojnë figurat dhe i ngjyrosin sipas dëshirës. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e nxënësve.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi vlerësohet për klasifikimin, emërtimin dhe vizatimin e saktë të figurave gjeometrike (trekëndëshit dhe rrethit).

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 97

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton figurat gjeometrike, siç janë: trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi, rrethi.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3;II.1,3; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 6.1; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Figurat në formë të trekëndëshit dhe të katrorit/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan karakteristikat e figurave gjeometrike;
- Dallon figurat gjeometrike;
- Krijon figura të ndryshme gjeometrike në tabelën me kunja.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete prej kartoni të prera në formë drejtkëndëshi dhe rrethi, spango, tabela me kunja, penj me ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Bëhet përsëritje e shkurtër e njohurive të marra një orë më parë për figurat gjeometrike. Pastaj paraqiten figurat e drejtkëndëshit dhe të rrethit dhe kërkohet emërtimi i tyre.
Nxënësit përshkruajnë karakteristikat e figurave gjeometrike.




**Hapi 2:** Nxirren disa nxënës te tabela. Kërkohet që ta tërheqin spangon ndërmjet tyre me dorë, në mënyrë që ta formojnë drejtkëndëshin. Pyeten: -*Si e vëreni se është drejtkëndësh?* Nxiten ata të përdorin termat e duhur. Përsëritet ushtrimi për figurat e tjera, me grupin tjetër të nxënësve.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të hapin librat dhe të vështrojnë foton e detyrës 1. Rrethin e madh ata e




ngjyrosin me ngjyrë të kuqe, katrorët pas tij me të gjelbër, drejtkëndëshin me të verdhë, rrathët me të kaltër dhe trekëndëshat me të kafenjtë.

**Hapi 4:** Nxënësit nxiten të tregojnë se çfarë duhet bërë në detyrën 2. I ngjyrosin katrorët me ngjyrë të verdhë, trekëndëshat me të kuqe dhe rrathët me të kaltër. Pyeten: *Çfarë kishte më shumë? Çfarë kishte më pak?* Nxënësit i numërojnë figurat e ngjyrosura dhe e bëjnë krahasimin e tyre.

**Hapi 5:** Në mënyrë të pavarur nxënësit ngjyrosin figurat e detyrës 3 sipas udhëzimit në libër. Pas plotësimit shkëmbehen librat dhe kontrollohen nga njëri-tjetri.

**Hapi 6:** Nxënësve u kërkohet të krijojnë forma të ndryshme me madhësi të ndryshme me ndihmën e tabelës me kunja dhe penjve me ngjyra. - *Çfarë formash mund të krijohen?* Vlerësohet puna e nxënësve.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete, përshkrimin e saktë të karakteristikave të figurave si dhe për krijimin e saktë të figurave gjeometrike.

**Detyrë:**
Vizatoni sende në fletore që kanë formën e secilës figurë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 98

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton figurat gjeometrike, siç janë: trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi, rrethi.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3;II.3; III.1,2,4;V.5 .

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 3.6; 6.1; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton saktë figurat gjeometrike;
- Klasifikon figurat sipas formës;
- Përcakton numrin e figurave gjeometrike.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete prej kartoni të prera në formë katrori, drejtkëndëshi, rrethi dhe trekëndëshi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve në grupe u shpërndahet nga një kuti me pjesë të formave gjeometrike. Detyra e tyre është t'i bashkojnë format dhe t'i ngjitin në hamer. Pasi t'i bashkojnë format, nën çdo formë duhet të shkruajnë emrin e figurës.


KATROR


RRETH


TREKËNDËSH


DREJTKËNDËSH




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të shikojnë me vëmendje detyrën 1 në libër. Figurat që e kanë formën e njëjtë duhen ngjyrosur me ngjyrë të njëjtë. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Pas plotësimit shkëmbehen librat me njëri-tjetrin.

**Hapi 3:** Në tabelën magnetike paraqiten petëza me formë të trekëndëshit, të katrorit, të drejtkëndëshit dhe të rrethit. Ftohen nxënësit vullnetarë t'i klasifikojnë sipas formës dhe t'i vendosin në fushat e caktuara. Në të njëjtën kohë nxënësit punojnë detyrën 2 në libër. Kontrollohet puna e tyre.

**Hapi 4:** Nxënësve u shpërndahen fletëzat e përgatitura. Prej tyre kërkohet të përcaktojnë numrin e figurave gjeometrike që janë përdorur dhe të ngjyrosin sipas udhëzimeve. Vlerësohet puna e nxënësve.





**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete; emërtimin dhe klasifikimin e saktë të figurave gjeometrike; për përcaktimin e saktë të numrit të figurave gjeometrike.

**Detyrë:**

Të plotësohen detyrat 1 dhe 2 në faqen 14 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 99

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Ngjyros figura simetrike dhe krijon figura simetrie.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3;II.1; III.2;III.6; IV.5; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;2.1; 3.4; 3.6; 6.3.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Simetria dhe drejtëza e simetrisë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton drejtëzen e simetrisë në figurat e dhëna;
- Ngjyros figurat sipas modelit në tekst duke vëzhguar drejtëzën e simetrisë;
- Vizaton figurën simetrike në lidhje me drejtëzën.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, ngjyra, pasqyrë, objekte të ndryshme, vizore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen fletë A4 dhe u kërkohet që të bashkojnë cepat e fletës dhe ta palosin atë. Pyeten: Në sa pjesë u nda fleta? (Në dy pjesë) – Nxënësit udhëzohen të shënojnë me ngjyrë të kuqe vijen e palosjes. U sqarohet se kjo vijë quhet drejtëza e simetrisë, e cila e ndan fletën në dy pjesë të barabarta. Ngjyroset ana e majtë e fletës me ngjyra të ndryshme, ku pas palosjes shfaqet figura në anën tjetër të fletës në mënyrë simetrike.
Pyeten:
- *Çfarë vëreni?*
- *A janë të njëjta figurat në dyja anët e fletës?*



**Hapi 2:** Nxënësit i hapin librat dhe vëzhgojnë me vëmendje figurat e paraqitura në detyrën 1 dhe 2. Ata




tregojnë me gisht drejtëzën e simetrisë, pastaj udhëzohen të vendosin pasqyrën në mes të drejtëzës dhe të thonë çfarë dallojnë. Nxënësit vërejnë figurën si një e tërë, dhe më pas ngjyrosin duke formuar figurën simetrike. Paraqiten disa shembuj në tabelë.

**Hapi 3:** Diskutohet fotoja e ushtrimit 3. –Sa drejtëza të simetrisë ka figura e parë? (Dy drejtëza); *– Në figurën e dytë sa drejtëza të simetrisë duhet vizatuar?(Një). Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.*

**Hapi 4:** Kërkohet nga nxënësit të vendosin mbi bankë një vizore dhe të formojnë figura simetrike duke u bazuar në drejtëzën e simetrisë (vizoren) me ndihmën e objekteve të ndryshme (për shembull pasqyra).

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të vizatojnë figurën simetrike në lidhje me drejtëzën e simetrisë në detyrën 4. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përcaktimin e drejtëzës së simetrisë në figurat e dhëna; për vizatimin dhe ngjyrosjen e saktë të figurave simetrike në lidhje me drejtëzën simetrike.

**Detyrë:**
Vizatoni një figurë simetrike.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 100

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Ngjyros figura simetrike dhe krijon figura simetrie.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3;II.1; III.2;III.6; IV.5; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;2.1; 3.4; 3.6; 6.3.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Simetria dhe drejtëza e simetrisë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon figurat simetrike nga ato josimetrike;
- Përcakton drejtëzën e simetrisë në figurat e dhëna;
- Krijon figura simetrike.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, ngjyra, pasqyrë, objekte të ndryshme, fletëza të përgatitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bëhet përsëritje e shkurtër e njohurive të marra nga ora e kaluar për simetrinë dhe drejtëzën e simetrisë. Më pas vizatohet një drejtëz simetrie në dysheme dhe kërkohet nga nxënësit të vendosin objekte në të dyja anët, ashtu që të jenë simetrike me njëra-tjetrën.



**Hapi 2:** Vëzhgojnë detyrën 1 dhe analizohet së bashku.
*- A janë të gjitha figurat simetrike? - Pse? -Cila nga figurat është simetrike?* Nxënësit përdorin pasqyrën për të parë a janë simetrike figurat. Udhëzohen që katrorët poshtë figurave simetrike t'i ngjyrosin me të kuqe, të tjerat me të gjelbër.

**Hapi 3:** Diskutohet me nxënësit. *-Çfarë mendoni, a është tavolina trup simetrik? -Po dera e klasës?- Çfarë*




*mendoni për trupin e njeriut?* Paraqiten para nxënësve disa ilustrime që formojnë figura simetrike.



Udhëzohen ata që të pavarur t'i punojnë detyrat 2 dhe 3 në bazë të kërkesave në libër.

**Hapi 4:** Nxënësve u shpërndahen fletë letre me ngjyra. U kërkohet të palosin fletën në dy pjesë dhe të presin me gërshërë një figurë nga ana e palosur. Hapin figurën e prerë dhe shënojnë drejtëzën e simetrisë. Figurat simetrike të krijuara ekspozohen në klasë. Vlerësohet puna e nxënësve.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitetet; dallimin e figurave simetrike; përcaktimin e drejtëzës së simetrisë dhe krijimin e figurave simetrike.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 101

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Figurat gjeometrike/Sipërfaqe/Modele

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1,2; 3.6; 6.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Simetria dhe drejtëza e simetrisë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon vijën bazë të simetrisë;
- Përcakton drejtëzën e simetrisë te figurat e dhëna;
- Krijon figura simetrike.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Burime nga interneti, fletë të bardha, ngjyrë, gërshërë, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të hedhin ngjyrë (tempero, uji, ngjyrë shkrimi) në mes të fletës së bardhë, e më pas ta palosin fletën në dy pjesë. Pas shpalosjes së fletës, vëzhgohet figura simetrike e formuar. Nxiten nxënësit të komentojnë figurat e tyre duke treguar se ku është vija e simetrisë (vija e palosjes së letrës). Më pas paloset prapë letra dhe pritet me gërshërë sipas dëshirës në formë të çrregullt. Pas shpalosjes, nxënësit tregojnë se a janë dy anët e figurës simetrike.



**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet t'i dallojnë figurat simetrike dhe josimetrike në detyrën e parë dhe më pas ta vizatojnë drejtëzën e simetrisë në figurat që janë simetrike.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të ngjyrosin pjesën e mbetur të figurës dhe të formojnë figura simetrike.




Pyeten:
Sa drejtëza të simetrisë ka figura që ngjyrosët?
Ku i dalloni se janë drejtëza të simetrisë?

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të formojnë figura simetrike duke numëruar pikat se sa janë të larguara nga drejtëza e simetrisë.

**Hapi 5:** Në një letër me katrorë, u jepet nxënësve një gjysmë figure dhe u kërkohet që të vizatojnë gjysmën tjetër. Kjo mund të jetë një formë ose një figurë, shtëpi, pemë, ose flutur. Për t'i ndihmuar u jepet një pasqyrë që ta afrojnë afër figurës që ta kenë më të qartë se si do të duket figura simetrike. Më pas, u jepet figura e plotë dhe u kërkohet që të vizatojnë vijën e simetrisë. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e verifikimit të vijës bazë së simetrisë; përcaktimit të drejtëzës së simetrisë në figurat e dhëna dhe krijimit të figurave simetrike.

**Detyrë:**
Gjeni figura dhe vizatoni drejtëzën e simetrisë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 102

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1,2.8; III.2; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.1,6; 6.4.


Mësojmë

KRAHASIMI I NUMRAVE

1. PËR SA ËSHTË NJË NUMËR MË I MADH SE TJETRI?

1
Altini ka 5 balona.
Edita ka 2 balona.
Sa balona ka Altini më shumë se Edita?
Altini ka ___ balona më shumë se Edita, sepse 5 – 2 = ___.

2
Numri 7 është për ___ më i madh se 5.
7 – ___ = ___
Numri 9 është për ___ më i madh se 4.
___ – ___ = ___
Numri 6 është për ___ më i madh se 3.
___ – ___ = ___
Numri 5 është për ___ më i madh se 4.
___ – ___ = ___

3
T'i plotësojmë fjalitë:
a) Numri 8 është për ____ më i madh se numri 3, sepse 8 – 3 = ____.
b) Numri 6 është për ____ më i madh se numri 5, sepse 6 – 5 = ____.
c) Numri 9 është për ____ më i madh se numri 6, sepse 9 – 6 = ____.
d) Numri 7 është për ____ më i madh se numri 2, sepse 7 – 2 = ____.

4
Pa i numëruar katrorët në rreshta, tregojmë sa katrorë më shumë ka rreshti i dytë.
Në rreshtin e dytë ka ____ katrorë më shumë se në rreshtin e parë.
Në rreshtin e dytë ka ____ katrorë më shumë se në rreshtin e parë.
Në rreshtin e dytë ka ____ katrorë më shumë se në rreshtin e parë.

18

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Për sa është një numër më i madh se tjetri?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson madhësinë e një numri ndaj një tjetri;
- Krahason numrin e sendeve duke njehsuar madhësinë ndaj tjetrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Lapsa me ngjyra, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të tregojnë se nga sa nxënës janë të ulur në secilin rresht. Pyeten: Në cilin rresht ka më shumë nxënës? Për sa më shumë?
Lipset nga nxënësit të krahasojnë numrin e lapsave me ngjyra që kanë me shokun apo shoqen e bankës, më pas të tregojnë cili ka më shumë dhe për sa më shumë. Nxiten të argumentojnë përgjigjet e tyre, duke shoqëruar lapsat një me një, dhe lapsat që nuk formojnë çifte me lapsat e shokut apo shoqes, tregojnë për sa kanë më shumë.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të formojnë një tregim për figurat në detyrën e parë. Ndihmohen duke i pyetur: Sa balona ka Altini? Sa balona ka Edlira? Sa balona ka më shumë Altini se Edlira? Si e shkruajmë me gjuhën matematikore?

(5 – 3 = 2 ).


Mësojmë

KRAHASIMI I NUMRAVE

1. PËR SA ËSHTË NJË NUMËR MË I MADH SE TJETRI?

1

Altini ka 5 balona.

Edita ka 2 balona.

Sa balona ka Altini më shumë se Edita?

Altini ka ___ balona më shumë se Edita, sepse 5 − 2 = ___.

2

Numri 7 është për ___ më i madh se 5.

7 − ___ = ___

Numri 9 është për ___ më i madh se 4.

___ − ___ = ___

Numri 6 është për ___ më i madh se 3.

___ − ___ = ___

Numri 5 është për ___ më i madh se 4.

___ − ___ = ___

3

T'i plotësojmë fjalitë:

a) Numri 8 është për ___ më i madh se numri 3, sepse 8 − 3 = ___.

b) Numri 6 është për ___ më i madh se numri 5, sepse 6 − 5 = ___.

c) Numri 9 është për ___ më i madh se numri 6, sepse 9 − 6 = ___.

d) Numri 7 është për ___ më i madh se numri 2, sepse 7 − 2 = ___.

4

Pa i numëruar katrorët në rreshta, tregojmë sa katrorë më shumë ka rreshti i dytë.

Në rreshtin e dytë ka ___ katrorë më shumë se në rreshtin e parë.

Në rreshtin e dytë ka ___ katrorë më shumë se në rreshtin e parë.

Në rreshtin e dytë ka ___ katrorë më shumë se në rreshtin e parë.

18

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë detyrën e dytë, ku në bazë të të plotësojnë në libër. Ndihmohen nxënësit që kanë vështirësi.

**Hapi 4:** Nxënësit i plotësojnë fjalitë në detyrën e tretë dhe tregojnë se për sa është numri 8 më i madh se numri 3 etj. Ata diskutojnë për gjetjet e tyre dhe i krahasojnë detyrat e bëra.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të gjejnë numrin e katrorëve në rreshtin e dytë pa i numëruar katrorët në rreshta.

**AKTIVITET SHTESË**

U kërkohet nxënësve të shkruajnë emrin dhe mbiemrin e tyre, dhe pastaj të krahasojnë numrin e shkronjave se kush ka më shumë shkronja në emrin dhe mbiemrin e tij; për sa më shumë. Nxënësit renditen sipas numrit të shkronjave në emër dhe mbiemër.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të madhësisë së një numri ndaj një tjetri, krahasimit të numrave të sendeve duke njehsuar madhësinë e tij.

**Detyrë:**

Të paraqitet në fletore ushtrimi 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 103

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1,2.8; III.2; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.1,6; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Për sa është një numër më i madh se tjetri?/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson madhësinë e një numri ndaj një tjetri;
- Krahason numrin e sendeve duke njehsuar madhësinë ndaj tjetrit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirit numerik, kapakë shishesh, gota plastike, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet problema: Beni kishte 7 vjet. Motra e tij, Linda, kishte 4 vjet. Për sa vjet është më i madh Beni se Linda? Kërkohet nga nxënësit të tregojnë zgjidhjen. ( 7 – 4 = 3 ).
Nxiten nxënësit që në grupe të vogla të krijojnë nga një problemë të ngjashme dhe të shkëmbejnë ato në mes grupeve për të gjetur rezultatin.

**Hapi 2:** Nxënësit i krahasojnë numrat e dhënë në detyrën e parë, e më pas tregojnë për sa është më i madh njëri numër se tjetri.

**Hapi 3:** Ftohen nga 3 nxënës para klasës. Njëri nxënës me anë të shiritit numerik të vendosur në dy-



PËR SA ËSHTË NJË NUMËR MË I MADH SE TJETRI?

Ushtrojmë

**1**

4 ☐ 3

Numri 4 është për ___ më i madh se numri 3.

5 ☐ 3

Numri 5 është për ___ më i madh se numri 3.

6 ☐ 3

Numri 6 është për ___ më i madh se numri 3.

**2**

T'i plotësojmë fjalitë:

*a*) Numri 8 është për ___ më i madh se numri 5, sepse 8 − 5 = ___.

*b*) Numri 10 është për ___ më i madh se numri 7, sepse 10 − 7 = ___.

*c*) Numri 9 është për ___ më i madh se numri 4, sepse 9 − 4 = ___.

*d*) Numri 7 është për ___ më i madh se numri 3, sepse 7 − 3 = ___.

**3**

I plotësojmë fjalitë, pastaj ato i paraqesim në boshtin numerik.

*a*) Numri që është për 2 më i madh se 7 është numri ___, sepse 2 + 7 = ___.

+ 2

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

*b*) Numri që është për 2 më i madh se 8 është numri ___, sepse ___ + ___ = ___.

*c*) Numri që është për 2 më i madh se 5 është numri ___, sepse ___ + ___ = ___.

*d*) Numri që është për 2 më i madh se 4 është numri ___, sepse ___ + ___ = ___.

**4**

Blendi ka 7 karamele, kurse shoqja e tij Njomëza ka 5 karamele. Sa karamele ka më shumë Blendi se Njomëza?

Blendi ka 7 karamele

Njomëza ka 5 karamele

☐ − ☐ = ☐

Pra, Blendi ka 2 karamele më shumë se Njomëza.

19

sheme, tregon se cili numër është për 2 më i madh se numri 7. Nxënësi tjetër paraqet me anë të barazimit: 2 + 7 = 9, ndërsa nxënësi i tretë paraqet detyrën në boshtin numerik. Aktiviteti vazhdon me 3 nxënës të tjerë.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të lexojnë problemin dhe të gjejnë zgjidhjen. Pyeten ata:
Sa karamele ka Blendi më shumë se Njomza?
Si e gjejmë?

**AKTIVITET SHTESË**

Nxënësit udhëzohen që në grupe t'i klasifikojnë kapakët e shisheve sipas ngjyrave, më pas t'i numërojnë dhe të krahasojnë se çfarë ka më shumë, dhe për sa më shumë.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të madhësisë së një numri ndaj një tjetri, krahasojnë numrin e sendeve duke njehsuar madhësinë ndaj tjetrit.

**Detyrë:**

Të plotësohet ushtrimi 2 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 104

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.7; II.3,4,8; IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1,3,6; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Për sa është një numër më i vogël se tjetri?

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon me anë të numërimit numrin të vogël;
- Dallon për sa është një numër më i vogël se tjetri;
- Përdor fjalor matematikor për të krahasuar numrat.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirit matematikor, zare, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Pyeten nxënësit: Sa gishtërinj keni në njërën dorë? Po në të dyja duart? Sa gishtërinj keni më pak në njërën dorë sesa në të dyja duart? Si e gjetët? Nxiten nxënësit të përdorin fjalorin matematikor për të llogaritur. P.sh., për të gjetur për sa është një numër më i vogël se tjetri, ne duhet t`i zbresim ata numra. Në këtë rast kemi: **10 – 5 = 5.**
Kërkohet nga nxënësit të marrin shembuj të tjerë për të krahasuar për sa është më e vogël një sasi se tjetra.

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit që në bazë të figurave të detyrës së parë të formojnë një tregim, duke i ndihmuar me pyetjet: Ku ndodhen fëmijët? Sa libra ka Zana? Sa libra ka Dioni? Sa libra ka më pak Dioni



Mësojmë

2. PËR SA ËSHTË NJË NUMËR MË I VOGËL SE TJETRI?

**1**

Zana i ka 9 libra, kurse Dioni 4 libra më pak se Zana.

Zana i ka ___ libra.

Dioni i ka: ___ – ___ = ___ libra.

Themi: Numri 5 është për 4 më i vogël se numri 9, sepse 9 – 4 = 5.

**2**

Numri 5 është për ___ më i vogël se numri 7.

7 – ___ = ___

Numri 4 është për ___ më i vogël se numri 9.

___ – ___ = ___

Numri 3 është për ___ më i vogël se numri 6.

___ – ___ = ___

Numri 4 është për ___ më i vogël se numri 5.

___ – ___ = ___

**3**

T'i plotësojmë fjalitë:

*a*) Numri 5 është për ___ më i vogël se numri 9, sepse 9 – 5 = ___.

*b*) Numri 1 është për ___ më i vogël se numri 6, sepse 6 – 1 = ___.

*c*) Numri 4 është për ___ më i vogël se numri 7, sepse 7 – 4 = ___.

**4**

Disa nga numrat: 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 i radhitni sipas këtyre rregullave:

*a*) Fillojmë nga 9 dhe çdo numër që vjen pas është për 2 më i vogël se numri para tij:

9, 7, ___ , ___, ___.

*b*) Fillojmë nga 10 dhe çdo numër që vjen pas është për 3 më i vogël se numri para tij:

10, 7, ___ , ___ .

20

se Zana? Si shkruhet në gjuhën matematikore?
9 – 4 = 5
Për të zhvilluar imagjinatën dhe fjalorin, pyeten nxënësit: Pse Zana ka më pak libra se Dioni? (Çdo përgjigje është e mirëseardhur).
Plotësohet ushtrimi i parë në libër.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë barazimet duke u bazuar në skemat e detyrës së dytë. Detyra e tretë kërkohet të plotësohet duke i lexuar të dhënat. U jepet ndihmë atyre që kanë vështirësi.

**Hapi 4:** Ftohen 5 nxënës që të renditen në shiritin matematikor, ashtu që i pari të fillojë nga numri 9, pastaj të tjerët nga 2 numra më të vegjël. Kështu fitohet vargu numerik:
9, 7, 5, 3, 2, 1. Detyrën b) e plotësojnë në mënyrë të pavarur.

**AKTIVITET SHTESË**
Ftohen nga 2 nxënës që të rrotullojnë zaret, e më pas të krahasojnë se kush e ka numrin më të vogël, dhe për sa më të vogël.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të madhësisë së një numri ndaj një tjetri, krahasojnë numrin e sendeve duke njehsuar madhësinë ndaj tjetrit.

**Detyrë:**
Të paraqitet në fletore ushtrimi 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 105

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime;
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.7; II.3,4,8; IV.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1,3,6; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Për sa është një numër më i vogël se tjetri?/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson për sa është një numër më i vogël se tjetri;
- Përdor fjalor matematikor për të krahasuar numrat;
- Interpreton ndryshimin e numrave në boshtin numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shiriti matematikor, birila ose shishe plastike, top, gjëra që gjenden përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Ftohen dy nxënës që të dalin para. Kërkohet nga njëri nxënës që të zgjedhë një numër dhe ta shkruajë atë me gisht në kurrizin e shokut. Pyetet nxënësi i dytë: Mund të thuash se cili ishte numri? Cili numër është për një më i vogël se ai numër? Paraqite në tabelë me gjuhën matematikore, p.sh.:

$5 < 6$; $6 - 1 = 5$

Përsëritet veprimtaria me nxënësit e tjerë.
Plotësohet ushtrimi i parë në libër.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fjalitë në ushtrimin e dytë duke treguar për sa është një numër më i vogël se tjetri.



PËR SA ËSHTË NJË NUMËR MË I VOGËL SE TJETRI?

Ushtrojmë

**1**

3 ☐ 4 — Numri 3 është për ___ më i vogël se numri 4.

3 ☐ 5 — Numri 3 është për ___ më i vogël se numri 5.

3 ☐ 6 — Numri 3 është për ___ më i vogël se numri 6.

**2**

T'i plotësojmë fjalitë:

*a*) Numri 6 është për ___ më i vogël se numri 8, kurse numri 2 është për ___ më i vogël se numri 8.

*b*) Numri 3 është për ___ më i vogël se numri 9, kurse numri 6 është për ___më i vogël se numri 9.

**3**

I plotësojmë fjalitë, pastaj ato i paraqesim në boshtin numerik.

*a*) Numri që është për 2 më i vogël se 7 është numri ___, sepse 7 − 2 = ___.



*b*) Numri që është për 2 më i vogël se 8 është numri ___, sepse ___ − ___ = ___.

*c*) Numri që është për 2 më i vogël se 5 është numri ___, sepse ___ − ___ = ___.

*d*) Numri që është për 2 më i vogël se 4 është numri ___, sepse ___ − ___ = ___.

**4**

Petriti i mbolli 9 fidanë, kurse shoku i tij, Sokoli 7 fidanë. Sa fidanë mbolli Sokoli më pak se Petriti?

Njehsojmë: ___ − ___ = ___.

Pra, Sokoli mbolli 2 fidanë më pak se Petriti.

21

**Hapi 3:** Ftohen 2 nxënës që të renditen në shiritin matematikor, ashtu që i pari të jetë te numri 7, ndërsa tjetri për 2 numra më pak. Kërkohet të tregojnë se cili numër është për 2 më i vogël se numri 7. Nxënësi i parë e paraqet me anë të barazimit, nxënësi tjetër e paraqet në boshtin numerik.



Aktiviteti vazhdon edhe me nxënës të tjerë, duke krahasuar numra të ndryshëm, gjithnjë duke përdorur konceptet matematikore: "më i vogël" , "më pak se", "per (sa) më pak se".

**AKTIVITET SHTESË**

Ftohen nga 2 nxënës që të rrotullojnë topin në drejtim të birilave (mund të përdoren shishe plastike). Më pas të krahasojnë se kush ka rrëzuar më pak birila, dhe për sa më pak. Pyeten nxënësit: Sa birila ke rrëzuar? Po shoku/shoqja sa ka rrëzuar? Kush më pak? Për sa më pak? Kërkohet të paraqitet në tabelë me anë të barazimit si ndryshim të numrave.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit për sa është një numër më i vogël se tjetri, përdorimit të fjalorit matematikor për të krahasuar numrat dhe interpretimit në boshtin numerik.

**Detyrë:**

Të plotësohet dhe të paraqitet në fletore ushtrimi 4.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 106

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë; zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.4; III.2; III.4; III.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.1; 3.6; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan numrat më të mëdhenj, më të vegjël se numri i dhënë;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në zgjidhjen e problemave me fjalë;
- Zbulon rregullën për të plotësuar vargjet numerike.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuha amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit njoftohen rreth temës së orës, vlerësimit të tyre me anë të detyrave. U tregohet që do të punohet në mënyrë individuale dhe të pavarur.

**Hapi 2:** Lexohen detyrat duke ua sqaruar kërkesat. Në detyrën 1 shkruhen numrat që janë më të mëdhenj se 6 e më të vegjël se 10. Në detyrën 2 shkruhen numrat e dhjetëshes së parë, në detyrën 3 janë dhënë çmimet e disa lodrave. Duhet të llogaritni se sa do të paguani për blerjen e tyre në shembujt e dhënë. *-Cili veprim duhet përdorur për llogaritje?*
Kalohet në detyrën 4. Nxënësit do të shkruajnë numrat që janë për 2 më të vegjël dhe për 2 më të mëdhenj se numri i dhënë. *–Cili numër është për 2 më i vogël se 7? –Po për 2 më i madh se 7?* Në detyrën 5 u tërhiqet vëmendja që në bazë të barazimit 10 – 4 = 6 të plotësojnë dy barazimet e dhëna.




Lexohet problemi me fjalë në detyrën 6 dhe për ta zgjidhur ndihmohen duke i pyetur: *-Çfarë duhet bërë për të gjetur sa faqe ka tregimi? -Sa faqe ka lexuar Dioni ditën e parë? – Si llogaritet 2 më pak se 6? – Sa faqe ka tregimi?* Në detyrën 7 duhet zbritur nga numri më i madh njëshifror numrin më të vogël çift njëshifror. Në detyrën 8 gjeni rregullën për sa po rriten numrat dhe plotësoni vargjet numerike.
Në detyrën 9 duhet llogaritur se sa euro shpenzoi Rrona për blerje në librari. Nxënësit punojnë të pavarur.

**Hapi 3:** Mblidhen librat për t'i kontrolluar e vlerësuar. Sqarohen vështirësitë që kanë hasur nxënësit gjatë zgjidhjes së detyrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për të shkruarit e numrave më të mëdhenj, më të vegjël se numri i dhënë; për zbatimin e saktë të mbledhjes apo zbritjes në zgjidhjen e detyrave me fjalë, si dhe për gjetjen e rregullës së saktë për plotësimin e vargjeve numerike.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 107

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.2; III.4, IV.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 2.3; 3.1; 3.3; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Edhe matematika është zbavitje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson me figura duke përcaktuar numrin e çdo figure;
- Mbledh saktë dy, tre, katër numra për të fituar një objekt;
- Njehson shumën, ndryshimin e numrave me dy veprime njëkohësisht.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ngjyra druri, etiketa me numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të vërejnë detyrën 1 dhe ta komentojnë. Ndihmohen me pyetje: *-Me çfarë do të njehsojmë në këtë detyrë? -Sa e ka numrin figura në barazimin e parë? –Pse?(2 + 5 = 7). Plotëso në tabelë. Për të njehsuar te barazimi tjetër, çduhet bërë? Nxënësit do të njehsojnë të pavarur. –Sa e ka numrin rrethi te barazimi i fundit? Si e gjetët numrin e rrethit? –Cili është veprimi i kundërt me zbritjen? –Pra: 1 + 5 = 6.* Shkëmbehen librat me shokun e bankës, ku vlerësojnë saktësinë e njehsimit të njëri-tjetrit.

**Hapi 2:** U kërkohet që të vërejnë detyrën 2 dhe të tregojnë se çfarë duhet bërë në të. Fillojnë për të njehsuar shumën e dy, tre, katër numrave të dhënë. Pyeten: *-Si mblidhen tre ose katër numra?*

Sipas shumës së fituar ngjyrosin objektin me ngjyrën e caktuar. Punojnë të pavarur. Njehsojnë një pjesë të shumave të dhëna.




**Hapi 3:** Nxënësit nxiten të formojnë trenin e numrave. Ata marrin nga një numër dhe renditen duke formuar vagonët e trenit.

Kalohet në detyrën 1, në faqen 24 ku nxënësi kryen mbledhjen dhe zbritjen e numrave, si operatorë. *–Çfarë po vëreni?* (fillon dhe mbaron me numrin 1). *Plotësoni çdo vagon me numrin përkatës. – Çfarë fituat?* (vargun numerik nga 1 deri 10).

**Hapi 4:** Vërejnë detyrën 2 dhe përgjigjen në pyetjen: *–Ju pëlqen qeni? –Pse?* U kërkohet që duke njehsuar t'i ndihmojnë qenushët për të gjetur shtëpizat e tyre. Pyeten: *-Te barazimi 2 + 8 – 1 = __, cili veprim kryhet i pari? (mbledhim 2+8=10); –Numrit 10 sa i duhet hequr? (10-1=9).*
Në fund tregojnë se qenushi i parë te cili numër e ka shtëpizën. Kështu vazhdohet edhe për tre të tjerët.

**Hapi 5:** Ngjyrosim figurat në detyrën 3, me ngjyra të caktuara sipas numrit. Pas përfundimit pyeten:*-Çfarë fituat? –Ju pëlqejnë lulet dhe cila lule? –Pse?*

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit njehsojnë me figura duke përcaktuar saktë numrin e çdo figure, njehsojnë saktë shumën me dy, tre apo katër mbledhorë. Po ashtu ata njehsojnë saktë shumën, ndryshimin duke përdorur dy veprime njëkohësisht.

**Detyrë:**
Të punohen barazimet e mbetura të detyrave 2 (në faqen 23) dhe 4 (në faqen 24.)

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 108

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; II.4; III.2; III.4; V. 5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.5; 2.2; 3.3; 3.5; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Zbaton mbledhjen, zbritjen në zgjidhjen e detyrave nga jeta;
- Gjen numrin më të madh, më të vogël se numri i dhënë;
- Orientohet sipas shigjetave për të gjetur rrugën e duhur.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kubi me numra, fletë A4, teli i numrave, kapëse druri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit punojnë në dyshe. Një herë njëri e hedh kubin e numrave dhe sipas numrit që i bie, do të shkruajë të gjitha shumat me dy mbledhorë që japin si rezultat numrin e caktuar. Pastaj e hedh tjetri dhe përsëritet veprimtaria. Kontrollojnë njëri-tjetrin. Fiton nxënësi i cili shkruan më tepër shuma të sakta.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë detyrën 1 dhe të gjejnë shumën. *–Sa kushton ariu? –Sa kushton makina? –Sa kushton libri? –Sa kushtojnë të gjitha së bashku?* Në dy shembuj të tjerë punojnë të pavarur.

**Hapi 3:** Nxënësit krahasojnë numrat duke përdorur telin e numrave, p.sh., për të krahasuar numrin 7




me numrin 4 vendosim kapësen te këta numra, në telin e numrave. *-Për sa është numri 7 më i madh se numri 4? –Për sa është numri 4 më i vogël se numri 7?*

**Hapi 4:** Kalohet në detyrën 2 ku nxënësit udhëzohen të plotësojnë fjalitë. Ata duhet gjetur numrin që është për x më i madh ose më i vogël se numri i dhënë. Punohet në mënyrë individuale. Shkëmbehen librat brenda bankës dhe kontrollojnë saktësinë e kryerjes së detyrës së njëri-tjetrit.

**Hapi 5:** Lexohet problemi në detyrën 3 dhe analizohet me ndihmën e pyetjeve. *–Sa fotografi ka Nora? –Po Toni ka 3 më pak se kush? –Sa fotografi ka Toni?* Nxënësit njehsojnë duke plotësuar barazimin në libër.

**Hapi 6:** Udhëzohen ata që në detyrën 4 të pavarur ta gjejnë rrugën e gjuetarit deri te dreri. *–Si do ta gjeni rrugën e duhur? –Vizatoni shigjeta sipas kahut të dhënë në shirit.*

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit zgjidhin saktë detyrat nga jeta e përditshme, gjejnë saktë numrin më të madh, më të vogël se numri i dhënë, si dhe orientohen saktë për të gjetur rrugën e caktuar.

**Detyrë:**
Shkruani emrat e anëtarëve të familjes dhe e krahasoni numrin e shkronjave të tyre.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 109

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.5.


Mësojmë

VEPRIMI I MBLEDHJES DHE I ZBRITJES - VETITË
1. SHUMA DHE MBLEDHORËT

1

5 + 3 = 8
5 mbledhori i parë; 3 mbledhori i dytë; 8 shuma

Numrat të cilët i mbledhim quhen mbledhorë.
5 + 3 quhet shumë e numrave 5 dhe 3. Shkruajmë 5 + 3 = 8.

2

Të shkruajmë shumën e numrave:
a) 2 dhe 3
2 + 3: Mbledhori i parë është 2, kurse mbledhori i dytë është 3.
b) 3 dhe 6
____ + ____: Mbledhori i parë është ____, kurse mbledhori i dytë është ____.
c) 4 dhe 3
____ + ____: Mbledhori i parë është ____, ndërsa mbledhori i dytë është ____.

*Përshkrimi:*
a) 2 + 3 është shuma e numrave ____ dhe ____. Meqenëse 2 + 3 = ____, themi se numri 5 është shuma e numrave ____ dhe ____.
b) 3 + 6 është shuma e numrave ____ dhe ____. Meqenëse 3 + 6 = ____, themi se numri 9 është shuma e numrave ____ dhe ____.
c) 3 + 4 është shuma e numrave ____ dhe ____. Meqenëse 3 + 4 = ____, themi se numri 7 është shuma e numrave ____ dhe ____.

3

Plotësojmë që të fitojmë barazi të sakta:
a) 2 + ___ = 7 b) 5 + 3 = ___ c) ___ + 6 = 10

*Përshkruajmë me fjalë:*
a) Në barazinë 2 + ___ = 7 mungon mbledhori i dytë 5, sepse 2 + 5 = 7.
b) _____
c) _____

26

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shuma dhe mbledhorët

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë dhe shumën në barazim;
- Përshkruan me shkrim shumën e numrave të dhënë;
- Gjen mbledhorin e parë, të dytin ose shumën që mungon.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza magnetike, vizatimi.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendosen në tabelë disa trekëndorë magnetikë dhe shkruhet shprehja numerike për të treguar se sa petëza janë gjithsej.




Shpjegohet se numrat që mblidhen quhen mbledhorë. Shprehja numerike 4 + 3 quhet shuma e numrave 4 dhe 3 dhe shkruhet 4 + 3 = 7.
Nxënësit përgjigjen në pyetjet:
*Cili është mbledhori i parë?*
*Cili është mbledhori i dytë?*
*Cila është shuma?*



Mësojmë

VEPRIMI I MBLEDHJES DHE I ZBRITJES - VETITË

1. SHUMA DHE MBLEDHORËT

**1**

5 + 3 = 8

5 mbledhori i parë; 3 mbledhori i dytë; 8 shuma

Numrat të cilët i mbledhim quhen mbledhorë.

5 + 3 quhet shumë e numrave 5 dhe 3. Shkruajmë 5 + 3 = 8.

**2**

Të shkruajmë shumën e numrave:

*a)* 2 dhe 3

2 + 3: Mbledhori i parë është 2, kurse mbledhori i dytë është 3.

*b)* 3 dhe 6

____ + ____: Mbledhori i parë është ____, kurse mbledhori i dytë është ____.

*c)* 4 dhe 3

____ + ____: Mbledhori i parë është ____, ndërsa mbledhori i dytë është ____.

*Përshkrimi:*

*a)* 2 + 3 është shuma e numrave ____ dhe ____. Meqenëse 2 + 3 = ____, themi se numri 5 është shuma e numrave ____ dhe ____.

*b)* 3 + 6 është shuma e numrave ____ dhe ____. Meqenëse 3 + 6 = ____, themi se numri 9 është shuma e numrave ____ dhe ____.

*c)* 3 + 4 është shuma e numrave ____ dhe ____. Meqenëse 3 + 4 = ____, themi se numri 7 është shuma e numrave ____ dhe ____.

**3**

Plotësojmë që të fitojmë barazi të sakta:

*a)* 2 + ___ = 7 *b)* 5 + 3 = ___ *c)* ___ + 6 = 10

*Përshkruajmë me fjalë:*

*a)* Në barazinë 2 + ___ = 7 mungon mbledhori i dytë 5, sepse 2 + 5 = 7.

*b)* _____

*c)* _____

26

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen që ta komentojnë detyrën 1 duke dalluar mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë dhe shumën.

**Hapi 3:** Udhëzohen të vëzhgojnë detyrën 2, shembullin nën a) dhe ta komentojnë duke u përgjigjur në pyetjet: *-Si shkruhet shuma e numrave 2 dhe 3? –Cili është mbledhori i parë? –Cili është mbledhori i dytë?* U kërkohet ta përshkruajnë me shkrim duke plotësuar fjalitë me numra përkatës te përshkrimi. Në fund lexohet përshkrimi i shumës së parë nën a).
Ngjashëm do të shkruajnë dhe do të përshkruajnë shumat e dhëna nën b) dhe c).

**Hapi 4:** Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë detyrën 3.

a) 2 + ___ = 7 *-Cili mungon në këtë barazim? –Pse? – Plotëso përshkrimin me fjalë në libër.*
b) 5 + 3 = __ *-Cili mungon në këtë barazim? –Pse? – Plotëso përshkrimin me fjalë.*
c) __ + 6 = 10 *-Cili mungon në këtë barazim? –Pse? – Plotëso përshkrimin me fjalë.*

Librat shkëmbehen me shokun e bankës ku kontrollohet plotësimi i barazimit dhe i përshkrimit të tij me fjalë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit dallojnë dhe përshkruajnë saktë me shkrim mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë dhe shumën. Po ashtu ata gjejnë saktë mbledhorët apo shumën që mungon.

**Detyrë:**
Shkruani shumën e dy numrave sipas dëshirës dhe e përshkruani me fjalë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 110

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.3; III.4; III.5, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.3;3.1; 3.3; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Shuma dhe mbledhorët/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë dhe shumën;
- Shkruan saktë shumën e mbledhorëve të dhënë;
- Gjen mbledhorin e parë, të dytin apo shumën që mungon duke e përshkruar me shkrim.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Zare, fletore, etiketa me fjali.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit punojnë dyshe. Secila dyshe ka një zar. Një herë e hedh zarin njëri, e pastaj tjetri nxënës. Numrat e rënë shkruhen nga të dytë në fletore, si shumë e numrave. Pyesin njëri-tjetrin se cili është mbledhori i parë, mbledhori i dytë dhe shuma në barazimin e shkruar. Me këtë rast vlerësojnë njëri – tjetrin. Udhëzohen të komentojnë ngjashëm detyrën 1. *–Sa është shuma e numrave 4 + 5? –Shkruaje.*

**Hapi 2:** Udhëzohen nxënësit të plotësojnë barazimet në tre shembujt e dhënë, në detyrën 2. Në fund i lexojnë me zë.

**Hapi 3:** Vendosen në tabelë etiketa me fjali në mënyrë të çrregullt. Nxënësit i vendosin me radhë duke formuar një detyrë me fjalë. Lexohet dhe zgjidhet. Detyra mund të jetë kjo: Anita kishte 5 kapëse


SHUMA DHE MBLEDHORËT

Ushtrojmë

1

mbledhori i parë | mbledhori i dytë | shuma

4 + 5 = ___

2

*a*) Nëse mbledhori i parë është 4, kurse i dyti 3, shuma është: ___ + ___ = ___.

*b*) Nëse mbledhori i dytë është 3, kurse i pari 7, shuma është: ___ + ___ = ___.

*c*) Nëse mbledhori i parë është 5, kurse i dyti 4, shuma është: ___ + ___ = ___.

3

Në pjatë ishin 4 mollë. Nëna më vonë i solli edhe 3 mollë. Sa mollë janë në pjatë?

Në pjatë janë: ___ + ___ = ___ mollë.

4

Plotësojmë për të fituar barazi të sakta:

*a*) 3 + ___ = 7 *b*) 6 + 4 = ___ *c*) ___ + 7 = 9

Me fjalë:

*a*) Mungon mbledhori i _____ dhe ai është ____.

*b*) Mungon shuma dhe ajo është ____.

*c*) Mungon mbledhori i _____ dhe ai është ____.

5

| Mbledhori i parë | 3 | 2 | 5 | 1 | 3 |
|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhori i dytë | 7 | 5 | 4 | 8 | 2 |
| Shuma | | | | | |

| Mbledhori i parë | 2 | | 5 | 1 | 4 |
|---|---|---|---|---|---|
| Mbledhori i dytë | | 2 | | 7 | 2 |
| Shuma | 10 | 7 | 9 | | |

27

flokësh. Shoqja ia solli edhe 2 kapëse. Sa kapëse flokësh kishte gjithsej? -Si mund ta zgjidhim? Njëri nxënës shkruan në tabelë: 5 + 2 = 7; *Cili është mbledhori i parë? –Cili është mbledhori i dytë? –Cila është shuma?*

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur në detyrën 4. Ata plotësojnë për të fituar barazi të saktë dhe përshkruajnë me fjalë se çfarë mungon në çdo shembull. Pas plotësimit, secili nxënës brenda dyshes, e komenton me fjalë nga një shembull.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen që të shkruajnë mbledhorin e dytë, të parin apo shumën që mungon. Pas plotësimit shkëmbehen librat me shokun e bankës dhe kontrollohet saktësia e njëri-tjetrit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit identifikojnë saktë mbledhorin e parë, të dytin dhe shumën; shkruajnë saktë shumën e dy mbledhorëve të dhënë, gjejnë mbledhorin e parë, të dytin apo shumën që mungon duke e përshkruar me shkrim.

**Detyrë:**

Të punohet detyra 3 dhe plotësohet shuma në shtëpinë e parë të detyrës 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 111

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,8; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2; 2.1; 3.1,4,5; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e zbritjes;
- Gjen ndryshimin e numrave;
- Krijon detyra me zbritje.


Mësojmë
2. I ZBRITSHMI, ZBRITËSI DHE NDRYSHIMI
1
6 i zbritshmi – 2 zbritësi = 4 ndryshimi
Numri 6 quhet i zbritshmi, kurse numri 2 quhet zbritës.
6 – 2 quhet ndryshimi i numrave 6 dhe 2. Shkruajmë 6 – 2 = 4.
2
Shkruani ndryshimin e numrave:
a) 5 dhe 2.
___ – ___: I zbritshmi është ___, zbritësi është ___ dhe ndryshimi është ___.
b) 8 dhe 1.
___ – ___: I zbritshmi është ___, zbritësi është ___ dhe ndryshimi është ___.
c) 7 dhe 7
___ – ___: I zbritshmi është ___, zbritësi është ___ dhe ndryshimi është ___.
Përshkrimi:
a) 5 – 2 është ndryshimi i numrave ___ dhe ___. Meqenëse 5 – 2 = ___, themi se numri 3 është ndryshimi i numrave ___ dhe ___.
b) ___
c) ___
3
Plotësojmë dhe lexojmë:
a) 9 – 3 = ___ b) 7 – 4 = ___ c) 10 – 7 = ___.
Lexojmë:
a) Ndryshimi i numrave 9 dhe 3 shënohet _____ dhe është numri ___.
b) Ndryshimi i numrave 7 dhe 4 shënohet _____ dhe është numri ___.
c) Ndryshimi i numrave 10 dhe 7 shënohet _____ dhe është numri ___.
28

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, shufra, kube, fletë të printuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxirren dhjetë nxënës përpara tabelës. Pyeten të tjerët: Sa nxënës janë këtu? (10); Nëse katër nxënës kthehen në vendet e tyre, sa nxënës mbesin këtu? (6). Paraqiten pastaj numrat në tabelë.

10 – 4 = 6. Shkruhet në tabelë për secilin numër si emërtohet kur zbresim. Numri 10 në këtë rast është i zbritshmi, numri 4 është zbritësi, ndërsa numri 6 është ndryshimi.

**Hapi 2:** Paraqiten përmes projektorit pamje të zbritjes të ilustruara me pemë ose me figura të tjera. Për secilin numër paraqitet edhe emërtimi i tij. Përsëritet disa herë, por vetëm se ndërrohen figurat dhe numrat në mënyrë që nxënësit të familjarizohen me këta terma.







**Hapi 3:** Shpërndahen në grupe shufra e kube. Kërkohet nga nxënësit të ndërtojnë nga dy kulla me to. Numërojnë sa shufra e kube janë dhe zbresin me shufrat e kubet e kullës tjetër.

**Hapi 4:** Nxënësit i emërtojnë kufizat e barazimeve të dhëna në detyrën 1. Lexojnë detyrën 2, e zgjidhin atë. Më pas tregojnë cila është zgjidhja e detyrës.

**Hapi 5:** Paraqiten në tabelë shprehjet: a) 9 – 3 =_____ b) 7 – 4 = _____ etj. Dalin nxënësit te tabela, kryejnë veprimet dhe lexojnë shprehjet, p.sh.: ndryshimi i numrave 9 dhe 3 është numri 6.

**Hapi 6:** Shpërndahen fletët e printuara ku është paraqitur vetëm një detyrë si kjo në foto.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| I zbritshmi | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| Zbritësi | 2 | 3 | 4 | 0 | 2 |
| Ndryshimi | | | | | |

Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë detyrën për 5 minuta.
Puna e nxënësit kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, për emërtimin e kufizave të zbritjes dhe llogaritjen e ndryshimit të numrave.

**Detyrë:**
Shkruani në fletore pesë barazime me zbritje.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 112

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,8; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2; 2.1; 3.1,4,5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** I zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e zbritjes;
- Gjen ndryshimin e numrave;
- Krijon detyra me zbritje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, shufra, kube, lapsa, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten para nxënësve pamje ku shihet një shportë mollë. Pyeten nxënësit: Nëse marrim një mollë, sa mollë mbesin në shportë?
Merren përgjigjet e nxënësve dhe paraqiten numrat në tabelë duke përsëritur shprehjet i zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi.




**Hapi 2:** Kërkohet nga nxënësit që me lapsat e tyre me ngjyra të formojnë detyra me zbritje. Puna realizohet në çifte. Nxënësit pastaj i lexojnë shprehjet që kanë krijuar duke theksuar kufizat e zbritjes, p.sh., 6 – 2 = 4 , i zbritshmi është 6, zbritësi është 2, ndërsa ndryshimin e kemi 4. Të gjitha çiftet në klasë e prezantojnë punën e tyre.




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të shikojnë detyrën 1 në libër, një nxënës tregon me fjalë pamjet që sheh aty. Paraqitet me numra shprehja në tabelë duke treguar cili numër është i zbritshmi, zbritësi dhe ndryshimi.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të shkruajnë dhe të njehsojnë ndryshimin e numrave të dhënë. Detyra punohet në mënyrë individuale.



**Hapi 5:** Nxënësit nxiten të lexojnë detyrën 3 në libër e cila paraqitet me fjalë. Ata e lexojnë dhe paraqesin si veprim të zbritjes numrat. Në detyrën 4 nxënësit i plotësojnë katrorët e zbrazët duke krijuar vetë veprimin e zbritjes.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 5 në libër duke u bazuar në ngjyrat e petaleve të lules, ku diku mugon i zbritshmi e diku mungon zbritësi. Nxënësit i gjejnë duke i theksuar me fjalë, pastaj i paraqesin veprimet edhe ne fletore.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim; për emërtimin e kufizave të zbritjes dhe llogaritjen e ndryshimit të numrave.

**Detyrë:**
Shkruani në fletore 4 detyra të ngjashme me detyrën 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 113

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,8; III.1, 2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4,5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e mbledhjes;
- Ndërron vendin e mbledhorëve në barazimet e dhëna;
- Shpjegon me fjalë të thjeshta vetinë e ndërrimit të vendit të mbledhorëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Projektori, mjete mësimore, lodra të sjella nga shtëpia etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxirren disa nxënës te tabela. Dalin katër vajza, pastaj edhe tre djem. Pyeten nxënësit: Sa nxënës janë gjithsej? (7 nxënës). Paraqitet shprehja edhe në tabelë 4 + 3 = 7.

U ndërrohen vendet vajzave dhe djemve. Pyeten nxënësit: Sa nxënës janë tani? 3 + 4 = 7.

A ndryshoi shuma pasi ndërruan vendet nxënësit? (Jo). Kur mbledhorët i ndërrojnë vendet, shuma nuk ndryshon.

**Hapi 2:** Përmes projektorit shfaqen para nxënësve pamje ku janë paraqitur ndërrimet e vendeve të mble-dhorëve përmes figurave të peshqve. Pyeten nxënësit: Sa është mbledhori i parë? (4); Sa është




mbledhori i dytë? (2); Po shuma? (6). U ndërrohet pastaj vendi mbledhorëve.




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të shikojnë me vëmendje pamjet në detyrat 1 dhe 2 në libër. Vërejnë se si u janë ndërruar vendet mbledhorëve. Paraqiten shembuj të ndërrimit të mbledhorëve edhe në tabelë, një herë me figura, pastaj edhe me numra.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet t'i zgjidhin detyrat 3 dhe 4 e më pas t'i arsyetojnë zgjidhjet e tyre.

**Hapi 5:** Nxënësit punojnë individualisht detyrat 5 dhe 6. E krahasojnë pastaj punën e tyre me shokun apo shoqen e bankës.

**AKTIVITET SHTESË**

Vendoset para nxënësve një bankë ku janë renditur sende të ndryshme, p.sh.: 3 libra dhe 2 fletore. Ftohen nxënësit të dalin përballë njëri-tjetrit. Ata do të shkruajnë në një fletë barazimin ashtu si i shohin mjetet mësimore. Përsëritet aktiviteti disa herë, edhe me lodrat që kanë sjellë fëmijët nga shtëpia.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete, për emërtimin e kufizave të mbledhjes dhe ndërrimin e vendeve të mbledhorëve.

**Detyrë:**

Në shtëpi punoni detyrat 8 dhe 9 që janë në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 114

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,8; III.1, 2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,4,5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e mbledhjes.
- Ndërron vendin e mbledhorëve në barazimet e dhëna
- Shpjegon me fjalë të thjeshta vetinë e ndërrimit të vendit të mbledhorëve

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** molla, topa me ngjyra, fletë pune etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Merret një tavolinë më e madhe dhe vendoset para nxënësve. Në të vendosen 6 mollë të kuqe dhe 3 mollë të verdha. Ftohen dy nxënës dhe ulen ballë për ballë me njëri-tjetrin. Pyeten nxënësit për mollët që shohin nga pozita e tyre ku janë ulur. Nxënësi i parë thotë: Unë po shoh 6 mollë të kuqe dhe 3 mollë të verdha. Nxënësi tjetër thotë: Unë po shoh 3 mollë të verdha dhe 6 mollë të kuqe. Paraqiten në tabelë numrat që i thonë dy nxënësit që ndodhen te tabela, 6 + 3 = 9 dhe 3 + 6 = 9. Nxënësit e thonë me fjalë që këtu kemi ndërrim të vendeve të mbledhorëve, shuma është e njëjtë.

**Hapi 2:** U shpërndahen nxënësve topa me ngjyrë të kaltër dhe të gjelbër. Në çifte nxënësit krijojnë mbledhorë duke përdorur topat me ngjyra. Ua ndërrojnë vendet mbledhorëve dhe llogaritin shumën. Nxiten nxënësit të prezantojnë punën e tyre dhe të emërtojnë kufizat e mbledhjes: Mbledhori i parë,




mbledhori i dytë, shuma.
Gjithashtu përmendin shprehjen *ndërrim i vendeve të mbledhorëve.*




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat në libër. Në detyrën 2 gjejnë shumën e numrave nga mbledhorët që u janë ndërruar vendet. Pastaj në detyrën 3 përcaktojnë mbledhorët, gjejnë shumën e numrave dhe emërtojnë kufizat e mbledhjes.

**Hapi 4:** Punohet detyra 4 në libër duke dalluar mbledhorët sipas ngjyrës. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, pastaj argumentojnë me fjalë detyrat.

**Hapi 5:** Në detyrën 5 nxënësit gjejnë shumën e numrave të paraqitur përmes parave, gjithashtu ua ndërrojnë vendet mbledhorëve dhe emërtojnë kufizat e mbledhjes.

**Hapi 6:** U shpërndahet nxënësve fleta e punës.(të cilën mund ta merrni këtu). Nxënësit punojnë në mënyrë individuale duke gjetur shumën e numrave të cilëve u ndërrohen vendet.



Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mbledhjen e numrave, për emërtimin e kufizave të mbledhjes dhe ndërrimin e vendeve të mbledhorëve dhe shpjegimin e tyre.

**Detyrë:**
Në fletoret e tyre të punohen 4 detyra të ngjashme me detyrën 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 115

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,8; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1, 3.1,4; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lidhja në mes mbledhjes dhe zbritjes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes;
- Kryen veprime me zbritje si veprim i kundërt i mbledhjes;
- Zgjidh problema të thjeshta dhe argumenton me fjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Letra me ngjyra, projektor, copëza letre, fletë pune etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




**Hapi 1:** Formohen grupet me nxënës. Shpërndahet në grupe figura e mollëkuqes ku është paraqitur lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes përmes pikave të zeza.
Pyeten nxënësit:
- Sa pika ka njëra anë e mollëkuqes?
- (3); Sa pika ka ana tjetër? (4); Sa pika janë gjithsej?
- (7); Po nëse nga shuma i largojmë 3 pika?
- (4); Nëse i largojmë 4 pika? (3).

U tregohet nxënësve që zbritja është veprim i kundërt i mbledhjes: 3 + 4 =7, 7 – 4 = 3

**Hapi 2:** Shpërndahen në grupe copëzat me letra ku janë të përfshirë numra që formojnë shuma të






ndryshme. Nxënësit shikojnë numrat te trekëndëshi, i gjejnë copëzat që përmbajnë ata numra dhe paraqesin lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet pamjet nga detyra 1. U sqarohet nxënësve lidhja ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes. Në tabelë u shfaqen edhe shembujt që e demonstrojnë këtë lidhje, p.sh.: 3 + 3 = 6, 6 – 3 = 3. Nxënësit i plotësojnë vetë dy detyrat e tjera.

**Hapi 4:** Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë detyrën 2 duke krijuar problema me fjalë nga figurat e dhëna dhe bëjnë zgjidhjet e tyre. Nxiten ata të thonë se mbledhja dhe zbritja janë të lidhura mes vete.




**Hapi 5:** Nxënësit punojnë në çifte. Njëri shkruan një barazim me mbledhje, tjetri e kthen atë barazim në zbritje. Me pas ndërrohen rolet. Disa çifte e prezantojnë punën e tyre.

**Hapi 6:** U shpërndahet nxënësve fleta e punës (të cilën mund ta merrni këtu).
Ata punojnë në mënyrë individuale duke zbatuar lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mbledhjen dhe zbritjen e numrave si veprim i kundërt ndaj njëri-tjetrit dhe argumentimin e lildhjes ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes, si dhe zgjidhjen e tyre.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 3, faqe 33, në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 116

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2; III.2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1,3.1,4,5. 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Lidhja në mes mbledhjes dhe zbritjes/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon lidhjen reciproke mes mbledhjes dhe zbritjes;
- Kryen veprime me zbritjen si veprim i kundërt i mbledhjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ilustrime, etiketa me numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet para nxënësve një ilustrim, ku shihen disa zogj. Komentohet duke i pyetur:

- *Sa zogj janë gjithsej në foto? (6)*
- *Si mund ta shprehim si veprim matematikor?* **4 + 2 = 6**
- *Si quhet numri i parë, i dytë dhe i tretë? mbledhori i parë mbledhori i dytë shuma*
- *A mund ta paraqesim ndryshe?* ***2 + 4 = 6*** (vërehet vetia e ndërrimit)
- *Nëse nga shuma heqim njërin mbledhor, çfarë do të fitojmë?* 6 - 4= 2 dhe 6 - 2=4



Kështu arrihet në përfundim se ekziston lidhja midis mbledhjes dhe zbritjes.
**Hapi 2:** Analizohet detyra e parë në libër dhe përshkruhet.




- Çfarë po shihni në gjethe? Tre numra 6, 5 dhe 4.
- Sa rrathë me ngjyrë të kaltër, e sa rrathë me ngjyrë të kuqe po i mban lepurushi? 5 rrathë të kaltër e 4 të kuq.

Mbi bazën e katër shembujve me numrat 6, 5 dhe 4 nxënësit do të dallojnë lidhjen mes mbledhjes dhe zbritjes. Plotësohen barazimet në dyshe. Në fund një nga dyshet lexon barazimet me mbledhje, tjetri me zbritje.
Ngjashëm plotësohet edhe detyra 2.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë detyrën 3, të krijojnë një problemë me fjalë dhe t'i zgjidhin barazimet. Vlerësohet puna e tyre.

**Hapi 4:** Rikujtohet veprimi me operatorë duke u bazuar në ilustrimin e paraqitur në fillim të orës.

- *Nga e ka drejtimin shigjeta?* Pra, nga gjashtë i heqim 2, mbesin 4.
- *Si duhet vepruar poshtë?* Kryhet veprim i kundërt me mbledhje 4 + 2 = 6.

Duke u bazuar në shembullin e dhënë, nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur katër shembuj të detyrës 4. Vlerësohet puna e tyre.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete; për kthimin e saktë të barazimeve me mbledhje në barazime me zbritje.

**Detyrë:**
Plotësoni tre shembujt e tjerë në ushtrimin 4.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 117

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,7; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.1,4; 4.2, 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbërthimi i numrave në mbledhorë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton numrin si shumë e dy mbledhorëve;
- Zgjidh situata problemore me veprimin e mbledhjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube, fletëza të përgatitura, letrat me ngjitëse, petëzat.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bëhet përsëritje e shkurtër e njohurive të marra nga orët e kaluara lidhur me veprimin e mbledhjes.
Pastaj nxënësve u shpërndahen kubet dhe fletëzat e përgatitura. Nxiten të ndajnë 6 kube në dy grupe (mbledhorë), në më shumë mënyra. Të gjitha ndarjet paraqiten në tabelë.









**Hapi 2:** Modeli i detyrës 1 paraqitet në tabelë. Ftohen me radhë nga dy nxënës, njëri t'i vendosë letrat e vogla me ngjitëse e tjetri të shkruajë barazimin në tabelë. Nxënësit punojnë në libër në mënyrë të pavarur.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të nxjerrin mbi bankë 10 petëza dhe të vëzhgojnë detyrën 2. Pyeten:–*Çfarë po shihni?-Sa rrathë me ngjyrë portokalli janë në anën e majtë?- Çfarë do të bëjmë me katrorët? (ndahen në dy grupe); - Në grupin e parë vendosim 0 rrathë, ndërsa në grupin e dytë dhjetë rrathë. Cilin numër e kemi fituar?(10); - Po nëse vendosim në grupin e parë një rreth, sa rrathë duhet të vendosim në grupin e dytë?(9).* Nxënësit me ndihmën e petëzave i gjejnë të gjitha zgjidhjet. Plotësojnë detyrat 3 dhe 4 dhe e krahasojnë punën me shokun.

**Hapi 4:** Analizohet detyra 5 përmes pyetjeve. - Çfarë po bëjnë fëmijët? (Po dekorojnë bredhin e Vitit të Ri); Çfarë po vendosin në bredh? (Po vendosin topa zbukurues); – Sa topa kanë gjithsej fëmijët? (9 topa); Katër topa i ka vendosur Era (1 të kuq dhe 3 të bardhë), ndërsa 5 topa Arti (2 të gjelbër dhe 3 të bardhë). Duke zbatuar diagramin plotësohet barazimi në libër.

**Hapi 5:** Nxënësve u lexohet një problemë. *"Babai bleu 5 fletore për Ermalin dhe Dean. Tregoni se si babai mund t'i ndajë fletoret"*. Udhëzohen të punojnë në mënyrë të pavarur. Saktësia e tyre vlerësohet.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në zgjidhjen e situatave problemore dhe për zbërthimin e saktë të numrit në dy mbledhorë.

**Detyrë:**
Të punohen detyrat 6 dhe 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 118

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,7; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1.2; 2.1; 3.1,4; 4.2, 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbërthimi i numrave në mbledhorë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen mbledhorët që formojnë një numër;
- Zbërthen numrin si shumë e dy dhe tre mbledhorëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube, fletëza të përgatitura, letrat me ngjitëse, petëzat.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bëhet përsëritje e shkurtër e njohurive të marra nga ora e kaluar. Kërkohet nga nxënësit të zbërthejnë numrin 8 në mbledhorë. Plotësohet skema në tabelë dhe lexohen barazimet.






**Hapi 2:** Komentohet shembulli i parë i detyrës 1. – *Sa rrathë të kuq kemi?*(10); - *Cili numër është vendosur në tabelë?* (10);
- *Çfarë duhet të gjejmë?* (Sa rrathë dhe sa numra mungojnë).
Në rreshtin e dytë mungojnë rrathët të cilët e paraqesin mbledhorin e parë. – *Sa rrathë duhet t'i vendosim në katrorin e parë?* (6 rrathë); -*Sa do të jetë mbledhori i parë?*(6); *Pse?* (Sepse 6+4=10)
Nxënësit i vizatojnë rrathët që mungojnë dhe gjejnë mbledhorin e duhur. Lexohen barazimet.

**Hapi 3:** Modeli i detyrës 2 paraqitet në tabelë. Ftohen nxënësit t'i vendosin mbledhorët e duhur në katrorët e zbrazët që të zbërthejnë numrin 7 dhe 10. – *Nëse mbledhori i parë është 2, sa do të jetë mbledhori i dytë që të fitojmë numrin 7?*(5)
Nxënësit i vendosin etiketat dhe i lexojnë barazimet.
Ndërkohë e plotësojnë librin.




**Hapi 4:** Jepen sqarimet e duhura rreth detyrës 3 në libër, ku nxënësit do të zbërthejnë numrin 10 si shumë e tre mbledhorëve. Shembulli i parë paraqitet në tabelë, ndërsa tre shembujt e tjerë punohen në mënyrë të pavarur. Vlerësohet saktësia e tyre.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete; gjetjen e mbledhorëve të duhur që formojnë një numër dhe zbërthimin e numrit në dy dhe tre mbledhorë.

**Detyrë:**
Të plotësohet shembulli i dytë në detyrën 1 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 119

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;2.1;3.1,4; 4.2, 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen vlerën numerike të shprehjeve;
- Shkruan barazi duke interpretuar mbledhjen dhe zbritjen në boshtin numerik;
- Zgjidh situatë problemore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numra, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet një problemë: *"Rina ka 5 lule, Blini ia dha asaj edhe 2 lule. Sa lule ka Rina?"* Kërkohet nga nxënësit të punojnë në dyshe, të shkruajnë barazimin dhe të gjejnë zgjidhjen. Një dyshe e nxënësve paraqet zgjidhjen në tabelë. Pyeten nxënësit: *Nga 7 lule sa kishte Rina, 5 lule u vyshkën. Sa lule i mbetën Rinës? (2); Si e gjetët?* Shkruhet barazimi në tabelë dhe emërtohen kufizat.






**Hapi 2:** Në tabelë vendosen katër etiketa me numrat:

| 6 | 8 | 5 | 7 |
|---|---|---|---|

Nxënësve në grupe u shpërndahen disa fletë me shprehje numerike si në detyrën 1. Prej tyre kërkohet të gjejnë vlerën e shprehjes numerike duke zbatuar veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes. Në fund, përfaqësuesi i grupit e vendos etiketën në tabelë afër numrit që tregon zgjidhjen dhe lexon barazimin para klasës. Njëjtë veprohet me të gjitha grupet. Nxënësit ngjyrosin drejtkëndëshat në libër me ngjyrën përkatëse të kutive.

**Hapi 3:** Lexohet problema e detyrës 2. Në bazë të të dhënave të detyrës nxënësit gjejnë zgjidhjen. Një nxënës vullnetar e tregon zgjidhjen e detyrës. Nxitet të thotë: "*Sarës i mbeti një balonë*".

**Hapi 4:** Kërkohet nga nxënësit ta analizojnë figurën e detyrës 3. Pyeten: -*Çfarë po shihni?* (një bosht numerik); - *Nga cili numër niset shigjeta e kuqe?; -Te cili numër arrin?; - Po shigjeta e kaltër, nga cili numër fillon dhe ku arrin?*

Nxënësit punojnë të pavarur, shkruajnë barazi duke u bazuar në interpretimet në boshtin numerik. Vlerësohet puna e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim, gjetjen e saktë të vlerës së shprehjes numerike dhe shkrimin e saktë të barazive të interpretimeve në boshtin numerik.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 120

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.4; III.2;III.4; III.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.2; 3.1,6; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krahason numrin e katrorëve, të rrathëve dhe të segmenteve;
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave;
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë;
- Zgjidh situata të thjeshta problemore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit njoftohen me temën që do të zhvillohet dhe shkruhet në tabelë. Kërkohet nga nxënësit t'u përmbahen rregullave të caktuara gjatë punimit të kërkesave për vlerësimin e njohurive dhe të punojnë në mënyrë të pavarur. Për çdo paqartësi mund të kërkojnë ndihmë.

**Hapi 2:** Ftohen nxënësit të lexojnë kërkesën e detyrës së parë dhe të shpjegojnë se çfarë po kërkohet. Nëse hasin në vështrësi u sqarohet se duhet të gjejnë sa katrorë ka më shumë në rreshtin e dytë se në




rreshtin e parë. Sqarohen kërkesat e detyrave të parashtruara për vlerësim të njohurive.
Detyra 2: Krahason numrin e segmenteve me numrin e rrathëve.
Detyra 3: Gjen shumën e numrave dhe përcakton mbledhorin e parë, të dytë dhe shumën.
Detyra 4: Gjen ndryshimin e numrave dhe përcakton të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin.
Detyra 5: Ua ndërron vendet mbledhorëve dhe gjen shumën.
Detyra 6: Zbërthen numrin 10 si shumë e dy mbledhorëve.
Detyra 7: Zgjidh problemën në bazë të të dhënave.
Detyra 8: Plotëson rrathët e zbrazët në kërmill duke njehsuar.

**Hapi 3:** Mblidhen librat për t'u vlerësuar. Diskutohet me nxënësit për vështirësitë që kishin hasur gjatë zgjidhjes së detyrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit krahasojnë saktë numrin e katrorëve, të rrathëve dhe të segmenteve; përcaktojnë saktë mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshimin, zbritësin dhe ndryshimin, si dhe gjejnë shumën dhe ndryshimin e numrave dhe zgjidh situata të thjeshta problemore.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 121

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron në rendin rritës numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.1; V.5 ; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 3.1,5,6; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat deri në 20

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Radhit vargun e numrave nga 1 – 20;
- Emërton njëshet dhe dhjetëshet e numrave të dhënë;
- Shkruan vargun e numrave nga 1 – 20.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Komplet matematikor (kube dhe shufra), gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Formohen grupet e nxënësve dhe secilit grup u shpërndahen nga 10 kube nga kompleti matematikor. Kërkohet që t`i bashkojnë në një vend.



Me bashkimin e kubeve, formohet shufra që në matematikë paraqet dhjetëshet.
10 kube = 1 shufër
10 njëshe = 1 dhjetëshe
10 Nj = 1 Dh






**Hapi 2:** Së bashku me nxënësit lexohet detyra 1, duke ia shtuar shufrës nga një kub, formohet numri njëmbëdhjetë, e me radhë. Udhëzohen nxënësit të dallojnë që
1 shufër + 10 kube = 2 shufra
1 dhjetëshe + 10 njëshe = 20 njëshe
1 Dh + 10 Nj = 20 Nj
Lexohet secili numër, duke treguar sa njëshe e dhjetëshe kanë.



**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë vargun e numrave nga 1 - 20, të dhënë në detyrën 2. Lexohet detyra 3 duke përmendur dhjetëshet dhe njëshet.

**Hapi 4 :** Paraqiten në tabelë 2 diagramet. Nxënësit i lidhin me anë të shigjetës numrat me numërorët.




## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e renditjes dhe shkrimit të numrave nga 1 - 20, emërtimit të njësheve dhe dhjetësheve në numrat e dhënë.

**Detyrë:**
Të shkruhen numrat nga 1 - 20 dhe të vizatohen për secilin numër sa kube e shufra ka.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 122

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron në rendin rritës numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.1; V.5; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 3.1,5,6; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat prej 11 deri në 20

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës numrat nga 1 deri në 20;
- Shkruan numërorët nga 0 – 20;
- Ndan numrat dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Komplet matematikor (kube dhe shufra), gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** U shpërndahen nxënësve në grupe, nga 1 shufër dhe 10 kube prej kompletit matematikor. Ata do ta ndërtojnë kullën ku secili nxënës shton një kub më shumë mbi shufër dhe thotë emrin e numrit derisa të arrijnë te numri 20. (“dhjetë dhe një” (11), “dhjetë dhe dy” (12); “dy dhjetëshe”, bëjnë 20). Më pas fillojnë duke hequr nga një kub duke numëruar nga 20 deri te 10.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe. Shkruhet numri në tabelë, njëri nxënës do të tregojë me gishta numrin e dhjetësheve, ndërsa tjetri numrin e njësheve. Për numrin 16 njëri tregon 10 gishtërinj, ndërsa tjetri 6 gishtërinj. Shkruajnë në tabelë barazimin: 10 + 6 = 16. Më pas duhet të ndërtojnë një kullë




me 1 shufër dhe 6 kube. Përsëritet aktiviteti deri te numri 20. Nxiten nxënësit që për secilin numër të thonë: "Numri 11 ka një shufër dhe 1 kub". Pyeten ata se çka ndryshon numri 10 me numrin 6? Numri 6 është numër njëshifror se ka një shifër si edhe numrat 0,1,2,3,4,5,7,8,9, dhe duhet të shkruhen në një katror të fletores. Ndërsa 10 është numër dyshifror se ka dy shifra, si: 11, 12.... 20 dhe duhet të shkruhen në dy katrorë të fletores.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen në formimin e dhjetësheve dhe njësheve duke organizuar aktivitetin me lapsa si në figurën e detyrës 1. Rëndësi ka drejtshqiptimi si dhe drejtshkrimi i numërorëve. Detyrat 2 dhe 3 paraqiten në tabelë, nxënësit plotësojnë në libër.

**Hapi 4:** Paraqitet detyra 4 në tabelë, ftohen disa nxënës të zgjidhin. Së pari thonë me gojë zgjidhjen, pastaj i plotësojnë barazimet.

17 =1 Dh + 7 Nj

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e numërimit në rendin rritës dhe zbritës numrat nga 1 deri 20, shkrimit të numërorëve nga 0 - 20 dhe ndarjen e saktë e numrave dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe.

**Detyrë:**

Të shkruhen me radhë numrat dhe emërtimet e tyre nga 10 deri në 20.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 123

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Numëron në rendin rritës numrat nga 1 deri në 20;
- Demonstron të kuptuarit e numrit përmes shoqërimit me objekte/vizatime.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.1; III.1; V.5; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 3.1,5,6; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat prej 11 deri në 20/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës numrat nga 1 deri në 20;
- Ndan numrat dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe;
- Gjen pasardhësin e numrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa, komplet matematikor (kube dhe shufra), gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** U shpërndahen nxënësve në grupe etiketa të zbrazëta. Udhëzohen ata të plotësojnë etiketat me numra nga 11 deri në 20, e pastaj t`i renditin. Kërkohet që t`i lexojnë me zë numrat e renditur në rendin rritës dhe rendin zbritës. Theks të veçantë i kushtohet drejtshqiptimit të numrave.

**Hapi 2:** Nxënësit analizojnë detyrën e parë. Tregojnë se cilët numra mungojnë, pastaj plotësojnë vendet e zbrazëta me numrat përkatës. Detyrën e dytë nxënësit e plotësojnë në mënyrë të pavarur, duke numëruar figurat përkatëse.




**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet që duke u bazuar në etiketat e renditura më parë, t'i plotësojnë detyrat 3 dhe 4. Udhëzohen që të kenë kujdes me vargjet numerike, së pari në rendin zbritës, e më pas në rendin rritës. Më pas detyra rishikohet në dyshe.

**Hapi 4:** Nxënësit këshillohen që të përdorin mjetet e konkretizimit më të përshtatshme për ta (numëratore, petëza, fasule, etiketa), që të gjejnë pasardhësin e numrave të dhënë në detyrë. Ftohen disa nxënës që të plotësojnë detyrat e paraqitura në tabelë, duke u bazuar në detyrën e 5, por me numra të tjerë.

8 ,  13 ,

9  19

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen që duke u bazuar në figura të plotësojnë detyrën 6, duke treguar sa dhjetëshe dhe njëshe ka secili numër. Detyra 7 plotësohet duke bashkuar numra, e më pas duke ngjyrosur figurën e fituar sipas dëshirës. Puna e nxënësve vlerësohet. Atyre që kanë vështirësi u jepet ndihmë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e numërimit në rendin rritës dhe zbritës nga numri 1 deri në 20, gjejnë pasardhësin e numrave, ndajnë numrat dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe.

**Detyrë:**
Të paraqitet në fletore detyra 5.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 124

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,4,8; III.2,4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,3,6; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 20

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Demonstron formimin e numrave me shufra dhe kube;
- Krijon problema në bazë të figurave;
- Njehson shumën e numrave deri në 20.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa, komplet matematikor (kube dhe shufra), zare, petëza, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Improvizohet detyra e parë duke ftuar 10 nxënës, e më pas edhe 3 nxënës. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se çfarë ndodhi. Nxiten të përdorin fjalorin matematikor (Ishin 10 nxënës dhe erdhën 3 nxënës). Fjala "erdhën", "u shtuan", në matematikë paraqitet me fjalën "plus", "edhe". Më pas shkruajnë fjalinë numerike në tabelë dhe njëkohësisht plotësohet individualisht detyra ne tekst:

**10+3=13**

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen që duke u mbështetur në katrorët e detyrës së dytë, të plotësojnë fjalitë numerike dhe ngjyrosin katrorët duke i veçuar me ngjyra dhjetëshet dhe njëshet. Rikujtohet që me shufra




paraqiten dhjetëshet, ndërsa me kube njëshet. Pasi të përfundojnë, rishikojnë punën e tyre në dyshe dhe vlerësojnë njëri-tjetrin.

**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit të përdorin mjete të konkretizimit më të përshtashme për ta (numëratore, petëza, fasule, kube e shufra), që të plotësohet detyra 3.

**Hapi 4:** Nxiten nxënësit të gjejnë lidhjen logjike të detyrës 4 dhe ta shpjegojnë atë. Vëzhgohen nxënësit duke plotësuar detyrën dhe vlerësohet puna e tyre.

**Hapi 5:** Ftohen nxënësit me radhë që të rrotullojnë zarin, dhe numri që u bie ia shtojnë numrit 10, pastaj e shënojnë barazimin në tabelë, p.sh.:

**10 + 5 = 15; 10 + 3 = 15...**

Disa nxënës rrotullojnë dy zare njëkohësisht:

**10 + 2 + 6 = 18 ;**

**10 + 1 + 5 = 16; 10 + 4 + 6 = 20.....**

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës së numrave dhe krijimit të fjalive numerike duke u bazuar në figurat e dhëna.

**Detyrë:**

Të paraqitet në fletore detyra 5.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 125

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,4,8; III.2,4; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3.1,3,6; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave deri në 20/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Interpreton mbledhjen në bosht numerik;
- Zbaton mbledhjen në situatë problemore;
- Njehson mbledhorët e numrit 20.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kuti vezësh, petëza, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet në tabelë boshti numerik me numrat deri në 20. Lexohet një situatë problemore: "4 fëmijë po lahen në lumë dhe 5 fëmijë të tjerë janë në breg të lumit. Sa fëmijë janë gjithsej?" Nxiten nxënësit të gjejnë zgjidhjen. Një vullnetar vizaton shigjetat sipas të dhënave, duke shkruar edhe barazimin e fituar: ***4 + 5 = 9.*** Bëhen pyetjet: "Po nëse në lumë lahen 14 fëmijë, më pas vijnë edhe 5 të tjerë? Nga cili numër duhet të niset shigjeta në boshtin numerik? Ftohet një nxënës tjetër ta vizatojë shigjetën e situatës së dytë dhe të shkruajë barazimin e fituar: ***14 + 5 = 19*** .

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë individualisht fjalitë numerike të detyrës 2 dhe 3. Puna e tyre vlerësohet.




**Hapi 3:** U shpërndahen nxënësve në secilin grup nga dy kuti të vezëve të cilat kanë nga 10 hapësira. Kërkohet që të ngjyrosin 7 hapësira në kutinë e parë me ngjyrë të kuqe. Pasi të përfundojnë, pyeten se edhe sa hapësira u kanë mbetur pa ngjyrosur për të plotësuar tërë kutinë (3), të cilat më pas i ngjyrosin me ngjyrë të kaltër. Secili grup duhet ta paraqesë aktivitetin duke shkruar fjalinë numerike e cila lexohet me zë: ***7 + 3 = 10***. Më pas kërkohet të ngjyrosin me të kuqe tërë hapësirat e kutisë së dytë (10) dhe pyeten nxënësit se sa hapësira të kuqe dhe sa të kaltra kanë gjithsej tani. E paraqesin situatën e re në fjali numerike: ***17 + 3 = 20.***

**AKTIVITET SHTESË:**
Nxënësit udhëzohen që në dyshe të bëjnë aktivitetin e numërimit me gishtërinj. Njëri nxënës të ngrejë p.sh.: 14 gishta, ndërsa tjetri duhet të gjejë se sa gishtërinj duhet të ngrejë (6) për të formuar të dy bashkë 20 gishtërinj gjithsej. Më pas ndërrojnë vendet dhe secila dyshe i shkruan ne fletore barazimet e fituara nga aktiviteti.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e formimit të fjalive numerike duke u bazuar në figurat e dhëna; njehsojnë shumën e numrave deri në 20, përcaktojnë mbledhorin që mungon në fjalitë numerike.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 126

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 1.4; 2.3; 3.3; 3.5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja numrave deri në 20

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Zbërthen numrat dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe;
- Zbret numrat deri në 20 duke argumentuar veprimin e zbritjes;
- Demonstron zbritjen në shiritin numerik.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shufrat, kubet, shirit numerik.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe, me shufra dhe kube sipas udhëzimeve të dhëna. Njëri nxënës vendos mbi bankë 7 kube dhe tjetri ia heq 2 kube. – *Sa kube mbetën?* Shkruajnë që të dy nxënësit në fletore si barazim veprimin e bërë: 7 – 2 = 5. Prapë njëri nxënës këtyre 7 kubeve ua shton 1 shufër dhe pyeten: - *Sa kube keni mbi bankë?* ( 10 + 7 = 17 ). Udhëzohet që të hiqen nga këto 17 kube, 2 kube. – *Sa kube mbetën?* Paraqesin me barazim: 17 – 2 = 15. Analizohet veprimi i zbritjes. – *Si është kryer zbritja?- A u prek dhjetëshja gjatë zbritjes?- Çfarë kanë të përbashkët këto dy zbritje të kryera, dy barazimet? – Ku ndryshojnë?*

**Hapi 2:** Udhëzohen ta komentojnë situatën në detyrën 1. Numërojnë sa makina ishin në parking. - *Sa makina po largohen? – Sa makina mbetën në parking?* U kërkohet ta plotësojnë barazimin në libër: 12 – 5 = 7.




**Hapi 3:** Vendoset në dysheme traka e numrave dhe ftohen dy nxënës. Nxënësit e tjerë nxiten ta vëzhgojnë dhe ta komentojnë zbritjen në bosht numerik. Përgjigjen në pyetjet: - *Nga cili numër po niset shigjeta e parë?* Njëri nxënës vendoset te numri 8 në trakën numerike. – *Sa numra po lëvizin pas?* Për aq hapa ecën mbrapa edhe nxënësi në trakë. –*Te cili numër ka arritur shigjeta?* – *Po nxënësi?* Po kështu veprohet edhe për barazimin 18 – 5 = 13. Nxënësi tjetër e demonstron në trakën numerike.

**Hapi 4:** Udhëzohen që të punojnë në dyshe, në detyrat 3 dhe 4. Në detyrën 3, njëri nxënës kryen zbritjen e numrave në anën e majtë, kurse tjetri zbritjen në anën e djathtë. Pyeten: – *Çfarë kanë të përbashkët çiftet e barazimeve? – Ku ndryshojnë ato?* Në mënyrë të ngjajshme punohet edhe në detyrën 4. Librat shkëmbehen në mes vete për ta vlerësuar punën e njëri-tjetrit.

**Hapi 5:** U kërkohet të punojnë individualisht dhe të pavarur në detyrën 5. Nxënësit do të zbresin me euro. Saktësia e zbritjes kontrollohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohet nxënësi për zbërthimin e saktë të numrave dyshifrorë në dhjetëshe dhe njëshe. Po ashtu zbret saktë numrat deri në 20 duke e argumentuar veprimin e zbritjes dhe e demonstron zbritjen në trakën numerike.

**Detyrë:**

Të punoni barazimet e mbetura në detyrat 3 dhe 4 në libër dhe të krijojnë një detyrë me fjalë me një barazim të detyrës 5.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 127

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** II.2; III.1; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 1.4; 2.3; 3.5.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave deri në 20/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon zbritjen në boshtin numerik;
- Njehson saktë zbritjen e numrave deri në 20;
- Krahason shprehjet numerike gjatë zbritjes.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shiriti numerik, shufra, kube, numratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendoset shiriti numerik në dysheme dhe ftohet një nxënës që të shkojë te numri 9. I kërkohet që të ecë deri te numri 4. Parashtrojmë pyetje: - *Sa hapa bëri për të arritur te numri 4? – Cilin veprim e paraqet lëvizja prapa?* Ftohet një nxënës ta shkruajë si barazim veprimin e kryer: 9 – 5 = 4. Ftohet nxënësi tjetër që vepron njësoj, por ai fillon nga numri 19 dhe lëviz deri te numri 14. Analizohet dhe shkruhet barazimi: 19 – 5 = 4. Paraqitet në boshtin numerik. Udhëzohen t'i plotësojnë barazimet në detyrën 1.

**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të shkruajnë shprehje numerike (barazime) me numrat e shkruar në tabelë: 16, 5, 6. Shkruhen barazimet e shkruara nga nxënësit: 16 – 5 – 6 = __ dhe 16 – 6 – 5 = ___. Diskutohen këto dy mënyra. *-Me cilën mënyrë është më lehtë e më shpejt të zbresim? (e dyta).* –Pse? *(sepse veçohet 10).*




**Hapi 3:** Udhëzohen t'i plotësojnë barazimet në detyrën 2. Zbresin tre numra. Në përfundim pyeten: - *Çfarë kanë të përbashkët këto barazime?* Shkëmbejnë librat me shokun.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen t'i vërejnë dy shembujt me rrathë, në detyrën 4. Paraqiten në tabelë vetëm barazimet. Krahasohen mes vete. – *Çfarë kanë të përbashkët këto dy vizatime?* (numrin e rrathëve të hequr). –*Ku ndryshojnë?* (numri i rrathëve në fillim dhe rezultati i fituar). –*Për sa ndryshojnë?* (për 10).

**10 – 3 = 7** **20 – 3 = 17**

U kërkohet t'i plotësojnë barazimet në detyrën 4, të pavarur e individualisht. Lexohen me zë barazimet e plotësuara.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësi vlerësohet për shpjegimin e mënyrës së zbritjes në bosht numerik, njehson saktë zbritjen e numrave deri në 20, si dhe krahason shprehjet numerike gjatë zbritjes.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 3 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 128

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situatë reale).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.2; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 3.3; 3.5; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Mbledh dhe zbret saktë me një numër dyshifror;
- Përshkruan me fjalë ecurinë e mbledhjes dhe të zbritjes;
- Zbaton mbledhjen, zbritjen në zgjidhjen e problemave me fjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të punojnë me numëratore sipas udhëzimeve. Ata paraqesin në numëratore 13 gogla (rrathë) dhe pyeten: – *Numri 13 sa dhjetëshe ka dhe sa njëshe?* Udhëzohen të shtojnë edhe 5 rrathë. Analizohet veprimi i mbledhjes. – *Gjatë mbledhjes a është rritur numri i njësheve? – Po numri i dhjetësheve a ndryshoi?* Shkruhet në tabelë: 13 + 5 = 10 + 3 + 5 = 10 + 5 + 3 = 10 + 8 = 18
Përsëritet e njëjti veprim, por me zbritje. – *Po nëse numrit 18 ia heqim 5 a ndryshon numri i njësheve? –Po numri i dhjetësheve a ndryshon?*

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë barazimet në detyrën 2 të librit, duke njehsuar shumën.




Punohen 4 barazime me mbledhje dhe 4 me zbritje. Pasi të përfundojnë pyeten: - *Si e keni kryer mbledhjen (zbritjen)? – Çfarë kanë të përbashkët çiftet e barazimeve? – Për sa dallojnë në mes vete mbledhorët e dytë? – Për sa dallojnë në mes vete shumat (ndryshimet)?*

**Hapi 3:** Udhëzohen ta lexojnë detyrën 3 me fjalë, dhe ta zgjidhin. Në fund komentohet ecuria e mbledhjes.

**Hapi 4:** Nxënësit do të plotësojnë individualisht nga një shtyllë me barazime të mbledhjes dhe të zbritjes, në detyrën 4. Ata punojnë sipas modelit të dhënë. Librat pas plotësimit, shkëmbehen me shokun e bankës dhe vlerësohet saktësia e njehsimit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mbledhje dhe zbritje të saktë me një numër dyshifror, duke e komentuar me fjalë ecurinë e veprimeve; Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në zgjidhjen e problemave me fjalë.

**Detyrë:**
Të punohen barazimet e mbetura në detyrat 2 dhe 4 në libër dhe të përshkruhen në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 129

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 1.4; 1.5; 3.3; 3.5; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen mbledhorin, zbritësin e panjohur.
- Shkruan shprehje numerike duke interpretuar mbledhjen dhe zbritjen në bosht numerik.
- Zgjidh detyra me mbledhje dhe zbritje.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** fletë A4,traka numerike, numratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha amtare (shqip), Edukatë fizike, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit do të organizohen në grupe. Çdo grupi i shpërndahet nga një fletë A4, me një shtëpi si në detyrën 1 të librit. Ata do të punojnë në grup për ta gjetur mbledhorin e dytë apo zbritësin. Shtëpitë do të jenë me veprime të mbledhjes ose të zbritjes. Në përfundim, përfaqësuesi i grupit e vendos shtëpinë e tyre në tabelë dhe fillon ta komentojë zgjidhjen. Ai duhet të thotë: *"Shtëpia jonë duhet t'i ketë 16 banorë në çdo kat. Në katin e parë janë 13 banorë. Për t'u bërë 16 duhet shtuar edhe 3 banorë, sepse 13 + 3 = 16".* Kështu vazhdohet për çdo grup.

**Hapi 2:** Vizatohet në tabelë një bosht numerik sipas dy shembujve të dhënë në detyrën 2. Në dysheme vendoset traka numerike. Nxënësit nxiten të formojnë shprehje numerike duke e përcjellë kahjen




dhe zgjidh saktë detyrat me mbledhje dhe zbritje.

e shigjetave në bosht numerik. Çdo shembull demonstrohet në trakë numerike nga nxënësit. Pyetja: - *Nga cili numër po niset shigjeta e parë? - Te cili numër arriti? - Sa numra ka lëvizur ajo? - Plotësoni në libër.*

Kështu veprohet edhe me veprimin e zbritjes. Shembullin e fundit në detyrën 2, në libër nxënësit e plotësojnë të pavarur. Puna e tyre vlerësohet.

**Hapi 3:** Nxënësit, në mënyrë individuale, mbledhin dhe zbresin barazimet në detyrën 3. Ata mund ta përdorin numëratorensipas nevojës. Pas përfundimit mund të pyeten rreth ecurisë së mble-dhjes, apo të zbritjes. - Çfarë kanë të përbashkët barazimet e shtyllës së parë? - Për sa ndryshojnë mbledhorët e dytë? - Për sa ndryshojnë shumat e tyre?

12 + 5 = 17
12 + 6 = 18
12 + 8 = 20

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në grup. Gjen saktë mbledhorin dhe zbritësin e panjohur. Po ashtu shkruan saktë shprehje numerike duke e interpretuar boshtin numerik, si

**Detyrë:**
Të plotësohen shtëpizat në detyrën 1 në libër dhe të shkruhen si barazime në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 130

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1;1.3; 2.1; 3.1; 3.3; 4.2.




| + | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|
| 11 | | 14 | 15 | | |
| 12 | | | | | |
| 13 | | | | 18 | |
| 14 | | | | | |

| – | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
|---|---|---|---|---|---|
| 15 | 14 | 13 | | | |
| 16 | | | | | |
| 20 | | | | | |
| 18 | | | | | 13 |

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kryen mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 20;
- Zbulon rregullën për plotësimin e barazimeve;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në zgjidhjen e situatave jetësore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numra, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen disa etiketa me shumë apo ndryshim të dy numrave, p.sh.:

| 8+4 | 15-7 |
|---|---|

Udhëzohen që duhet ngritur etiketa varësisht numri i shqiptuar (të kërkuar). Shqiptohen 5, 6 numra dhe kalohet në detyrën 1. Nxënësit do të shkruajnë barazime me mbledhje dhe zbritje sipas situatave të dhëna.

**Hapi 2:** Nxënësit punojnë në dyshe detyrën 3, duke plotësuar njërën nga tabelat. Pas plotësimit pyeten ata: *-Te tabela e mbledhjes për sa po rriten shumat? –Për sa po rriten mbledhorët e dytë?* Të njëjtat pyetje bëhen edhe për tabelën e zbritjes.




**Hapi 3:** Nxënësit të pavarur do të punojnë në detyrën 4. Ata do ta ndihmojnë Artanin për ta gjetur rrugën për në shkollë, duke njehsuar. Fushat me shprehje që kanë të njëjtën vlerë i ngjyrosin.

**Hapi 4:** Nxënësit punojnë në dyshe, me shokun e bankës. Secili do të plotësojë nga një shtyllë me mbledhje dhe me zbritje. Ata së pari udhëzohen të gjejnë rregullën e plotësimit e më pas i plotësojnë barazimet. Pyeten: *-Cila është rregulla? Pse? –Në fund cilin numër duhet ta fitoni?* Librat shkëmbehen mes vete.

**Hapi 5:** Nxënësit punojnë individualisht detyrën 7. Ata njehsojnë dhe rezultatin e shënojnë në shiritin poshtë.

**Hapi 6:** Në detyrën 8 udhëzohen që t'i krahasojnë mes vete shumat në euro, duke vendosur njërën nga shenjat <, >, =.
Detyrat kontrollohen dhe vlerësohet saktësia e plotësimit.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit mbledhin dhe zbresin saktë numrat deri në 20, si dhe i zbatojnë për të zgjidhur situata nga jeta; zbulojnë rregullën dhe plotësojnë saktë barazimet.

**Detyrë:**
Të punohen detyrat 2 dhe 6. Po ashtu, të plotësohen tabela dhe barazimet në detyrat 3 dhe 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 131

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e dhëna.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1; 3.1; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Zbatimi i mbledhjes dhe zbritjes në problema

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Përdor mbledhjen si veprim i kundërt i zbritjes;
- Zgjidh saktë problemat e thjeshta matematikore.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numra, para të letrës, mjete shkollore, numëratore, shufra, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** U shpërndahen nxënësve në grupe etiketat me numra. Në disa etiketa janë paraqitur veprime me plus, në disa veprime me minus, e në disa etiketa është vetëm shuma ose ndryshimi. Nxënësit në grupe i gjejnë veprimet dhe i bashkojnë me rezultatin që u përshtatet. Grupet prezantojnë me radhë punën e tyre, ndërsa të tjerët i korrigjojnë ata nëse ka nevojë.

**Hapi 2:** Paraqitet në tabelë një veprim me mbledhje dhe një veprim me zbritje. Përsëriten kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes nga ana e mësimdhënëses: mbledhori i parë, mbledhori i dytë, shuma, i zbritshmi, zbritësi, ndryshimi.
I përsërisin edhe nxënësit disa herë këto shprehje.




**Hapi 3:** Në detyrën 1 në libër u tregohet nxënësve që në secilin kat të shtëpisë do të hyjnë nga 18 fëmijë. Kanë hyrë 12 fëmijë, plus 4 fëmijë, edhe sa fëmijë duhet të hyjnë? Udhëzohen nxënësit të përdorin petëza, fasule ose numëratore. Kështu vazhdohet me plotësimin e të gjitha shtëpive të numrave të tjerë.

**Hapi 4:** Nxënësit punojnë në çifte: njëri nxënës luan rolin e blerësit dhe llogarit sa para duhet paguar për të blerë sende që janë në figurat e detyrës së dhënë; nxënësi tjetër luan rolin e shitësit dhe llogarit sa para duhet t'ia kthejë blerësit. Për secilën blerje kërkohet të shkruajnë një barazim të mbledhjes, që tregon sa kanë kushtuar gjërat e blera dhe një barazim të zbritjes, që tregon sa para duhet t'i kthehen blerësit.

**Hapi 5:** Kërkohet të zgjidhet detyra 2 në mënyrë individuale. Detyra punohet duke u bazuar në hapin paraprak, ku nxënësit bëjnë blerjen dhe shitjen e gjërave të ndryshme.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të zgjidhin detyrën 3 në mënyrë individuale. Ata i ndërrojnë librat me shokun/shoqen e bankës dhe e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, duke dhënë edhe këshilla për përmirësime nëse ka nevojë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mbledhjen dhe zbritjen e numrave dhe për saktësinë e zgjidhjes së problemave të thjeshta matematikore.

**Detyrë:**
Shkruani në fletore 5 barazime me mbledhje dhe 5 barazime me zbritje.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 132

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1; 3.1; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra lidhur me mbledhjen dhe zbritjen/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Përdor mbledhjen si veprim i kundërt i zbritjes;
- Zgjidh saktë problemat e thjeshta matematikore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me numra, mjete shkollore, numëratore, shufra, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Organizohet një garë mes nxënësve – shoku me shokun e bankës. Janë përgatitur etiketat me numrat 1 deri në 20. Ngrihet një etiketë nga mësuesja, p.sh., 15. Kërkohet nga nxënësit që njëri të thotë një numër, p.sh., 9, e tjetri sa më shpejt e thotë numrin tjetër 6, që shuma e atyre dy numrave te jetë 15. Kjo lojë vazhdon me disa numra që të përfshihen në lojë sa më shumë nxënës.

**Hapi 2:** Detyra 1 e librit shkruhet në tabelë. Ftohen nxënësit të vendosin shenjat "+" dhe "-". Nxënësit vendosin shenjën e duhur dhe arsyetojnë me fjalë pse duhet vendosur ajo shenjë. P.sh. 16⊞2 = 18 .

**Hapi 3:** Në detyrën 2 përdoret numëratorja për t'u plotësuar detyrat me mbledhje dhe zbritje. Ftohen nxënësit pranë tabelës ku është vendosur numëratorja. Nxënësi kryen veprimin duke paraqitur edhe




në tabelë shprehjen. Vazhdohet kështu derisa të plotësohen të gjitha kolonat me detyra.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë barazimet dhe të shkruajnë shkronjat për secilin barazim. Lexohet fjalia që formohet nga shkronjat e fituara. Analizohet kuptimi i fjalisë bashkë me mësuesen dhe u tregohet nxënësve më shumë rreth kuptimit të saj. Nxënësit përdorin kube, shufra ose mjete mësimore për ta lehtësuar veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes.

**Hapi 5:** Kërkohet nga nxënësit të bashkojnë me shigjetë shprehjen me vlerën numerike të saj në detyrën 4. Ata punojnë në mënyrë individuale, por krahasojnë pastaj me shokun e bankës dhe shikojnë nëse ka nevojë për përmirësime.

**Hapi 6:** Bisedohet me nxënësit se sa vjet mund të jetojë dreri. Merren disa mendime. Më pas zgjidhet detyra 5, dhe përmes veprimeve të mbledhjes dhe të zbritjes gjejnë dhe shkruajnë sa vjet jeton dreri.

**AKTIVITET SHTESË**

U shpërndahen nxënësve kube me ngjyra të ndryshme. Kërkohet nga ta të formojnë vetë veprime me mbledhje dhe zbritje. Nxënësit e prezantojnë punën e bërë në grup dhe e krahasojnë atë me grupet e tjera. Detyrat e krijuara shënohen edhe në fletoret e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete; për mbledhjen dhe zbritjen e numrave dhe zgjidhjen e saktë të problemave të thjeshta matematikore.

**Detyrë:**

Detyrat 7 dhe 8 në libër, të punohen në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 133

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1; 3.1; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Përdor mbledhjen si veprim i kundërt i zbritjes;
- Zgjidh saktë problemat e thjeshta matematikore.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Topa të vegjël, bonbone, etiketa me numra, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** U shpërndahen nxënësve topa të vegjël ose bobone. Kërkohet nga ata të përgatisin problema me mbledhje dhe zbritje. Lexohen pastaj ato. P.sh., ***Arta kishte 11 bonbone. Nëna ia dha edhe 5 bonbone.*** Sa bonbone ka gjithsej Arta? Udhëzohen nxënësit të llogarisin me numëratore, të shkruajnë barazimin në fletore, me pas ta lexojnë. Shkruhet barazimi në tabelë dhe diskutohet për të. Më pas vazhdohet me zbritje: ***Arta ka 16 bonbone. Ajo i hëngri 4 bonbone.*** Sa bonbone i mbetën Artës? Ndiqen hapat e njëjtë si në veprimin e parë.

**Hapi 2:** Kërkohet nga nxënësit të punojnë detyrën 1 në çifte: njëri nxënës zgjidh tabelën e parë, e tjetri tabelën e dytë. Pasi të përfundojnë, në këtë mënyrë i ndërrojnë rolet dhe detyra punohet komplet nga secili nxënës. Diskutojnë për ecurinë dhe saktësinë e detyrës.




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 2 individualisht dhe ta ngjyrosin atë sipas kërkesave. Pasi të përfundojnë të gjithë, ngrenë lart librin për të parë a janë përdorur ngjyrat e duhura.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të lexojnë problemën dhe ta zgjidhin atë. Lexohet me zë detyra nga disa nxënës me radhë dhe ata së bashku me mësuesen i formojnë edhe disa detyra të tilla. Paraqiten në tabelë zgjidhjet dhe gjithashtu edhe në fletoret e nxënësve.

**Hapi 5:** U shpërndahen nxënësve fletët e punës me 4 detyra me fjalë. Këshillohen që të lexojnë me vëmendje kërkesat e detyrave dhe t'i zgjidhin ato. Detyrat punohen në mënyrë individuale. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**AKTIVITET SHTESË**

Formohen grupet me nxënës. Më parë janë përgatitur disa numra në fletë të vogla, në formë të etiketave të cilat i palojmë. Kërkohet nga nxënësit të tërheqin një letër. Hapet letra, me numrin e që u qëllon, nxënësit në grup formojnë problema me fjalë, një për veprimin e mbledhjes dhe një për atë të zbritjes. Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre duke argumentuar me fjalë zgjidhjen e detyrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mbledhjen dhe zbritjen e numrave, për krijimin e problemave të thjeshta dhe saktësinë e zgjidhjes së tyre.

**Detyrë:**

Krijoni dy problema me fjalë dhe zgjidhni ato.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 134

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1; 3.1; 4.2; 5.1.


VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

Vlerësojmë

1 Njehsojmë dhe plotësojmë.

19 −9 +4 −10 +12 +3 −9 +3 −6

2 Erzeni i ka 14 pëllumba, kurse Arti 6 pëllumba më pak. Sa pëllumba ka Arti?

Arti ka: ___ − ___ = ___ pëllumba.

3 Në katrorin e zbrazët, shkruajmë numrin e duhur.

11 + □ = 17 14 − □ = 10 □ − 10 = 4

3 + □ = 13 19 − □ = 13 □ − 3 = 10

4 Në oborrin e shkollës janë duke luajtur dy grupe nxënësish. Në grupin e parë luajnë 6 nxënës, kurse në grupin e dytë 7 nxënës më shumë se në grupin e parë. Sa nxënës janë duke luajtur në oborrin e shkollës?

Në oborrin e shkollës janë duke luajtur: ___ + ( ___ + ___ ) = ___ + ___ = ___ nxënës.

5 > < = ?

11 + 6 ○ 15 17 − 3 ○ 13 18 − 9 ○ 9

12 + 5 ○ 12 7 + 6 ○ 15 12 − 12 ○ 7

6 Shkruajmë shprehjen dhe njehsojmë vlerën e saj:

*a*) Shumën e numrave 8 dhe 6 e rritim për numrin 4.

*b*) Shumën e numrave 10 dhe 7 e zvogëlojmë për numrin 8.

57

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Përdor mbledhjen si veprim i kundërt i zbritjes;
- Zgjidh saktë problemat e thjeshta matematikore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirit me numra, topa të vegjël, bonbone, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendoset në dysheme shiriti me numrat prej një deri në njëzet. Përsëriten ata disa herë duke kalur nxënësit mbi numrin që u thuhet. Pastaj kështillohen nga ata të dëgjojnë me vëmendje fjalët e mësueses kur u kërkohet të bëjnë mledhjen ose zbritjen e numrave në shirit. P.sh., nxënësi vendoset te numri 12, i thuhet t'i shtojë 4, nxënësi kërcen pastaj te numri 16. Veprimi vazhdon kësisoj edhe me zbritje. Nxënësi është te numri 16, i kërkohet të zbresë për 2, nxënësi kërcen te numri 14. Veprimtaria përsëritet disa herë me disa nxënës të ndryshëm.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 1 në libër. Ajo fillon nga numri 19 ku janë paraqitur veprime me mbledhje e zbritje dhe rrathët e zbrazët. Nxënësit kryejnë veprimin e parë; numrin e fituar e shkruajnë në rrethin e zbrazët duke e kryer kështu me radhë veprimin e radhës.



VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

Vlerësojmë

1

Njehsojmë dhe plotësojmë.

19 −9 +4 −10 +12 +3 −9 +3 −6

2

Erzeni i ka 14 pëllumba, kurse Arti 6 pëllumba më pak. Sa pëllumba ka Arti?

Arti ka: ___ − ___ = ___ pëllumba.

3

Në katrorin e zbrazët, shkruajmë numrin e duhur.

11 + □ = 17 14 − □ = 10 □ − 10 = 4

3 + □ = 13 19 − □ = 13 □ − 3 = 10

4

Në oborrin e shkollës janë duke luajtur dy grupe nxënësish. Në grupin e parë luajnë 6 nxënës, kurse në grupin e dytë 7 nxënës më shumë se në grupin e parë. Sa nxënës janë duke luajtur në oborrin e shkollës?

Në oborrin e shkollës janë duke luajtur: ___ + ( ___ + ___ ) = ___ + ___ =___ nxënës.

5

> < = ?

11 + 6 ○ 15 17 − 3 ○ 13 18 − 9 ○ 9

12 + 5 ○ 12 7 + 6 ○ 15 12 − 12 ○ 7

6

Shkruajmë shprehjen dhe njehsojmë vlerën e saj:

*a*) Shumën e numrave 8 dhe 6 e rritim për numrin 4.

*b*) Shumën e numrave 10 dhe 7 e zvogëlojmë për numrin 8.

57

**Hapi 3:** Nxënësit e lexojnë në heshtje detyrën. Pyeten nëse e kanë kuptuar ose jo. Ata që e kanë kuptuar e kryejnë detyrën në mënyrë të pavarur, ndërsa të tjerët që nuk e kanë të qartë atë nxiten që ta lexojnë disa herë ose u jep ndihmë mësuesja.

**Hapi 4:** Paraqiten në tabelë veprime ku mungon njëri numër, p.sh., 11 + ____= 16. Pyeten nxënësit: Cilin numër e dimë? (mbledhori i parë është 11); Cilin numër po mungon? (mbledhori i dytë ); Numri pas barazimit, si quhet dhe cili është ai numër? (shuma është 16); Atëherë numrit 11 sa i duhet shtuar që të fitojmë shumën 16? (shtojmë numrin 5). Nxiten nxënësit që të përsërisin kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes duke plotësuar numrat që mungojnë.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën me fjalë, ta zgjidhin atë dhe pastaj secili të krijojë një detyrë të thjeshtë me fjalë në mënyrë të pavarur. Pastaj punojnë detyrën 5 në libër duke vendosur shenjën e duhur <, =, > për numrin që është i paraqitur aty dhe numrin që fitojnë pasi kryejnë veprimin e kërkuar. Nxënësit përdorin numëratore ose fije shkrepëse për të punuar.

**Hapi 6:** Ata tashmë i dinë kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes. Nxënësit punojnë detyrën 6 duke i lexuar detyrat me fjalë, i vendosin shenjat + ose - varësisht se cila shprehje përmendet, shuma apo ndryshimi.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për mbledhjen dhe zbritjen e numrave, për saktësinë e zgjidhjes së problemave dhe krijimin e problemave të thjeshta me fjalë.

**Detyrë:**
Të krijojë dy problema me fjalë dhe t'i zgjidhë ato.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 135

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Trupat gjeometrikë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera);
- Krahason trupat gjeometrikë (përmasat e tyre).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.3,4; III.1, 2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.4; 4.2; 5.1; 6.1,2,4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kubi dhe kuboidi

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton trupat gjeometrikë: kubin dhe kuboidin;
- Numëron gjëra që ngjasojnë me kubin dhe kuboidin;
- Krahason kubin me kuboidin.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Teknologji, lodra që e kanë formën e kubit dhe të kuboidit, gjëra nga mjedisi ose mjete mësimore që e kanë formën e kubit dhe të kuboidit, fletë të printuara etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet me projektor një video ku paraqiten kubi dhe kuboidi (në linkun këtu):

https://www.youtube.com/watch?v=Uxq5wEOJZ9s . Njihen nxënësit me formën e kubit dhe të kuboidit duke parë përmbledhjen në video. Pastaj në ambientin aty afër gjejnë objekte që kanë formën e kubit dhe të kuboidit. Kësisoj u bëhet e qartë nxënësve se në hapësirën tonë gjenden trupa, sende, objekte, me forma të kubit dhe të kuboidit.

**Hapi 2:** Paraqiten me projektor përsëri pamje të trupave gjeometrikë. Bëhet bisedë me nxënësit për gjërat që kanë formën e kubit dhe të kuboidit. U tregohet atyre që të gjitha këto gjëra janë trupa që zënë




vend në hapësirë. Bisedohet edhe për dallimet ndërmjet kubid dhe të kuboidit bazuar në pamjet që shohin.





**Hapi 3:** U shpërndahen nxënësve në grupe fletë të printuara ku janë paraqitur trupat gjeometrikë (kubi dhe kuboidi) dhe figurat gjeometrike (katrori dhe drejtkëndëshi). U kërkohet atyre të shikojnë me vëmendje dhe të dallojnë trupat gjeometrikë nga figurat gjeometrike. Flasin për dallimet e tyre.



**Hapi 4:** Lipset nga nxënësit të vijëzojnë objektet që nuk janë në formë të kubit dhe të kuboidit, diskutohet më pas për to.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen që detyra 3 të zgjidhet individualisht, të ngjyrosin kubet dhe kuboidet sipas kërkesave të detyrës.

**Hapi 6:** U shpërndahen nxënësve fletë të punës ku janë paraqitur vijat për të formuar kubin dhe kuboidin.
Kërkohet nga ata t'i presin format dhe të formojnë kubin dhe kuboidin.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete; për emërtimin dhe krahasimin e trupave gjeometrikë - kubit dhe kuboidit.

**Detyrë:**
Sillni në klasë sende që kanë formën e kubit dhe të kuboidit.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 136

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Trupat gjeometrikë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton trupa gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera);
- Krahason trupat gjeometrikë;
- Identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.4; 6.1; 6.2; 6.4.


KUBI DHE KUBOIDI

Ushtrojmë

1 Duke i bashkuar pikat, vizatojmë kube.

2 Duke i bashkuar pikat, vizatojmë kuboide.

3 Duke shënuar numra në katrorët nën kube, i radhitim ato sipas madhësisë.

4 Duke shënuar numra në katrorët nën kuboide, i radhitim ato sipas madhësisë.

59

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kubi dhe kuboidi /U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon objektet në formë të kubit dhe të kuboidit;
- Vizaton kube dhe kuboide duke i bashkuar pikat;
- Radhit kubet dhe kuboidet sipas madhësisë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete prej druri me formë të kubit dhe të kuboidit; sende të mjedisit: zare, lapsa, kuti barnash, kuti këpucësh, kokërr sheqeri etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bëhet përsëritje e shkurtër nga ora e kaluar për kubin dhe kuboidin. Nxënësit tregojnë mjetet e krijuara në orën e edukatës figurative dhe ato që i kanë sjellë nga shtëpia. Udhëzohen të vendosin mbi bankë sende që kanë formën e kuboidit. Nxiten të thonë: *"Libri ka formë të njëjtë me kuboidin"*, *"Kutia e barnave ka formë të njëjtë me kuboidin"* etj. Pastaj kërkohet të vendosin mbi bankë sendet që kanë formën e kubit. Thonë: *"Zari ka formën e kubit", "Dhurata ka formën e kubit" etj. –A kemi në klasë objekte që kanë formën e kuboidit?* Një përgjigje e mundshme: goma, kutia e ngjyrave, çanta, fletorja, dera, tabela etj.




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat. Demonstrohet në tabelë vizatimi i kubit. Paralelisht nxënësit vizatojnë në libër. Duke i bashkuar pikat, në fillim vizatohet një katror, pastaj vizatohet katrori tjetër dhe në fund bëhet lidhja e tyre duke e formuar kubin. Nxënësit vazhdojnë t'i vizatojnë edhe dy kube të tjera në mënyrë të pavarur. Shkëmbehen librat me shokun e bankës.

**Hapi 3:** Demonstrohet në tabelë vizatimi i kuboidit. Pasi bëhet bashkimi i katër pikave të para pyeten nxënësit: -*Çfarë po vëreni? –Çfarë forme ka kjo figurë?* (të drejtkëndëshit). Vazhdohet me bashkimin e pikave të tjera duke formuar edhe një drejtkëndësh.
- *Sa drejtkëndësha po shihni?* (2). Bëhet lidhja e tyre dhe formohet kuboidi. Të pavarur vizatojnë edhe dy kuboide.

**Hapi 4:** Në grupe shpërndahen disa kuboide dhe kube me madhësi të ndryshme. Një dyshe rendit sipas madhësisë kubet, dyshja tjetër kuboidet. Pas diskutimit në grup përfaqësuesi i grupit tregon se si e kanë bërë radhitjen.

Të bazuar në këtë aktivitet, nxënësit i plotësojnë detyrat 3 dhe 4 në mënyrë të pavarur. I radhisin kubet dhe kuboidet sipas madhësisë, duke shënuar numrat në katrorët e zbrazët poshtë tyre. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete; identifikimin e objekteve në formë kubi dhe kuboidi. Po ashtu vlerësohen për vizatimin dhe radhitjen e saktë të tyre.

**Detyrë:**
Vizatoni kubin dhe kuboidin.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 137

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Trupat gjeometrikë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton trupa gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera);
- Krahason trupat gjeometrikë;
- Identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.4; 6.1; 6.2; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Cilindri, koni dhe sfera

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton trupat gjeometrikë: cilindrin, konin dhe sferën.
- Identifikon objekte nga rrethina në formë cilindri, koni dhe sfere;
- Dallon cilindrin nga sfera.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete prej druri dhe kartoni me formë të cilindrit, të konit dhe të sferës, ngjyra, objekte të ndryshme nga rrethina.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen objekte me forma të ndryshme nga druri apo kartoni. Prej tyre kërkohet të grupojnë trupat në tri bashkësi sipas formës. Pas përfundimit, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe shikojnë punën e grupeve.
U tregohen nxënësve cilindri, koni dhe sfera dhe emërtohen ata. Ftohen nxënësit të marrin një objekt dhe të tregojnë çfarë forme ka. P.sh.: *"Lapsi ka formën e cilindrit", "Rruaza e ka formën e sferës", "Maja e lapsit e ka formën e konit"*. Krahasohen me trupat e tjerë dhe vihet në dukje se këta trupa rrotullohen.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të analizojnë figurën në detyrën e parë. Pyeten: - Çfarë po vëreni në fig-




urë? – Çfarë po bën djali? –Çfarë forme ka topi? Nxiten të thonë: *"Topi e ka formën e sferës"*. Nxënësit përshkruajnë edhe figurat e tjera në libër.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të përshkruajnë dhe të emërtojnë figurat në detyrën 2. Ndërkohë që e thonë emrin e ngrenë trupin lart me dorë.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe. Njëri nxënës i gjen trupat që i ngjasojnë cilindrit dhe e shenjon me ngjyrë të gjelbër, ndërsa tjetri trupat që kanë formën e sferës dhe e shenjon me ngjyrë të kuqe. Librat shkëmbehen mes vete për të vlerësuar njëri-tjetrin. Vendosin simbolet ❤ dhe ☆.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë detyrën 4 dhe ta komentojnë.

Pyeten ata:

- Sa lloje të figurave po vëreni?
- Çfarë ka më shumë, figura në formë të cilindrit apo të sferës?
- Figurat në formë të cilindrit do t'i ngjyrosim me ngjyrë të kuqe.
- Po figurat në formë të sferës me çfarë ngjyre do t'i ngjyrosim?

Nxënësit udhëzohen të punojnë në mënyrë të pavarur.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete, emërtimin e saktë të trupave dhe identifikimin e objekteve në formë cilindri, koni dhe sfere. Po ashtu, vlerësohen për dallimin e cilindrit nga sfera.

**Detyrë:**

Sillni në klasë sende të ndryshme që kanë formën e cilindrit, të konit dhe të sferës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 138

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Trupat gjeometrikë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Emërton trupa gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera);
- Identifikon objekte të ngjashme me kubin, kuboidin dhe sferën.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.4; III.2; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 2.1; 3.4; 6.1; 6.2; 6.4.


CILINDRI, KONI DHE SFERA

Ushtrojmë

1

Shkruajmë: 1 - për sferën, 2 - për konin dhe 3 - për cilindrin.

2

Trupi në figurë përbëhet nga figurat e ndryshme gjeometrike. Përcaktojmë numrin e tyre dhe ngjyrosim fushat me të njëjtën ngjyrë.

61

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Cilindri, koni dhe sfera/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon trupat gjeometrikë: cilindrin, konin dhe sferën;
- Përcakton trupat e formës së njëjtë me anë të numrit të caktuar;
- Modelon me plastelinë trupa në formë të cilindrit, të konit dhe të sferës.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete prej druri ose prej kartoni në formë të cilindrit, të konit dhe të sferës. Sende të mjedisit: lëmshe prej leshi, sfera metalike, qiri, kavanoz, portokall etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bëhet përsëritje e shkurtër e njohurive të marra nga ora e kaluar. Nxënësit tregojnë gjërat që i kanë sjellë nga shtëpia dhe ato të krijuara në orën e edukatës figurative, me formë të cilindrit, të konit dhe të sferës.
Pranë tre rrathëve të mëdhenj vendosen tri etiketa me fjalët CILINDËR, KON, SFERË. Ftohen nxënësit të vendosin brenda secilit rreth sendet e marra nga shtëpia, duke formuar tri bashkësi të ndryshme. Udhëzohen ata ta emërtojnë trupin pastaj ta vendosin në rrethin e duhur.






**Hapi 2:** Analizohet figura e detyrës 1. Pyeten: -Çfarë po shihni?-Sa sfera me ngjyrë të gjelbër janë? –Sa është numri i koneve?- Po cilindra, sa janë?- Çfarë ka më shumë? –Çfarë ka më pak? Në katrorët poshtë trupave udhëzohen nxënësit të vendosin 1- për sferën, 2- për konin dhe 3- për cilindrin. Nxënësit i shkëmbejnë librat me shokun/shoqen e bankës për të kontrolluar punën e njëri-tjetrit.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të vështrojnë me vëmendje trupin e paraqitur në detyrën 2. Kërkohet të përcaktojnë numrin e figurave gjeometrike dhe të ngjyrosin fushat me të njëjtën ngjyrë. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**Hapi 4:** Modelohen me plastelinë trupa në formë të cilindrit, të konit dhe të sferës me madhësi të ndryshme dhe vendosen mbi një fletë ku janë të shënuar emrat e trupave gjeometrikë.
Punimet e nxënësve ekspozohen në klasë. Vlerësohet puna e tyre.



**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për identifikimin e saktë të cilindrit, të konit dhe të sferës; për përcaktimin e trupave të formës së njëjtë me anë të numrit të caktuar dhe modelimin me plastelinë.

**Detyrë:**
Të vizatohen në fletore cilindri, koni dhe sfera.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 139

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.4; 4.2, 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kllapat

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon kllapat si simbole matematikore
- Zbaton vetinë e shoqërimit gjatë mbledhjes dhe zbritjes;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave duke përdorur kllapat.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u lexohet: Ëmbla shkoi në dyqan dhe bleu 2 banane, 3 mollë dhe 5 dardha. – Sa fruta bleu Ëmbla?

Nxënësit mendojnë në mënyrë të pavarur, më pas diskutojnë në dyshe mënyrën e zgjidhjes së detyrës. Disa dyshe ftohen në tabelë. Njëri e shkruan barazimin e tjetri e komenton me fjalë.
Shkruhet barazimi në tabelë. Vendosen kllapat dhe u sqarohet çka janë ato kur përdoren.
(2 + 3) + 5= 5 + 5 = 10 2 + (3 + 5)= 2 + 8= 10




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të vendosin mbi bankë 5 petëza të verdha, 3 të gjelbra dhe 2 të kuqe. - *Gruponi petëzat e verdha dhe të gjelbra.* –Sa petëza grupuat? (Tetë); –Sa petëza janë gjithsej? (Dhjetë). Në tabelën magnetike u tregohet nxënësve mënyra e grupimit të petëzave me dy duar. Pastaj shkruhet dhe shpjegohet mënyra e zgjidhjes së detyrës duke i përdorur kllapat: (5+ 3) + 2= 8 + 2 = 10. – Cilët mbledhorë i shoqëruam në kllapa? A mendoni se do të ndryshojë shuma nëse ndryshojmë grupimin? Pse? Demonstrohet me petëza dhe arrihet në përfundim se shuma nuk ndryshon.

5 + (3 + 2)= 5+ 5 = 10

Nxënësit plotësojnë detyrën 2 në libër në mënyrë të pavarur.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe shembujt e detyrës 4. Njëra nga dyshet zgjidh shembullin e parë, tjetra shembullin e dytë. Shkëmbehen librat për të vlerësuar njëritjetrin.

Shembulli a, b- duke përdorur kllapat njehsojnë shumën.

Shembulli c, d- nxënësit vendosin sipas dëshirës kllapat dhe zgjidhin barazimet.

Shembulli e, ë- njehsojnë ndryshimin e numrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete, shoqërimin e mbledhorëve duke i përdorur kllapat dhe zgjidhjen e saktë të detyrave të dhëna.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 140

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.1,2, 4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.4; 4.2, 6.4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kllapat/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon mënyrën e mbledhjes së tre numrave me kllapa;
- Përdor kllapat gjatë njehsimit të shumës dhe të ndryshimit;
- Zgjidh problemat me fjalë duke përdorur kllapat.


KLLAPAT

Ushtrojmë

1

3 + 4 + 2

(3 + 4) + 2 3 + (4 + 2)

2

Duke i përdorur kllapat, njehsojmë shumën:

*a*) (7 + 2) + 1 = ___ + 1 = ___ *b*) (4 + 3) + 2 = ___ + ___ = ___

7 + (2 + 1) = 7 + ___ = ___ 4 + (3 + 2) = ___ + ___ = ___

3

*a*) Të njehsojmë ndryshimin e numrit 9 dhe 6 – 4:

___ – ( ___ – ___ ) = ___ – ___ = ___.

*b*) Ndryshimin 10 – 3 e zvogëlojmë për numrin 2:

( ___ – ___ ) – ___ = ___ – ___ = ___.

4

*a*) Dy grupe nxënësish luajnë në oborrin e shkollës. Në një grup janë 4 nxënës, kurse në të dytin 3 nxënës më tepër. Sa nxënës luajnë në oborrin e shkollës?

Njehsojmë: ___ + ( ___ + ___ ) = ___ + ___ = ___.

Pra, në oborrin e shkollës luajnë 11 nxënës.

*b*) Blendi ka mbi bankën e vet 6 lapsa, 3 prej tyre ia dha Arditit. Por, mbi tavolinë ka edhe 2 goma. Sa sende mbetën mbi bankën e Blendit?

Njehsojmë: ( ___ - ___ ) + ___ = ___ + ___ = ___.

Pra, mbi bankën e Blendit mbetën edhe 5 sende.

63

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Petëza, kube, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve në grupe u shpërndahen etiketa me nga tre mbledhorë dhe kërkohet të grupojnë mbledhorët për të njehsuar shumën. Udhëzohen ata të përdorin kube, shkopinj ose fasule. Nxënësit në grupe gjejnë shumën e numrave duke përdorur kllapat. Përfaqësuesi i grupit e shkruan në tabelë mënyrën e zgjidhjes së detyrës.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3+ 3+ 2 | 4+ 2+ 1 | 5+1+1 | 6+ 3+ 1 | 7+ 2+ 1 |

**Hapi 2:** Nxiten nxënësit të përshkruajnë me fjalë mënyrën e grupimit të mbledhorëve. - Çfarë tregojnë duart në foto? (kllapat); -Cilët rrathë i bashkuan me duart? (3 + 4); -A mendoni se me anë të grupimit (kllapave) gjendet më lehtë shuma?

Zgjidhet barazimi në tabelë:


KLLAPAT

Ushtrojmë

1

3 + 4 + 2

(3 + 4) + 2 3 + (4 + 2)

2

Duke i përdorur kllapat, njehsojmë shumën:

*a*) (7 + 2) + 1 = ___ + 1 = ___ *b*) (4 + 3) + 2 = ___ + ___ = ___

7 + (2 + 1) = 7 + ___ = ___ 4 + (3 + 2) = ___ + ___ = ___

3

*a*) Të njehsojmë ndryshimin e numrit 9 dhe 6 – 4:

___ – ( ___ – ___ ) = ___ – ___ = ___.

*b*) Ndryshimin 10 – 3 e zvogëlojmë për numrin 2:

( ___ – ___ ) – ___ = ___ – ___ = ___.

4

*a*) Dy grupe nxënësish luajnë në oborrin e shkollës. Në një grup janë 4 nxënës, kurse në të dytin 3 nxënës më tepër. Sa nxënës luajnë në oborrin e shkollës?

Njehsojmë: ___ + ( ___ + ___ ) = ___ + ___ = ___.

Pra, në oborrin e shkollës luajnë 11 nxënës.

*b*) Blendi ka mbi bankën e vet 6 lapsa, 3 prej tyre ia dha Arditit. Por, mbi tavolinë ka edhe 2 goma. Sa sende mbetën mbi bankën e Blendit?

Njehsojmë: ( ___ - ___ ) + ___ = ___ + ___ = ___.

Pra, mbi bankën e Blendit mbetën edhe 5 sende.

63

$(3 + 4) + 2 = 7 + 2 = 9$ $3 + (4 + 2) = 3 + 6 = 9$

Sqarohet: *Në fillim mblidhen numrat që janë brenda kllapave.*

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë shembujt në detyrat 2 dhe 3, dhe në çifte të njehsojnë shumën duke i përdorur kllapat. Njëri nxënës zgjidh detyrat nën a, nxënësi tjetër detyrat nën b, njëjtë edhe në detyrën 3. Shkëmbejnë librat dhe korrigjojnë njëri-tjetrin. Nxënësit i lexojnë barazimet e zgjidhura.

**Hapi 4:** Analizohet shembulli i parë i detyrës 4 përmes pyetjeve: - Sa grupe të nxënësve po luajnë në oborr të shkollës? Në grupin e parë janë 4 nxënës, kurse në grupin e dytë sa nxënës janë? (4 +3); –Çfarë do të gjeni? (Sa nxënës luajnë në oborrin e shkollës?). Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur problemat. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete; përdorimin e kllapave gjatë njehsimit të shumës dhe të ndryshimit dhe zgjidhjen e saktë të detyrave sipas përdorimit të kllapave.

**Detyrë:**

Të përgatiten fletëza me këto detyra, të cilat do t'i zgjidhin në fletore: (9 – 5)- 2; 5 + (1 + 3); (6 – 3) + 7.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 141

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kupton shenjat: +, -, <, =, >, dhe i përdor ato në rastet e caktuara;
- Përcakton mbledhorin e parë, mbledhorin e dytë, shumën, të zbritshmin, zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.2; 3.1,3,6; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson mbledhorët e numrit 20;
- Plotëson barazimin me numrin që mungon;
- Zbaton përdorimin e kllapave për të kryer veprime matematikore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Traka matematikore, petëza, fasule, numëratore, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të gjejnë zgjidhjen e gjëegjëzës. *Në një shportë ishin tri mollë, dy ftonj dhe tetë kumbulla. Sa fruta ishin në të?* Nxënësi i parë që gjen zgjidhjen e saktë, shkruan barazimin në tabelë: (3 + 2 ) + 8 = 5 + 8 = 13 ose ( 8 + 2 ) + 3 = 10 + 3 = 13.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen që të punojnë në dyshe me mjete të konkretizimit më të përshtashme për ata (petëza, fasule, kube, shkopinj, numëratore). Kërkohet të plotësojnë detyrën e parë, duke gjetur mbledhorin që mungon për të formuar numrin 20.




**Hapi 3:** Paraqiten në tabelë diagramet:




Ftohen disa nxënës të plotësojnë barazimet me ndihmën e trakës numerike. Në fillim nxënësi shkon të numri (8), dhe pyetet se sa katrorë duhet të kalojë që të shkojë te numri 6 (2 katrorë). Vazhdohet aktiviteti me numra të tjerë të diagramit të parë dhe të dytë.

**Hapi 4:** Duke u bazuar në detyrën e mësipërme, kërkohet nga nxënësit të plotësojnë detyrën e dytë në mënyrë të pavarur. Puna e tyre vlerësohet.

**Hapi 5:** Kërkohet që detyra e tretë të lexohet nga një nxënës. Plotësohet ajo në libër. Udhëzohen që të krijojnë situata problemore dhe të paraqesin barazimet për zgjidhjen e tyre. Bëhet paraqitja e tyre në fletore. U kërkohet të paraqesin në formë të barazimit detyrën e dhënë:

*Me kube një kala 6-katëshe ndërtova, më pas edhe 3 kate shtova. Kur motrës ia tregova, 2 kate rrëzova. Kush më thotë me sa kate kalanë e përfundova?*

**( 6 + 3 ) – 2 = 9 – 2 = 7**

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës dhe ndryshimit të numrave deri në 20; përcaktojnë mbledhorin dhe zbritësin që mungon në fjalitë numerike.

**Detyrë:**

Të plotësohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 142

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.1,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.2,4; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Mbledhja e numrave duke plotësuar 10

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan mbledhorin e dytë si shumë të dy mbledhorëve;
- Plotëson dhjetëshen;
- Njehson shumën e numrave duke plotësuar 10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kuti vezësh, petëza, fasule, numëratore, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet problema: Arti kishte 7 vetura lodër. Shokët i dhanë edhe 4 të tjera për ditëlindje. Sa makina iu bënë? Udhëzohen nxënësit të punojnë individualisht detyrën. Kërkohet nga disa të tregojnë mënyrën e zgjidhjes.

**Hapi 2:** U shpërndahen nxënësve në secilin grup nga një kuti e vezëve secila sosh ka nga 10 hapësira. Kërkohet që ata të vendosin mbi bankë 9 petëza të kuqe dhe 5 petëza të kaltra.
Udhëzohen të vendosin në kuti petëzat e kuqe, pastaj në vendin e zbrazët të shtojnë petëza të kaltra.




Pyeten nxënësit: Sa petëza të kaltra shtuat në kuti? Sa mbetën jashtë kutisë? Si i ndatë petëzat e kaltra? Paraqitet në tabelë dhe shkruhet barazimi.

**9 + 5 = 9 + ( 1 + 4 ) = ( 9 + 1 ) + 4 = 10 + 4 = 14**

1 + 4

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen në plotësimin e detyrës 1. Sa vende për makina ka në parking? Sa makina janë parkuar? Edhe sa makina po presin? Edhe sa makina mund të hyjnë? Sa makina mbetën jashtë parkingut? Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë barazimin dhe rëndësi e veçantë i kushtohet plotësimit të dhjetëshes.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen me pyetje, për të plotësuar detyrat 2,3. Pyeten: Cilët janë mbledhorët? (8+5); Edhe sa duhet t`i shtojmë numrit 8 që të bëhet 10? ( 2); Sa na mbesin te numri 5? (2); Si e ndatë numrin 5?(2 + 3); Pse mbledhori i dytë ndahet si shumë e dy mbledhorëve? (për të plotësuar dhjetëshen). Kërkohet të plotësohen të gjitha barazimet me pyetje të ngjashme.

**Hapi 5:** Nxënësit zgjidhin detyrën 4 individualisht. Duke përdorur kutinë e vezëve, shkruajnë mbledhorin e dytë si shumë e mbledhorëve për të plotësuar 10. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e ndarjes së mbledhorit të dytë si shumë e dy mbledhorëve; plotësojnë dhjetëshen; zgjidhin detyrat duke plotësuar 10.

**Detyrë:**

Të zgjidhen barazimet: 8 + 3 dhe 9 + 5 duke plotësuar 10.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 143

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.1,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.2,4; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave duke plotësuar 10/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan mbledhorin e dytë si shumë të dy mbledhorëve;
- Plotëson dhjetëshen;
- Njehson shumën e numrave duke plotësuar 10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vizatohen me shkumës 10 rrathë në dysheme. Ftohen 9 nxënës të rreshtohen në rrathët e vizatuar. Më pas ftohen edhe 3 nxënës të tjerë t`u bashkohen. I plotësojnë 10 rrathët. Pyeten nxënësit: Sa nxënës ishin në fillim? (9); Sa nxënës u bashkuan? (3); Nga këta 3 nxënës sa mundën të rreshtohen në rrathë? (1); Sa nxënës mbetën jashtë rrathëve? (2); Pra, si u nda mbledhori i dytë? ( 1 + 2 ). Kërkohet që nga një nxënës të shkrujë barazimin në tabelë dhe të shpjegojë se si u plotësua 10 dhe si u nda mbledhori i dytë.

$$9 + 3 = 9 + ( 1 + 2 ) = ( 9 + 1 ) + 2 = 10 + 2 = 12$$




Vazhdon aktiviteti (me rrathë) me mbledhorët 8 dhe 5 nga detyra parë.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen që të përdorin numëratoret për të plotësuar detyrën e dytë. Pyeten: Sa i nevojitet numrit 7 të bëhet 10? Nga kush e merr? (mbledhori i dytë); Si e ndajmë numrin 4? (3 + 1 ); A mund të na tregojë ndonjëri si plotësohet 10 me mbledhorët 9 dhe 7? Si e ndajmë mbledhorin e dytë? (1 + 6 ). Detyra paraqitet në tabelë, nxënësit shkruajnë në fletore.

**Hapi 3:** Pyeten nxënësit të tregojnë se sa mbledhorë janë në barazimin e dhënë të detyrës së tretë. (3) Cilët janë ata? ( 7, 3, 5). Udhëzohen që në kllapa të veçojnë 2 mbledhorë që plotësojnë 10. (( 7+3 ) + 5). Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë individualisht, më pas t'i krahasojnë zgjidhjet me shokun e bankës.

**Hapi 4:** Nxënësit zgjidhin individualisht detyrat e paraqitura në tabelë:

8 + 5 = 8 + ( 2 + 3 ) = ( 8 + 2 ) + 3 = 10 + _ = __

7 + 5 = 7 + ( _ + _ ) = ( _ + _ ) + _ = 10 + _ = __

2 + 3

**6 + 6 = 6 + ( _ + _ ) = ( _ + _ ) + _ = 10 + _ = __**

Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet. Ndihmohen nxënësit që kanë vështirësi.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e ndarjes së mbledhorit të dytë si shumë e dy mbledhorëve; plotësojnë dhjetëshen; zgjidhin detyrat duke plotësuar 10.

**Detyrë:**

Të zgjidhen barazimet e detyrës 4 në libër dhe të paraqiten në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 144

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.1,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.2,4; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave duke plotësuar 10/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan mbledhorin e dytë si shumë të dy mbledhorëve;
- Plotëson dhjetëshen;
- Njehson shumën e numrave duke plotësuar 10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, shirit matematikor, fletë të printuara, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të përdorin numëratoret. Paraqiten mbledhorët 9 + 5 në tabelë. Një nxënës numëron 9 rruaza në numëratoren e klasës, e nxënësit e tjerë në numëratoret e veta. Pyeten nxënësit se edhe sa rruaza nevojiten për t`u shtuar në rendin e parë që të plotësohet 10.
Me numërim të rruazave tregohet se nevojitet edhe 1. Sa rruaza të tjera mbetën për rendin e dytë? ( 4 ). Paraqitet detyra 5 në tabelë.






**Hapi 2:** Vendoset në dysheme shiriti matematikor. Ftohen tre nxënës të dalin para klasës që të zgjidhin detyrën e gjashtë, me mbledhorët 7 dhe 8. Njëri nxënës tregon numrin 7 në shirit, pastaj tregon se edhe sa vende duhet të kalohen për të shkuar te numri 10. (3); Edhe sa mbetën për t`u shtuar? (5).
Nxënësi i dytë paraqet në tabelë barazimin në boshtin numerik. Nxënësi i tretë paraqet në tabelë barazimin
**7 + 8 = 7 + ( 3 + 5 ) = ( 7 + 3 ) + 5 = 10 + 5 = 15**
Më pas paraqitet edhe skema.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe për të plotësuar barazimet e detyrës së tetë. Vëzhgohet puna e tyre duke i ndihmuar nëse ata kanë nevojë.

**Hapi 4:** U shpërndahen nxënësve fletë të përgatitura me shembuj si më poshtë.




Nxënësit plotësojnë individualisht. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e ndarjes së mbledhorit të dytë si shumë e dy mbledhorëve; plotësojnë dhjetëshen; zgjidhin detyrat duke plotësuar 10.

**Detyrë:**
Të zgjidhen barazimet e detyrës 7 në libër, si dhe të paraqiten në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 145

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0);
- Zbaton vetinë e ndërrimit dhe të shoqërimit për mbledhjen e numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,8; III.1,4; IV.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.2,4; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Mbledhja e numrave duke plotësuar 10/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan mbledhorin e dytë si shumë të dy mbledhorëve;
- Njehson shumën e numrave duke plotësuar 10;
- Zbërthen numrin dyshifror si shumë të 2 mbledhorëve.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, dorëza gome, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe. U shpërndahen një palë doreza gome për secilin grup. Paraqitet në tabelë barazimi 6 + 8. Kërkohet që të vendosin mbi bankat e tyre 6 petëza të kuqe dhe 8 të kaltra. Në gishtërinjtë e dorezës të vendosen aq petëza të kuqe sa është mbledhori i parë ( 6 ). Më pas të shtojnë aq petëza të kaltra sa të ketë vende të zbrazëta në gishtërinjtë e dorezave ( 4 ). Pyeten nxënësit: Sa petëza të kaltra mbetën jashtë gishtërinjve? ( 4 ); Si u nda mbledhori i dytë që të plotësohet 10?




Grupi i parë që gjeti zgjidhjen e barazimit, vendos "lapsat në mes", dhe nxënësi që ka atë laps të zgjedhur, shkruan barazimin në tabelë. Aktiviteti përsëritet edhe me mbledhorët 9 + 7 dhe 7 + 7. Më pas plotësohet në libër detyra 9.

**Hapi 2:** Udhëzohen të punojnë me numëratore. Kërkohet të paraqesin numrin 13. Pyeten ata: Sa rruaza janë në rreshtin e parë dhe sa janë në rreshtin e dytë? Pra si e ndatë numrin 13 në numëratore? (10 + 3) për të shtuar edhe 4 rruaza, në cilin rresht keni mundësi të shtoni? (rreshtin e dytë) Pse?
Paraqitet në tabelë barazimi



**13 + 4 =( 10 + 3 ) + 4 = 10 + ( 3 + 4 ) = 10 + 7 = 17**

**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit të punojnë individualisht në zgjidhjen e detyrave të paraqitura në tabelë. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

| | |
|---|---|
| 8 + 7 = 8 + ( _ + _ ) = ( 8 + _ ) = 10 + _ = _ | 14 + 5 = ( 10 + _ ) + 5= 10 + ( _ + 5 ) = 10+_=___ |
| 6 + 5 = | 16 + 3 = |

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e ndarjes së mbledhorit të dytë si shumë e dy mbledhorëve; zgjidhin detyrat duke plotësuar 10; zbërthejnë numrin dyshifror si shumë të mbledhorëve (Dh + Nj).

**Detyrë:**
Të zgjidhet problema matematikore në libër dhe të paraqitet në fletore (detyra 11).

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 146

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4. V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.4; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shkruan dy barazime të zbritjes nga barazimet e mbledhjes;
- Shkruan barazime duke interpretuar mbledhjen dhe zbritjen në bosht numerik;
- Shpjegon zbritjen si veprim i kundërt me mbledhjen.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shufrat, kube, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuha amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Shkuhen në tabelë tre numra, p.sh.: 6, 4, 2. Kërkohet nga nxënësit të krijojnë me këta numra dy barazime me mbledhje dhe dy barazime me zbritje. Lexohen dhe shkruhen në tabelë.

**Hapi 2:** Kalohet në detyrën 1, dhe nxënësit tregojnë se çfarë po shkruajnë në tabelë. Pyeten: -Cilin veprim e përdorën Ardi dhe Arta? –Po Besa dhe Edoni? -Çfarë janë mes vete veprimi i mbledhjes dhe veprimi i zbritjes? –Pse?
Nxënësit duhet të arrijnë në përfundim se këto dy veprime janë të kundërta.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të komentojnë shembullin e dhënë në detyrën 2. -Sa trekëndorë kemi gjithsej?-Po nëse 9 trekëndorëve ua heqim 4, sa na mbesin? – Çfarë paraqet numri 5 te barazimi me




mbledhje? - Po nëse numrit 9 ia heqim 5, sa na mbesin?.- Çfarë paraqet numri 4 te barazimi me mbledhje? Pra, këto dy veprime çfarë janë mes vete? Dy shembuj të tjerë nxënësit i punojnë individualisht. Në fund, lexohen barazimet e krijuara.

**Hapi 4:** Paraqitet në tabelë shembulli i parë, i boshtit numerik nga detyra 3 dhe bashkë me nxënësit komentohet e plotësohen barazimet me mbledhje dhe zbritje. Nxiten nxënësit të tregojnë që zbritja është veprim i kundërt me mbledhjen.

$6 + 3 = 9$ $3 + 6 = 9$ $9 - 6 = 3$ $9 - 3 = 6$

Shembullin e dytë e plotësojnë të pavarur. Në fund, lexohen barazimet e plotësuara.

**Hapi 5:** Detyra 4, 5 punohet në dyshe, duke plotësuar barazimet. Pas plotësimit lexohen ato.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të punojnë individualisht në detyrën 6. Plotësohen 8 barazimet në shembullin e parë. Pas plotësimit parashtrohet pyetje: *-Ku dallojnë 4 barazimet e para nga 4 barazimet e fundit?* Nxënësit krijojnë vetë 8 barazime me numrat e dhënë, në shembullin e dytë.

Ata vlerësohen për përfundimin e kësaj detyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit shkruajnë saktë dy barazime të zbritjes nga barazimet e mbledhjes, si dhe për interpretimin e boshtit numerik. Po ashtu ata shpjegojnë zbritjen si veprim të kundërt me mbledhjen.

**Detyrë:**
Të punohen detyrat 7 dhe 8 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 147

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.4; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Krijon dy barazime me zbritje nga barazimet me mbledhje;
- Shkruan barazime duke interpretuar shigjetat në boshtin numerik;
- Përdor konceptet matematikore *mbledhje, zbritje.*

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë A4, numëratore, shufra, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në fletë A4, emrin dhe mbiemrin e tyre. U kërkohet të mbledhin numrin e shkronjave të emrit e të mbiemrit dhe anasjelltas. Më pas, nga numri i përgjithshëm të zbresin një herë numrin e shkronjave të emrit e më pas të mbiemrit. Barazimet lexohen, shkruhen në tabelë. Nxiten nxënësit që gjatë komentimit të tyre, të përdorin konceptet *mbledhje* dhe *zbritje* si veprime të kundërta.

**Hapi 2:** Komentohet nga nxënësit shembulli me trekëndorë në detyrën 1, si dhe lexohen barazimet. –Çfarë kanë të përbashkët të gjitha barazimet? (numrat: 6, 4, 10); –Pra, me tre numra çfarë barazime mund të formojmë?
Nxënësit udhëzohen të punojnë individualisht dy shembujt e tjerë të detyrës 1.




**Hapi 3:** Nxiten nxënësit që të plotësojnë barazimet me mbledhje duke interpretuar shigjetat në boshtin numerik. Ndihmohen me pyetje: -Sa numra është shigjeta e parë e gjelbër? –Shigjeta e dytë, e gjelbër nga cili numër niset dhe ku arrin? –Sa numra është e gjatë shigjeta e dytë? –Paraqiteni këtë me barazim. Në të njëjtën mënyrë interpretohen edhe shigjetat e kuqe. Më pas, duke u mbështetur në barazimet me mbledhje shkruajnë dy barazime me zbritje. Shembullin e dytë e punojnë të pavarur.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen që të ndërtojnë një kullë me 7 kube të kuqe. Atyre u shtojnë edhe 3 kube të kaltra. *–Sa kube keni gjithsej?- Plotësoni barazimet në libër.* Nga 2 barazime me mbledhje formojnë 2 barazime me zbritje.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet që të punojnë individualisht në plotësimin e detyrës 4. Puna e tyre e pavarur kontrollohet e vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit krijojnë saktë dy barazime të zbritjes nga barazimet me mbledhje; shkruajnë barazime të sakta duke interpretuar shigjetat në boshtin numerik si dhe përdorin konceptet mbledhje, zbritje si dy koncepte të kundërta.

**Detyrë:**
Me numrat 15, 12, 3 shkruani 4 barazime në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 148

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave, pa e prishur dhjetëshen

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Demonstron me mjete pune zbritjen e numrave pa prishur dhjetëshen;
- Shpjegon ecurinë e zbritjes pa e prishur dhjetëshen;
- Njehson ndryshimin e numrave pa prishur dhjetëshen.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shufra, kube, numëratore.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në çifte, ku njëri do të vendosë mbi bankë 17 kube. Prej tyre i heq 4 kube. Shoku i bankës e shkruan si barazim këtë veprim: 17 – 4 = 13. Lexohet barazimi dhe parashtrohet pyetja: -Gjatë zbritjes a ka ndryshuar numri i kubeve? –Po dhjetëshja, a është prishur? –Pra, kemi zbritje pa u prishur dhjetëshja. -Ç'mendoni pse nuk u prish dhjetëshja gjatë zbritjes?

**Hapi 2:** Nxënësit i përshkruajnë shembujt në detyrën 2. I plotësojnë barazimet në libër dhe i lexojnë ato. Në tabelë shkruhen barazimet: 6 – 2 =4, 16 – 2 = 14. Nxiten të krahasohen ato.-Ku dallojnë këto dy barazime?




**Hapi 3:** Plotësohet detyra 2 në mënyrë të pavarur nga nxënësit.
Përshkruajnë ecurinë e zbritjes dhe dallimin mes dy barazimeve 10 -3 = 7 , 20 – 3 = 17.

**Hapi 4:** Nxënësit plotësojnë barazimet e detyrës 3 duke u bazuar në paraqitjet figurative. Krahasohen çiftet e barazimeve nga nxënësit. Ndihmohen me pyetje: -Për sa dallohet ndryshimi te çiftet e barazimeve? –Pse?

**Hapi 5:** Udhëzohen të vërejnë shigjetat në bosht numerik dhe të plotësojnë barazimet në detyrën 4. Ju tërhiqet vëmendja te drejtimi i shigjetave gjatë zbritjes, prej numrit më të madh kah numri më i vogël.

**Hapi 6: N**xënësit udhëzohen që të zbresin numrat në detyrën 5. Ata punojnë individualisht sipas modelit të dhënë. Puna e nxënësve kontrollohet e vlerësohet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësi demonstron me mjete pune zbritjen e numrave pa prishur dhjetëshen, shpjegon ecurinë e zbritjes dhe njehson saktë ndryshimin e numrave pa prishur dhjetëshen.

**Detyrë:**
Barazimet e detyrës 5 të përshkruhen në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 149

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë.
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4; V.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.4; 3.6; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave, pa e prishur dhjetëshen/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson ndryshesën e numrave pa e prishur dhjetëshen.
- Komenton ecurinë e zbritjes së numrave pa e prishur dhjetëshen;
- Zbaton zbritjen pa prishur dhjetëshen në zgjidhjen e situatave problemore.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, kub.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Njoftohen nxënësit që do të punojnë në grupe. Çdo grup ka një kub, i cili në çdo faqe është ndryshimi i dy numrave. Kubi hedhet nga secili nxënës. Ndryshimi shkruhet në fletë A4 me një ngjyrë të caktuar dhe njehsohet ndryshesa. Kështu vazhdon çdo nxënës brenda grupit. Njehsimet kontrollohen mes vete. Po ashtu në çdo grup përzgjidhet një ngjyrë e caktuar lapsi dhe pronari i tij e lexon barazimin e tij. Ky aktivitet përmblidhet me një pyetje përmbledhëse: -Çfarë kanë të përbashkët të gjitha këto barazime?

**Hapi 2:** Udhëzohen që të njehsojnë ndryshesën e numrave në detyrën 1. U tërhiqet vëmendja që të punojnë paralelisht: një barazim majtas, një djathtas. Mund të ndihmohen nga boshti numerik. Pas për-




fundimit lexohen dhe krahasojnë dy barazime paralele. *-Ku dallojnë?- Për sa dallojnë mes vete?*

9 – 6 = 3 19 – 6 = 13

**Hapi 3:** Nxënësit njehsojnë të pavarur ndryshesat e numrave në detyrën 2. Lexojnë dhe komentojnë ecurinë e zbritjes me ndihmën e pyetjeve: -Çfarë zbritje kemi? –Cilat shifra zbriten? –Cila shifër nuk prishet por përshkruhet?

**Hapi 4:** Lexohet detyra me fjalë dhe zgjidhet nga nxënësit individualisht. Lexohet edhe zgjidhja.

**Hapi 5:** Udhëzohen të vërejnë detyrën 5 dhe ta komentojnë. -Çfarë paraqesin numrat në gjethe? -Ç'paraqet numri brenda rrethit? -Cilin numër duhet shkruar në gjethin e zbrazët, në rendin e parë?- Si gjendet numri që mungon? Tre shembujt e tjerë punohen në mënyrë të pavarur. -Çfarë kanë të përbashkët këto 4 rende me gjethe? -Ku ndryshojnë?

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të zbresin nga numri 19, numrat e vendosur rreth tij në petalet e lules. Ata punojnë individualisht.
Punohet vetëm një shembull. Puna e tyre kontrollohet e vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit njehsojnë saktë ndryshesën e numrave pa e prishur dhjetëshen dhe duke komentuar ecurinë e zbritjes. Po ashtu ata zgjidhin saktë situatat problemore duke zbatuar këtë lloj zbritjeje.

**Detyrë:**
Të punohen detyrat 4 dhe 7 dhe shembujt e paplotësuar të detyrave 5 dhe 6.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 150

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.2; III.4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.4; 2.2; 3.1; 3.6; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Zbritja e numrave, duke veçuar dhjetëshen

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton zbritësin si shumë e dy mbledhorëve;
- Komenton me fjalë ecurinë e zbritjes së numrave, duke veçuar 10;
- Njehson saktë ndryshesën e numrave duke veçuar 10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, shufra, kube, shkopinj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të nxjerrin 14 shkopinj (1 dhjetëshe dhe 4 shkopinj të veçuar). Nga to duhet hequr 5 shkopinj. Parashtrohet pyetja: -Si do t'i zbresim këta dy numra? Nxënësit tregojnë mënyrën e tyre të zbritjes. –Ç'mendoni, a është më lehtë që numrit 14 t'ia heqim një herë 4?- Sa mbesin? (14 – 4 = 10 ;) –Po tani edhe sa na kanë mbetur për të hequr numrit 10? ( 10 – 1 = 9 ) –Pra sa bëjnë 14 – 5 =? Nxënësit plotësojnë barazimet në detyrën 1.

Hapi 2: Shkruhet në tabelë shprehja numerike: 13 – 9 = Parashtrohet pyetja: - Për të zbritur më lehtë, kur zbritësi është numër më i madh se njëshet e numrit dyshifror, si veprojmë?
-Sa i duhet hequr numrit 13 që të mbetet (veçohet) 10? –Nga numri 9 që duhet hequr ne ia hoqëm vetëm 3. Edhe sa na kanë mbetur për t'ia hequr numrit 10?- Pra, si e ndajmë numrin 9?




Shkruhet në tabelë barazimi:
**13 – 9 = 13 – ( 3 + 6 )= (13 – 3 ) – 6 = 10 – 6 = 4**

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë barazimet në detyrën 2 në libër. Ata punojnë individualisht. Kur të mbarojnë, komentojnë zbritjet e tyre duke i ndihmuar me pyetje të ngjashme si më lart. Mund të shkruhen edhe në tabelë gjatë komentimit të tyre.
Çfarë zbritje kemi në këto barazime?- Pse duhet mësuar ky lloj i zbritjes?

**Hapi 4:** Shkruhet në tabelë shembulli i parë, nga detyra 3 e librit. Paraqitet skema e zbritjes duke veçuar 10 dhe komentohet së bashku me nxënësit. Kurse skemën e shembullit të dytë e plotësojnë të pavarur dhe në fund e komentojnë.

**Hapi 5:** Formohet një detyrë problemore sipas situatës në detyrën 4. P.sh.: - Katër nxënës duhet t'i marrin librat e tyre në çanta. Të gjithë librat janë mbi tryezë. Çdo çantë ka një numër dhe çdo libër një ndryshim me numra. Ndihmohen nxënësit t'i gjejnë librat e tyre.

Nxënësit punojnë të pavarur. Njehsojnë ndryshimin duke veçuar 10 dhe kështu gjejnë librat e çdo nxënësi. Libri i caktuar lidhet me anë të shigjetës me çantën, e cila bart ndryshesën e caktuar. Puna e tyre vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit emërtojnë saktë zbritësin si shumë e dy mbledhorëve, duke komentuar me fjalë ecurinë e zbritjes me veçim të 10. Po ashtu ata njehsojnë saktë ndryshesën e numrave duke veçuar 10.

**Detyrë:**
Krijoni një detyrë problemore me fjalë, duke e zbatuar zbritjen me veçim të 10 gjatë zgjidhjes së saj.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 151

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 2.1; 3. 1,4,5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e numrave, duke veçuar dhjetëshen/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kryen zbritjen e numrave me numrat deri 20;
- Njehson ndryshmin e numrave duke veçuar 10;
- Krijon situata problemore me zbritje me fjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fije shkrepse ose shkopinj, numëratore, shufra, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxirren përpara tabelës 13 fëmijë. I numërojmë së bashku ata. Pyeten nxënësit: Për të mbetur 10 fëmijë, sa fëmijë duhet të shkojnë në bankat e tyre? (3 fëmijë). Janë 15 zogj në pemë, nëse fluturojnë 5 zogj nga pema, edhe sa zogj mbesin në pemë? Shkruajmë barazimet në tabelë: 13 – 3 = 10, 15 – 5 = 10. Merren edhe disa shembuj të tjerë ku bëhet zbritja e numrave duke veçuar numrin 10.

**Hapi 2:** Paraqitet në tabelë boshti numerik dhe sqarohet para nxënësve mënyra si bëhet zbritja e numrave duke veçuar dhjetëshen përmes boshtit numerik.
Nxënësit pasi t'i kuptojnë sqarimet, e plotësojnë detyrën e parë në libër.




mentojnë mënyrën e zgjidhjes të disa prej tyre.

**Hapi 3:** U shpërndahen nxënësve në grupe shufra, kube ose fije shkrepëse. Kërkohet nga ata të formojnë detyra ku paraqesin zbritjen e numrave duke veçuar numrin 10. Pastaj plotësojnë detyrat 2 dhe 3 në libër.




**Hapi 4:** Pyeten nxënësit pse është ndarë zbritësi si shumë e dy mbledhorëve në detyrat 3 dhe 4? Pse nuk mund të ndahet ndryshe? (p.sh., 14-6: 6 ndahet në 4 +2; pse nuk ndahet ndryshe?). Kërkohet nga nxënësit të përmendin që ndarja bëhet për të veçuar dhjetëshen. Punohen detyrat 3 dhe 4.

**Hapi 5:** Paraqitet në tabelë zbritja e numrave duke veçuar 10, p.sh., 13 – 6, sqarohet para nxënësve ndarja e numrit 6 si shumë e dy mbledhorëve për të veçuar 10. Dalin në tabelë edhe nxënësit për të kryer detyra të ngjashme. Punohen në libër detyrat 5 dhe 6.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje detyrën 8 në libër. Punohet detyra duke i ndjekur hapat paraprakë. Nxiten nxënësit të krijojnë detya me fjalë si shembulli i kësaj detyre. I zgjidhin ato në fletore dhe argu-

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim; për gjetjen e ndryshmit të numrave duke veçuar 10 dhe krijimin e situatave problemore me zbritje me fjalë.

**Detyrë:**
Të punohen në shtëpi detyrat 7 dhe 9 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 152

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,2; III.1,2 ,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 5.6; 6.2,6.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e shumës

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kupton zbritjen si heqje e elementeve nga grupi;
- Njehson ndryshimin e numrave duke veçuar 10;
- Krijon situata problemore me zbritje me fjalë.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, shufra, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Merren disa topa të vegjël dhe vendosen 14 topa në një tavolinë. U tregohet nxënësve që duhet të largojmë 6 topa, por si mund ta bëjmë këtë që ta kemi më të lehtë për ta veçuar numrin 10? Ata shprehin disa mendime dhe u tregohet nxënësve që numrin 6 duhet ta ndajmë në dy mbledhorë në mënyrë që të largojmë njëshet nga numri 14 p.sh.: 14 – (4 + 2) = 14 – 4 – 2 = 10 - 2 = 8. Jepen disa shembuj të tillë derisa ta kuptojnë zbritjen e numrave nga shuma.

**Hapi 2:** Vizatohen 13 rrathë në tabelë dhe paraqitet veprimi i zbritjes 13 – 4 = Pyeten nxënësit: Për të zbritur këta dy numra duke e veçuar 10, sa rrathë duhet të fshijmë?

(Duhet të ndajmë numrin 4 në dy mbledhorë që të largojmë njëshet 3 + 1 ). Paraqitet detyra e kompletuar në tabelë, pastaj nxënësit i punojnë detyrat e tjera.




**Hapi 3:** Shkruhet në tabelë detyra 3. Nxënësit dalin me radhë, tregojnë me fjalë se si duhet vepruar dhe e zgjidhin detyrën. Detyra punohet edhe në libër në mënyrë individuale.

**Hapi 4:** Detyrat 4 dhe 5 që janë me fjalë, nxënësit i punojnë në çifte. Njëri nxënës punon detyrën 3, tjetri detyrën 4, kontrollojnë punën e njëri-tjetrit, pastaj ndërrohen rolet. Nxënësit ashtu në çifte krijojnë një detyrë me fjalë dhe e prezantojnë para nxënësve duke e zgjidhur në tabelë. Përdorin numëratore, kube ose shufra për të lehtësuar zbritjen.

**Hapi 5:** Nxënësve u shpërndahen detyra me fjalë të cilat janë përgatitur më parë dhe janë paluar në formë katrore. Letrat futen në një kuti dhe nxënësit do të tërheqin një letër dhe do të bëjë zgjidhjen e detyrës me fjalë e cila është paraqitur në letër. Bisedohet pastaj rreth zgjidhjes së detyrave me fjalë.

**AKTIVITET SHTESË:**
Kërkohet nga nxënësit që njëri të thotë një numër nga 10 deri në 20 (p.sh., 12), tjetri të thotë sa duhet hequr që të veçohet dhjetëshja. (duhet hequr 2 ). Vazhdohet kjo lojë me sa më shumë nxënës. Ata që gabojnë thonë ndonjë vjershë ose këndojnë ndonjë këngë.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim dhe aktivitete; për zbritjen e shumës duke veçuar 10 dhe formimin e problemave me fjalë për zbritjen e numrave nga shuma.

**Detyrë:**
Në shtëpi të punohen detyrat 3 dhe 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 153

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë edhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,2; III.1,2 ,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 5.6; 6.2,6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbritja e shumës/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Bën zbritjen e numrave me numra deri në 20;
- Njehson ndryshimin e numrave duke veçuar 10;
- Zgjidh situata problemore me zbritje me fjalë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Numëratore, shufra, kube.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Lexohet vjersha:

Në një degëz molle,
Veçoje dhjetëshen,
Në pesëmbëdhjetë kokrra mollë,
Që të mos ngatërrohesh.

Kur këputëm shtatë
Ndaje shtatë, në pesë plus dy
Pesëmbëdhjetë, kur heqim pesë,
Thoni, vallë, sa lamë?

Për këtë dhe zbritja,
Me dhjetë barazohet,
Duhet të mësohet,
Hiq dhe dy,
Tetë do të formohet.

**Paraqitet shprehja: 15 – 7 = 15 – (5 + 2 ) = (15 – 5) -2 = 10 – 2 = 8**

**Hapi 2:** Paraqiten në tabelë shembuj të zbritjes së shumës duke e ndarë zbritësin në dy mbledhorë. Nxënësit plotësojnë detyrat pasi ta kenë kuptuar mirë atë.







**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrat 2 dhe 3 në mënyrë individuale, duke ndjekur shembujt paraprakë. I krahasojnë pastaj me shokun/shoqen e bankës. Nxënësit përdorin numëratore, kube ose shufra për të lehtësuar zbritjen.

**Hapi 4:** Lexohet detyra me fjalë nga mësuesja. Nxiten nxënësit të japin përgjigje se si duhet të shkruhet ajo. Nxënësit plotësojnë hapësirat e zbrazëta duke vendosur numrat në vendet e duhara. E punojnë më pas detyrën. Kontrollohet dhe vlerësohet plotësimi i detyrës.

**Hapi 5:** Detyrat 6 dhe 7 punohen në mënyrë të pavarur. Nxënësit udhëzohen që për të zbritur shumën duke veçuar 10, të zbresin së pari me numrin i cili i largon njëshet, për ta pasur më të lehtë zbritjen. P.sh.:
17 – 2 – 7 = _____, 19 – 6 – 9 = _____,
12 – 7 – 2 = _____ etj.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 7 në libër dhe në vend të rezultatit vendosin shkronjën përkatëse. Ata do të fitojnë emërimin e një feste e cila festohet në përfundim të abetares. Bisedohet pastaj me nxënës: Pse kjo festë quhet kështu? A do të festoni edhe ju kur ta përfundoni abetaren? Edhe sa shkronja keni për të arritur deri te kjo festë? etj.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim; për zbritjen e shumës duke veçuar 10 dhe zgjidhjen e problemave me fjalë për zbritjen e numrave nga shuma.

**Detyrë:**
Në shtëpi të punohet detyra e fundit në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 154

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20, duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,2; III.1,2 ,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 5.6; 6.2,6.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon zbritjen si heqje e elementeve nga grupi;
- Interpreton mbledhjen si bashkim i dy grupeve;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Blloqe, lodër, numëratore, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare(shqipe); Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendoset në mur një pikado, ku kemi paraqitur një numër në mes, dhe në dy rrathët e tjerë të pikados, janë numrat të cilët na e japin shumën në mes, ose ndonjëherë mungon njëri mbledhor. Dalin me radhë nxënësit, gjuajnë në pikado dhe numrin e qëlluar e shkruajnë në tabelë, pastaj gjuajnë përsëri dhe e gjejnë shumën e atyre dy numrave. Nëse ka qëlluar në numrin që e tregon shumën, atëherë nxënësi do të përcaktojë vetë mbledhorët, p.sh.: 13 = 8 + 5.

**Hapi 2:** Ndahen nxënësit në dy grupe të mëdha. Grupeve u jepen fletë A4 dhe blloqe lodër ku janë paraqitur numra të ndryshëm. Njëri grup ka për detyrë të formojë veprime të mbledhjes duke i përdorur blloqet, duke ndërtuar një mur me blloqe. Ndërsa grupi tjetër, formon detyra me zbritje. Veprimet e kryera paraqiten në fletë A4, krahasojmë pastaj punën e të dyja grupeve.




**Hapi 3:** Hapen librat, u sqarohet nxënësve si duhet vepruar. Fillohet puna nga ana e majtë dhe shkojnë në të djathtë, duke i kryer veprimet me mbledhje dhe zbritje, pastaj vazhdohet poshtë, përpjetë dhe arrihet aty ku është filluar detyra. Numrat e fituar shkruhen në katrorët bosh.

**Hapi 4:** Në detyrën e radhës, nxënësit i plotësojnë format e pikados me numrat e duhur. Ata i ndjekin shembujt që u zbatuan më herët te loja me pikado. Shkruajnë mbledhorët që mungojnë në drejtkëndëshat e zbrazët.

**Hapi 5:** Paraqitet në tabelë një shembull i detyrës 3, vizatohet një tabelë, ku në majë të tabelës qëndron shuma, në anën e majtë ndodhen mbledhorët e parë, ndërsa nxënësit dalin dhe e gjejnë mbledhorin e dytë për ta formuar shumën që është lart. Detyrat e tjera të këtij lloji, nxënësit i punojnë të pavarur në libër.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen t'i punojnë dy detyrat e fundit në libër duke i kryer veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes. Argumentojnë pastaj me fjalë, rezultatet dhe mënyrën si kanë ardhur deri te rezultati. Për ta lehtësuar punën e tyre përdorin numratore ose mjete të tjera.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për shpjegimin, interpretimin dhe njësimin e numrave deri në 20.

**Detyrë:**
Në fletore kryeni 3 detyra me mbledhje dhe 3 me zbritje me numrat deri 20.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 155

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3, II.1,2; III.1,2 ,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.4; 5.6; 6.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon zbritjen si heqje e elementeve nga grupi;
- Interpreton mbledhjen si bashkim i dy grupeve;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kube, numëratore, fletë A4.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe); Edukatë figurative; Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten në tabelë shembuj të mbledhjes dhe të zbritjes duke u përsëritur kufizat e tyre. Dalin nxënës me radhë te tabela dhe kryejnë detyra me mbledhje dhe zbritje duke i përmendur kufizat e tyre, si dhe duke argumentuar me fjalë zgjidhjen e detyrës. Nxiten nxënësit të formojnë detyra edhe në mënyrë individuale në fletoret e tyre.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë detyrat 1 dhe 2 në libër. Te detyra 1, njehsojnë duke e gjetur shumën e numrave të dhënë. Te detyra 2 njehsojnë duke e gjetur ndryshimin e numrave. Rezultatet i shkruajnë në rrathët e zbrazët.

**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit të zgjidhin detyrat 3 dhe 4.
Gjejnë shumën dhe ndryshimin e numrave 16 dhe 3.




16 + 3 = 19 16 – 3 = 13

Për ta lehtësuar mbledhjen dhe zbritjen, nxënësit përdorin numëratore ose kube. Përmendin kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes gjatë zgjidhjes së detyrave.

**Hapi 4:** Njehsojnë dhe plotësojnë detyrën 5 në libër. Gjejnë zbritësin pasi i zbritshmi dhe ndryshimi janë të njohur. Në detyrën 6 njehsojnë vlerën e shprehjes (15 – 3) + 4= duke u liruar së pari nga kllapat e pastaj veprimi tjetër me radhë.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet t'i punojnë me kujdes detyrat 7 dhe 8. Vendosin √ për frutën me peshën më të vogël te detyra 7. Ndërsa te detyra 8 vendosin √ për frutën me peshën më të madhe.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen ta kryejnë detyrën 9. Gjejnë numrin që po mungon dhe argumentojnë me fjalë që zbritja është veprimi i kundërt i mbledhjes. Ndërsa te detyra e fundit në libër nxënësit e analizojnë detyrën duke u munduar ta gjejnë numrin që po mungon, numër i cili është zgjidhja e komplet detyrës 10. Detyrat e nxënësve kontrollohen dhe vlerësohen.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për shpjegimin, interpretimin dhe njehsimin e shumës dhe ndryshimit me numrat deri në 20.

**Detyrë:**
Në fletore kryeni 3 detyra me mbledhje dhe 3 me zbritje me numrat deri 20.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 156

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.1,4; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Edhe matematika është zbavitje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Gjen barazime që japin numrin e përcaktuar;
- Shpjegon zgjidhjen e situatës problemore, duke u orientuar në labirinth;
- Njehson shumën dhe ndryshesën e numrave të dhënë për të fituar një figurë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Ngjyra, etiketa me numër.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendoset në tabelë etiketa me numrin 14. Nga nxënësit kërkohet të gjejnë sa më shumë barazime që japin numrin e përcaktuar. Të gjitha barazimet shkruhen në tabelë dhe lexohen.




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë figurën 1 dhe t'u përgjigjen pyetjeve. – A i pëlqejnë lepurit karotat? – Si mund të zbulojmë sa karota mund të hajë lepuri? Nxënësit duke u orientuar në labirinth gjejnë numrin e karotave që mund t'i hajë lepuri.




**Hapi 3:** Nxënësit vëzhgojnë detyrën 2 dhe tregojnë se çfarë duhet bërë. Udhëzohen të njehsojnë në fletore shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë. Nxënësit shkëmbejnë fletoret dhe e krahasojnë punën e njëri-tjetrit.

**Hapi 4:** Sipas shumës dhe ndryshimit të fituar, nxënësit ngjyrosin figurat me ngjyrat e përcaktuara. Vlerësohet puna e tyre.




**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit gjejnë barazime të sakta që japin numrin e përcaktuar, tregojnë numrin e saktë të karotave që mund të hajë lepuri, ngjyrosin figurat dhe njehsojnë saktë shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

**Detyrë:**
Shkruani në fletore disa barazime nga detyra 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 157

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,7; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.1,4; 4.2, 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Zbatimi i mbledhjes dhe i zbritjes në problema

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson me figura duke përcaktuar numrin e çdo figure;
- Zgjidh situata problemore duke zbatuar veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa me figura dhe numra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Në tabelë paraqitet një detyrë. Nga nxënësit kërkohet të gjejnë zgjidhjen në bazë të të dhënave të paraqitura në etiketa.




**Hapi 2:** Vëzhgohet dhe analizohet detyra 1 duke i pyetur nxënësit:- Çfarë po vëreni? (Disa figura të kafshëve); -Çfarë duhet të gjejmë? (Numrin që fshihet pas kafshës.); Numrat që janë mbi shigjeta na




tregojnë se në cilin rresht të kafshëve mund të gjejmë më lehtë numrin. Fillojmë prej rreshtit të katërt. –Në rreshtin e katërt sa lepuj janë dhe sa është shuma? (3 lepuj, shuma 12); – Cilin numër ka lepuri? (4). Vazhdohet me rreshtin e dytë, të parë dhe të tretë dhe zbulohen numrat. Makushi =2, zogu = 6, dreri=5.
Njëjtë veprohet edhe me detyrën 2. Numrat që fshihen pas frutave janë: dardha=2, dredhëza=3, qershia=1, molla=7.

**Hapi 3:** Sqarohet kërkesa e detyrës 3. Nxënësit udhëzohen që të pavarur t'i plotësojnë fushat e zbrazëta, në mënyrë që shuma e tyre si horizontalisht edhe vertikalisht të jetë e barabartë me 20.

Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive; përcaktimin e saktë të numrit për çdo figurë dhe zgjidhjen e saktë të problemës.

**Detyrë:**
Të shkruhen në fletore barazimet e detyrës 2.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 158

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Identifikon numrat çift dhe tek nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2 ; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1, 4;5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat çift dhe tek

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon numrat çift dhe tek;
- Dallon numrin çift nga numri tek në vargun e numrave të dhënë;
- Liston numrat çift dhe tek.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fasule, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të nxjerrin mbi bankë 2 fasule, ndërsa në tabelë shkruhet numri 2. Më pas ata nxjerrin edhe 2 fasule të tjera. –Sa është numri i fasuleve? (Katër). Pas numrit 2 shkruhet numri 4. -Nxirrni edhe dy fasule. Në tabelë shkruhet vargu i numrave: 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20 dhe u tregohet nxënësve se janë numra çift.
Në mënyrë të njëjtë vazhdohet edhe me numrat tek: 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19. Vihet në pah se numrat tek nuk mund të ndahen në dy pjesë të barabarta, ndësa numrat çift po.

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë figurën e detyrës 1 dhe të shkruajnë numrin në secilën shtëpi. Ndihmohet duke i pyetur: - Çfarë mendoni, cili numër duhet të shkruhet pas numrit 3? (5); Pse? Cili varg i numrave formohet? (Vargu i numrave tek). Nxënësit vazhdojnë t'i shkruajnë numrat në çdo shtëpi.


NUMRAT ÇIFT DHE TEK - NUMRAT RENDORË

Mësojmë

1. NUMRAT ÇIFT DHE TEK

1

1 3 15 2 4 10

2

0 1 2 3 4 5 6 19 20

0,2,4,6 1,3,5

Numrat çift: 0,2,4,6,___,___,___,___,___,___,___,___.

Numrat tek: 1,3,5,___,___,___,___,___,___,___,___.

3

Shkruajmë numrat çift të dhjetëshes së dytë.

12, ___, ___, ___, ___ .

Shkruajmë numrat tek të dhjetëshes së parë.

___, ___, ___, ___, ___ .

4

Numri më i vogël çift i dhjetëshes së dytë është ___.

Numri më i madh tek i dhjetëshes së parë është ___.

5

Nga numri më i madh tek i dhjetëshes së dytë, zbresim numrin më të madh tek të dhjetëshes së parë.

Numri më i madh tek i dhjetëshes së dytë është ___, kurse numri më i madh tek i dhjetëshes së parë është ___. Ndryshimi i kërkuar është:

___ – ___ = ___ .

85

**Hapi 3:** Plotësohet vargu i numrave deri në 20. Numrat me ngjyrë të kuqe janë numra çift, ndërsa ata me ngjyrë të kaltër janë numra tek. Mund të drejtohen pyetje si: - Numri 7 është numër çift apo tek? Numri 12 është çift apo tek? Nxënësit e dallojnë numrin çift nga numri tek në vargun e numrave të dhënë.

**Hapi 4:** Paraqiten në tabelë numrat e dhjetëshes së parë dhe numrat e dhjetëshes së dytë. Ftohet një dyshe vullnetare në tabelë. Njëri shkruan numrat çift të dhjetëshes së dytë, tjetri numrat tek të dhjetëshes së parë. Paralelisht nxënësit plotësojnë librin. Lexohen vargjet e numrave të formuar. Njëjtë veprohet edhe në detyrën 4.

**Hapi 5:** Nxënësve u shpërndahen disa etiketa. Prej tyre kërkohet të shkruajnë numrat çift me ngjyrë të kuqe, numrat tek me ngjyrë të kaltër dhe t'i rendisin sipas radhës. Puna e nxënësve vlerësohet.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 |

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete; për identifikimin dhe dallimin e numrave çift dhe tek. Po ashtu ata vlerësohen për listimin e saktë të numrave çift dhe tek.

**Detyrë:**

Të punohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 159

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Identifikon numrat çift dhe tek nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2 ; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1; 3.4; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Numrat çift dhe tek/ U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Veçon numrat çift nga numrat tek;
- Dallon numrin çift nga numri tek në vargun e numrave të dhënë;
- Ngjyros fushat e numrave çift dhe tek.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fasule, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqiten para nxënësve disa mollë të vizatuara me numrat nga 1 deri 20 dhe dy shporta me shkrimin çift dhe tek. Ftohen nxënësit me radhë të marrin mollën me numër dhe ta vendosin në shportën e duhur. Vazhdohet kështu deri në përfundim të numrave. Në fund lexohen numrat e vendosur në shporta.






**Hapi 2:** Duke u bazuar në aktevitetin paraprak nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur detyrën 1. Veçojnë numrat çift nga numrat tek, duke lidhur numrin me shportën.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe detyrën 2. Njëri plotëson katrorët me numrat çift, nxënësi tjetër plotëson katrorët me numrat tek. Shkëmbehen librat me shokun e bankës për të kontrolluar saktësinë e plotësimit të detyrës.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet që në mënyrë të pavarur të rrethojnë numrat çift me ngjyrë të kuqe, numrat tek me ngjyrë të kaltër. Kontrollohet dhe vlerësohet puna e tyre.

**Hapi 5:** Udhëzohen të zgjidhin detyrën 4 në mënyrë të pavarur. Fushat me numrat tek i ngjyrosin me të kuqe, ndërsa fushat me numrat çift me ngjyrë të gjelbër. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në aktivitete dhe veçimin e saktë të numrave tek nga numrat çift. Po ashtu ata vlerësohen edhe për dallimin dhe ngjyrosjen e saktë të fushave me numra çift dhe tek.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 160

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.1; 3.4; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Demonstron mbledhjen në trakën numerike;
- Gjen shumën e numrave duke plotësuar dhjetë;
- Zgjidh problemat e thjeshta matematikore.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shiriti numerik.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendoset shiriti numerik në dysheme. Ftohet një nxënës të qëndrojë mbi numrin 0. Kërcen dy hapa para. –Te cili numër arrite? (4); – Cili veprim është kur ecim para? Një nxënës tjetër e shkruan barazimin në tabelë: 0 + 2 = 2. Kërkohet të kërcejë edhe dy hapa të tjerë. – Te cili numër arrite? (6); – Si mund ta paraqesim si barazim? Ftohet një nxënës ta shkruajë në tabelë barazimin: 2 + 2 = 4. Nxënësit nxiten t'i gjejnë të gjitha barazimet duke kërcyer nga dy hapa para deri te numri 20. Barazimet shkruhen në tabelë: 4 + 2 = 6, 6 + 2= 8, 8 + 2 = 10, 10 + 2 = 12, 12 + 2 = 14, 14 + 2 = 16, 16 + 2 = 18, 18 + 2 = 20

**Hapi 2:** Duke u bazuar në aktivitetin e zhvilluar, nxënësit në mënyrë të pavarur e plotësojnë detyrën 1 në libër.
Vihet në pah se gjatë kërcimit në shiritin numerik fituam numrat çift: 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20.




Ftohet një nxënës t'i renditë në tabelën magnetike.

**Hapi 3:** Nxënësit ndihmohen me pyetje për të plotësuar detyrën 2. Pyeten: -Cilët janë mbledhorët? (8 + 4); – Edhe sa duhet t'i shtojmë numrit 8 që të bëhet 10? (2); -Sa na mbesin te numri 4? (2); - Si u nda numri 4? (2+2). Paraqitet në tabelë me anë te skemës. Plotësohen të gjitha barazimet me pyetje të ngjashme.




**Hapi 4:** U lexohet problema në detyrën 3.

- Diskutohet me nxënës:
- Sa është i zbritshmi? (17);
- Cili është numri më i madh tek i dhjetëshes së parë? (9);
- Sa është ndryshimi? Ngrihet në tabelë një nxënës dhe e zgjidh detyrën.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet të lexojnë problemën në detyrën 4, të gjejnë zgjidhjen dhe të lexojnë përgjigjen. Puna e tyre vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit demonstrojnë mbledhjen në boshtin numerik, gjejnë shumën e saktë të numrave duke plotësuar dhjetën si dhe zgjidhin saktë problemën me fjalë.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 161

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton radhën e numrave rendorë.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimi i numrave rendorë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Tregon numrat rreshtorë për të treguar vendndodhjen e tij ose të një objekti;
- Paraqet një objekt në rresht sipas kërkesës (numrit rreshtor) që i jepet.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të printuara, gjëra që gjenden përreth etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit nxiten të shprehin mendime për pyetjen: Çfarë kuptoni me fjalën rresht:




Përgjigjet e tyre shënohen në tabelë.

**Hapi 2:** Ftohen 20 nxënës të dalin përpara tabelës dhe të numërojnë: 1, 2,…….20. Pyeten ata: I sati me radhë je: i pari, i dyti, i treti, …. i njëzeti? Më pas i fundit del i pari dhe tregon se si janë në radhë.




Përsëritet aktiviteti duke e përzier renditjen.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të vërejnë figurën e detyrës së parë dhe ta përshkruajnë atë. Ndihmohen me pyetjet: Çfarë shihni në figurë? Sa kuaj janë? Çfarë janë duke bërë? Nga cili numër po fillon? Trego, kali i bardhë i sati me radhë është? Po kali para tij? I sati është kali më këmbë të bardha? Pas të pestit cili vjen?
Paraqiten në tabelë numrat rreshtorë deri në 20 dhe u shpjegohen nxënësve emërtimet e tyre (numrave rreshtorë) dhe çfarë paraqesin ata. Lexohen disa herë nga e gjithë klasa. Rëndësi të veçantë i kushtohet drejtshqiptimit të numërorëve rreshtorë.

**Hapi 4:** Nxënësit e zgjidhin detyrën e dytë duke i shënuar numrat e kërkuar në vagonët e trenit. Së pari i shënojnë numrat nga 1 deri në 20, e më pas i ngjyrosin rrathët me ngjyrat e kërkuara. Në detyrën e katërt ata i analizojnë fazat e ndërtimit të njeriut prej bore, duke kërkuar që të arsyetojnë radhën e menduar.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të shkruajnë numrat rreshtorë nga 1 deri në 6 në fletët e printuara. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të numrave rreshtorë për të treguar vendndodhjen e tij ose të një objekti.

**Detyrë:**
Të shkruhen me radhë emrat e anëtarëve të familjes sipas moshës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 162

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.2,7; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5; 6.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:**
Paraardhësi dhe pasardhësi i një numri

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përdor termat paraardhës dhe pasardhës;
- Cakton pozicionin e numrave në detyrë duke përdorur fjalët paraardhës dhe pasardhës;
- Shkruan numrat sipas kërkesave të detyrave.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa, gjëra që gjenden përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Ftohen 20 nxënës para klasës dhe u shpërndahen etiketa me numra nga 1 deri në 20, ashtu që secili nxënës të ketë nga një etiketë me numër. Kërkohet që nxënësit të renditen sipas numrave që kanë. Ftohet të bëjë një hap para të tjerëve nxënësi që mban numrin 6, më pas nxënësi që mban numrin 5 dhe nxënësi që mban numrin numrin 7. Nxiten nxënësit të thonë: "Numri 7 është pasardhës i numrit 6"; "Numri 5 është paraardhës i numrit 6". Aktiviteti vazhdon edhe me numra të tjerë.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të tregojnë paraardhësin dhe pasardhësin e numrave me ngjyrë. Kërkohet të formulojnë fjalinë e plotë: *"Paraardhës i numrit 5 është numri 4. Pasardhës i numrit 5, është numri 6"*. Vazhdon bashkëbisedimi me nxënës, njëkohësisht plotësohet detyra në libër.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet t'i plotësojnë detyrat 6 dhe 7 individualisht, më pas t`i krahasojnë ato me shokun/shoqen e bankës.




**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen t'i zgjidhin detyrat 8 dhe 9 duke i shoqëruar numrat me paraardhësin dhe pasardhësin e tyre. Puna e nxë-nësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**Hapi 5:** Vizatohet në tabelë boshti numerik deri te numri 20. Ftohen nxënësit të dalin me sy mbyllur të prekin një numër, e më pas të tregojnë cili është numri paraardhës dhe pasardhës i tij. Kjo veprimtari vazhdon me të gjithë nxënësit.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e radhitjes së numrave deri në 20; tregimit të numrit paraardhës dhe pasardhës dhe përdorimit të termave paraardhës dhe pasardhës.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 10 në libër dhe të paraqitet në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 163

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Tregon paraardhësin, pasardhësin, qëndron ndërmjet numrave nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.2,7; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.5; 6.4.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Paraardhësi dhe pasardhësi i një numri/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përdor termat paraardhës dhe pasardhës;
- Cakton pozicionin e numrave në detyrë duke përdorur fjalët paraardhës dhe pasardhës;
- Shkruan numrat sipas kërkesave të detyrave.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Etiketa, gjëra që janë përreth.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Përgatiten etiketa me numrat nga 1 deri në 20. Vendosen të përmbysura mbi bankën e mësueses. Ftohen nxënësit të zgjedhin një etiketë dhe të tregojnë numrin, më pas paraardhësin dhe pasardhësin e atij numri. Në tabelë paraqiten duke përdorur shkumësat me ngjyra: numri i zgjedhur- me të kuqe; paraardhësi me të kaltër; pasardhësi – me të gjelbër.
Shembull:




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën e parë duke shkruar parardhësin që mungon. Në detyrën e dytë të shkruajnë pasardhësin që mungon. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen.




**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen të zgjidhin detyrën 3 duke shkruar paraardhësin dhe pasardhësin e tyre. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

**Hapi 4:** Këshillohen nxënësit për mënyrën e zgjidhjes së detyrës 5, ku mblidhen dy kufizat paraprake të vargut, duke filluar nga kufiza e tretë.

1, 2, 3, 5, 8, 13

( 2 + 3 = 5;  3 + 5 = 8;  5 + 8 = 13 )

**Hapi 5:** Vizatohet tabela në dërrasën e zezë. Ftohen nga dy nxënës, njëri të shkruajë paraardhësin e numrit të dhënë, tjetri të shkruajë pasardhësin. Detyra paraqitet edhe në fletore të nxënësit.

| -1 | +1 |
|---|---|
| | 4 |
| | 7 |
| | 11 |
| | 19 |
| | 6 |
| | 12 |
| | 9 |
| | 14 |

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e radhitjes së numrave deri në 20, tregimit të numrit paraardhës dhe pasardhës dhe përdorimit të termave paraardhës dhe pasardhës.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 164

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe kupton të dhënat statistikore (me figura të ndryshme) nga jeta e përditshme;
- Lexon dhe plotëson një tabelë me të dhëna të thjeshta nga mjedisi;
- Organizon mbledhjen e të dhënave e informacioneve dhe përdor informacionet e mbledhura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.8; III.2,6,7; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.2,5; 7.1.


GRUMBULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE
1. GRUMBULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE
Mësojmë
1
Altini dhe Edlira kanë shënuar numrin e autobusëve, kamionëve, automobilave dhe skuterëve, që kanë kaluar në rrugën e tyre brenda një ore. Ata fituan këto të dhëna:
Autobusë Kamionë Automobila Skuterë
Duke ditur se me simbolin shënohet se një e dhënë është paraqitiur 5 herë, marrim këtë tabelë. E quajmë këtë tabelë e të të dhënave.
Autobusë Kamionë Automobila Skuterë
9
Autobusë Kamionë Automobila Skuterë
Nga tabela lexojmë se brenda një ore kanë kaluar:
___ autobusë.
___ kamionë.
___ automobila.
___ skuterë.
Nëse për çdo paraqitje të ndonjë automjeti, ngjyrosim një fushë tek ai, merret ky diagram të cilin e quajmë diagram i të dhënave.
91

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Grumbullimi dhe paraqitja e të dhënave

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Grumbullon ose klasifikon në grup gjërat, apo figurat në bazë të një cilësie të përbashkët;
- Plotëson diagramin dhe grafikun;
- Diskuton rezultatet e të dhënave të grafikut.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kubi numerik, fletë të printuara, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë; Edukatë fizike; Sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Paraqitet para nxënësve një kub, ku në të gjashtë faqet e tij ka pika nga 1 deri në 6 (në formë të zarit). Ftohet një nxënës të dalë para të tjerëve dhe ta rrotullojë kubin në dysheme disa herë. Ndërkohë nxënësve të tjerë në klasë u shperndahen fletë ku janë pergatitur tabelat:


a)


b)


Mësojmë

2 Alberti dhe gjyshi luajnë me zare dhe shkruajnë se sa herë është paraqitur secili numër. Pasi zari është hedhur 45 herë, ata kanë fituar këto të dhëna:

ose

9

*Vërejmë se*: gjatë lojës më së shumti është paraqitur numri ___ dhe më së paku numri ___.

Nëse për çdo paraqitje të numrit, ngjyrosim një fushë tek ai numër, merret kjo paraqitje e të dhënave në diagram me shtylla:

42

Nxënësit udhëzohen që ta përcjellin me kujdes kubin që bie në dysheme dhe të mbajnë shënim si p.sh.: Kubi bie te numri dy, nxënësit shënojnë një vijë në kolonën ku i kanë dy pika. Kubi bie te numri gjashtë, nxënësit shënojnë një vijë në kolonën ku i kanë gjashtë pika. Kur nxënësi që e gjuan kubin e ndërpret lojën, nxënësit udhëzohen t'i numërojnë vijat që i kanë në secilën kolonë dhe ta bartin atë shënim me numër, në tabelën tjetër, p.sh.: nëse në kolonën me katër pika kanë tri vija në tabelë, atëherë e shkruajnë numrin 3 në tabelën b), në kolonën me katër pika. Pasi nxënësit plotësojnë me shënime tabelat e tyre, ata i krahasojnë ato me njëri-tjetrin.
U tregohet nxënësve se kjo detyrë e tregon grumbullimin dhe paraqitjen e të dhënave.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen t'i vëzhgojnë figurat e librit në detyrën 1. Duke i lexuar së bashku të dhënat e shënuara, ta plotësojnë tabelën. Më pas tregohet se të dhënat mund t`i paraqesim edhe duke e ngjyrosur diagramin e paraqitur.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të punojnë në dyshe për ta plotësuar detyrën 2.

**Hapi 4:** Kërkohet ta zgjidhin individualisht detyrën 3. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit të sendeve sipas një cilësie të përbashkët; shënojnë numrin e gjërave në tabela për të dhënat; plotësojnë diagramin e të dhënave.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër dhe të paraqitet në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 165

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Lexon dhe kupton të dhënat statistikore (me figura të ndryshme) nga jeta e përditshme;
- Lexon dhe plotëson një tabelë me të dhëna të thjeshta nga mjedisi;
- Organizon mbledhjen e të dhënave e informacioneve dhe përdor informacionet e mbledhura.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.8; III.2,6,7; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1; 3.2,5; 7.1.


Ushtrojmë

PUNA ME TË DHËNA

1

Roberti dhe Ana vendosën t'i analizojnë të dhënat lidhur me llojin e atleteve që i pëlqejnë nxënësit e klasës së tyre.

Të dhënat e fituara ata i paraqitën në këtë formë:

Roberti

| Nike | Adidas | Reebok | Fila | Jordan |
|---|---|---|---|---|

Ana

| Nike | Adidas | Reebok | Fila | Jordan |
|---|---|---|---|---|

Nga të dhënat e mësipërme plotësojmë tabelën:

| Lloji i atleteve | Nike | Adidas | Reebok | Fila | Jordan |
|---|---|---|---|---|---|
| Numri i nxënësve | | | | | |

Plotësojmë fjalitë:

Numri më i madh i nxënësve pëlqejnë atletet _____.

Numri më i vogël i nxënësve pëlqejnë atletet _____.

94

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Puna me të dhëna/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Grumbullon ose klasifikon në grup gjërat, apo figurat në bazë të një cilësie të përbashkët;
- Plotëson diagramin dhe grafikun;
- Diskuton rezultatet e të dhënave të grafikut.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Lapsat me ngjyra (ngjyrat e drurit), fletë të printuara, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë; Edukatë fizike, Sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet në grup të vendosin mbi bankë 7 ngjyrat e drurit që i posedojnë ata: e kuqe, e verdhë, portokalli, vjollcë, e gjelbër, e kaltër dhe e zezë. Udhëzohen t'i grupojnë lapsat e ngjyrosjes sipas ngjyrave. Pas grumbullimit, kërkohet nga nxënësit t'i numërojnë lapsat e ngjyrave, të mbajnë shënim në tabelën e të dhënave, si dhe ta bëjnë ngjyrosjen e diagramit, në fletët e printuara nga mësuesi/ja.








Grupet e paraqesin punën para të tjerëve.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vazhdojnë ta punojnë në grupe detyrën 1. Së pari të lexojnë me vëmendje, e më pas t'i bëjnë plotësimet e nevojshme, duke e bërë edhe analizën e të dhënave.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet ta punojnë në dyshe detyrën e dytë, duke e plotësuar tabelën, e më pas edhe duke e ngjyrosur diagramin.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen që individualisht ta plotësojnë detyrën e tretë. T'i analizojnë të dhënat në detyrë, më pas ta ndërtojnë tabelën dhe grafikun në shtylla. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet. Nxënësit që kanë vështirësi, u ndihmohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e klasifikimit të sendeve sipas një cilësie të përbashkët, shënimin e numrit të sendeve në tabela për të dhënat dhe plotësimit të diagramit të të dhënave.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 166

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen në problema me fjalë (në situata reale).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** III.2; III.4; III.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 1.3; 3.6; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Mbledh dhe zbret saktë numrat deri në 20;
- Plotëson saktë katrorët me numra ashtu që shuma në çdo rresht dhe shtyllë të jetë 18;
- Zgjidh problema me fjalë duke zbatuar mbledhjen me plotësim të 10.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Libër.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:**
Gjuha amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit njoftohen rreth temës së orës mësimore, vlerësimit të tyre me anë të detyrave, si dhe punës në mënyrë individuale dhe të pavarur.

**Hapi 2:** Lexohen detyrat duke ua sqaruar kërkesat.
Në detyrën 1 do të shkruajnë të gjithë numrat që ndodhen ndërmjet numrave 11 dhe 16.
Në detyrën 2 kanë një problem me fjalë, për zgjidhjen e të cilit duhet të plotësojnë barazimin dhe ta njehsojnë shumën.
Në detyrën 3 udhëzohen ta zbulojnë rregullën dhe të plotësojnë vargun numerik. *Ndihmohen me pyetjen:* -Për sa është numri 3 më i madh se 5? –Po numri 7 se 5?
Për detyrën 4 ndihmohen me pyetje: -Cilën lloj të mbledhjes duhet përdorur? Pse? U tërhiqet vëmendja




të kenë kujdes në ndarjen e saktë të numrit 7.
Në detyrën 5 duhet gjetur dy mbledhorë, duke i bashkuar numrat, që të japin shumën 20. Punohet sipas shembullit të dhënë në detyrë.
Detyra 6 është e një shkalle vështirësie më të lartë. Duhet të plotësojnë katrorët, ashtu që, shuma e numrave në çdo rresht dhe shtyllë të jetë 20. Pyeten: -Ç'mendoni, cili katror duhet të plotësohet së pari, në rresht apo shtyllë?
Në detyrën 7 kanë mbledhje të numrave deri në 20 si dhe zbritje të numrave nga 20. U tërhiqet vëmendja që të përcjellin me kujdes kahjen e shigjetave.
Në detyrën 8 kanë për të mbledhur 5 numra. Nxënësit fillojnë të punojnë të pavarur në zgjidhjen e detyrave.

**Hapi 3:** Mblidhen librat për t'u kontrolluar e vlerësuar. Sqarohen vështirësitë që kanë hasur gjatë zgjidhjes së detyrave.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit mbledhin dhe zbresin saktë numrat deri në 20; plotësojnë saktë katrorët me numra, ashtu që shuma në çdo rresht e shtyllë të jetë 20. Po ashtu zgjidhin problema me fjalë duke zbatuar saktë mbledhjen me plotësim të 10-shes.

**Detyrë:**

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 167

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përkufizon ekuacionet (barazimet) dhe inekuacionet (jobarazimet) lineare me një të panjohur, si dhe zgjidhjet përkatëse të tyre.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.3; 3.5; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij




**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Shpjegon kuptimin e së panjohurës X në një barazim;
- Gjen zgjidhjen e barazimit, numrin e panjohur në detyrë;
- Përdor provën për të vërtetuar saktësinë e zgjidhjes së barazimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fishe fjalësh, karamele (bombone).

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve në grupe u shpërndahen disa fishe me fjalë, ku mungon shkronja X.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| __i__ëllonja | __i__a | N__ënës | Le __on | Gu___im |

Nxënësit nxiten të gjejnë shkronjën që mungon. –Cila është shkronja që mungon (e panjohur)? Shqiptohet tingulli i saj dhe lexohen fjalët e plotësuara.

**Hapi 2:** Para nxënësve paraqitet një pjatë me karamele. Pyeten: - Dini sa është numri i karameleve në pjatë? Nxënësit njoftohen se numri i panjohur shënohet me shkronjën X dhe lexohet "iks". Zbulohet numri i karameleve dhe shënohet se X=20. Çdo nxënësi i shpërndahet nga një karamele.



Mësojmë

BARAZIMI, JOBARAZIMI DHE ZGJIDHJA

1. KUPTIMI I BARAZIMIT DHE ZGJIDHJES SË TIJ

**1**

Fjolla ftoi në ditëlindjen e saj 16 shokët dhe shoqet e klasës. Gjatë shërbimit, ajo vendosi t'ua bëjë një befasi atyre. Ajo solli dy pjata me ëmbëlsira, njërën të mbuluar dhe të dytën të hapur, në të cilën ishin 3 ëmbëlsira. Më pastaj ajo pyeti: *Sa ëmbëlsira janë në pjatën e mbuluar?*

Pasi ajo bëri një sqarim se në dy pjatat ka aq ëmbëlsira sa ka shokë dhe shoqe në ditëlindje, njëri nga shokët shkroi në një letër kështu:

numri (i panjohur) i ëmbëlsirave në pjatën e mbuluar — numri i ëmbëlsirave në pjatën e hapur

X + 3 = 16

barazim

Për të gjetur vlerën e numrit të panjohur X, përkujtojmë lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes:

*Secili nga dy mbledhorët mund të shkruhet si ndryshim i shumës dhe mbledhorit tjetër.*

a + b = c → a = c – b ; b = c – a

X + 3 = 16
X = 16 – 3
X = 13

Prova: X + 3 = 16
13 + 3 = 16 e saktë

Pra, numri i ëmbëlsirave në pjatën e mbuluar është X = 13.

Gjithashtu, mund të themi edhe se, X = 13 është zgjidhje e barazimit X + 3 = 16.

Duke analizuar provën e bërë, vërejmë se shkronjat paraqesin vendin ku duhet të vendoset një numër i caktuar ose si thuhet vendndodhje e numrit.

Një numër thuhet se është zgjidhje e një barazimi nëse, kur ai vendoset në vendin e shkronjës, merret një barazi e saktë.

**2**

Duke zbatuar lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes, përcaktojmë numrin e panjohur.

12, X, 5

X + 5 = 12
X = 12 – 5
X = 7

17, 9, X

9 + X = 17

48

**Hapi 3:** Lexohet detyra 1 nga një nxënës. Analizohet me anë të pyetjeve: -A dihet numri i ëmbëlsirave në pjatën e mbuluar?
-Me çfarë shënohet numri i panjohur? –Sa ëmbëlsira janë në pjatën e hapur?- Sa shokë e shoqe ishin gjithsej në ditëlindje?
Shënohet në tabelë çdo përgjigje e nxënësve dhe fitohet shprehja: X + 3 = 16.
Pyeten: Në këtë barazim, cili është mbledhori i parë? –Cili është mbledhori i dytë? –Cila është shuma?-Ç'mendoni, si gjendet mbledhori i panjohur?
Nëse nuk japin përgjigjen e saktë, u përkujtohet lidhja mes mbledhjes dhe zbritjes. Shkruhet në tabelë:

a + b = c → a = c - b ; b = c - a

U sqarohet skema e dhënë se për të gjetur mbledhorin e panjohur duhet nga shuma të zbritet mbledhori i njohur. Ana e majtë e barazimit duhet të barazohet me anën e djathtë të tij.
Zgjidhet barazimi në tabelë dhe njoftohen me provën: X + 3 = 16 Prova: X + 3 = 16
X = 16 – 3 13 + 3 = 16
X =13 16 = 16

U sqarohet që: Numri 13 paraqet zgjidhjen e barazimit, sepse kur vendoset në vend të shkronjës fitohet një barazim i saktë.

**Hapi 4:** Shkruhet në tabelë: 18, X, 5. Nxënësit udhëzohen të punojnë në dyshe për formimin e barazimit, zgjidhjes dhe vërtetimit me anë të provës. Një çift ftohet ta zgjidhë barazimin në tabelë duke shpjeguar zgjidhjen.

**Hapi 5:** Nxënësit zgjidhin individualisht detyrën 2. Saktësia e tyre kontrollohet e vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit shpjegojnë saktë kuptimin e së panjohurës X në barazim; gjejnë saktë zgjidhjen e barazimit, numrit të panjohur dhe përdorin provën për të vërtetuar saktësinë e zgjidhjes.

**Detyrë:**
Krijoni një barazim me të panjohur, zgjidh dhe vërteton saktësinë me anë të provës.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 168

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Të gjejmë numrin e panjohur

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Identifikon mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur;
- Zgjidh problema me fjalë duke përdorur numrat nga 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.1;3.1; 3.5; 3.6; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të gjejmë numrin e panjohur/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton numrin e panjohur duke zbatuar lidhjen mes mbledhjes dhe zbritjes;
- Analizon barazimet me të panjohur dhe zgjidhjet e tyre;
- Gjen numrin e panjohur në detyra me fjalë, nga jeta.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Mjete pune, shkopinj, fasule, petëza, ngjyra druri.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit ftohen që të punojnë në dyshe me shokun/shoqen e bankës. Ata do të përdorin mjetet me të cilat do të punojnë: ngjyra druri, shkopinj, petëza ose fasule. Nxënësi i parë i nxjerr 12 shkopinj, i dyti i merr disa shkopinj pa e treguar numrin. Nxënësi i parë numëron sa shkopinj kanë mbetur. Ata shkruajnë barazimin, duke përdorur numrin e panjohur dhe e zgjidhin. Ndërrohen rolet e nxënësve. Ftohen 2 dyshe ta paraqesin detyrën para klasës, në tabelë.

**Hapi 2:** Nxënësit individualisht zgjidhin detyrën 1 në libër. Pas zgjidhjes lexohet dhe analizohet me pyetje: -Çka kanë të përbashkët këto 2 barazime? –Ku ndryshojnë? –Çfarë kemi të panjohur te barazimi




1? –Po te barazimi 2, çështë e panjohur? –Si e gjetët zgjidhjen e tij?

**Hapi 3:** Lexohet detyra 2 nga një nxënës. Komentohet çdo element i barazimit si dhe zgjidhja e tij nga nxënësit. Plotësohet zgjidhja e barazimit, zbritësit të panjohur në libër.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen që të punojnë individualisht në zgjidhjen e barazimeve, në detyrën 3. Pas plotësimit, këto barazime mund të zgjidhen edhe në tabelë nga nxënësit, duke i komentuar. Në fund, i krahasojnë të tria barazimet, duke përcaktuar se çfarë paraqet numri i panjohur në çdo barazim.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën 4, ta shkruajnë si barazim me të panjohur dhe ta zgjidhin individualisht. Punohet në mënyrë të pavarur. Puna e tyre vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit përcaktojnë saktë numrin e panjohur duke e zbatuar lidhjen mes mbledhjes dhe zbritjes si dhe analizojnë barazimet dhe zgjidhjet e tyre; gjejnë saktë numrin e panjohur në detyra me fjalë.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 169

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet lineare.

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Identifikon mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra nga 1 deri në 20).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.3; III.4, V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.3;3.1; 3.4; 3.6; 5.1.


Ushtrojmë

6 Shkronjën X e zëvendësojmë me numër.

7 + 9 = 16 | □ + 12 = 20 | 12 – □ = 6
7 + x = 16 | x + 12 = 20 | 12 – x = 6
x = 9 | x = | x = □

7 Duke ditur njërin mbledhor, gjejmë mbledhorin tjetër.

7 + x = 11 Prova: 7 + ___ = 11
x = 11 – 7
x= ___

x + 13 = 20 Prova: ___ + 13 = 20
x = ___ – ___
x= ___

11 + x = 18 Prova: __ + __ = ___
x = ___ – ___
x = ___

x + 12 = 19 Prova: __ + __ = ___
x = ___ – ___
x = ___

13 / 7 X
___ + ___ = 13
x = ___ – ___
x = ___
Prova: ___ + ___ = 13

18 / X 6
___ + ___ = 18
x = ___ – ___
x = ___
Prova: ___ + ___ = 18

8 Duke njehsuar, plotësojmë tabelat.

| X | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
|---|---|---|---|---|---|
| X + 6 | 11 | | | | |

| X | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
|---|---|---|---|---|---|
| X – 6 | 9 | | | | |

100

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të gjejmë numrin e panjohur/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Zëvendëson shkronjën X me numër në barazim;
- Njehson mbledhorin e panjohur në barazime;
- Zbaton provën për të vërtetuar saktësinë e zgjidhjes së barazimit.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Kutia me shkumësa.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuha amtare (shqipe).

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



**Hapi 1:** Para nxënësve paraqiten dy kutia me shkumësa. Në kutinë e parë janë 12 shkumësa, kurse në të dytën nuk dihet sa janë. Në të dyja kutitë gjithsej janë 20 shkumësa. Sa shkumësa ka në kutinë e dytë? Nxënësve u kërkohet ta shtrojnë detyrën si barazim. Pyeten:–Me çfarë shënohet numri i panjohur? Pasi ta zgjidhin individualisht, njëri nxënës ftohet ta shkruajë e ta zgjidhë në tabelë. Bëhet edhe prova.

12 + X = 20 Prova: 12 + 8 = 20
X = 20 – 12 20 = 20
X = 8

-Sa shkumësa ka në kutinë e dytë?

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen që ta lexojnë detyrën 6 dhe ta zgjidhin individualisht. Pas zëvendësimit të shkronjës X me një numër në barazimet e detyrës 6, ata përgjigjen në pyetje: -Çfarë paraqet numri i pa-



Ushtrojmë

**6** Shkronjën X e zëvendësojmë me numër.

7 + 9 = 16
7 + x = 16
x = 9

□ + 12 = 20
x + 12 = 20
x =

12 − □ = 6
12 − x = 6
x = □

**7** Duke ditur njërin mbledhor, gjejmë mbledhorin tjetër.

7 + x = 11 Prova: 7 + __ = 11
x = 11 − 7
x= __

x + 13 = 20 Prova: __ + 13 = 20
x = __ − __
x= __

11 + x = 18 Prova: __ + __ = __
x = __ − __
x = __

x + 12 = 19 Prova: __ + __ = __
x = __ − __
x = __

13 / 7 X
__ + __ = 13
x = __ − __
x = __
Prova: __ + __ = 13

18 / X 6
__ + __ = 18
x = __ − __
x = __
Prova: __ + __ = 18

**8** Duke njehsuar, plotësojmë tabelat.

| X | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
|---|---|---|---|---|---|
| X + 6 | 11 | | | | |

| X | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
|---|---|---|---|---|---|
| X − 6 | 9 | | | | |

100

njohur në barazimin e dytë? –Me cilin numër u zëvendësua? –Pse? –Po çfarë tregon numri i panjohur në barazimin e fundit? –Cili është ai? –Pse?

**Hapi 3:** Nxënësit do të punojnë në çifte në detyrën 7. Njëri do ta zgjidhë barazimin e parë, tjetri do ta zgjidhë barazimin e dytë. Më pas i shkëmbejnë librat mes vete.
Thirren dy-tre çifte para tabelës për t'i zgjidhur e analizuar barazimet. Ata tregojnë se çfarë paraqet numri i panjohur në çdo barazim.

**Hapi 4:** Nxënësit e plotësojnë njërën nga tabelat e detyrës 8. Ata do të punojnë individualisht e të pavarur. Saktësia e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit zëvendësojnë saktë të panjohurën X me numrin e duhur në barazim; njehsojnë saktë mbledhorin e panjohur, si dhe zbatojnë provën për të vërtetuar saktësinë e zgjidhjes së barazimit.

**Detyrë:**
Duke njehsuar plotësoni tabelën e paplotësuar të detyrës 8 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 170

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet lineare.

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Zgjidh problema të thjeshta nga jeta duke shfrytëzuar ekuacionet dhe inekuacionet.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.2; III.4; III.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 2.2; 3.1; 3.5; 3.6; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Paraqet me anë të barazimit problemin me fjalë;
- Zgjidh problemet me fjalë nga jeta e përditshme;
- Gjen mbledhorin e panjohur duke bërë edhe provën.


DETYRA PËR PËRSËRITJE

Përsërisim

1 Në një kafaz të përbashkët, Altini dhe Rinori kanë 17 pëllumba. Nëse 9 pëllumba janë të Altinit, sa pëllumba ka Rinori?

Është e njohur se:
Altini i ka ___ pëllumba.
Rinori i ka x pëllumba
Së bashku kanë ___ pëllumba.

___ + ___ = ___
x = ___ − ___
x = ___
Pra, Rinori i ka ___ pëllumba.

2 Blerta lexoi 9 faqe të një libri dhe i mbetën për t'i lexuar edhe 11 faqe. Sa faqe ka libri?

Është e njohur se:
Libri ka x faqe.
Blerta ka lexuar ___ faqe.
Kanë mbetur pa i lexuar___ faqe.

x − □ = □
x = □ + □
x = □.
Pra, libri ka ___ faqe.

3 Nëse një numër rritet për numrin 12, fitohet numri 20. Cili është ai numër?

20
x
12

x + 12 = 20
x = ___ − ___
x = ___
Pra, numri i kërkuar është ____.

4 Shkronjën X e zëvendësojmë me numër:

7 + 6 = 13
7 + x = 13
x = 6

□ + 11 = 19
x + 11 = 19
x = □

12 − □ = 5
12 − x = 5
x = □

5 Të gjejmë mbledhorin e panjohur:

12 + x = 17
x = ___ − ___
x = ___
Prova: ___ + ___ = ___

x + 9 = 17
x = ___ − ___
x = ___
Prova: ___ + ___ = ___

101

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fishe me fjali, shkopinj, fasule.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Vendosen në tabelë, në mënyrë të çregullt fishe me fjali. Nxënësit i rendisin sipas kuptimit logjik duke formuar një problemë me fjalë:
*- Në një kullosë ishin duke kullotur 4 dele. Më vonë erdhën edhe disa dele dhe gjithsej u bënë 12. Sa dele erdhën në kullosa?*
Nxënësit e lexojnë, e paraqesin me anë të barazimit dhe e zgjidhin në fletore:

4 + X = 12
X = 12 − 4
X = 8

Ftohet një nxënës vullnetar që ta paraqesë barazimin dhe zgjidhjen e tij në tabelë.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen ta lexojnë problemin me fjalë në detyrën 1. Analizohet me gjithë klasën, duke shkruar në tabelë se çfarë është e njohur, çfarë dimë dhe çfarë kërkohet të gjejmë. Nxënësit e



DETYRA PËR PËRSËRITJE

Përsërisim

**1** Në një kafaz të përbashkët, Altini dhe Rinori kanë 17 pëllumba. Nëse 9 pëllumba janë të Altinit, sa pëllumba ka Rinori?

Është e njohur se:
Altini i ka ___ pëllumba.
Rinori i ka x pëllumba
Së bashku kanë ___ pëllumba.

___ + ___ = ___
x = ___ − ___
x = ___
Pra, Rinori i ka ___ pëllumba.

**2** Blerta lexoi 9 faqe të një libri dhe i mbetën për t'i lexuar edhe 11 faqe. Sa faqe ka libri?

Është e njohur se:
Libri ka x faqe.
Blerta ka lexuar ___ faqe.
Kanë mbetur pa i lexuar___ faqe.

x − ☐ = ☐
x = ☐ + ☐
x = ☐.
Pra, libri ka ___ faqe.

**3** Nëse një numër rritet për numrin 12, fitohet numri 20. Cili është ai numër?

20, x, 12

x + 12 = 20
x = ___ − ___
x = ___
Pra, numri i kërkuar është ____.

**4** Shkronjën X e zëvendësojmë me numër:

7 + 6 = 13 | ☐ + 11 = 19 | 12 − ☐ = 5
7 + x = 13 | x + 11 = 19 | 12 − x = 5
x = 6 | x = ☐ | x = ☐

**5** Të gjejmë mbledhorin e panjohur:

12 + x = 17
x = ___ − ___
x = ___
Prova: ___ + ___ = ___

x + 9 = 17
x = ___ − ___
x = ___
Prova: ___ + ___ = ___

101

**Hapi 3:** Nxënësit e lexojnë problemin në detyrën 2. Pyeten se çfarë dinë. E shkruajnë të pavarur barazimin dhe e zgjidhin në libër. Në fund, tregojnë se sa faqe i ka libri.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në çifte me shkopinj ose fasule. *-Nëse një numër rritet për 5, fitohet numri 12. Cili është ai numër?* Njëri nxënës vendos mbi bankë 5 shkopinj. Tjetri e paraqet me anë të barazimit dhe e zgjidhin. Në fund i shtojnë shkopinj aq sa tregon zgjidhja e barazimit. Një çift e komenton zgjidhjen para klasës. Në mënyrë të ngjashme zgjidhet detyra 3, në mënyrë individuale e të pavarur.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen që në mënyrë individuale e të pavarur të punojnë detyrat 4 dhe 5. Në detyrën 5 duhet ta bëjnë provën. Pas përfundimit krahasohen dy barazimet e detyrës 5. Ata tregojnë se çfarë kanë të përbashkët dhe ku dallojnë mes vete këto dy barazime.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit paraqesin saktë me anë të barazimit problemin me fjalë si dhe e zgjidhin atë. Po ashtu ata e gjejnë mbledhorin e panjohur duke ia bërë provën.

**Detyrë:**

Krijoni një detyrë me fjalë me të panjohur dhe e zgjidh atë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 171

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet lineare.

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike;
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2; 2.1, 3. 1,4, 5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon barazimin nga jobarazimi;
- Gjen numrat që janë zgjidhje e jobarazimit.
- Zgjidh detyrat e dhëna

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela, kuti vezësh, mjete shkollore, etiketa me numra etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Shkruhen në tabelë shprehjet: 5 + 3 = 8 5 + 2 < 8 5 + 4 > 8 Kërkohet nga nxënësit t'i gjejnë dallimet mes këtyre dy shprehjeve numerike. Pyeten nxënësit: A janë të gjitha barazime? (Jo.) Cila nga këto shprehje numerike është barazim? (E para.) Pse? (Sepse e ka shenjën e barazimit dhe 5 + 3 = 8) U tregohet nxënësve se shembulli i dytë dhe i tretë nuk janë barazime, sepse nuk e kanë shenjën "=". Njoftohen nxënësit se këto janë jobarazime dhe e kanë shenjën ose më e madhe ">" ose më e vogël "<".

**Hapi 2:** Merret në klasë një kuti vezësh. Kutia ka 10 vende për vezë. Mbushen 6 vende me mjete shkollore: lapsa, goma, mprehëse. Shkruhet në tabelë 6 + _ < 10 dhe numrat 2, 3, 4. Ftohen 3 nxënës me




mjete pune në dorë. Njëri ka 2 mjete në dorë, i dyti ka 3, dhe i treti ka 4 mjete në dorë. Kërkohet nga nxënësit të provojnë ta mbushin kutinë. Udhëzohet nxënësi 1 t'i vendosë 2 sendet në kuti.
Pyetet: A është e vërtetë që 6 + 2 < 1O? (Po.) Pse? (Sepse 6 + 2 = 8 dhe në kuti ka edhe 2 vende.) Përsëritet me disa nxënës aktiviteti në mënyrë që t'i kuptojnë mirë jobarazimet.
U tregohet nxënësve se jobarazimi për dallim nga barazimi ka më shumë se një zgjidhje.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të lexohet jobarazimi i shkruar në tabelë si në detyrën 1. X + 2 < 9. Ngjiten në tabelë etiketa me numrat prej 0 deri ne 12. Udhëzohen nxënësit që ta zëvendësojnë shenjën X me numrat me radhë dhe të vërejnë se a është i vërtetë jobarazimi. Thirret një nxënës ta marrë etiketën zero dhe ta vendosë mbi X, pastaj e lexon shprehjen: 0 + 2 < 9 sepse 0 + 2 = 2. U tregohet që numri 0 është zgjidhje e këtij jobarazimi. Sipas shembullit të parë nxënësit vazhdojnë t'i plotësojnë shembujt e tjerë dhe t'i shkruajnë në tabelë.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen ta lexojnë detyrën 2, t'i rrethojnë numrat që e vërtetojnë jobarazimin.

**Hapi 5:** Jepen sqarimet e nevojshme për zgjidhjen e detyrës 3 dhe ndihmohen nxënësit t'i zgjidhin në çifte. Përdorin pyetjet që janë përdorur te pyetjet paraprake. Nxënësit pastaj e ndërrojnë librin me shokun e bankës dhe e kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

**Hapi 6:** Nxënësit udhëzohen ta punojnë detyrën 4 në mënyrë individuale. Ngjyrosin me ngjyrë të kuqe numrat, të cilët kur vendosen në vend të shkronjës X, formojnë jobarazi të saktë. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete; Për krahasimin e barazimeve nga jobarazimi, si dhe gjetjen e numrave që janë zgjidhje e jobarazimit.

**Detyrë:**
Të punohen në fletore dy detyra me jobarazime, të ngjashme me detyrën 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 172

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike;
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 2; 2.1, 3. 1,4, 5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Kuptimi i barazimit dhe zgjidhjes së tij

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon barazimin nga jobarazimi;
- Gjen numrat që janë zgjidhje e jobarazimit.
- Zgjidh detyrat e dhëna.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela, shporta, topa të vegjël, etiketa me numra etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Merren dy shporta. Në njërën shportë vendosim topa të vegjël. Në topa janë shkruar numrat nga 1 deri në 9. Pra secili top përmban një numër. Shkruajmë në tabelë shprehjen 8 + X < 15. Marrim topin me numër 0 dhe e vendosim mbi X. Pyesim nxënësit 8 + 0 < 15 a është i saktë jobarazimi nëse në vend të X vendosim numrin 0? (Po.) Atëherë topin me numrin 0 e vendosim në shportën tjetër. Vazhdojmë kështu me të gjithë topat që janë në shportën e parë. Topat që na japin jobarazime të sakta, i vendosim në shportën e dytë. Shkruhen numrat në tabelë.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen ta punojnë detyrën 5 në libër. Nxënësit punojnë duke u bazuar në shem-




bullin paraprak me shporta dhe topa. Veçojnë numrat nga shporta e parë të cilët mund t'i vendosin në vend të shkronjës X, për të fituar jobarazi të saktë. Këta numra pastaj i vendosin në shportën e dytë. Shkruajnë në anën e djathtë *e saktë* kur zgjidhja e jobarazimit është e saktë.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të plotësohet detyra 6 në libër. Edhe te kjo detyrë ndiqen hapat paraprakë, duke i marrë nga shporta e parë, te shporta e dytë numrat që japin jobarazi të saktë. Nxënësit tregojnë me fjalë se si i dallojnë barazimet nga jobarazimet.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen ta punojnë detyrën 7 ku do t'i ngjyrosin me ngjyrë të kuqe numrat të cilët kur vendosen në vend të shkronjës X, formojnë jobarazi të saktë. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet në çifte të formojnë shprehje shkronjore me jobarazime. Nxënësit pastaj zgjidhin jobarazimet dhe shkruajnë në një bashkësi të veçantë numrat që japin jobarazime të sakta. Njëri nxënës prezanton pastaj para të tjerëve detyrën që ka formuar me shokun ose shoqen.

**AKTIVITET SHTESË**

Kthehen nxënësit në grupe dhe u shpërndahet nga një fletë ku janë vizatuar dy shporta. Në shportën e parë vendosen etiketa me këta numra: 11, 12, 13, 14, 15, 8, 9, 16, 10, 18, 17, ndërsa shporta e dytë është e zbrazët. Shkruajnë jobarazimin X - 8 < 6, kërkohet t'i gjejnë zgjidhjet dhe etiketat me numrat që vërtetojnë jobarazimin, i bartin në shportën e zbrazët.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për dallimin e barazimeve nga jobarazimi, si dhe gjetjen e numrave që janë zgjidhje e jobarazimit.

**Detyrë:**

Në fletore, të punohen dy detyra me jobarazime të ngjashme me detyrën 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 173

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike;
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II. 2; III.1, 2, 4 .

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1, 3. 1,4, 5; 4.2; 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Të gjejmë numrat e panjohur/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon barazimin nga jobarazimi;
- Gjen numrat që janë zgjidhje e jobarazimit;
- Zgjidh detyrat e dhëna.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela, etiketa me numra, fletë pune të printuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bëhet një përsëritje duke krahasuar barazimin dhe jobarazimin. Shkruhen në tabelë disa shprehje, p.sh.: 3+1 ___ 5 3+2___5 3+4____5. Më parë janë përgatitur tri etiketa me shenjat >, <, = të cilat vendosen në tabelë. Thirret ndonjë nxënës që në katrorët e zbrazët të vendosin njërën prej etiketave me shenja >, <, =. Nxënësit plotësojnë katrorët me shenja përkatëse dhe i lexojnë ato:
3 + 1 < 5 3 + 2 = 5 3 + 4 > 5

Pyeten nxënësit: A janë të gjitha barazime? (Jo.) Cila nga këto shprehje numerike është barazim? (E dyta,) U përsëritet nxënësve që shembulli i parë dhe i tretë nuk janë barazime sepse nuk e kanë shenjën "=". Këto janë jobarazime dhe e kanë shenjën ose me e madhe ">" ose me e vogel "<".




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet ta lexojnë jobarazimin e shkruar në tabelë si në detyrën 1. X + 4 < 11. Ngjiten në tabelë etiketa me numrat prej 0 deri në 16. Udhëzohen nxënësit, që ta zëvendësojnë shenjën X, me numrat me radhë dhe të vërejnë se a është i vërtetë jobarazimi. Vjen një nxënës e merr etiketën zero, vendos mbi X, dhe e lexon shprehjen: 0+4<1 1 sepse 0+4 =4.
U tregohet nxënësve që numri 0 është zgjidhje e jobarazimit. Shkruhen numrat në tabelë dhe fletore.

**Hapi 3:** Sqarohet detyra 2 dhe udhëzohen nxënësit t'i bëjnë plotësimet sipas kërkesave të librit. Më pas nxënësit do të lexojnë zgjidhjet dhe të diskutojnë për to.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet ta zgjidhin individualisht detyrën 3 ku do të ngjyrosin me ngjyrë të kuqe numrat, të cilët kur vendosen në vend të shkronjës X, formojnë jobarazi të saktë. Pastaj nxënësit e krahasojnë detyrën e vet me atë të shokut ose shoqes së bankës.

**Hapi 5:** U shpërndahet nxënësve fleta e punës (të cilën mund ta merrni këtu). Kërkohet nga ta, të punojnë në mënyrë të pavarur.
U sqarohet nxënësve që katrorët me numrat që na japin zgjidhje të saktë të jobarazimit, duhet të ngjyrosen me ngjyrë të kuqe.
Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.



## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për krahasimin e barazimeve nga jobarazimi, si dhe gjetjen e numrave që janë zgjidhje e jobarazimit.

**Detyrë:**
Të punohet në shtëpi detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 174

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Ekuacionet dhe inekuacionet

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përkufizon shprehjet shkronjore dhe i dallon ato nga shprehjet numerike;
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II. 2, 7; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1, 3. 1,4, 5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Edhe matematika është zbavitje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kupton të panjohurën;
- Gjen vlerën e së panjohurës;
- Zgjidh detyrat e dhëna.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela, etiketa me numra, fletë pune të printuara.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Bashkë me nxënës krijohen disa situata problemore me të panjohurën X dhe diskutojmë me nxënës, p.sh.: Narti mendoi një numër, nëse numrit që mendoi Narti i shtojmë 5, bëhet 13. Cilin numër mendoi Narti? X + 5 = 13
Nëna gatoi disa biskota. Ajo u dha fëmijëve 6 biskota dhe i mbetën vetëm 12 biskota. Sa biskota morën fëmijët? X – 6 = 12 Paraqiten detyrat në tabelë dhe gjendet vlera e X.

**Hapi 2:** Bëjmë një lojë me nxënës: Unë e mendova një numër, ia shtova numrin 6, u bë numri 10. Cilin numër kam menduar? Shkruhet shprehja në tabelë, gjendet vlera e X. Vazhdohet kjo lojë me disa nxënës. Numrat paraqiten në tabelë dhe nxënësit dalin e gjejnë numrin e panjohur duke e zgjidhur




detyrën.

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të punojnë në çifte. Nxënësi 1, nxjerr 1O ngjyra. Nxënësi 2 merr disa ngjyra dhe nuk i tregon shokut sa i ka. Nxënësi 1 numëron sa ngjyra i kanë mbetur. Shkruajnë barazimin duke e përdorur numrin e panjohur, gjejnë zgjidhjen e tij. Ndihmohen nxënësit gjatë punës. Herën e dytë ndërrohen rolet e nxënësve. Disa çifte paraqesin detyrën para të tjerëve.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen t'i punojnë detyrat në libër. Bëjnë zgjidhjen e detyrës duke e gjetur numrin e panjohur, pastaj i bashkojnë kafshët me ushqimin e preferuar. Numri i së panjohurës X te kafsha, dhe numri te ushqimi i preferuar del i njëjtë. Nxënësit i bashkojnë me vijë ose shigjetë këta numra.

**Hapi 5:** Pasi të përfundohen të gjitha detyrat në libër. Nxënësit e ndërrojnë librin me shokun ose shoqen e bankës, i kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit dhe i përmirësojnë gabimet nëse ka.



**Hapi 6:** Nxënësve u shpërndahen fletë të punës me të panjohurën X (të cilën mund ta merrni këtu). Kërkohet nga ta të punojnë në mënyrë të pavarur. U sqarohet nxënësve ecuria e punës për të ardhur deri te zgjidhja. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur.
Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për kuptimin e së panjohurës dhe gjetjen e vlerës të së panjohurës.

**Detyrë:**
Të punohen në shtëpi 4 detyra të ngjashme me ato në klasë.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 175

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryhen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0).

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II. 2, 7; III.1, 2, 4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.2; 2.1; 3. 1,4, 5; 4.2; 5.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kryen veprime me mbledhje dhe zbritje;
- Gjen vlerën e së panjohurës;
- Zgjidh detyrat e dhëna.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Tabela, lapsa me ngjyra, petëza me figura gjeometrike, numëratore etj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Ndahen nxënësit në grupe dhe u shpërndahen petëza me figura gjeometrike dhe një fletë e bardhë A4. Kërkohet nga nxënësit t'i përsërisin njohuritë e fituara më herët për figurat gjeometrike. Emërtojnë figurat së bashku në grup dhe me ato petëza punojnë sipas imagjinatës së tyre: tren, ndërtesë, shtëpi, robot etj. Pastaj kërkohet nga nxënësit t'i numërojnë figurat gjeometrike sa ka nga secili lloj. I shkruajnë poshtë fletës. Grupet prezantojnë punën e tyre para nxënësve dhe mësueses.

**Hapi 2:** Paraqiten dy numra në tabelë, p.sh.: 6 dhe 16. Pyeten nxënësit cilët janë numrat më të mëdhenj se 6 dhe më të vegjël se 16. Pra numrat që gjenden në mes të këtyre dy numrave. Shkruajmë pastaj ata numra në tabelë pasi t'i marrim përgjigjet e nxënësve.
*6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16.* Punojnë pastaj detyrën e parë në libër duke i gjetur numrat ndërmjet 12 dhe 18.


Vlerësojmë

VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

1 T'i shkruajmë të gjithë numrat, që janë më të mëdhenj se 12 dhe më të vegjël se 18.
Numrat e kërkuar janë: ___, ___, ___, ___, ___.

2 Numri 19 është numër njëshifror: Po Jo
Numri 8 është dyshifror: Po Jo

3 Plotësojmë:
19 20 15

4 Plotësojmë:
17 < ☐ ☐ > 19 ☐ > 13 ☐ = ☐

5 Besniku e mendoi një numër. Numrin e menduar rrite për 8 dhe fito numrin 17. Cilin numër e mendoi ai?
Pra, Besniku e mendoi numrin ____.

6 Njehsojmë dhe plotësojmë.
14 + 6 = ☐ 20 – 7 = ☐ ☐ + 6 = 14 5 + ☐ = 19

7 Numërojmë figurat e formës së njëjtë dhe ngjyrosim fushat në tabelë.
10 9 8 7 6 5 4 3 2 1

106

**Hapi 3:** Luhet një lojë me nxënës: Unë e mendova një numër, ia zbrita numrin 5, u bë numri 10. Cilin numër kam menduar? Shkruhet shprehja në tabelë, gjendet vlera e x-it. Vazhdohet kjo lojë me disa nxënës. Numrat paraqiten në tabelë dhe nxënësit dalin e gjejnë numrin e panjohur duke e zgjidhur detyrën.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen t'i punojnë detyrat 2 dhe 3 në libër. Në detyrën 3 nxënësit dallojnë cili numër është njëshifror dhe cili është dyshifror. Ndërsa në detyrën 3 plotësojnë katrorët duke shkruar numrat nga numri 20 deri te numri 1, pra nga numri më i madh deri te numri më i vogël.

**Hapi 5:** Nxënësve u kërkohet ta punojnë detyrën 4 duke shkruar një numër pas shenjës që gjendet aty. Ndërsa në detyrën 5 nxënësit e punojnë detyrën me fjalë dhe kërkohet nga ta të formojnë nga dy detyra me fjalë në fletore, të ngjashme me atë në libër. Gjejnë pastaj vlerën e së panjohurës.

**Hapi 6:** Detyrën 6 nxënësit e punojnë në mënyrë të pavarur. Kryejnë mbledhjen dhe zbritjen e numrave. Nxënësit e argumentojnë me fjalë mënyrën e zgjidhjes së detyrës, pastaj përmendin kufizat e mbledhjes dhe zbritjes. Për ta lehtësuar mbledhjen dhe zbritjen, nxënësit përdorin numëratore ose lapsa me ngjyra. Puna e nxënësve vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim dhe aktivitete, për mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri 20, krahasimin e numrave dhe gjetjen e vlerës të së panjohurës.

**Detyrë:**
Të punohet në shtëpi detyra 7 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 176

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë me shembuj nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,7; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.1,4; 4.2, 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Gjysma

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan format në dy pjesë të barabarta;
- Emërton gjysmën e një sasie;
- Gjen gjysmën e numrave çift.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Drejtkëndësha, katrorë, rrathë prej letre për çdo nxënës, fletëza të përgatitura.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen drejtkëndësha dhe rrathë prej letre, të përgatitura më parë. Diskutohet me ta: - Ndani dejtkëndëshin në dy pjesë të barabarta. -A puthiten pjesët? - A janë të barabarta? Si quhet secila pjesë e ndarë në mënyrë të barabartë? (gjysma). Udhëzohen të marrin një rreth –Ndani rrethin në dy pjesë të barabarta duke e palosur. –Ngjyrosni gjysmën e rrethit dhe drejtkëndëshit.




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurën në detyrën 1. Pyeten: - Sa bukë po shihni në foto? - Në sa pjesë të barabarta është ndarë buka? - Si quhet secila pjesë e bukës? Nxënësit emërtojnë njërën nga dy pjesët e barabarta - GJYSMA Nëse bashkojmë dy gjysma çfarë fitojmë? (një bukë).


GJYSMA DHE ÇEREKU

1. GJYSMA

Mësojmë

1

Njëra nga dy pjesët e barabarta GJYSMA

Njëra nga dy pjesët e barabarta GJYSMA

2

8 mollë

4 mollë paraqesin gjysmën e 8 mollëve.

4 mollë paraqesin gjysmën e 8 mollëve.

Gjysma e 8 mollëve është 4 mollë, sepse 4 + 4 = 8.

3

Përcaktojmë dhe ngjyrosim gjysmën e drejtkëndëshave:

8 6 4 8 10 2

4 4

4

— gjysma nga 20 figurat

— gjysma nga 20 figurat

Gjysma e numrit 20 është numri 10, sepse

10 + 10 = 20.

5

Nga 6 + 6 = 12, rrjedh se gjysma e numrit 12 është numri 6.

Nga 8 + 8 = ___, rrjedh se gjysma e numrit ___ është numri ___.

Nga 10 + 10 = ___, rrjedh se gjysma e numrit ___ është numri ___.

107

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet të tregojnë sa është numri i mollëve në detyrën 2 dhe sa është gjysma e tyre. *Gjysma e 8 mollëve është 4 mollë. Pse? (Sepse 4 + 4=8).*

**Hapi 4:** Udhëzohen të përcaktojnë dhe ngjyrosin gjysmën e drejtkëndëshave në detyrën 3. Ata i shkëmbejnë librat dhe e krahasojnë punën me njëri-tjetrin.

**Hapi 5:** Shpërndahen disa fletë të përgatitura si më poshtë. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë gjysmën e numrave çift. Vlerësohet puna e tyre.


Gjysma e numrit 8 = ☐


Gjysma e numrit 10 = ☐


Gjysma e numrit 14 = ☐


Gjysma e numrit 18 = ☐

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e ndarjes së formave në pjesë të barabarta, emërtimit të gjysmës së një tërësie dhe gjetjen e gjysmës së numrit çift.

**Detyrë:**

Të punohet detyra 5 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 177

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë me shembuj nga jeta e përditshme.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.2,7; III.1,2,4; V.5.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2;2.1;3.1,4; 4.2, 5.1.

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Çereku

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Ndan format në katër pjesë të barabarta;
- Emërton çerekun e një sasie;
- Gjen çerekun e numrave çift.




**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Rrathë dhe katrorë prej letre, plastelina, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u tregohet një biskotë prej plasteline. Ndahet në dy pjesë të barabarta. Bisedohet: Kjo është gjysma e biskotës. - Sa gjysma ka biskota? (2); Ndahet edhe një herë. Prej katër pjesëve të ndara veçohet një pjesë e biskotës. – Ky është çereku i biskotës. –Sa çerekë ka biskota? (Katër)
Nxënësve u shpërndahen rrathë dhe katrorë prej letre. Kërkohet t'i ndajnë në katër pjesë të barabarta, me anë të dy palosjeve dhe ta ngjyrosin çerekun e tyre.



**Hapi 2:** Analizohet figura e detyrës 1 duke i pyetur nxënësit. - Në sa pjesë të barabarta është ndarë keku?




(4); - Si quhet njëra pjesë e kekut? (Çereku); – Çfarë paraqet çereku? (Çereku paraqet gjysmën e gjysmës); - Sa çerekë përbëjnë një gjysmë? (2 çerekë përbëjnë një gjysmë); - Një tërësi sa çerekë e përbëjnë? (4 çerekë përbëjnë një tërësi).

**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet t'i numërojnë dardhat. Pyeten:
-Sa dardha janë në figurë? (12); – Cilën pjesë të dardhave paraqesin 6 dardha? (Gjysmën); –Po çerekun, sa dardha e paraqesin? (Tri dardha). Nxënësit e plotësojnë detyrën 2.

**Hapi 4:** Udhëzohen të punojnë në dyshe. Përcaktojnë dhe ngjyrosin çerekun e drejtkëndëshave në detyrën 3. Vërehet se çe-reku i numrave 8, 4, 12 dhe 16 është 2, 1, 3 dhe 4. Nxënësit i shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin duke kontrolluar punën e tyre.

**Hapi 5:** Kërkohet të vizatojnë në fletore katrorë dhe rrathë, t'i ndajnë në pjesë të barabarta dhe të ngjyrosin çerekun e figurave. Vlerësohet puna e tyre.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e ndarjes së formave në katër pjesë të barabarta, emërtimit të çerekut të një sasie dhe gjetjen e çerekut të numrave çift.

**Detyrë:**
Të punohet detyra 4 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 178

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Njësitë matëse

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde (pëllëmba e dorës, hapsi etj);
- Krahason me sy gjatësitë e dy ose më shumë sendeve;
- Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,4, III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 1.2, 2.1 3.1, 3.4.


MATJA E GJATËSISË

1. MATJA E GJATËSISË

Mësojmë

1

Për matjen e gjatësisë së dërrasës, lartësisë së lisit, gjerësisë së rrugës, thellësisë së pishinës etj., shfrytëzojmë një shkop ose shirit të gjatësisë së njëjtë, të cilin e quajmë **metër**.

Fjalën metër e zëvendësojmë me shkronjën ***m***,
**1** *metër* **= 1** *m*.

2

3

Njësitë më të vogla për matjen e gjatësisë.

1 centimetër

1 cm 1 cm

1 cm

4

T'i matim gjatësitë e lapsave. Në anën e djathtë vizatojmë lapsat, duke i renditur ata sipas madhësisë.

5 □ □ □ □ □ □ < □ < □ < □ < □ <

109

## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Matja e gjatësisë

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon metrin si njësi e gjatësisë;
- Krahason gjatësitë e objekteve të ndryshme;
- Kryen matje me njësi jostandarde dhe standarde.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirita letre me gjatësi të ndryshme, vizore, ngjyra, lloje të ndyshme të metrit.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u shpërndahen disa shirita letre me ngjyra, me tri gjatësi të ndryshme. Kërkohet të formojnë bashkësi me shirita që janë me gjatësi të njëjtë. Pyeten: -Sa bashkësi formuat? (3); –Cila është vetia e përbashkët e elementeve të bashkësisë?; - Cila bashkësi ka më shumë elemente? Nxënësit udhëzohen të marrin nga një shirit prej çdo bashkësie dhe t'i krahasojnë me sy. - Cili shirit është më i gjatë? - Cili më i shkurtër? - Cili po aq? Renditni shiritat sipas madhësisë, nga më i vogli te më i madhi.
**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet të nxjerrin mbi bankë lapsat dhe të masin me gomë gjatësinë e tij.


MATJA E GJATËSISË

1. MATJA E GJATËSISË

Mësojmë

1

Për matjen e gjatësisë së dërrasës, lartësisë së lisit, gjerësisë së rrugës, thellësisë së pishinës etj., shfrytëzojmë një shkop ose shirit të gjatësisë së njëjtë, të cilin e quajmë **metër**.

Fjalën metër e zëvendësojmë me shkronjën ***m***,
**1** *metër* = **1** *m*.

2

3

Njësitë më të vogla për matjen e gjatësisë.

1 centimetër

1 cm

1 cm

1 cm

4

T'i matim gjatësitë e lapsave. Në anën e djathtë vizatojmë lapsat, duke i renditur ata sipas madhësisë.

5

<

<

<

<

109

Pyeten: - Sa është gjatësia e lapsit? - Cila është njësia matëse? (Goma); Nëse nuk përputhet plotësisht, nxiten nxënësit të thonë: "Afërsisht …gomë i gjatë". Krahasojnë gjatësinë e lapsave me shokun/shoqen e bankës.

**Hapi 3:** Ftohen dy nxënës të bëjnë matjen e librit me pëllëmbë. Të dhënat e fituara shkruhen në tabelë dhe lexohen. Bisedohet me nxënësit pse rezultati nuk është i njëjtë.
Pastaj libri matet me vizore dhe vërehet se gjatësia nuk ndryshon kur e përdorim vizoren.

**Hapi 4:** Lexohen të dhënat në detyrën 1, si quhet njësia për matjen e gjatësisë dhe si e shkruajmë 1 metër = 1 m.

**Hapi 5:** Nxënësit njoftohen me llojet e metrit. Udhëzohen të nxjerrin vizoret dhe të vërejnë si është e shkallëzuar. Largësia prej një numri në numrin tjetër paraqet një centimetër, e cila shënohet me cm- njësi më e vogël për matjen e gjatësisë. Shkruhet në tabelë dhe lexohet nga nxënësit.
Demonstrohet në tabelë matja e një segmenti me vizore, duke theksuar se duhet filluar nga zeroja e vizores. Nxënësit bëjnë matjen e fletoreve dhe të ngjyrave me vizore dhe tregojnë me zë të dhënat e fituara.

**Hapi 6:** Nxënësve u kërkohet të matin dhe të krahasojnë gjatësitë e lapsave në detyrë 4. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit krahasojnë saktë gjatësitë e objekteve; kryejnë matje të sakta me njësi jostandarde dhe standarde; identifikojnë metrin si njësi për matjen e gjatësisë dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivitete.

**Detyrë:**

Mat gjatësinë e tavolinës në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 179

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Njësitë matëse

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde (pëllëmba e dorës, hapsi etj);
- Krahason me sy gjatësitë e dy ose më shumë sendeve;
- Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,4, III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 1.2, 2.1 3.1, 3.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Matja e gjatësisë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon metrin si njësi e gjatësisë dhe pjesët e tij cm, dm;
- Krahason gjatësitë e objekteve të ndryshme;
- Kryen matje me njësi jostandarde dhe stadarde.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Shirita letre me gjatësi 1 dm, vizore, ngjyra, lloje të ndyshme të metrit, kube, shkopinj.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Shpërndahen shirita letre me gjatësi 10 cm. Kërkohet nga nxënësit të bëjnë matjen e shiritit dhe të tregojnë se sa është gjatësia e tij. Në tabelë ngjitet një shirit i letrës me gjatësi 1 m.
Ftohen nxënësit të vendosin shiritat poshtë metrit derisa të barazohen. Pyeten: - Për të plotësuar metrin sa shirita nevojiten? Sqarohet se shiriti me gjatësi 10 cm është decimetri. Një metër ka 10 decimetra. Shkruhen në tabelë njësitë më të vogla për matjen e gjatësisë, pjesët e metrit:

| | | |
|---|---|---|
| 1 *m* = 10 *dm* | *m* – *dm* – *cm* | 1 *dm* = 10 *cm* |




**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen të vizatojnë me vizore dy segmente me gjatësi 8 cm dhe 12 cm. Kërkohet të fillojnë prej pikës zero të vizores së shkallëzuar. Shkëmbehen librat me shokun/shoqen e bankës dhe kontrollojnë punën e njëri-tjetrit.

**Hapi 3:** Nxënësit bëjnë matjen e gjatësisë së tavolinës dhe lartësinë e derës, duke e paraqitur në m-dm-cm. Në fund lexohen zgjidhjet me zë dhe bëhen korrigjimet e nevojshme.

**Hapi 4:** Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë me kujdes figurën në detyrën 4. E masin me vizore dhe i përcaktojnë gjatësitë e shkopinjve. Pyeten:
- Cili shkop ka gjatësinë më të madhe?
- Cili shkop ka gjatësinë më të vogël?
- Sa më të vogël?

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen ta vizatojnë shuplakën e dorës në fletore. Kërkohet të matin gjatësinë dhe gjerësinë e shuplakës së dorës duke përdorur njësi të ndryshme: kube, shkopinj dhe vizore. Nxënësit mbajnë shënime në fletore dhe në fund i krahasojnë të dhënat me shokun e bankës. Vlerësohet saktësia e matjeve.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit krahasojnë saktë gjatësitë e objekteve; kryejnë matje të sakta me njësi jostandarde dhe standarde; identifikojnë metrin dhe pjesët e tij si njësi për matjen e gjatësisë dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në akivitete.

**Detyrë:**

Matni gjatësinë e dy lodrave në shtëpi.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 180

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Njësitë matëse

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde (pëllëmba e dorës, hapsi etj);
- Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,4, III.1,2,4.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1, 1.2, 2.1 3.1, 3.4.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Matja e gjatësisë/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Identifikon metrin si njësi e gjatësisë dhe pjesët e tij cm, dm;
- Kryen matje me njësi jostandarde;
- Vizaton segmente me gjatësi të ndryshme.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Vizore, ngjyra.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shakthtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Shkruhet në tabelë "Matja e gjatësisë". Bisedohet me nxënësit:
- Me çfarë mund të masim gjatësinë e një objekti?
- Cila është njësia për matjen e gjatësisë? Si shkruhet?
- Cilat janë njësitë më të vogla për matjen e gjatësisë?

**Hapi 2:** Ftohen dy nxënës të masin me hapa gjatësinë e klasës. Pyeten: - Sa hapa është afërsisht gjatësia e klasës? Krahasohen të dhënat e dy nxënësve. Të dhënat do të ndryshojnë sepse hapat e nxënësve nuk janë të njëjtë.


Ushtrojmë

5

Ta matim, duke marrë si njësi matëse, gjatësinë e lapsit.

Druri është i gjatë sa _____ lapsa.

Druri është i gjatë afërsisht sa _____ lapsa.

Druri është i gjatë afërsisht sa _____ lapsa.

6

Mund të përdorim më tepër se një njësi matjeje për gjatësi. Kështu:

Druri është i gjatë afërsisht sa _____ lapsa të gjelbër.

Druri është i gjatë afërsisht sa _____ lapsa të verdhë.

7

Të vizatojmë segmente me gjatësitë e dhëna:

6 *cm*

4 *cm*

9 *cm*

7 *cm*

11 *cm*

111

**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit të vështrojnë detyrën 1. Pyeten:

- Cila është njësia matëse për matjen e drurit? (Lapsi);
- Sa lapsa është i gjatë druri i parë? Nxënësit bëjnë matjen e drurit dhe plotësojnë detyrën. Krahasohen të dhënat e fituara.

**Hapi 4:** Nxënësit udhëzohen të bëjnë matjen e gjatësisë së drurit me dy njësi matjeje (lapsa të gjelbër dhe të verdhë), në detyrën 6. Pas plotësimit lexohen zgjidhjet.

**Hapi 5:** Kërkohet nga nxënësit të zgjidhin individualisht detyrën 7. Vizatojnë segmente me gjatësi 6 cm, 4 cm, 9 cm, 7 cm dhe 9 cm. Puna e tyre kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive; kryejnë matje me njësi jostandarde; identifikojnë metrin dhe pjesët e tij si njësi për matjen e gjatësisë dhe vizatojnë saktë segmente me gjatësi të ndryshme.

**Detyrë:**

Vizatoni në fletore segmente me gjatësi 8, 10 dhe 12 cm.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 181

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Njësitë matëse

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq;
- Përdor njësi matëse standarde si: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.2,6,7; VI.2

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.2,3,5; 8.1;




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Kryen matje me njësi standarde (cm);
- Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq;

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Lapsa, shishet e ujit, vizore, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen ta bëjnë matjen e gjatësisë së shisheve të ujit të tyre, më pas ta krahasojnë me shokun ose shoqen e bankës. Më pas nga kutia e lapsave, ta gjejnë lapsin më të shkurtër dhe më të gjatë, dhe ta bëjnë matjen e tyre. Më pas të gjejnë se për sa është më i gjatë lapsi i gjatë se lapsi më i shkurtë, dhe për sa është më i shkurtë lapsi i shkurtër se lapsi i gjatë. Kërkohet të bëjnë matje të saktë, si dhe t'i formulojnë fjalitë mirë kur tregohet për krahasimin e gjatësive të lapsave.

**Hapi 2:** Nxënësit udhëzohen ta plotësojnë detyrën e parë. Kërkohet nga nxënësit t'i bëjnë matjet e kërkuara, duke e përdorur vizoren. Kontrollohen nxënësit që kanë vështirësi duke i udhëzuar për përdorim të drejtë të vizores dhe njësisë matëse centimetrit (cm).




**Hapi 3:** Nxënësve u kërkohet që duke i vështruar segmentet e detyrës 2, si dhe sendet e detyrës 3, t'i krahasojnë objektet sipas gjatësisë duke i përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtë, po aq. Më pas me anë të matjeve me vizore ta përcaktojnë gjatësinë e tyre, si dhe të verifikojnë si përkojnë me përgjigjet e mëparshme (krahasimi me hamendje).

**Hapi 4:** Kërkohet nga nxënësit ta punojnë në dyshe detyrën 4, duke i kryer matjet dhe më pas duke llogaritur se cila rrugë është më e shkurtër.

**Hapi 5:** Nxënësit udhëzohen që individualisht ta plotësojnë detyrën e pestë. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet. Nxënësit që kanë vështirësi, ndihmohen.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e matjes me njësi standarde (cm), krahasojnë objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq.

**Detyrë:**

Të plotësohet detyra 6 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 182

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Zgjidh problema me fjalë me numra nga 1 deri në 20;
- Cakton vlerën e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të shkronjave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1; III.2,5,7.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1,2; 3.1,3,5; 6.4; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Vlerësojmë të kuptuarit

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Lexon kërkesat e ushtrimeve saktë;
- Plotëson kërkesat për vlerësimin e njohurive brenda orës mesimore;
- Zgjidh saktë detyrat nga vlerësimi për njohuritë.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Fletë të printuara, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Rikujtohet se çfarë është vlerësimi i njohurive, cili është qëllimi dhe rëndësia e tij. Përsëriten rregullat e sjelljes gjatë detyrës me shkrim dhe punës individuale.

**Hapi 2:** Ndahen nxënësit në grupe A dhe B. Shpërndahen librat: "Matematika - ushtrime kontrolluese". Paraqitet vlerësimi për njohuritë në ekran dhe jepen këshilla të qarta për çdo ushtrim. Nxiten nxënësit t'i lexojnë vetë kërkesat. Këshillohen ngadalë dhe saktë çdo etapë e ushtrimit duke i udhëzuar nxënësit.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen ta punojnë individualisht. Puna e nxënësve vëzhgohet duke kaluar bankë




më bankë dhe duke i udhëzuar, sidomos ata që shfaqin vështirësi.

**Hapi 4:** Mblidhen fletët, nxiten nxënësit të diskutojnë për vështirësitë dhe problemet që kanë pasur. Mbahen shënime, të cilat merren parasysh në orët në vijim.

**Hapi 5:** Nxënësve që punojnë më shpejt, u shpërndahen fletë të printuara (fig.1). Figurat (format gjeometrike) janë si vendmbajtëse të numrave, ku duke i zëvendësuar ato me numrat përkatës, llogarisin vlerën e shprehjes.




Fig.2



Fig.1

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e leximit të kërkesave të ushtrimeve, plotësojnë kërkesat për vlerësim të njohurive brenda orës mësimore; zgjidhin detyrat për vlerësim të njohurive.

**Detyrë:**

Të plotësohet fleta e printuar (fig. 2) e cila është shpërndarë nga mësuesja.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 183

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Njësitë matëse

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Krahason drejtpërdrejt objekte sipas gjatësisë duke i përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtë, po aq;
- Përdor njësi matëse standarde si: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.2,6,7; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.2,3,5; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Zbatimi i matjeve në problema

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Dallon njësitë matëse: m, dm, cm, mm;
- Kryen matje me njësi jostandarde dhe standarde;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen e njësive matëse.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Metri (m), decimetri (dm), vizorja, fletë të printuara, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë; Edukatë fizike; Sportet dhe shëndeti.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësve u kërkohet të tregojnë me duar sa i bie të jetë afërsisht gjatësia prej 1 metre (1m ~ sa hapja e duarve të nxënësve). Më pas të tregojnë sa është afërsisht gjatësia e një decimetri (1 dm ~ sa hapja e një pëllëmbe të nxënësve). Një centimetër ( 1cm ~ sa trashësia e një gishti), dhe në fund të tregojnë sa është një milimetër ( 1mm ~ gati të bashkohen dy gishtërinjtë). Prezantohet metri dhe bëhet krahasimi me hapjen e duarve të nxënësve, pastaj decimetri krahasohet me pëllëmbën e duarve, centimetri me trashësinë gishtit, dhe në fund milimetri, tregohen vijat e shpeshta të vizores së nxënësve.

**Hapi 2:** Nxiten nxënësit t'u japin përgjigje pyetjeve: Çfarë kuptoni ju me fjalën matje? Çfarë përdorim




për të matur? Për t'i matur sendet e mëdha, cilën njësi përdorim? E më të voglat? Paraqiten në ekran disa figura, dhe pyeten nxënësit me cilën njësi maten: si makinë (m), lulja (cm), gjilpëra (mm), etj. Sqarohen një nga një të gjitha figurat, sendet e vogla i masim me njësi matëse më të vogël, ndërsa më të mëdhatë me njësi matëse më të madhe. Udhëzohen nxënësit ta punojnë detyrën e dytë në libër duke i treguar njësitë matëse të secilës figurë. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen ta plotësojnë në dyshe detyrën e tretë duke dhënë sqarime se nëse bashkohen bankat duhet të mblidhen njësitë matëse. Nëse pritet materiali i pëlhurës, ne shpenzojmë dhe duhet të zbresim.

**Hapi 4:** Duke u bazuar në figurën e vizores, kërkohet nga nxënësit ta plotësojnë detyrën e katërt, e cila është paraqitur edhe në tabelë. Ftohen disa nxënës që së bashku me mësuesen të plotësojnë barazimet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të njësive matëse: m, dm, cm, mm, kryejnë matje me njësi standarde dhe jostandarde, zbatojnë mbledhjen dhe zbritjen e njësive matëse.

**Detyrë:**

Të maten 3 sende në shtëpi, duke i viztuar ato në fletore dhe duke e treguar gjatësinë e tyre.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 184

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Identifikon mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur nga numri 1 deri në 20.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.1,3; II.2,8; III.2,4,7; VI.6.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.2,3,5; 4.2.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Detyra për përsëritje

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Emërton kufizat e mbledhjes dhe të zbritjes;
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave;
- Përdor fjalorin matematikor.

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** kompleti matematikor (shufra dhe kube), gjëra që rrethojnë

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe. U shpërndahen shufra dhe kube nga kompleti matematikor. Kërkohet nga ata të formojnë numra (p.sh., numrin 15). Më pas nxënësit tregojnë si e formuan (1 shufër dhe 5 kube). Barazimi shkruhet në tabelë: 15 = 10 + 5. Përsëritet veprimtaria me disa numra, duke formuar me shufra dhe kube, si dhe duke paraqitur në tabelë barazimet.

**Hapi 2:** Paraqitet në tabelë barazimi: 15 - 8 = ☐



Përsërisim

DETYRA PËR PËRSËRITJE

**4** Njehsojmë dhe plotësojmë.

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| +3 | 5 | 2 | 4 | 6 | 3 | 7 | 1 | −3 | 8 | 5 | 9 | 6 | 10 | 4 | 7 |
| | 8 | | | | | | | | 5 | | | | | | |
| +3 | 15 | 12 | 14 | 16 | 13 | 17 | 11 | −3 | 18 | 15 | 19 | 16 | 20 | 14 | 17 |
| | 18 | | | | | | | | 15 | | | | | | |
| +4 | 6 | 1 | 3 | 5 | 2 | 4 | 0 | −4 | 10 | 8 | 6 | 9 | 5 | 7 | 4 |
| | | | | | | | | | | | | | | | |
| +4 | 16 | 11 | 13 | 15 | 12 | 14 | 10 | −4 | 20 | 18 | 16 | 19 | 15 | 17 | 14 |
| | | | | | | | | | | | | | | | |

**5** Njehsojmë shumën dhe ndryshimin:

| + | 5 | 8 | 9 |
|---|---|---|---|
| 7 | | | |
| 5 | | | |
| 9 | | | 18 |

| − | 5 | 8 | 9 |
|---|---|---|---|
| 13 | | | |
| 17 | | | |
| 19 | | | 10 |

| + | 9 | 3 | 6 |
|---|---|---|---|
| 6 | | | |
| 7 | | | |
| 8 | | | |

| − | 4 | 7 | 9 |
|---|---|---|---|
| 11 | | | |
| 18 | | | |
| 14 | | | |

**6**

| 17 | 11 | 9 | 6 |
|---|---|---|---|
| 9 + | 7 + | 13 − | 11 − |
| 8 + | 5 + | 15 − | 16 − |
| 7 + | 3 + | 18 − | 13 − |
| 6 + | 2 + | 17 − | 15 − |

116

Parashtrohen pyetjet: Cili veprim duhet kryer për të gjetur zgjidhjen? (të zbritjes)
Si mund të gjendet ndryshimi në mënyrë më të lehtë? (nxënësit bëjnë zgjidhje të ndryshme). Pranohen të gjitha mënyrat e zgjidhjeve.
Më pas orientohen me pyetje: Sa duhet zbritur nga numri 15 që të mbetet 10?(5) Ku e morët numrin 5? ( nga zbritësi 8) Si u nda numri 8? (në 5 dhe 3). Plotësohet në tabelë:

**15 – 8 = □**
**15 – 5 = 10**
**10 – 3 = 7**

Vazhdohet zgjidhja e barazimeve të tjera të detyrës 1, duke ndihmuar nxënësit me pyetjet si më lartë. Ndërkohë nxënësit plotësojnë detyrën në libër.

**Hapi 3:** Kërkohet nga nxënësit të lexojnë detyrën dhe të tregojnë zgjidhjen. Nxënësi i parë që jep përgjigje të saktë, sqaron para klasës mënyrën e zgjidhjes së detyrës, si dhe shkruan në tabelë barazimin: **3 + 8 + 11 = 22**

**Hapi 4:** Udhëzohen nxënësit të plotësojnë në dyshe detyrën e tretë, ku njëri nxënës te veprimi i mbledhjes kryen hapin e parë të detyrës, ndërsa tjetri hapin e dytë. Te zbritja ndërrohen rolet.

**Hapi 5:** Kerkohet të zgjidhet individualisht detyra 4. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës së numrave, njehsimit të ndryshimit të numrave dhe përdorimit të fjalorit matematikor.

**Detyrë:**
Të plotësohet detyra 5 dhe 6 në libër.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*

# Mësimi 185

## ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Fusha kurrikulare:** Matematikë
**Lënda:** Matematikë
**Shkalla e kurrikulës:** I **Klasa:** I
**Tema:** Numrat natyrorë

**Rezultatet e të nxënit të temës:**
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë (nga 1 deri në 20 duke përfshirë dhe numrin 0);
- Identifikon mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur nga numri 1 deri në 20;
- Përdor njësi matëse standarde si: m, cm, kg, orë, ditë, javë, muaj, vit dhe të monedhave.

**Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës:** I.3; II.8; III.2,6,7; VI.2.

**Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:** 1.1; 3.2,3,5; 8.1.




## ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

**Njësia mësimore:** Njehsojmë me numrat deri në 20/U

**Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Njehson shumën e numrave;
- Njehson ndryshimin e numrave;
- Përdor fjalorin matematikor;
- Kryen matje me njësi standarde (cm).

**Kriteret e suksesit:** Përcaktohen me nxënësit në klasë.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Birila (shishe plastike), top, vizore, gjëra që rrethojnë.

**Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:** Gjuhë amtare (shqipe); Shkathtësi për jetë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

**Hapi 1:** Renditen 20 birila (ose shishe plastike) para klasës. Ftohen dy nxënës, njëri ta rrotullojë topin për t'i rrëzuar birilat, ndërsa tjetri për ta shënuar barazimin në tabelë, p.sh.:

20 – 7 = 13

Veprimtaria vazhdohet me dy nxënës të tjerë për të rrëzuar birilat e mbetur, në të njëjtën mënyrë ku njëri rrotullon topin, ndërsa tjetri shënon barazimin. Pasi të rrëzohen të gjithë birilat, niset nga fillimi me 20 birila.




**Hapi 2:** Nxënësve u kërkohet ta punojnë detyrën e parë në çifte. Njëri nxënës t'i zgjidhë barazimet me veprimin e mbledhjes, e tjetri me veprimin e zbritjes. Pas plotësimit udhëzohen çiftet ta kontrollojnë bashkë punën e njëri-tjetrit. Njëri çift i lexon zgjidhjet para të tjerëve dhe së bashku bëhen korrigjimet e nevojshme. Më pas udhëzohen nxënësit ta ngjyrosin figurën sipas kërkesave të librit.

**Hapi 3:** Nxënësit udhëzohen ta lexojnë problemën në detyrën e dytë, të kërkojnë informacione të rëndësishme dhe ta kuptojnë atë që kërkohet. Të vizatojnë figura për t'i përfaqësuar numrat në problemë dhe ta zgjidhin problemin.

**Hapi 4:** Kërkohet ta plotësojnë individualisht detyrën e tretë. Udhëzohen që së pari ta kryejnë mbledhjen, apo ndryshimin, e më pas t'i krahasojnë numrat (shumën apo ndryshimin). Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

**Hapi 5:** Udhëzohen nxënësit të vizatojnë në fletore dy segmente: *AB = 7 cm, dhe CD = 5 cm* Më pas ta gjejnë shumën e gjatësive të tyre: *7cm + 5cm = 12 cm*

## Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës dhe ndryshimit të numrave, përdorimin e fjalorit matematikor dhe vizatimit të segmenteve duke përdorur njësitë matëse cm.

**Detyrë:**

Të plotësohet detyra 4 në libër dhe të paraqitet në fletore.

*Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:*